

Kohëzgjatja e proceseve gjyqësore në Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës mbështetur në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut



BE / KiE “Mbështetje për Efikasitetin e Drejtësisë - SEJ”

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented
by the Council of Europe



KOMISIONI EVROPIAN PËR EFIKASITETIN E DREJTËSISË (CEPEJ)

Kohëzgjatja e proceseve gjyqësore në Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës mbështetur në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (31 korrik 2012)

Botimi i dytë

Autor: Zj. Françoise Calvez,
gjyqtare (Francë)
Përditësuar më 26.03.2012 nga Z. Nicolas Régis

Ky raport është miratuar nga CEPEJ
në mbledhjen e 20-të plenare të tij
(Strasbourg)

Botimi në frëngjisht:

Analyses des délais judiciaires dans les Etats membres du Conseil de l'Europe à partir de la jurisprudence de la Cour européenne des Droits de l'Homme

Mendimet e shprehura në këtë punim janë përgjegjësi e autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht politikën zyrtare të Këshillit të Evropës.

Të gjitha kërkesat për të drejtat lidhur me riprodhimin apo përkthimin e të gjithë dokumentit apo një pjese të tij të drejtohen në Sektorin e Informimit të Publikut dhe Botimeve, Drejtoria e Komunikimit (F-67075 Strasbourg Cedex ose publishing@coe.int). Të gjitha komunikimet e tjera lidhur me këtë botim t'i drejtohen CEPEJ-it.

Botimet e Këshillit të Evropës
F-67075 Strasbourg Cedex
<http://book.coe.int>
© Këshilli i Evropës, 2012
Shtypur në Këshillin e Evropës

Përmbledhje e raportit

I. Termat e referencës

Qëllimi i këtij raporti është të shikonte nëse mund të përdorej ose jo jurisprudenca e GJEDNJ-së për të nxjerrë disa përfundime të përgjithshme në lidhje me kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore në Evropë. Këto qenë çështjet që duheshin analizuar:

1. Në çfarë përfundimesh në lidhje me kohëzgjatjen e proceseve për llojet e veçanta të çështjeve gjyqësore (afate minimale/maksimale) do të mund të arrinin nisur nga çështjet gjyqësore në të cilat GJEDNJ ka konstatuar shkelje të së drejtës për gjykim brenda një afati kohor të arsyeshëm ose ka konstatuar se nuk ka pasur shkelje;
2. Cilat kategori të çështjeve janë konstatuar në jurisprudencën e GJEDNJ-së; dhe
3. Cilat janë format e vonesave të konstatuara në jurisprudencën e GJEDNJ-së dhe cilat janë shkaqet e tyre? Si bazë shërben raporti i zonjës Calvez i vitit 2006, i cili është përditësuar në vitin 2011 nga zoti Régis.

II Struktura e raportit

Raporti është i strukturuar në dy pjesë. Në pjesën e parë, **paraqiten kriteret e vlerësimit të justifikimit të kohëzgjatjes së procesit gjyqësor dhe rregullat për llogaritjen e kohëzgjatjes së proceseve** në jurisprudencën e Gjykatës. Në pjesën e dytë, raporti **paraqet fazat e proceseve ku ka pasur vonesa, identifikon shkaqet e vonesave për llojet e ndryshme të proceseve** dhe paraqet një pamje të përgjithshme të **rrugëve ligjore të brendshme për zvogëlimin e kohëzgjatjes së proceseve**. Në shtojcat e raportit jepen **të dhëna statistikore për vlerësimin që GJEDNJ-ja i ka bërë kohëzgjatjes së arsyeshme të çështjeve gjyqësore sipas vendeve (Shtojca I); një analizë e çështjeve gjyqësore me përparësi të identifikuar nga Gjykata (Shtojca II); dhe një tabelë të çështjeve komplekse, së bashku me konstatimet e shkeljeve dhe jo shkeljeve (Shtojca III) dhe çështjeve normale (jo komplekse) (Shtojca IV).**

III. Gjetjet kryesore të raportit

1. Gjykata ka vendosur **kriteret e mëposhtme për të vlerësuar nëse kohëzgjatja e një procesi gjyqësor ka qenë e arsyeshme ose jo:**

- *Kompleksiteti i çështjes* (çështjet komplekse duan një kohë më të gjatë që të përfundojnë, por kompleksiteti në vetvete jo gjithmonë mjafton për ta justifikuar kohëzgjatjen e procesit);
- *Sjellja e paditësit* (ky është i vetmi kriter që ka bërë që Gjykata të arrijë në përfundimin se neni 6 nuk ishte shkelur edhe pse kohëzgjatja e procesit dukej qartë që qe e tepruar)
- *Sjellja e autoriteteve kompetente* (nëse autoritetet kanë marrë masa korrigjuese të menjëhershme dhe të duhura për të administruar mbingarkesën e përkohshme të paparashikueshme të gjykatave, mund të justifikohet një kohë më e gjatë përpunimi e disa çështjeve)
- *Çfarë rrezikon paditësi* (disa çështje mund të kërkojnë një shpejtësi të veçantë; kryesisht **“çështje me përparësi”**):
 - mosmarrëveshjet e punës që kanë të bëjnë me largimin nga puna, mospagimin e rrogës dhe ndalimit të ushtrimit të aktivitetit;
 - dëmshpërblimi për viktimat e aksidenteve;
 - çështje në të cilat paditësi është duke vuajtur dënimin me burg;
 - çështjet e lidhura me dhunën policore;
 - çështjet ku shëndeti i paditësit është në gjendje kritike;
 - çështje me paditës në moshë të shkuar;
 - çështje të lidhura me jetën familjare dhe marrëdhëniet e fëmijëve dhe prindërve;

- çështje me paditës me zotësi dhe kushte fizike të kufizuara.

Krahas kriterëve individuale, Gjykata bën edhe *një vlerësim të përgjithshëm të rrethanave të çështjes*. Ajo mund të konstatojë se është tejkaluar “koha e arsyeshme”, nëse sipas një vlerësimi të tillë global, Gjykata konstaton se koha gjithsej ka qenë e tepruar ose nëse konstaton periudha të gjatë pasiviteti nga ana e autoriteteve kompetente.

2. Në jurisprudencën e saj, Gjykata ka përcaktuar mënyrat e llogaritjes së kohëzgjatjes së proceseve. **Momenti i fillimit për llogaritjen** ndryshon sipas llojit të çështjes: civile, penale apo administrative. Në çështjet civile normalisht është data kur është ngritur çështja në gjykatë; në çështjet penale, dita që shërben si pikënisje mund të jetë edhe data kur është arrestuar personi i dyshuar ose kur është ngritur akuza kundër tij, ose data më të cilën kanë filluar hetimet paraprake. Në çështjet administrative, është data kur paditësi e ka ngritur çështjet për herë të parë përpara autoriteteve administrative. **Fundi i periudhës** siç vlerësohet nga gjykata, në rastin e çështjeve penale, është data më të cilën është shpallur vendimi i formës së prerë për akuzën kryesore ose data e vendimit të prokurorisë ose gjykatës për pushimin e çështjes. Në çështjet civile, afati përkon me datën kur vendimi merr formë të prerë; por, Gjykata merr në konsideratë edhe kohëzgjatjen e procedurës së përmbartimit, e cila konsiderohet si pjesë integrale e procesit.

3. Shkaqet e vonesës janë ndarë në shkaqe që hasen në të gjitha llojet e proceseve dhe shkaqe që janë specifike për lloje të caktuara procesesh:

| Lloji i procesit | Etapa e procesit | Nga vjen vonesa |
|--------------------------------|--|--|
| Të gjitha proceset | <i>Përpara se të fillojë procesi</i> | Shpërndarja territoriale e kompetencës së gjykatës; transferimi i gjyqtarëve; numër i pamjaftueshëm gjyqtarësh; përdorim rregullisht i trupave gjyqësore me disa gjyqtarë; numri i çështjeve të prapambetura; pasivitet i plotë nga autoritetet gjyqësore; mangësi sistematike në rregullat procedurale; |
| | <i>Nga fillimi deri në mbylljen e seancave dëgjimore</i> | Mosthirrja e palëve apo dëshmitarëve; fletëthirrje të paligjshme; hyrje në fuqi me vonesë e legjislacionit; përplasje për kompetencën mes autoriteteve administrative dhe atyre gjyqësore; transmetim me vonesë i dosjes së çështjes tek gjykata e apelit; vonesa që u ngarkohen avokatëve, juristëve, autoriteteve vendore dhe autoriteteve të tjera; plogështi e gjyqësorit në zhvillimin e çështjes; përfshirja e ekspertit në cilësinë e dëshmitarit; shtyrjet e shpeshta të seancave; intervale të tepruara midis seancave; vonesë e tepruar përpara seancës. |
| | <i>Pas seancave dëgjimore</i> | Kalim i tepruar kohe nga çasti i bërjes së aktgjykimit deri tek njoftimi i tij sekretarisë së gjykatës ose palëve; |
| Proceset civile | | Mospërdorimi i tagrit diskrecionar të gjykatës; mungesë e rregullave të procedurës civile ose këto rregulla janë jo-adekuate; |
| Proceset penale | | Probleme strukturore në lidhje me organizimin e prokurorisë; vendimi për t'i bashkuar apo jo çështjet penale; mosparaqitje në seancë e dëshmitarëve; vartësia e procesit civil tek rezultati i procesit penal; |
| Proceset administrative | | Vonesa që u atribuohen autoriteteve jo gjyqësore. |

4. Raporti përmban edhe një pamje të përgjithshme të **rrugëzgjdhjeve ligjore kombëtare** të parashikuara për të reaguar ndaj kohëzgjatjes së paarsyeshme të proceseve. Edhe pse merret kryesisht me apelimet e depozituara nga Shtetet anëtare pas konstatimeve negative të Gjykatës Evropiane dhe të konsideruara si të efektshme, raporti shqyrton nëse GJEDNJ i ka konsideruar të efektshme ose jo apelimet e veçanta.

5. Në raport, shqyrtohen shumë aktgjykime të GJEDNJ-së për të parë se cilat janë **standardet dhe rregullat për kohëzgjatjen e proceseve**. Në veçanti, shikohet nëse do të mund të kishim një ide për kohëzgjatjen maksimale/minimale të llojeve të veçanta të çështjeve që shihen si të arsyeshme ose jo nga gjykata. Megjithëse eksperti ka vënë re se Gjykata nuk ka dashur të vendosë rregulla krejt të prera, me argumentimin se çdo çështje

duhet të shihet më vete, analiza dhe krahasimi i numrit të madh të çështjeve mund të na japë një **ide të vlefshme** lidhur me qasjen e ndjekur nga Gjykata. Është konstatuar sa më poshtë:

- Një kohëzgjatje gjithsej deri në **dy vjet për çdo shkallë të gjykimit në çështjet normale (jo komplekse) është konsideruar si e arsyeshme**. Kur proceset kanë zgjatur **më shumë se dy vjet**, Gjykata e shqyrton nga afër çështjen për të konstatuar nëse autoritetet kombëtare kanë treguar ose jo korrektesën¹ e duhur gjatë procesit;
- Në **çështjet me përparësi**, Gjykata mund të shmanget nga kjo qasje e përgjithshme dhe të **konstatojë shkelje edhe sikur çështja të ketë zgjatur më pak se dy vjet**;
- Në **çështjet komplekse**, Gjykata mund të lejojë një kohë më të gjatë, por u kushton vëmendje të veçantë **periudhave të pasivitetit** që janë dukshëm të tepruara. Por edhe në këtë rast, kjo kohë më e gjatë e lejuar rrallë i kalon pesë vjet dhe thuajse kurrë nuk është më shumë se tetë vjet;
- Të vetmet çështje në të cilat Gjykata **nuk konstatoi shkelje përkundër kohëzgjatjes dukshëm të tepruar të procesit** kanë qenë çështjet ku **vonesa është shkaktuar edhe nga sjellja e paditësit**.

6.Më poshtë jepet një pamje e shkurtër e përgjithshme e llojeve të çështjeve të analizuara në lidhje me kohëzgjatjen e procesit:

Këto i përkasin periudhës 2006-2011.

Shkelja e kohës së arsyeshme (neni 6) - përmbledhje

| <i>Lloji i çështjes</i> | <i>Çështjet</i> | <i>Kohëzgjatja</i> | <i>Vendimi</i> |
|-------------------------|-----------------------|------------------------------|----------------|
| Çështje penale | Të ndryshme | Më shumë se 5 v. | <i>Shkelje</i> |
| Çështje civile | Çështje me përparësi | Më shumë se 2 v.(min: 1v10m) | <i>Shkelje</i> |
| Çështje civile | Çështje komplekse | Më shumë se 8 v. | <i>Shkelje</i> |
| Administrative | Me përparësi | Më shumë se 2 v. | <i>Shkelje</i> |
| Administrative | E rregullt, komplekse | Më shumë se 5 v. | <i>Shkelje</i> |

Mungesë shkeljeje e kohës së arsyeshme (neni 6) - shembuj

| <i>Lloji i çështjes</i> | <i>Çështjet</i> | <i>Kohëzgjatja</i> | <i>Vendimi</i> |
|-------------------------|---|---|-------------------|
| Çështje penale | Çështje normale | 3v6m (gjithsej në të 3 shkallët); 4v3m (gjithsej në të 3 shkallët + hetimi) | <i>Pa shkelje</i> |
| Çështje penale | Komplekse | 8v5m (hetimi dhe 3 shkallët) | <i>Pa shkelje</i> |
| Çështje civile | Çështje të thjeshta | 1v10m në shkallën e parë; 1v8m në apel; 1v9m Gjykata e Kasacionit | <i>Pa shkelje</i> |
| Çështje civile | Çështje me përparësi (marrëdhënie pune) | 1v7m në shkallën e parë (marrëdhënie pune); 1v9m në apel; 1v9m Gjykata e Kasacionit | <i>Pa shkelje</i> |

Vlerat e tabelës më lart kanë të bëjnë vetëm me çështjet e analizuara dhe nuk mund të merren si rregull fikse. Çështjet e ardhshme do të shihen duke mbajtur në konsideratë rrethanat e tyre të veçanta, sipas kriterëve të vendosura nga Gjykata. Por sidoqoftë mund të vlejnjë në funksion të vlerësimit dhe analizës së përgjithshme.

¹“Diligence” në gjuhën angleze – mund të përkthet edhe si përkujdesje, kujdes. (shënim i përkthyesit).

Parathënie

Ky studim synon të krijojë njohuri konkrete për çështjet e trajtuara nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut për të gjykuar për përputhshmërinë e afateve të proceseve gjyqësore me kërkesat e nenit 6, pika 1, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Studimi është ndërtuar në mënyrë të atillë që vendimmarrësit e politikave dhe profesionistët e gjyqësorit në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës të mund ta përdorin këtë informacion specifik për të orientuar reformën e kornizave normative dhe praktikave administrative dhe gjyqësore drejt afateve optimale dhe të parashikueshme të proceseve gjyqësore, në përputhje me Programin Kuadër të CEPEJ-së: “Një objektiv i ri për sistemet gjyqësore: trajtimi i çështjeve brenda afateve optimale dhe të parashikueshme¹”.

Botimi i parë i këtij raporti është hartuar nga Françoise Calvez (gjyqtare, Francë) për llogari të Grupit të Posaçëm të Punës të CEPEJ-së për afatet e proceseve gjyqësore. Mbulon periudhën 1985 deri më 8 tetor 2005. Botimi i dytë i është besuar zotit Nicolas Regis (magjistër, Francë) për llogari të Grupit të Punës SATURN të CEPEJ-së². Raporti merr në konsideratë jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut deri më 31 korrik 2011.

Raporti është miratuar nga CEPEJ në mbledhjen e tij plenare të dhjetor 2012.

¹ Shih dokumentin CEPEJ(2004)19.

² SATURN (Rrjeti Kërkimor për Studimin dhe Analizën e Përdorimit të Kohës Gjyqësore)

TRYEZA E LËNDËS

Pjesa e parë: Kriteret e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut për të konstatuar "afatin kohor të arsyeshëm" sipasnenit 6, pika 1, të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut

| | |
|--|-----|
| Shënim hyrës: Shterimi i rrugëzgjdhjeve ligjore të brendshme | 14 |
| I. Kriteret e vendosura për vlerësimin e kohëzgjatjes | 18 |
| A – Kompleksiteti i çështjes | 18 |
| B – Sjellja e paditësit | 21 |
| C – Sjellja e autoriteteve kompetente | 22 |
| 1. Argumentet e autoriteteve kombëtare, të pranuar nga Gjykata | 22 |
| 2. Argumentet e autoriteteve kombëtare, të rrëzuara nga Gjykata | 23 |
| D – Çfarë rrezikon paditësi | 26 |
| E – Vlerësimi i përgjithshëm i rrethanave të çështjes | 28 |
| II. Llogaritja e kohëzgjatjes së procesit dhe faktorët që ndikojnë në këtë llogaritje | 29 |
| A – Pikënisja | 29 |
| B – Fundi i periudhës me interes | 33 |
| Pjesa e dytë: Arsyet e vonesave dhe shikim i përgjithshëm i kohëzgjatjes së proceseve | |
| I. Arsyet e vonesave | 37 |
| A. Arsyet e jashtme | 37 |
| B. Shkaqe që hasen në të gjitha llojet e proceseve | 40 |
| 1. Vonesa në fillimin e procesit | 40 |
| 2. Vonesat që ndodhin në fillim dhe në fund të procesit | 46 |
| 3. Vonesa që ndodhin pas procesit | 53 |
| C. Shkaqet e vonesës sipas llojit të procesit | 54 |
| 1. Proceset civile | 54 |
| 2. Proceset penale | 56 |
| 3. Proceset administrative | 59 |
| II. Zgjidhjet vendase për reduktimin e kohëzgjatjes së procesit dhe përmbledhje e proceseve përkatëse | 60 |
| A. Direktivat e Gjykatës Evropiane | 60 |
| B. Rrugëzgjdhjet vendase ekzistuese: përmbledhje | 62 |
| III. Puna kërkimore për kohën e arsyeshme | 66 |
| A. Tendencat kryesore të Gjykatës Evropiane lidhur me afatin kohor të arsyeshëm: | 66 |
| B. Disa shembuj në lidhje me kohën e arsyeshme | 68 |
| 1. Çështje civile të thjeshta: . | 68 |
| 2. Çështje penale të thjeshta: | 69 |
| 3. Çështjet e ndërlikuara | 70 |
| Konkluzion. | 71 |
| Bibliografia | 73 |
| Shtojca 1 | 74 |
| Shtojca 1: Shkelje për “kohëzgjatje të procesit” (neni 6, pika 1) sipas vendeve (*) | 76 |
| Shtojca 2: Çështjet prioritare për të cilat Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut kërkon korrektesë të veçantë nga autoritetet (29/10/05) | 78 |
| Shtojca 3: çështjet komplekse – shkelje e nenit 6, pika 1, dhe mosshkelje e nenit 6, pika 1 | 83 |
| Shtojca 4: çështjet jo komplekse – shkelje e nenit 6, pika 1, dhe mosshkelje e nenit 6, pika 1 | 108 |

Neni 6.1 e Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, datë 4 nëntor 1950, thotë:

“Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze të natyrës penale që i është drejtuar. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t’i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose të sigurimit kombëtar në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e domosdoshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta natyra e publicitetit do të dëmtonte interesat e drejtësisë.”

Kjo dispozitë kyçe e Konventës ka bërë që përpara Gjykatës të ngrihen disa çështje gjyqësore lidhur me konceptin e dëgjimit apo gjykitimit të drejtë. Sa i takon vëllimit, shumica e çështjeve kanë pasur të bëjnë me të drejtën që çështjet gjyqësore të shqyrtohen brenda një kohe të arsyeshme. Kjo vlen si për çështjet penale ashtu edhe ato civile, meqë neni 6.1 përmend edhe *“çdo akuze të natyrës penale”*.

Vendimet gjyqësore që kanë konstatuar shkelje të nenit 5, pika 3, apo të nenit 6, pika 1, mund të duket se bazohen në të njëjtat arsye, por ka edhe disa dallime të caktuara: së pari, neni 5, pika 3, ka të bëjë me arrestimin dhe situatën e personave në paraburgim³ dhe së dyti kërkon korrektesë të posaçme, siç e ka bërë të qartë Gjykata në aktgjykimin e çështjes *“Stögmüller”*, datë 10 nëntor 1969: *“nuk ngatërrohet dispozita e nenit 5, pika 3 dhe ajo e nenit 6, pika 1. Kjo e fundit zbatohet për të gjitha palët e procesit gjyqësor dhe ka për synim t’i mbrojtë këto palë nga vonesat e tepruara procedurale; sidomos në çështjet penale, ka për qëllim të shmangë situatën ku një person kundër të cilit është ngritur aktakuza të jetë subjekt tepër gjatë i mungesës së qartësisë lidhur me fatin e tij. Neni 5, pika 3, nga ana e vet, përmend vetëm personat në paraburgim të cilëve u është drejtuar akuzat. Kjo nënkupton se duhet të ketë korrektesë të veçantë në kryerjen e ndjekjes penale të çështjeve që kanë të bëjnë me persona të tillë. Sikur vetëm në këtë aspekt, koha e arsyeshme e përmendur në këtë dispozitë mund të dallohet nga ajo e parashikuar në nenin 6.”*

Mirëpo, edhe pse ky theks tek nevoja për korrektesë në zhvillimin e çështjeve mund të duket sikur është ndonjë dukuri e kohëve të fundit, ajo ka një histori juridike shumë më të gjatë.

Për shembull, që në fillim të shekullit XIV, është futur një procedurë e thjeshtuar në të drejtën kanunore në mënyrë që të mund të trajtoheshin më shpejt disa kategori të caktuara çështjesh (shih Ch. Van Rhee, në *The Law’s Delay (Vonesa e ligjit)*, Kësaj dukurie nuk i ka shpëtuar as e drejta anglosaksone, siç e shohim tek veprat e Dikensit, sidomos në romanin *“Klubi Pikui”*, ku autori është tejet kritik kundrejt kohëzgjatjes së disa proceseve të caktuara në Angli⁴. Shumë më vonë, Këshilli për Drejtësi Civile, i kryesuar nga Lord Woolf, ka botuar raportin *“Access to Justice”* (Liria për t’iu drejtuar sistemit të drejtësisë, korrik 1996), ku jepen propozime të ndryshme për përsheptimin e proceseve civile Mbretërinë e Bashkuar.

Avazet e vjetra në frëngjishte (*justice rétive, justice fautive*) dhe në anglishte (*“justice delayed justice denied”, drejtësi e vonuar, drejtësi e munguar*) i përmbledhin më se qartë arsyet përse Gjykata Evropiane e vendos kaq shumë theksin tek nevoja për t’i shmangur vonesat.

Në të drejtën ndërkombëtare, Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (1948) e mishëron nocionin e një gjykimi apo dëgjimi të drejtë por nuk e përmend shprehimisht një *“afat të arsyeshëm”*. Neni 10 thotë: *“Gjithkush gëzon njëlloj të drejtën për një proces gjyqësor objektiv e publik para një gjykate të pavarur e të paanshme, në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të veta dhe për vendimin mbi çfarëdo lloj akuze penale.”*

Mirëpo përmendja e barazisë nuk është pa lidhje me nocionin e *“afatit të arsyeshëm”*, meqë vonesat e tepruara janë një burim madhor pabarazie, për shembull mes atyre që mund ta përballojnë, si psikologjikisht ashtu edhe financiarisht, pritjen e rezultatit të një çështjeje dhe madje mund të kërkojnë ta vonojnë më tej atë, dhe atyre për të cilët çdo shtyrje në kohë e një seance sjell pasoja financiare apo njerëzore të papërballueshme. Në kesi rastesh, kalimi i kohës në vetvete mund të përbëjë një burim padrejtësie shtesë.

³ Por, Gjykata Evropiane e zbaton nenin 6, pika 1, për fazën e hetimit të procesit penal.

⁴ C.H. Van Rhee, *“The laws delay: an introduction”* (Vonesa e ligjit: hyrje), në: *“The law’s delay: essays in undue delay in civil litigation”* (Vonesa e ligjit: ese për vonesat e parregullta në ndërgjyqësinë civile”, Intersentia, 2004

Për rrjedhojë, neni 6, pika 1, i Konventës Evropiane futi nocionin e afatit në proceset gjyqësore të shekullit XX, si edhe një shqetësim të ri për dhënie të menjëhershme të drejtësisë. Më pas Gjykata Evropiane dhe Komisioni e kanë përkthyer këtë koncept në jurisprudencë përmes një përmbledhjeje mbresëlënëse vendimesh dhe aktgjykimesh, numri të cilave është rritur në mënyrë eksponenciale në dekadën e fundit të shekullit XX.

Kjo ide del përsëri në nenin 14, pika 3, të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, datë 19 dhjetor 1966, ku gjithkujt kundër të cili është ngritur një akuzë penale i jepet e drejta "të gjykohej pa vonesë të tepruar". Kjo është një bazë mbi të cilën mund të mbështetet çdo individ që pas hyrjes në fuqi të protokollit fakultativ të datës 17 gusht 1994, i cili e lejon Komisionin për të Drejtat e Njeriut të shqyrtojë komunikimet individuale.

Kjo çështje është ngritur edhe në legjislacionin e Komunitetit. Gjykata e Drejtësisë e Komuniteteve Evropiane e përfshin Konventën e të Drejtave të Njeriut në tërësinë e legjislacionit të saj, siç e ka shprehur shprehimisht edhe në aktgjykimin e çështjes "Kremzow - Republika e Austrisë", çështja nr.C- 299/95: "Së pari duhet thënë se, sikurse ka qenë vazhdimisht qëndrimi i Gjykatës (në veçanti, shih Opinionin 2/94 [1996] ECR I-1759, pika 33), të drejtat themelore janë pjesë e pandarë e parimeve të përgjithshme të legjislacionit të Komunitetit, respektimin e të cilit siguron Gjykata. Në këtë kuptim, Gjykata frymëzohet nga traditat kushtetuese të përbashkëta mes Shteteve Anëtare dhe nga udhëzimet që japin traktatet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut për të cilat Shtetet Anëtare kanë bashkëpunuar ose nënshkruar të cilave janë. Në këtë aspekt, Konventa ka rëndësi të veçantë. Siç është shprehur edhe më parë Gjykata, del se janë të papranueshme në Komunitet ato masa të cilat nuk janë në përputhje me respektimin e të drejtave të njeriut të cilat njihen dhe garantohen (shih, veçanti, çështjen nr.C-260/89 ERT [1991] ECR I-2925, pika41)".

Në aktgjykimin e çështjes "Baustahlgewebe - Komisioni", datë 17 dhjetor 1998, Gjykata e Drejtësisë mori në shqyrtim mundësinë e zbatimit të nenit 6, pika 1, të Konventës Evropiane për proceset e gjykatës së shkallës së parë dhe zbatoi në mënyrë skrupuloze të gjitha kriteret e "kohës së arsyeshme" të identifikuar nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

Ky parim del edhe në legjislacionin e Komunitetit. Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 1348/2000, datë 29 maj 2000, për vënien në dispozicion në Shtetet Anëtare të dokumenteve gjyqësore dhe jashtëgjyqësore në çështjet civile ose tregtare, fut kërkesën për një sistem të vënies në dispozicion të dokumenteve të mbështetur tek nocionin i afatit të arsyeshëm.

Në fund, neni 47, paragrafi i dytë, i Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian, të cilës Traktati i Lisbonës i ka dhënë fuqi të barasvlershme me traktatet e BE-së⁵, parashikon se kohëzgjatja e procesit duhet t'i përkojë një "afati kohor të arsyeshëm". Neni 52, pika 3, më tej përcakton se "për aq sa të drejtat që përmban kjo Kartë përputhen me të drejtat që garantohen nga Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, kuptimi dhe fusha e veprimit e këtyre të drejtave është e njëjtë me ato të të drejtave që parashikon kjo Konventë (...)".

Pra e drejta për gjykim të çështjes brenda një afati kohor të arsyeshëm është tashmë e mishëruar në të drejtën ndërkombëtare dhe atë evropiane dhe dalëngadalë po përfshihet edhe në legjislacionet e brendshme të palëve kontraktuese.

Afati nuk del në Kodin e Procedurës Civile të Francës, por është përcaktuar shprehimisht në Ligjin për Prezumimin e Pafajësisë, datë 15 qershor 2000, i cili e përfshin që në nenin e parë të Kodit të Procedurës Penale dhe në dispozita të tjera të mëpasshme. Gjithashtu, që pas vitit 2006, nocioni i afatit zë një vend simbolik në nenin L. 111-3 të Kodit Gjyqësor.

Ai del edhe në legjislacionin italian⁶, ku të drejtës për gjykim të rregullt i është dhënë fuqi kushtetuese, si edhe në kushtetutën spanjolle të vitit 1978, neni 24.2 i së cilës parashikon të drejtën për gjykim ose dëgjim brenda një afati të arsyeshëm dhe e cila këtë e kthen në një të drejtë themelore përmes "recurso di amparo". Po kështu, prej datës 1 janar 2002, neni 127 i Kushtetutës Sllovaqe u jep personave fizikë dhe atyre juridikë të drejtën për të kundërshtuar shkeljet e të drejtave themelore, në bazë të të cilit Gjykata Kushtetuese ka nxjerrë vendime gjyqësore lidhur me kohëzgjatjen e proceseve.

⁵ Hyrja në fuqi: 1 dhjetor 2009.

⁶ Neni 111 i Kushtetutës Italiane.

Shumica e sistemeve juridike të brendshme tani parashikojnë afate për përfundimin e disa procedurave të caktuara juridike dhe gjyqësore.

Duhet pranuar se e drejta për gjykim ose dëgjim të rregullt dhe për t'u dëgjuar brenda një afati të arsyeshëm nuk bën pjesë në kategorinë e të drejtave për të cilat shtetet nuk mund të kërkojnë asnjëherë përjashtim, qoftë edhe në rrethana të jashtëzakonshme.

Neni 15 i Konventës Evropiane i lejon shtetet t'u shmangen detyrimeve të parashikuara në konventë *“në rast lufte ose rreziku tjetër publik, që i kanoset jetës së kombit”*, edhe pse kjo nuk zbatohet për nenin 2 (e drejta për jetën), 3 (ndalimi i torturës dhe i trajtimit çnjerëzor ose poshtërues) dhe 7 (nuk ka dënim pa ligj).

Me përjashtim të këtyre të drejtave të ashtuquajtura të paprekshme⁷, palët kontraktuese e kanë të drejtën për t'u shmangur detyrimeve të konventës.

Teorikisht, palët mund edhe të tërhiqen nga ushtrimi i të drejtave të tyre, për sa kohë kjo tërheqje nga e drejta i përmbush kushtet e parashikuara nga Gjykata Evropiane. Si e bërë shprehimisht si në heshtje, tërheqja nga të drejtat duhet të jetë e qartë dhe me vullnet të lirë dhe pala në fjalë duhet informuar për natyrën dhe shkallën e të drejtave prej të cilave ka vendosur të tërhiqet. Në çështjen *“Deweer”*, lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar nga gjykata, që është një aspekt i të drejtës për dëgjim të rregullt, Gjykata mbajti qëndrimin se *“në një fushë të lidhur me rendin publik (ordre public) të Shteteve anëtare të Këshillit të Evropës, çdo masë apo vendim që pretendohet se është në shkelje të nenit 6 kërkon shqyrtim veçanërisht të kujdesshëm”* (aktgjykimi i çështjes *“Deweer - Belgjikë”*, datë 27 shkurt 1980).

Siç e kanë theksuar disa komentues, edhe pse është e mundshme të tërhiqesh nga disa elemente të caktuara të së drejtës për dëgjim të rregullt të çështjes tënde, disa aspekte të tjera janë një pjesë kaq integrale e këtij nocioni saqë në mungesë të tyre ky nocion nuk do të zbatohet më⁸.

Në një sërë rezolutash, Këshilli i Ministrave i Këshillit të Evropës është shprehur se *“vonesat e tepruara në vënien në vend të drejtësisë përbëjnë një rrezik të rëndësishëm, sidomos për respektimin e shtetit ligjor”*.

Ekziston gjithmonë rreziku se mos dikujt i mohohet drejtësia nëse zvarritet procesi. Me kalimin e kohës, mund të preken për keq disa interesa legjitim, provat mund të zhduken dhe do të duhet të paraqiten prova të reja, lejohen apo madje nxiten manovra procedurale, dëshmitarët largohen dhe e humbasin besueshmërinë dhe lindin kosto shtesë, të cilat palët në mirëbesim ndonjëherë mund të mos jenë në gjendje t'i përballojnë.

Mirëpo, koha është po aq e rëndësishme për kryerjen siç duhet të hetimeve, për hedhjen dritë mbi të gjitha çështjet me aspekt juridik dhe për zgjidhjen e relatave mes palëve dhe që gjykata të arrijë në një përfundim të arsyeshëm. Pra, një problem delikat është afati kohor i arsyeshëm.

Siç do ta shohim, Gjykata ka ndjekur një qasje pragmatike për këtë çështje. Në përgjithësi, Gjykata përpiqet të konstatojë nëse koha është përdorur apo jo me mençuri në të gjitha fazat e procesit përkatës dhe identifikon periudhat e pasivitetit, të cilat i kritikon nëse nuk janë të justifikuar në dukje.

Përpara se të vazhdojmë me temën kryesore të këtij raporti, është mirë të përmendim termat e referencës të CEPEJ-së. Nga ky raport kërkohet të analizojë çështjen e kohëzgjatjes së proceseve në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, duke u mbështetur në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, sidomos në çështjet gjyqësore më të fundit. Në to thuhet: *“ka dy çështje kryesore që do të duheshin studiuar. Njëra ka të bëjë me kohëzgjatjen e procesit e cila konsiderohet e arsyeshme ose e paarsyeshme (në përgjithësi dhe për lloje të veçanta çështjesh gjyqësore), ndërsa tjetra ka të bëjë me analizën e shkaqeve kryesore të vonesave (në çështjet gjyqësore për të cilat është konstatuar se kohëzgjatja ka qenë e paarsyeshme”*.

⁷ F. Sudre, *“la dimension internationale and européenne des libertés and droits fondamentaux”*, në: *Libertés and droits fondamentaux*, redaktorë R. Cabrillac, M-A Frison-Roche dhe T. Revet, Dalloz, 2004, f. 33 deri në 51.

⁸ J-C Soyfer dhe Mr de Salvia neni 6, në *“Convention européenne des droits de l'homme commentaire article pararticle”* redaktuar nga L-E Pettiti, Economica f. 244

Autori ka këqyrrur një numër të madh aktgjykimesh dhe vendimesh të Gjykatës dhe vendimesh të ish-Komisionit.

Burimi kryesor ka qenë hapësira në internet HUDOC e Gjykatës, e cila është eksploruar duke shkruar “neni 6, pika 1” dhe fjalët “*délai raisonnable*” (kohëzgjatja e arsyeshme).

Këtu është bashkëlidhur një tabelë⁹ ku paraqitet numri i çështjeve të identifikuara në këtë mënyrë për të cilat janë nxjerrë aktgjykime në periudhën 1985-2011 (31 korrik 2011), përfshirë edhe zgjidhjet në mënyrë miqësore. Ky numër është vetëm orientues, po të kemi parasysh marzhin e mundshëm të gabimit në përdorimin e motorit të kërkimit. Megjithatë, duket se nga ana statistikore ky numër është i saktë në mënyrë të arsyeshme. Në këtë tabelë jepet edhe numri i banorëve për çdo vend dhe datat e ratifikimit dhe të njohjes së të drejtës së kërkesës individuale për çdo shtet kontraktues.

Në lidhje me Shtetet që u janë nënshtruar mbi 100 konstatimeve negative, janë lexuar sistematikisht aktgjykimet që mbulojnë periudhën 2000-2005: kjo në lidhje me Francën, Greqinë, Italinë, Poloninë, Portugalinë dhe Turqinë. Kemi këqyrrur edhe vendimet e mëparshme më të rëndësishme në lidhje me vendet që na ka kërkuar sekretariati i CEPEJ-së dhe nëpunësit e tjerë të Sekretarisë së Gjykatës dhe Këshillit të Ministrave. Ky raport është përditësuar më 15 dhjetor 2011, për të përfshirë aktgjykimet më të rëndësishme të nxjerra nga data 1 janar 2006 deri më 31 korrik 2011, sipas kriterëve të mëposhtme: rëndësia që i jepet aktgjykimit nga Gjykata (niveli 1, 2 dhe 3; aktgjykimet e Kolegjit të Gjyqtarëve; aktgjykimet pilot), rëndësia që i jepet aktgjykimit nga doktrina dhe origjinaliteti i çështjes në fjalë.

Shpejt u duk qartë se aktgjykimet e kohëve të fundit hedhin shumë pak dritë mbi shkaqet e vonesave ngaqë Gjykata tani e bën arsyetimin në mënyrë shumë të përmbledhur. Për shkak të vëllimit të madh të çështjeve gjyqësore për kohëzgjatjen e procesit, Gjykata vetëm sa i përmend kriteret e vendosura në jurisprudencën e saj, përveçse për arsye pedagogjike në rastin e shteteve të reja anëtare apo kur rrethanat e veçanta të çështjes kërkojnë shpjegime më të hollësishme. Për rrjedhojë doli nevoja për t’u mbështetur në aktgjykime shumë më të hershme të Gjykatës së mëparshme dhe të Gjykatës së re dhe në vendimet e Komisionit për të identifikuar kriteret që ka përcaktuar dhe zbatuar Gjykata. Megjithatë, në periudhën 2006-2011 shohim zhvillimin e aktgjykimeve pilot¹⁰, që ofrojnë një mundësi për të rikujtuar metodat e Gjykatës dhe që japin sqarime të dobishme. Për shembull, Gjykata Evropiane e ka konsoliduar jurisprudencën e saj për rrugëzgjidhjet e efektshme ligjore me aktgjykimin madhor të çështjes “Kudia - Poloni”, vendim i datës 26 tetor 2000 (shih Pjesën 1A, më poshtë).

Duhet theksuar që në fillim se statistikat duhen interpretuar me maturi të konsiderueshme, duke qenë se në vetvete nuk mund të pasqyrojnë realitetin e çdo vendi. Ka shtete për të cilat Gjykata ka konstatuar relativisht shumë pak raste me kohëzgjatje të tepruar të proceseve, por jo medoemos mund të arrihet në përfundimin se gjykatat e tyre janë veçanërisht korrekte.

Në disa raste, mund të lindin probleme në një fazë më të hershme, lidhur me mundësinë për t’iu drejtuar gjykatave. Qytetarët mund t’i përdorin në mënyrë shumë të kufizuar gjykatat për shkak të kostove të lindura ose ngaqë nxiten apo janë më të efektshme rrugëzgjidhjet alternative. Po kështu në disa vende mund të ketë shumë pak ndërgjegjësime për të drejtën për t’iu drejtuar Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut ndërsa në vende të tjera ka praktika juridike që janë të specializuara për këtë Gjykatë, çka sjell një numër shumë të konsiderueshëm çështjesh gjyqësor dhe një numër po aq më të lartë aktgjykimesh kundër shteteve.

Për më tepër, procese shumë të shpejta jo gjithmonë çojnë në drejtësi të mirë. Disa procedura të përshpejtuara ku përparësi i jepet shpejtësisë dhe jo të drejtave të palës së paditur mund ta cenojnë cilësinë e drejtësisë. Gjykata Evropiane ka mbajtur gjithmonë qëndrimin se parimi i vënies në vend të drejtësisë shkon shumë përtej nocionit të afateve kohore të arsyeshme¹¹ dhe se ky parim mund të justifikojë procese më të zgjata por më të drejta.

⁹ Shtojca 1

¹⁰ P.sh. në çështjen “Burdov - Rusi” (nr.2), vendim i datës 4 maj 2009.

¹¹ Në aktgjykimin e çështjes “Intiba - Turqi”, datë 24 maj 2005, pika 54, Gjykata shprehej se megjithëse neni 6 i Konventës kërkon që procesi të zhvillohet me shpejtësinë e duhur, Konventa mishëron parimin më të përgjithshëm të dhënies së duhur të drejtësisë (aktgjykimi është vetëm në frëngjishte). Shih edhe aktgjykimin e çështjes “Boddaer - Belgjikë”, datë 12 tetor 1992.

Termat e referencës i kërkojnë ekspertit gjithashtu të konstatojë, në bazë të vëllimit të konsiderueshëm të çështjeve, nëse Gjykata ka përcaktuar rregulla për kohëzgjatjen maksimale të proceseve që mund të konsiderohej e arsyeshme për kategori të veçanta të çështjeve ose, nga ana tjetër, për kohëzgjatjen minimale të proceseve sipas të cilave Gjykata do të mund të arrinte në përfundimin se ka pasur një shkelje të së drejtës për t'u dëgjuar rregullisht brenda një afati kohor të arsyeshëm.

Është mirë që këtu të bëjmë ca komente për metodikën e raportit.

Që përpara tridhjetë vjetësh, pas një debati të brendshëm për këtë temë, Gjykata nuk pranonte t'u jepte shteteve asnjë vendim juridik lidhur me atë se cila mund të konsiderohej si kohëzgjatje standarde e procesit gjyqësor. Gjykata i qëndron edhe sot e kësaj dite besnike kësaj qasjeje praktike dhe angazhimit të saj për t'i peshuar të gjithë kriteret e përcaktuar prej saj sipas rrethanave të secilës çështje gjyqësore dhe nuk ka përcaktuar asnjëherë rregulla precize, për shembull se sa kohë duhet t'i kushtojë gjykata një çështjeje divorci në mënyrë që të mos bëhet objekt sanksioni nga Strasburgu. Ky qëndrim nuk ka ndryshuar që pas reformës së vitit 1998.

Maksimumi, duket se dy vjet për shkallë gjykimi është afati përtej të cilit mund të lindin dyshime dhe përtej të cilit Gjykata u kushton vëmendje të veçantë rrethanave të çështjes. Kur konstaton se ka kaluar një kohë e konsiderueshme në përgjithësi ajo përdor një gjuhë të përgjithshme, për shembull thotë se Gjykata vëren se gjykata e apelit e ka dhënë vendimin e saj më se shtatë vjet e tre muaj pas ngritjes së çështjes përpara saj dhe se një kohëzgjatje e tillë në pamje të parë do të dukej e paarsyeshme për një shkallë të vetme gjykimi dhe për rrjedhojë do të kërkonte këqyrje nga afër sipas nenit 6, pika 1, të Konventës¹². Ose mund të shprehej, "*fakti se kanë kaluar më shumë se shtatë vjet që pas ngritjes së akuzave pa shprehur asnjë vendim për to në një aktgjykim ku të shpallet i fajshëm ose i pafajshëm i pandehuri sigurisht që tregon një periudhë jashtëzakonisht të gjatë çka në shumicën e çështjeve gjyqësore do të duhej të konsiderohej si tejkallim i afatit kohor të arsyeshëm të parashikuar në nenin 6, pika 1.*"¹³.

Për t'i ofruar material aktual Këshillit, autorët kanë përgatitur një sërë tabelash me çështje gjyqësore ku jepen karakteristikat e përbashkëta që mundësojnë krahasimin e kohëzgjatjes së procesit dhe vendimin e Gjykatës.

Në to përfshihen:

- **një tabelë e çështjeve "me përparësi"**, sa i takon asaj se çfarë rrezikon paditësi. Nga këndvështrimi i kryetarit të një gjykate këto mund të kategorizoheshin si çështjet me përparësi. Sa i takon menaxhimit të fluksit të çështjeve, këta shembuj të veçantë do të duhej të trajtoheshin më me shpejtësi se çështjet e tjera ku faktori kohë është më pak i rëndësishëm për rezultatin. (Shtojca 2)

- **dy tabela me çështje komplekse, me konstatime të shkeljeve dhe jo shkelje përkatësisht** (shtojca 3). Këto çështje janë njohur si të vështira nga Gjykata, për të cilat ka pranuar proces më të zgjatur për aq sa nuk janë të cenueshme për arsye të tjera, si sjellja e paditësit apo e autoriteteve.

Raporti përfundimtar plotësohet me një tabelë të çështjeve jo komplekse që mundëson krahasimin e kohëzgjatjeve të proceseve me natyrë rutinë (shtojca 4).

Këto dy grupe tabelash, që përfshijnë nga njëra anë një kërkesë të Gjykatës për shpejtësi më të madhe dhe nga ana tjetër një pranim të faktit se vështirësia e çështjes justifikon njëfarë vonese, ofrojnë një spektër çështjesh që tregojnë se si mund të ndryshojë kohëzgjatja e procesit gjyqësor.

Raporti është ndarë në dy pjesë:

- pjesa e parë merret me kriteret e vendosura prej Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut për të konstatuar nëse ka kaluar apo jo një kohë e arsyeshme;

¹² Aktgjykim i çështjes "Marien - Belgjikë", datë 3 nëntor 2005 (vetëm në frëngjishte).

¹³ Aktgjykim i çështjes "Neumeister - Austri", 1968.

- pjesa e dytë merret me arsyet e vonesave, siç dalin nga vendimet e Gjykatës, vendimet e Komisionit dhe rezolutat e Këshillit të Ministrave, dhe jep një pamje të parë të përgjithshme të kohëzgjatjes së proceseve në formë tabelore.

Raporti plotësohet me shtojcat e lartpërmendura.

PJESA E PARË

Kriteret e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut për të konstatuar “afatin kohor të arsyeshëm” sipas nenit 6, pika 1, të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut

Shënim hyrës: Shterimi i rrugëzgjdhjeve ligjore të brendshme

A. Ekzistenca e një rrugëzgjdhjeje të efektshme

Konventa synon të plotësojë rregullimet e kombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Siç është shprehur Gjykata në aktgjykimin e çështjes “Handyside”, datë 7 dhjetor 1976: *“makineria e mbrojtjes e krijuar nga Konventa është ndihmëse për sistemet kombëtare në mbrojtje të të drejtave të njeriut”*. Për shkak të kësaj natyre plotësuese, neni 35 i Konventës vendos detyrimin për t’i shtuar të gjitha rrugët e brendshme ligjore.

Pra, paditësi, përpara se të ngrejë padi përpara Gjykatës Evropiane, nëse kjo padi është e pranueshme, duhet më parë ta ketë cituar shkeljen e të drejtën për t’u dëgjuar rregullisht brenda një afati kohor të arsyeshëm përpara një gjykate të brendshme. Gjykata e zbaton me elasticitet këtë rregull, duke kërkuar që paditësit t’i kenë shfrytëzuar të gjitha rrugët ligjore që mund të pritet prej tyre në mënyrë të arsyeshme sipas legjislacionit të brendshëm, por pa i shtrënguar të bëjnë apelime të cilave u mungon perspektiva e suksesit.

Gjykata verifikon ekzistencën, në legjislacionin e brendshëm të Shteteve anëtare, të një “rruge ligjore të efektshme”, e cila përkufizohet si vijon: [...] *në kuptim të nenit 35, pika 1, të Konventës, u takon Shteteve të dëshmojnë ekzistencën e një rruge ligjore të mundshme dhe të duhur e cila të jetë e efektshme si në teori ashtu edhe në praktikë dhe të ketë gjasa për zgjidhjen e shkeljes së pretenduar*. Gjykata shton se një rrugëzgjdhje e tillë duhet të ekzistojë në teori dhe në praktikë në një shkallë sigurie të mjaftueshme (shih, ndër të tjera, vendimin e çështjes “Ziabreva - Rusi”, datë 18 dhjetor 2008, pika 15 dhe 16).

Kur nuk ka asnjë rrugëzgjdhje të efektshme për t’i vënë në vend apo dënuar vonesat gjyqësore, Gjykata mendon se paditësi mund ta ngrejë përpara saj shkeljen e së drejtës për t’u dëgjuar brenda një afati kohor të arsyeshëm, pavarësisht nëse procesi është ende i hapur përpara një gjykate të brendshme, sidomos në shkallën e apelit apo të gjykatës së lartë¹⁴.

Në vendimin e çështjes “Daddi - Itali”, datë 16 qershor 2009, Gjykata Evropiane rikujton se rregulla për shterimin e rrugëzgjdhjeve të brendshme synon t’u japë mundësi Shteteve Kontraktuese të parandalojnë apo ndreqin shkeljet që u ngarkohen atyre përpara se këto t’i nënshtrohen zbatimit të këtij rregulli, në përputhje me parimin e subsidiaritetit¹⁵. Për këtë, Gjykata mbështetet në nenin 13 të Konventës, i cili thotë se “Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e njohura në këtë Konventë, ka të drejtë të bëjë ankim efektiv tek një organ i vendit të tij, edhe kur shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare”.

Për të siguruar përmbushje më të efektshme të kërkesës ligjore për “afat kohor të arsyeshëm”. Gjykata Evropiane ia ndërroi drejtimin jurisprudencës së saj në aktgjykimin e çështjes “Kudla - Poloni”, datë 26 tetor 2000, duke u shprehur se neni 13 i Konventës ofron një garanci që dallon nga ato të parashikuara në nenin 6, që, nëse është e nevojshme, mund t’i nënshtrohet një konstatimi të veçantë negativ në mënyrë që të sigurohet që Shtetet të parashikojnë një rrugëzgjdhje operative të efektshme përpara një autoriteti kombëtar në mënyrë që të garantohet e drejta për t’u dëgjuar brenda një afati kohor të arsyeshëm.

¹⁴ Aktgjykimet “Zanghi - Itali”, datë 19 shkurt 1991; “X - Francë”, datë 31 mars 1992; “A.V - Francë”, datë 2 prill 1994.

¹⁵ “Akdivar dhe të tjerë - Turqi”, datë 16 shtator 1996, pika 65, Përmbledhje e Aktgjykimeve dhe Vendimeve 1996 IV, f. 1210 dhe “Aksov - Turqi”, datë 18 dhjetor 1996, pika 51, Përmbledhje e Aktgjykimeve dhe Vendimeve 1996 IV, f. 2275.

Neni 6, pika 1, më parë konsiderohej se kishte epërsi kundrejt nenit 13 si *lex specialis* dhe Gjykata nuk kishte pranuar t'i këqyrte ankesat për shkelje të nenit 13 nëse kishte konstatuar më parë shkelje të nenit 6, pika 1.

Mirëpo, *“shpeshësia gjithnjë e më e madhe me të cilën po konstatohen shkelje në këtë aspekt ka bërë kohët e fundit që Gjykata ta tërheqë vëmendjen tek “rreziku i rëndësishëm” që i kanoset shtetit ligjor brenda redevë juridike të brendshme kur ndodhin “vonesa të tepruara në dhënien e drejtësisë” në lidhje me të cilën palët ndërgjyqëse nuk kanë asnjë rrugëzgjdhje ligjore të brendshme”*. (pika148)

Duke kujtuar qëllimin e nenit 35, pika 1 (i cili ka afërsi me nenin 13, sipas Gjykatës), pra dhënia mundësi shteteve kontraktuese për të parandaluar ose ndrequr shkeljet e pretenduara kundër tyre përpara se këto akuza të ngrihen përpara saj. Duke përmendur punën përgatitore për Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Gjykata vijonte: *“Qëllimi i nenit 35, pika 1, i cili parashikon rregullën e shterimit të rrugëzgjdhjeve ligjore të brendshme, është t'u jepet shteteve kontraktuese mundësia për të parandaluar ose ndrequr shkeljet e pretenduara kundër tyre përpara se këto akuza të ngrihen përpara Gjykatës”*¹⁶.

Gjykata, sipas këtij aktgjykimi të rëndësishëm, synon t'i sanksionojë Shtetet mbi këtë bazë të dyfishtë, dhe, duke vepruar kështu, u kërkon të gjitha Shteteve Kontraktuese të vendosin procedura të brendshme që u lejojnë palëve ndërgjyqëse të ankohen, përmes një rruge ligjore e cila të jetë e efektshme si ligjërishit ashtu edhe praktikisht, dhe mund të jetë ose jo gjyqësore, lidhur me kohëzgjatjen e tepruar të proceseve.

Gjithashtu, në vendimin e çështjes “Mifsud - Francë”, datë 11 shtator 2002, Gjykata vendosi se një rrugëzgjdhje e tillë e efektshme mund të marrë formën jo vetëm të një rruge ligjore që mundëson përshpejtimin e procesit gjyqësor por edhe të një rruge ligjore kompensuese, duke shtuar se *“fakti që kjo rrugëzgjdhje tërësisht kompensuese nuk mund të përdoret për përshpejtimin e procesit të papërfunduar ende nuk është vendimtar. Gjykata rithekson në lidhje me këtë se ka mbajtur qëndrimin se rrugëzgjdhjet ligjore që ka në dispozicion pala ndërgjyqëse brendapërbrenda vendit për të paraqitur një ankesë lidhur me kohëzgjatjen e procesit janë “të efektshme”, në kuptim të nenit 13 të Konventës, nëse e “parandalojnë” shkeljen e pretenduar apo vazhdimin e saj, ose nëse ofrojnë ndreqje adekuate për çdo shkelje që ka ndodhur”*.

Për rrjedhojë, neni 13 ofron një mundësi, pra që rrugëzgjdhjet janë “të efektshme” nëse mund ta detyrojnë gjykatën në fjalë të marrë vendim më herët ose t'i japë palës kompensim adekuat për vonesat e ndodhura (aktgjykimi i çështjes “Kudla”, pika 159). Sipas Gjykatës, duke pasur parasysh lidhjet e ngushta midis nenit 13 dhe nenit 35 pika 1 (shih edhe aktgjykimin e çështjes “Kudla”, pika 152), për rrugëzgjdhjet ligjore të brendshme në kuptim të këtij të dytit zbatohet të njëjtat kritere të efektivitetit.

Por mbi të gjitha, në aktgjykimin e lartpërmendur të çështjes “Mifsud - Francë”, dhe më pas në aktgjykimin e çështjes “Nouhad - Francë”, datë 9 korrik 2002, Gjykata mban qëndrimin se rrugëzgjdhjet kompensuese janë të mjaftueshme për të vendosur mospranimin për shkak të mosshterimit të rrugëzgjdhjeve ligjore të brendshme¹⁷.

Rrjedhimisht, Gjykata tani u jep shteteve dy alternativa në legjislacionin e brendshëm, ose t'u ofrojnë paditësve kompensim për cenim të shkaktuar nga vonesa të tepruara, ose të mundësojnë, me kërkesë të paditësit, përshpejtimin e procesit. Do të shohim në pjesën e dytë të këtij raporti se ka një gamë të gjerë “rrugëzgjdhjes të efektshme”. Mirëpo, Gjykata rregullisht rikujton se *“zgjdhja më e efektshme” është një rrugëzgjdhje që synon përshpejtimin e proceseve, “meqë parandalon edhe konstatimin e shkeljeve të mëpasshme lidhur me të njëjtin proces gjyqësor dhe jo thjesht riparacion shkeljen a posteriori...”* (për shembull, aktgjykimi i Kolegjit Gjyqësor në çështjen “Scordino - Itali” (nr.1), datë 29 mars 2006, pika 183 dhe 184).

Por, siç thuhet më lart, kërkohen vetëm apelime të mundshme dhe të duhura¹⁸. Kjo nënkupton më tej se rrugëzgjdhje të tilla u nënshtrohen edhe kërkesave të afatit kohor të efektshëm dhe të arsyeshëm dhe kështu monitorohen nga Gjykata Evropiane.

¹⁶ Aktgjykimi “Kudla”, pika 152

¹⁷V. S. Guinchard, “Procès équitable” (Proces me barazi), *Répertoire Procédure Civile*, Dalloz, mars 2011, f. 94, Nr. 347.

¹⁸R. Bindels, “L'influence du droit d'être jugé dans un délai raisonnable prévu par l'article 6 § 1 de la Convention européenne des droits de l'homme sur l'administration de la justice civile belge”, në *Annales de Droit de Louvain*, Vol. 62, 2002, nr. 3 dhe 4, f. 349-428.

B. Verifikimi i efektivitetit të rrugës ligjore

Sipas Gjykatës barra u takon autoriteteve të Shtetit që të dëshmojnë, në çështje të ngritur përpara saj, efektivitetin e rrugëzgjdhjes ligjore në fjalë: me anë të jurisprudencës më të re Shteti mund ta ndryshojë kështu qëndrimin e Gjykatës Evropiane. Por kjo do të thotë gjithashtu se ekzistenca e një rrugëzgjdhjeje të efektshme në nivel të brendshëm nuk mund të merret si e mirëqenë dhe mund të rikontrollohet nga Gjykata e Strasburgut.

Nëse shohim shembullin portugez, kur vendosi për ta rrëzuar çështjen “Paulino Tomas - Portugali”, datë 27 mars 2003, Gjykata u shpreh, për herë të parë, se dekreti legjislativ i datës 21 nëntor 1967, për përgjegjësinë jashtëkontraktore të shtetit ishte një mjet i efektshëm për të kundërshtuar kohëzgjatjen e procesit. Deri atëherë, Komisioni vazhdimisht i kishte rrëzuar argumentet e mbështetura në këtë dekret (shih vendimin për çështjen “Gama da Costa - Portugali”, datë 5 mars 1990), sepse nuk kishte asgjë në jurisprudencë për të treguar se ankimi përmes kësaj rruge do të kishte gjasë të kishte sukses. Mirëpo, pas ndryshimit të praktikës së gjykatës së lartë administrative më 15 tetor 1998 në aktgjykimin e çështjes “Pires Neno”, Këshilli konstatoi se, deri më tetor 1999, kjo rrugëzgjdhjeje kishte përfutur aq siguri juridike të mjaftueshme për t’u përdorur në funksion të nenit 35, pika 1, të Konventës, sa për t’u konsideruar si e mundshme dhe e nevojshme.

Në një tjetër çështje portugeze, në fushën penale, Gjykata mbajti qëndrimin se paraqitja e kërkesës për një urdhër për përshpejtimin e procesit sipas nenit 108 dhe 109 të Kodit të Procedurës Penale ishte një parakusht për çdo padi të ngritur përpara Gjykatës dhe një rrugë ligjore që duhej të shterohej paraprakisht (vendimi për pranueshmërinë e çështjes “Moreira Barbosa”, datë 29 prill 2004)¹⁹. Gjykata konstatoi se në këtë çështje paditësi e kishte ushtruar këtë drejtë pa arritur sukses dhe se paditësi nuk ishte i detyruar të ngrinte padi në bazë të përgjegjësisë jashtëkontraktore sipas dekretit legjislativ të vitit 1967, qëllimi i të cilit është në fakt i njëjtë. Për rrjedhojë, Gjykata e rrëzoi argumentin e qeverisë se nuk qenë shteruar rrugët ligjore të brendshme²⁰.

Situata në Itali është një ilustrim i mirë i natyrës së mbikëqyrjes nga Gjykata Evropiane. Në Itali, ligji “Pinto”, datë 24 mars 2001, parashikon një rrugë ligjore për shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga kohëzgjatja e tepruar e procesit gjyqësor. Në vendimin e çështjes “Brusco - Itali”, datë 6 shtator, Gjykata e rrëzoi kërkesëpadinë e paraqitur përpara hyrjes në fuqi të ligjit të lartpërmendur, por pasi e informoi paditësin për ekzistencën e ligjit në fjalë dhe pasi i kërkoi t’u rikthehet gjykatave të brendshme (për një shembull të kohëve më të fundit lidhur me rrëzimin e kërkesëpadisë në bazë të ligjit “Pinto”, shih vendimin e çështjes “Daddi - Itali”, datë 16 qershor 2009).

Përpara vitit 2004, Gjykata kishte marrë shpesh vendime kundër Italisë për shkelje të së drejtës për t’u dëgjuar brenda një afati kohor të arsyeshëm. Mirëpo, një përmirësim i dallueshëm është vënë re që pas vitit 2004. Sidoqoftë, ka pasur ca shkelje më të reja (shih Shtojcën, ndryshimet “zigzag” në konstatimet kundër Italisë në periudhën 2006-2011). Në disa aktgjykime të Kolegjit të Gjykatës në vitin 2006, duke përfshirë edhe aktgjykimin e çështjes “Scordino” (nr.1), datë 29 mars 2006²¹, Gjykata ka konstatuar se me qindra raste kompensimi të miratuara nga gjykatat e brendshme në Itali sipas Ligjit “Pinto” ndodhen ende pa një vendim përfundimtar përpara gjykatave, dhe i kërkon Italisë të bëjë të gjithë hapat e nevojshëm për të siguruar që rrugët ligjore kompensuese të parashikuar nga ligji “Pinto” të jenë “të efektshme”. Zbatimi i kësaj rruge ligjore konsiderohet i pamjaftueshëm kryesisht për shkak të vlerës së dëmshpërblimeve të miratuara dhe kohëzgjatjes së tepruar të proceseve me të cilat lidhen²². Gjykata Evropiane thekson në aktgjykimet madhore të saj se rrugëzgjdhje ligjore “e efektshme” është ajo që mundëson ose përshpejtimin e procesit ose dhënien e kompensimit të duhur palës ndërgjyqëse.

¹⁹ Shih edhe vendimin e çështjes “Tomé Mota - Portugali”, nr.32082/96

²⁰ Shih edhe çështjen “I.S - Sllovaki”, datë 4 prill 2000, pika 31.

²¹ Shih, në lidhje me të drejtën për t’u dëgjuar brenda një afati të arsyeshëm kohor, edhe çështjet “Cocchiarella - Itali”; “Giuseppe Mostacciolo - Itali” (Nr. 1); “Musci - Itali”; “Giuseppina dhe Orestina Procaccini - Itali”; “Riccardi Pizzati - Itali”; “Ernestina Zullo - Itali”; “Apicella - Itali”.

²² Gjykata e Kasacionit e Italisë ka bërë në të vërtetë një ndryshim të kahut të jurisprudencës në katër aktgjykime të shkallës së kasacionit, të nxjerrë më 27 nëntor 2003 (Nr. 1338, 1339, 1340 dhe 1341), në të cilët konfirmonte se “jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut duhet marrë në konsideratë nga gjykatat italiane kur të zbatojnë Ligjin nr.89/2001 (...). Megjithatë përcaktimi i dëmit jo pasuror sikurse bëhet nga Gjykata e Apelit në përputhje me nenin 2 të Ligjit nr.89/2001 është për nga natyra e vet e mbështetur në vënie dhe barazisë, ai duhet të bëhet në një mjedis të përcaktuar me ligj, sepse duhet bërë lidhja me vlerat e miratuara në çështje të ngjashme nga Gjykata e Strasburgut, nga e cila mund të ndryshojë por vetëm për aq sa është e arsyeshme”.

Në rastin e dytë, vetë rrugëzgjdhja duhet të përkojë me kërkesën ligjore për afat kohor të arsyeshëm dhe Gjykata tregohet më e rreptë kur vlerëson efektivitetin e kësaj rruge ligjore, për shembull duke mbajtur qëndrimin se afati për ekzekutimin e një vendimi të marrë në bazë të një rruge ligjore kompensuese “*në përgjithësi të mos jetë më shumë se gjashtë muaj prej momentit kur vendimi i shpërblimit të dëmit bëhet i ekzekutueshëm*” (pika 198). Për më tepër, ndërkohë që një gjykatë e brendshme ndodhet në pozitën më të mirë për të konstatuar ekzistencën e dëmit dhe për të përcaktuar vlerën e shpërblimit të dëmit, kohëzgjatja e tepruar e procesit konsiderohet se shkakton dëm jo pasuror, kompensimi për të cilin varet nga karakteristikat dhe efektiviteti i rrugëzgjdhjes ligjore të brendshme, por kjo vlerë duhet të mos jetë e paarsyeshme kundrejt shumave të përcaktuara nga Gjykatave (Gjykata vëren në këtë aspekt se dëmshpërblimi i miratuar është jo më shumë se 10% e shumave gjithsej që miraton zakonisht ajo vetë, pika 214)²³.

Pra, rrugëzgjdhjet ligjore kompensuese në vetvete nuk përbëjnë rrugë ligjore të efektshme, të duhura dhe të arritshme. Sipas pikëpamjes së Gjykatës Evropiane, një efektivitet i tillë kërkon edhe një nivel të mjaftueshëm kompensimi. Gjykata i ndjek me kujdes këto cilësi (shih, për shembull, aktgjykimin e çështjes “Vidas - Kroaci”, datë 3 korrik 2008). Sipas jurisprudencës evropiane, niveli adekuat i rrugëzgjdhjes ligjore mund të cenohet nga koha e tepruar që është shpenzuar për shqyrtimin apo nga dhënia e një dëmshpërblimi në vlerë shumë më të pakët se shumatat që jep Gjykata në çështje gjyqësore të ngjashme. Kështu, Gjykata Evropiane verifikon efektivitetin e dëmshpërblimit në bazë të kriterëve të mëposhtme: vlera e dëmshpërblimit të miratuar, kohëzgjatja e procedurës së dëmshpërblimit dhe shpejtësia e pagimit të dëmshpërblimit (shih vendimin e çështjes “Cocchiarella - Itali”, datë 29 mars 2006, pikat 86-98).

Kjo mënyrë verifikimi është përdorur në çështjen e kohëve të fundit “Sartory - Francë”, vendim datë 24 shtator 2009. Objekti i çështjes kishte të bënte me një procedurë të anulimit të transferimit të një nëpunësi civil e cila zgjati gjashtë vjet, periudhë e konsideruar e tepruar. Gjykata verifikoi kohëzgjatjen dhe rezultatin e procedurës së dëmshpërblimit. Kjo procedurë kishte filluar në vitin 2002, i qe kaluar Këshillit të Shtetit në 2006 dhe kishte përfunduar në 2007 me një ofertë për shpërblim dëmi prej 3 mijë euro.

Gjykata vendosi se kjo shumë e miratuar nga Këshilli i Shtetit nuk qe adekuate në kushtet e kohëzgjatjes së tepruar të procesit të lidhur me objektin e çështjes dhe në kushtet e procedurës së dëmshpërblimit të çelur sipas nenit R 311-1 të Kodit të Drejtësisë Administrative dhe konstatoi shkelje të nenit 6 pika 1. Kjo i dha mundësi paditësit të pretendonte se qe viktimë në kuptim të nenit 34 të Konventës ngaqë reparacioni kishte qenë i papërshtatshëm dhe i pamjaftueshëm, pavarësisht njohjes së shkeljes së kohëzgjatjes së arsyeshme të procesit administrativ²⁴.

Pra, shumata e dëmshpërblimit është një faktor thelbësor për të siguruar njohjen e përshtatshmërisë dhe efektivitetit të rrugëzgjdhjes ligjore. Mirëpo, kjo shumë varet edhe nga karakteristikat dhe efikasiteti i rrugëzgjdhjes ligjore të brendshme në përgjithësi. Një Shtet i cili ka futur disa rrugë ligjore, përfshirë edhe atë që ka për qëllim përsheptimin e procesit dhe atë që ka për qëllim shpërblimin e dëmit, dhe i cili, në përputhje me traditën juridike të vendit dhe standardin e jetesës në atë vend, nxjerr vendime që janë të shpejta, të arsyetuara dhe të ekzekutuara shumë shpejt, mund të miratojë shumata dëmshpërblimi që nuk janë të arsyeshme, që janë edhe më të ulëta se ato të vendosura nga Gjykata²⁵. Kështu, gjykatat e brendshme mund të përdorin si pikë referimi shumatat e miratuara në nivel të brendshëm për llojet e tjera të dëmeve dhe të mbështeten në bindjet e brendshme të tyre, edhe sikur kjo të çojë në miratimin e shumave më të vogla se ato të vendosura nga Gjykata Evropiane në çështje të ngjashme (shih, për shembull, vendimin e çështjes “Apicella - Itali”, datë 29 mars 2006, pikat 78, 94 dhe 95).

Jurisprudenca e Gjykatës gjithashtu në përgjithësi e konkretizon përgjegjësinë e Shtetit për kohëzgjatjen e tepruar të proceseve në sistemin e tij gjyqësor (shih aktgjykimin e Kolegjit të Gjykatës në çështjen “Burdov - Rusi” (nr.2), datë 15 janar 2009, pika 111), duke paraqitur si argument, siç kemi thënë, hipotezën për dëm jopasuror dhe duke i kërkuar gjykatës që merret me dëmshpërblimin të japë arsyet e veçanta për çdo vendim që bie ndesh me këtë (shih aktgjykimin e lartpërmendur të çështjes “Apicella - Itali”, pika 93, dhe “Cocchiarella - Itali”, pika 94).

²³ Lidhur me situatën në Itali, shih rezolutën e kohëve të fundit të Këshillit të Ministrave CM/ResDH(2009)42, datë 19 mars 2009.

²⁴ Obs.N. Fricero, *Procedures* No. 11, nëntor 2009, Comm. 363.

²⁵ Shih Udhëzuesin e Praktikës së Mirë, *op. cit.*, Nr. 107, f. 24 dhe 25.

Duhet thënë gjithashtu se dëmshtëpërblimi jo gjithmonë duhet të jetë financiar. Në pjesën e dytë të këtij raport shikohen format e ndryshme të mundshme të procedurave paragjyqësore të vendosura nga Shtetet pas konstatimet negative të Gjykatës Evropiane, si edhe evoluimi i këtyre procedurave.

Gjithashtu, në jurisprudencën e kohëve të fundit Gjykata Evropiane e ka përshkruar në mënyrë të dallueshme, ndonjëherë me shumë hollësi, llojin e masës që e konsideron të përshtatshme për kompensimin e shkeljeve të së drejtës për t'u dëgjuar brenda një afati kohor të arsyeshëm. Në çështjen “Yakışan - Turqi”, vendim datë 6 mars 2007, për kohëzgjatjen e procesit penal (thujse 13 vjet dhe ende të pambyllur më datën e dhënies së vendimit) dhe kohëzgjatjen e paraburgimit (11 vjet e 7 muaj, edhe ende vazhdonte më datën e dhënies së vendimit), Gjykata konstatoi shkelje të nenit 5, pika 3, dhe të nenit 6, pika 1, dhe përfshiu një pikë të posaçme në përputhje me nenin 41, për të thënë se mendonte se një mjet i duhur për zgjidhjen e shkeljes së konstatuar do të ishte dhënia fund sa më shpejt e procesit penal, duke marrë në konsideratë kërkesat për dhënien e duhur të drejtësisë, ose lirimi i paditësit gjatë procesit, sikurse parashikohet në nenin 5, pika 3.

Por në çështjen “De Clerck - Belgjikë”, vendim datë 25 shtator 2007, Gjykata e kufizoi këtë qasje. Në këtë çështje, paditësit i kishin kërkuar Gjykatës të urdhëronte ndërprerjen e menjëhershme të procesit penal të çelur kundër tyre, me arsyetimin se qe në tejkalim të kërkesës për kohëzgjatje të arsyeshme të procedurës hetimore penale, sipas nenit 46 të Konventës. Gjykata e rrëzoi kërkesëpadinë, duke theksuar se nuk mund t'u jepte urdhër autoriteteve të pavarura gjyqësore për ndërprerjen e një ndjekjeje penale të çelur në mënyrë të ligjshme.

I. KRITERET E VENDOSURA PËR VLERËSIMIN E KOHËZGJATJES

Përkufizimi i afatit kohor të arsyeshëm dhe prezantimi i metodave që përdor Gjykata Evropiane: përgjithësisht, Gjykata përdor gjuhën e mëposhtme: *“arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procesit duhet vlerësuar në bazë të rrethanave të çështjes dhe duke u kushtuar vëmendje kritereve të vendosura nga jurisprudenca e Gjykatës, sidomos kompleksitetin e çështjes, sjelljen e paditësit dhe sjelljen e autoriteteve përkatëse”.*

Që prej aktgjykimit të çështjes “Neumeister”, datë 27 qershor 1968, këto tre kritere zbatohen njësoj nga Gjykata si për çështjet penale ashtu edhe për ato civile. Në aktgjykimin e çështjes “König”, datë 28 qershor 1978, shtoi edhe një kriter tjetër, pra çfarë interesi rrezikon paditësi.

Duke u mbështetur në këto kritere, Gjykata bën një vlerësim të përgjithshëm në përputhje me qasjen e saj praktike (shih pikën E, më poshtë). Vlerësimet e përgjithshme, ndër të tjera, konstatojnë se afatet kohore që, të marra më vete, nuk do të ishin të paarsyeshme bëhen të paarsyeshme nëse mblidhen bashkë. Vlerësimet praktike kërkojnë këqyrjen e “rrethanave të veçanta të çështjes” në mënyrë që të vlerësohet në se kohëzgjatja e procesit është e arsyeshme apo e paarsyeshme (aktgjykimi “König - RFGJ”, 28 qershor 1978).

A – KOMPLEKSITETI I ÇËSHTJES

Kompleksiteti i çështjes mund ta justifikojë një proces të zgjatur. Një kompleksitet i tillë mund të ketë lidhje ose me rregullat ligjore të zbatueshme për ndërgjyqësinë ose me faktet e çështjes.

Kur ka të bëjë me **rregullat ligjore**, kompleksiteti mund të vijë nga disa burime: një ndryshim i legjislacionit, kalimi i Shtetit drejt ekonomisë së tregut, ndërveprimi mes procedurave administrative dhe gjyqësore (për shembull, pushimi nga puna i një punonjësi me aftësi të kufizuar në Austri dhe Francë), pritshmëria që vendimi i procesit penal të zhblllokojë procesin civil²⁶, ndërthurja ose bashkëlidhja e disa çështjeve, nevoja për të pajtuar interesat e individit me ato të komunitetit, prania e disa të pandehurve në gjykatë, etj.

²⁶ Aktgjykimi i çështjes “Djanzozov - Bullgari”, datë 8 korrik 2004.

Kompleksiteti i fakteve të çështjes mund të lindë nga nevoja për të marrë në intervistë një numër të madh dëshmitarësh, nga problemet lidhur me lokalizimin e dëshmitareve (aktgjykimi i çështjes “Mitev - Bullgari”, datë 22 dhjetor 2004) dhe nga procesi i zgjatur i rindërtimit të fakteve dhe marrjes së provave (aktgjykimi i çështjes “Akçakale - Turqi”, datë 25 maj 2004), ose nga mungesa totale e dëshmitarëve në një çështje penale (komisioni, çështja “Jean-Claude Boddaert - Belgjikë”, datë 17 prill 1991).

Faktorë të tjerë ndërlikues janë përdorimi i ekspertëve të specializuar ose nevoja për përkthimin e dokumenteve apo për të përdorur përkthim verbal (në aktgjykimin e çështjes “Sari - Turqi dhe Danimarkë”, datë 8 nëntor 2001, e cila kishte të bënte me një vrasje të kryer në Danimarkë nga paditësi, një shtetas turk, Gjykata tërhoqte vëmendjen drejt vonesave faktike që kishin lindur nga nevoja për ta përkthyer procesin në dy gjuhë).

Disa çështje të caktuara janë komplekse si për arsye faktike ashtu edhe për arsye juridike, siç është nevoja për të ditur, prej më shumë se njëzet vjetësh, nëse paditësi ka qenë apo jo në gjendje falimentimi më 14 shtator 1971 dhe, nëse jo, cilat kanë qenë pasuritë e tij atë vit²⁷.

Gjithashtu Gjykata duket se disa çështje të caktuara i trajton si komplekse për nga vetë natyra e tyre. Të tilla janë për shembull, konsolidimi i tokave, blerja me detyrim, çështjet e krimit ekonomik dhe veprat penale financiare ndërkombëtare.

Për shembull, në çështjen “Wiesinger - Austri”, datë 30 tetor 1991, kishte të bënte me një skemë të konsolidimit të tokave, Gjykata e pranonte *“sikurse e pranojnë të gjithë pjesëmarrësit e procesit të Strasburgut, se konsolidimi i tokave është, për nga natyra që ka, një proces kompleks i cili prek interesat si të individit ashtu edhe të komunitetit në tërësi”* (ky problem ishte ngritur më parë në çështjen “Erkner dhe Hofauer”).

Në vendimin e çështjes “Wejrup- Danimarkë”, datë 7 mars 2002, në lidhje me një çështje krimi ekonomik, Gjykata citonte kompleksitetin e çështjes, e cila kishte të bënte me veprimtaritë e shefit të financës të një shoqërie holding me një grup prej pesëdhjetë shoqëri tregtare në mbarë botën dhe kërkonte këqyrjen e llogarive të këtyre shoqërive tregtare për një periudhë pesëvjeçare. Gjykata vërente se *“shkalla dhe kompleksiteti i një çështjeje penale që ka të bëjë me një krim ekonomik, i cili shpesh komplikohet më tej nga përzierja e disa personave të dyshuar, mund ta justifikojë kohën e zgjatur të procesit”*.

Në aktgjykimet e çështjeve “C.P. dhe të tjerë - Francë” (datë 18 tetor 2000) dhe “Hozee - Vendet e Ulëta” (22 maj 1998), Gjykata konstatonte se nuk qe shkelur neni 6, pika 1. Megjithatë, në çështjen e parë, procesi kishte zgjatur shtatë vjet, nëntë muaj e njëzetegjashtë ditë.

Në çështjen “Hozee” të përmendur më lart, Gjykata e shqyrtoi procesin me hollësi për të analizuar kompleksitetin e zhbërjes së një rrjeti shoqëri tregtare të ndërlidhura dhe të një sistemi kontabël që ishte bërë enkas sa më i vështirë në mënyrë që të autoritetet të mos i zbulonin praktikave të paligjshme në fushën fiskale dhe atë të sigurimeve shoqërore.

Gjykata e këqyri me hollësi këtë etapë të procedurës dhe e drejtoi vëmendjen drejt kompleksitetit të detyrës së zbrërthimit të një rrjeti shoqëri tregtare dhe llogarish të pleksura të cilat qenë krijuar në mënyrë të atillë që t’ua bënin sa më të vështirë autoriteteve zbulimin e praktikave të paligjshme fiskale dhe të sigurimeve shoqërore.

Gjykata vërente gjithashtu se autoriteteve u duhej të merrnin dëshmi nga një numër i konsiderueshëm dëshmitarësh dhe të merrnin dhe këqyrnin një vëllim shumë të konsiderueshëm materialesh, dhe se shkalla dhe kompleksiteti i hetimit ndërlikohej më tej nga përzierja e të dyshuarve të tjerë në këtë krim. Gjykata arrinte në përfundimin se nuk kishte pasur asnjë periudhë pasiviteti dhe se kohëzgjatja e hetimit nuk kishte qenë e paarsyeshme.

Në një çështje që kishte të bënte me kushtetutshmërinë e një tatimi mbi energjinë elektrike, Gjykata vërente se kjo çështje ishte komplekse ngaqë Gjykatës Kushtetuese i duhej të kërkonte dhënien e mendimeve nga një sërë autoritetesh (aktgjykimi i çështjes “Klein - Gjermani”, datë 27 korrik 2000).

²⁷ Aktgjykimi i çështjes “Sablon - Belgjikë”, datë 10 prill 2001 (vetëm në frëngjishte).

Por jo gjithmonë kompleksiteti i një çështjeje mjafton për ta justifikuar kohëzgjatjen e procesit. Në lojë hyjnë edhe kritere të tjera dhe Gjykata bën një vlerësim të përgjithshëm në bazë të të gjitha kritereve të ndryshme.

B – SJELLJA E PADITËSIT

Ky kriter përbën një veçanti: është i vetmi kriter i cili mund të kërkojë një relacioni për mos-shkeljen, ndërsa në të njëjtën kohë ka një procedurë të zgatur dhe kështu, krahas kësaj, nuk mund të konstatohet asnjë pasivitet për t'u shënuar i juridiksioneve kombëtare. Nëse është shkaku thelbësor i vonesës, nuk ka shkelje të nenit 6, pika 1. Në përputhje me këtë Gjykata merr në shqyrtim çështjen se kujt i takon faji për kohëzgjatjen e tepruar të procesit.

Në vendimin e çështjes “Oberling - Francë”, datë 11 prill 2006, Gjykata vërente se *megjithëse paditësi mund të akuzohej për mungesë korrekte në parashtrimin e deklarimeve në shkallën e parë, një sjellje e tillë në asnjë mënyrë nuk e shpjegon kohëzgjatjen e procesit në shkallën e apelit*, pra gjashtë vjet e dy muaj për të dy proceset administrative.

Në një vendim për pranimin e kërkesëpadsisë, për një çështje civile²⁸, Komisioni rikujtonte *“se ajo që kërkohet në kuadër të një procedure civile është një “korrektesë normale” dhe se vetëm ngadalësia në Shtetin mund të çojë në përfundimin se ka një “vonesë e arsyeshme”.* Në këtë rast, kjo tregonte mos-shkeljen e nenit 6, pika 1, duke çmuar se më së shumti ishte sjellja jo korrekte e paditësit ajo që qe përgjegjëse për kohëzgjatjen “para së gjithash të paarsyeshme” pra më shumë se dhjetë vjet për një procedurë divorci.

Në një çështje penale, Gjykata ka mbajtur qëndrimin se *“... neni 6 nuk u kërkon paditësve të bashkëpunojnë aktivisht me autoritetet gjyqësore”* (aktgjykimi i çështjes “Eckle - Republika Federale e Gjermanisë, datë 15 korrik 1982, pika 82)²⁹. Sikurse Komisioni, edhe Gjykata është e mendimit *“se personit në fjalë i kërkohet vetëm të tregojë korrektesë në kryerjen e hapave proceduralë në lidhje me të, të mos përdorë taktika vonuese dhe të shfrytëzojë fushëveprimin që i ofron legjislacioni i brendshëm lidhur me shkurtime të procesit. Ai nuk ka asnjë detyrim të ndërmarrë masa që nuk janë për këtë qëllim”* (aktgjykimi i çështjes “Alimentaria Sanders SA”, datë 7 korrik 1989). Sidoqoftë, *“sjellja e paditësit përbën një fakt objektiv i cili nuk mund t'i ngarkohet Shtetit të paditur dhe i cili duhet marrë në konsideratë gjatë konstatimit nëse afati kohor i arsyeshëm i përmendur në nenin 6, pika 1... është tejkaluar apo jo”* (aktgjykimi i çështjes “Wiesinger - Austri”, datë 30 tetor 1991, pika 57)³⁰.

Në çështje penale, Gjykata gjithmonë e zbrit kohën gjatë së cilës paditësi i është shmangur drejtësisë. Në çështjen e lartpërmendur “Sari - Turqi dhe Danimarkë”, Gjykata shprehej se periudha prej dy vjet, katër muaj dhe gjashtë ditë, prej datës 23 shkurt 1990, data e arratisë së tij, deri më datë 29 qershor 1992, data e arrestimit të tij në Stamboll, ishte përgjegjësi vetëm e paditësit, i cili në këtë kohë iu shmang drejtësisë me vullnetin e tij të lirë (aktgjykimi vetëm në frëngjishte). Gjykata theksonte se detyrimi për t'u paraqitur përpara gjykatës qe një element thelbësor i procesit gjyqësor, me përjashtim të forcës madhore ose të një justifikimi legjitim, dhe se nuk bëhej fjalë që paditësi të përfitonte nga vendimi i tij për t'iu larguar drejtësisë.

Gjykata ka marrë në konsideratë edhe faktin se një paditës e vonoi procesin duke mos ua dhënë adresën autoriteteve (aktgjykimi i çështjes “Mitev - Bullgari”, datë 22 dhjetor 2004).

Mirëpo, ajo përjashton çdo vonesë që do të konsiderohej pasojë e forcës madhore. Për shembull, shtrimi i përsëritur në spital i paditësit gjatë procesit, për shkak të shëndetit të lig, nuk mund të konsiderohej përgjegjësi e tij (aktgjykimi i çështjes “Lavents - Letoni”, datë 28 shkurt 2003).

Në aktgjykimin e çështjes “Jetzen - Luksemburg”, datë 4 mars 2008, Gjykata Evropiane theksonte se neni 6 nuk u kërkonte personave në fjalë të bashkëpunonin aktivisht me autoritetet gjyqësore. Këta persona nuk mund të fajësoheshin as për shfrytëzimin e plotë të mundësive që u ofronte legjislacioni i brendshëm. Sidoqoftë, sjellja e paditësit përbën një fakt objektiv i cili nuk mund t'i ngarkohet Shtetit të paditur dhe i cili duhet marrë në konsideratë gjatë konstatimit nëse procesi e ka tejkaluar apo jo një afat

²⁸ Vendim përfundimtar për pranueshmërinë, “Hervouet - Francë”, datë 2 korrik 1997.

²⁹ “Corigliano - Itali”, datë 10 dhjetor 1982, pika 42.

³⁰ Cituar në “Versini - Francë”, datë 10 korrik 2001.

kohor të i arsyeshëm. Një shembull i një pengese objektive është kur i pandehuri mungon në mënyrë të përsëritur nga seancat për arsye shëndetësore (aktgjykimi i çështjes “Rashid - Bullgari” (nr.2), datë 5 qershor 2008).

Paditësit mbahen përgjegjës për vonesën vetëm në rastin e vullnetit të keq të dëshmuar. Për shembull, në proceset penale, Gjykata ka vendosur se paditësi, i cili kishte paraqitur dy ankesa, nuk e kishte penguar procesin sepse për vonesat në këtë të fundit përgjegjësinë e kishin autoritetet, gjyqtari i parë hetues qëndroi pasiv 18 muaj (aktgjykimi i çështjes “Malet - Francë”, datë 11 shkurt 2010).

Në një çështje civile italiane jashtëzakonisht të gjatë (15 vjet) Gjykata pajtohej me Komisionin se dy paditësit nuk kishin vepruar asnjëherë për ta përshpejtuar shqyrtimin e çështjes së tyre, përkundrazi kishin paraqitur një varg të tërë kërkesash për shtyrje (të paktën 17 seanca të shtyra), dhe vendosi se përgjegjës për vonesat në proces qenë ata vetë, duke arritur në përfundimin se nuk qe shkelur neni 6, pika 1³¹.

Për rrjedhojë, Gjykata e bën qartë dallimin këtu. I takon vetë paditësit të vendosë ta rihapë apo jo procesin apo ta kalojë në një gjykatë tjetër, në përputhje me aktet nënligjore për proceset civile dhe sipas nismës së palëve, dhe gjykatat nuk mund të ndikojnë në vendime të tilla.

Situata është ndryshe në rastin e apatisë së paditësi gjatë rrjedhës së procesit. Gjykatat duhet të sigurojnë që procesi të ecë pa pengesa, për shembull duke vepruar në mënyrë të vëmendshme kur i kërkohet të miratojë një kërkesë për shtyrje të seancës, të dëgjojë dëshmitarë apo të ndjekë afatet e vendosura për përgatitjen e akt-ekspertizës³².

Mirëpo, paditësit nuk mund të kritikohen se i përdorin të gjitha rrugët ligjore në dispozicion të tyre. Në aktgjykimin e çështjes “Guerreiro- Portugali”, datë 31 janar 2002, Gjykata argumentonte se “*nuk mund t’u vihet faji paditësve se i kanë shfrytëzuar plotësisht rrugët ligjore në dispozicion të tyre sipas legjislacionit të brendshëm*” (aktgjykimi i çështjes “Erkner dhe Hofauer - Austri”, datë 23 prill 1987, pika 68). Në këtë rast, edhe pse disa prej apelimeve të paditësve qenë rrëzuar, apelimi i regjistruar më 13 mars 1990 kishte qenë pjesërisht i suksesshëm.

Gjykata vërente gjithashtu se nuk mund të kritikohet qëndrimi i një paditësi nëse thjesht kishte shfrytëzuar të drejtën që parashikon ligji, edhe sikur ushtrimi i kësaj të drejte (konkretisht kërkesa për akt-ekspertizë) të jetë arsyeja kryesore e vonesës së procesit (aktgjykimi i çështjes “Sopp - Gjermani”, datë 8 tetor 2009, pika 35; shih edhe aktgjykimin e çështjes “Bendayan Azcantot dhe Benalal Bendayan - Spanjë”, datë 9 qershor 2009, pika 73).

Gjykata i këqyr nga afër vonesat që mund të shkaktohen nga sjellja e paditësit. Në aktgjykimin e çështjes “Proszak- Poloni”, datë 16 dhjetor 1997, Gjykata identifikonte një sërë kundërshtimesh pa bazë, mospjesëmarrje në seancë, të justifikuara vetëm pjesërisht me arsye mjekësore, bashkërendim të keq mes paditëses dhe avokatit të saj dhe mospranimi nga e saj për të marrë pjesë në ekzaminimin psikiatrik që ishte shumë e rëndësishme për vonesat në proces, dhe konstatonte se nuk kishte shkelje të nenit 6, pika 1.

Në një çështje tjetër polake, shkaku kryesor i vonesave procedurale ishte sjellja e paditësit dhe i të pandehurit tjetër në procesin penal, kështu që Gjykata arriti në përfundimin se periudha prej gjashtë vjetësh dhe një muaji për aq sa kishte zgjatur procesi me këtë vepër të rëndë mashtrimi nuk ishte e paarsyeshme. Gjykata e kritikonte mospjesëmarrjen e përsëritur në seancë të paditësit për arsye mjekësore të pajustificuara dhe mospjesëmarrjen në ekzaminimin mjekësor të vendosur nga gjykata për të parë nëse mund të merrte apo jo pjesë në proces³³.

³¹ Aktgjykimi i çështjes “Circosta dhe Viola - Itali”, datë 4 dhjetor 1995.

³² Aktgjykimi i çështjes “Patrianakos - Greqi”, datë 15 korrik 2004. Për lindjen e një detyrimi të ri për përgatitjen e një çështjeje për gjykim në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane. Shih më poshtë.

³³ Aktgjykimi i çështjes “Klamecki - Poloni”, datë 28 mars 2002.

Në një çështje, ku procesi zgjati shatë vjet e dy muaj në të dy shkallët e gjykimit, nuk u konstatua asnjë shkelje; Gjykata e shpjegoi kështu analizën e saj: *“paditësi nuk ka treguar korrektesën që duhet të tregojë një palë në procesin e rregulluar nga rregulla sipas të cilës rrjedhën e procesit civil e kanë në dorë palët, meqë ai ka paraqitur disa kërkesa procedurale jo precize dhe të pabazuara. Sa u takon gjykatave kombëtare, ato nuk mund të mbajnë përgjegjësi për vonesat mjaft të zgjata, duke e bërë të mundur të konsiderohet kohëzgjatja e përgjithshme e procesit si e tepruar.”* (pika 209, përkthim jo zyrtar)³⁴

C – SJELLA E AUTORITETEVE KOMPETENTE

Sipas Gjykatës, sjellja e autoriteteve kompetente, në vetvete, mund të çojë në shkelje të kriterit për afat kohor të arsyeshëm.

1. Argumentet e autoriteteve kombëtare, të pranuar nga Gjykata

Gjykata Evropiane pranon se disa rrethana të caktuara që çojnë në ngarkesë të jashtëzakonshme të gjykatave mund ta çlirojnë nga përgjegjësia shtetin.

Për shembull, në aktgjykimin e çështjes *“Foti dhe të tjerë - Itali”*, datë 10 dhjetor 1982, përpara shqyrtimit më vete të çdo procesi në fjalë, Gjykata vërente *“shkallën e problemeve që kanë ndodhur në Rexho Kalabria nga viti 1970 deri në 1973 [të cilat] ... kanë pasur dy rrjedhoja të rëndësishme për çështjen që kemi përpara. Së pari, ato shkaktuan një klimë politike dhe shoqërore të pazakontë, në të cilën gjykatat e kishin të përligjur frikën nga përshkallëzimi i tensionit dhe madje i rikthimit të trazirave nëse do të shpallnin të pandehurit fajtorë dhe do të jepnin dënime të rënda. Së dyti, këto probleme nuk kanë qenë pa pasoja për funksionimin e drejtësisë penale. Këto pasoja janë ndjerë kryesisht në Gjykatën Rajonale të Rexhos, por edhe gjykatat në Potenca, ku janë transferuar çështjet, janë përballur me një ngarkesë dosjesh të prapambetura me vëllim të jashtëzakonshëm.”* Gjykata arrinte në përfundimin se *“këto rrethana duhen medoemos të mbahen parasysht dhe, sidomos, koha e kaluar për shkak të transferimit të çështjeve nuk duhet konsideruar si e pajustificuar.”*

Në çështjen *“Buchholz”*³⁵, Gjykata mori në konsideratë punën e autoriteteve kombëtare për trajtimin e rritjes së konsiderueshme të ngarkesës së punës të gjykatave të apelit për marrëdhëniet e punës, që kishte ardhur nga rënia ekonomike dhe numri i çështjeve të prapambetura, sidomos në gjykatën e Hamburgut. Numri i posteve gjyqësore u rrit në vitin 1974, kur filloi të rritej numri i çështjeve. Gjykata gjithashtu vërente se gjykata e Hamburgut ia kishte dalë mbanë të merrej me më shumë çështje në 1976 dhe 1977 se në 1974 dhe 1975, ndërsa kohëzgjatja mesatare e proceseve u shkurtua, dhe se u krijua një seksion i gjashtë në vitin 1976 të cilit iu rikalua më shumë se një e dyta e çështjeve ende të hapura përpara një seksioni tjetër. Në fund, për të përshpejtuar punën e gjykatave të marrëdhënieve të punës, Qeveria paraqiti një propozim për një reformë legjislative, e cila u miratua nga asamblëta parlamentare në vitin 1979.

Përkundër faktit se interesi në rrezik ishte i rëndësishëm për paditësin dhe se çështja me objekt marrëdhëniet e punës në fjalë zgjati katër vjet, nëntë muaj e gjashtëmbëdhjetë ditë në të tre nivelet e gjykatave, Gjykata, pas një shqyrtimi të hollësishëm të të gjitha etapave procedurale dhe masave që, në rrethanat e çështjes, sidomos strategjia e mbrojtjes, kishin ndihmuar në vonimin e procesit, arriti në përfundimin se nuk kishte shkelje të nenit 6, pika 1.

Ky arsyetim është konfirmuar në aktgjykimin e çështjes *“Zimmermann dhe Steiner - Zvicër”*, datë 13 korrik 1983, në të cilin Gjykata shprehej se *“një vëllim i prapambetur i përkohshëm nuk do të thotë përgjegjësi e Shteteve Kontraktuese, me kusht që të kenë marrë, me shpejtësinë e kërkuar, masa korrigjuese për ta trajtuar një situatë të jashtëzakonshme si kjo.”*

Mes arsyeve të pranuar nga Gjykata si përjashtim i autoriteteve kombëtare nga përgjegjësia për procesin e zgjatur në mënyrë të tepruar janë një sërë faktorësh specifikë të tillë si ata që lidhen me kërkesat për ndihmën gjyqësore ndërkombëtare në çështjet penale. Në aktgjykimin e çështjes *“Neumeister- Austri”*, datë 27 qershor 1968, Gjykata shprehej se *“për shembull, nuk është e mundur të mbahen përgjegjës autoritetet gjyqësore austriake për vështirësitë në të cilat hasin jashtë vendit për të siguruar ekzekutimin e letër-porosive të shumta të tyre”*.

³⁴ Aktgjykimi i çështjes *“Dosta - Republika Çeke”*, datë 25 maj 2004.

³⁵ Aktgjykimi i çështjes *“Buchholz - Gjermani”*, datë 6 maj 1981.

Po kështu, autoritetet nuk mbajnë përgjegjësi për pasojat e grevave të avokatëve, me përjashtim të rastit kur nuk arrijnë ta përcaktojnë në mënyrë precize efektin e tyre³⁶. Shtetet duhet të bëjnë çmos për ta shkurtuar çdo vonesë (aktgjykimi i çështjes “Papageorgiou - Greqi”, datë 22 tetor 1997).

2. Argumentet e autoriteteve kombëtare, të rrëzuara nga Gjykata

Kur shtetet pretendojnë se një gjykatë përballet me një vëllim të jashtëzakonshëm çështjesh të prapambetura, në përgjithësi Gjykata shprehet se *“neni 6 pika 1 i Konventës u vendos Shteteve Kontraktuese detyrimin për t’i organizuar sistemet gjyqësore të tyre në mënyrë të atillë që t’i përmbushin kërkesat e kësaj dispozite”*, sidomos sa i takon kushtit për afat kohor të arsyeshëm. Kjo kërkesë zbatohet edhe sot, edhe nëse vonesat i shkakton struktura e sistemit gjyqësor të vendit³⁷.

Kufizimet buxhetore të një Shteti nuk mund ta çlirojnë atë Shtet nga detyrimet e veta (aktgjykimi i çështjes “Burdov - Rusi” (Nr. 2), datë 15 janar 2009, pika 65-69).

Shtetet kontraktuese mund të zgjedhin vetë hapat që do të ndjekin për përshtatjen e sistemeve gjyqësore të tyre për të përmbushur kërkesën ligjore për afat kohor të arsyeshëm, por nëse autoritetet nuk marrin masa adekuate shtetet duhet të pranojnë përgjegjësinë, sepse është parë në jurisprudencë se mbingarkesa kronike e çështjeve përpara një gjykate nuk përbën justifikim të vlefshëm për kohëzgjatjen e procesit (shih, ndër të tjera, aktgjykimin e çështjes “Dumont - Belgjikë”, datë 28 prill 2005, vetëm në frëngjishte).

Gjithashtu, *“u takon Shteteve Kontraktuese t’i organizojnë sistemet juridike të tyre në mënyrë të atillë që gjykatat të mund t’u garantojnë të gjithëve të drejtën për të marrë vendim të formës së prerë brenda një afati kohor të arsyeshëm në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve civile të tyre”*.

Ky parim është zbatuar për proceset përpara gjykatave të larta, si në çështjen “Vergos - Greqi”, datë 24 qershor 2004, ku procesi përpara Gjykatës së Lartë Administrative kishte zgjatur katër vjet e njëmbëdhjetë muaj dhe në çështjen “Paummel - Gjermani”, datë 1 korrik 1997, ku vetëm procesi përpara Gjykatës Kushtetuese federale kishte zgjatur pesë vjet e thuajse tre muaj.

Ky parim zbatohet edhe kur ka disa shkallë gjykimi. Në raste të tilla, shtetet janë përgjegjëse sipas nenit 6, pika 1, për çdo periudhë pasiviteti, pavarësisht nëse ky pasivitet është pasojë e tejnngarkesës kronike të gjykatave apo e mungesës së theksuar të personelit gjyqësor.

Shpesh arsyeja e proceseve tejet të gjata penale është koha e përdorur për hetimin e çështjeve. Në një çështje jo të ndërlikuar e cila kishte nxjerrë dy procese penale të cilët kishin zgjatur, përkatësisht, katër vjet dhe katër vjet e tre muaj, Gjykata konstatoi shkelje të nenit 6, pika 1³⁸. Autoritetet u justifikuan se kishte qenë i vështirë lokalizimi i dëshmitarëve, mirëpo Gjykata nuk e pranoi këtë argument, sidomos ngaqë aktgjykimet e gjykatës penale qenë shpallur në mungesë të të pandehurve. Në veçanti, Gjykata konstatoi se tre vjet për të hetuar një ankesë, së cilës paditësi i qe bashkuar si palë civile, ishin të tepruara nëse mbahen në konsideratë rrjedhojat financiare për të.

Në një çështje penale në të cilën paditësi është ndjekur penalisht për njollosje të personit në rrethana rënduese pasi kishte kritikuar sjelljen e dy gjyqtarëve, Gjykata konstatoi se kishte pasur shkelje të nenit 6, pika 1. Sa i takon kohëzgjatjes gjithsej të çështjes, e cila zgjati gjashtë vjet, Gjykata shprehej se *“në pamje të parë, kjo dukej si kalim i konsiderueshëm kohe për një çështje të këtij lloji”*. Pasi shqyrtoi të gjitha fazat e procesit, Gjykata vendosi se faza hetimore, në të cilën kishte pasur dy periudha të pashpjeguara pasiviteti prej katërmëdhjetë dhe tremëdhjetë muaj, kishte qenë tejet e gjatë për një çështje jo komplekse³⁹.

Në çështjet e së drejtës civile, që me aktgjykimin e çështjes “Köning - RFGJ (28 qershor 1978), ku vërente se gjyqtari mund të kishte shkaktuar vonesa edhe në zbatimin e masave hetimore dhe në përcjelljen e dosjes së çështjes për gjykim, Gjykata Evropiane ka përcaktuar një detyrim të veçantë për

³⁶ Aktgjykimi i çështjes “Savvidou - Greqi”, datë 1 gusht 2000.

³⁷ Aktgjykimi i çështjes “Hadjidjanis - Greqi”, datë 28 prill 2005 (vetëm në frëngjishte).

³⁸ Aktgjykimi i çështjes “Dachar - Francë”, datë 10 tetor 2000.

³⁹ Aktgjykimi i çështjes “Corigliano - Itali”, 10 dhjetor 1982.

gjyqtarët që këta ta menaxhojnë dosjen e çështjes në mënyrë të atillë që të sigurojnë një kohëzgjatje të arsyeshme të procesit gjyqësor.

Gjykata e ritheksoi me forcë këtë në dy aktgjykime: “Poelmans - Belgjikë” dhe “Leonardi - Belgjikë”, datë 3 shkurt 2009, ku shprehej se *edhe kur proceset civile rregullohen nga parimi i vendosjes nga pala, që do të thotë se u jepen palëve kompetencat për marrjen e nismës dhe shtyrjen përpara të procesit, është detyrim i Shtetit ta organizojë sistemin gjyqësor në mënyrë të atillë që të respektohet kriteri i një procesi brenda një afati kohor të arsyeshëm*⁴⁰. Për rrjedhojë nga gjyqtari kërkohet të sigurojë përmbushjen e kërkesave të nenit 6 sa i takon afatit kohor të arsyeshëm, sidomos përmes ushtrimit të kompetencave që ia jep ligji, në mënyrë që të zgjidhë çdo manovër zvarritëse të palëve të procesit, siç e ka përcaktuar Gjykata në një çështje gjyqësore në të cilën Qeveria citonte si argument sjelljen e palës së paditur si shkakun kryesor të vonesave në një padi për konstatimin e atësisë (aktgjykimi i çështjes “Ribiero - Portugali”, datë 30 prill 2003).

Del qartë nga jurisprudenca e Gjykatës në lidhje me Francën dhe Gjermaninë se edhe pse çështja në fjalë ka natyrë civile dhe mbështetet tek marrja e nismës nga ana e palëve (siç është rasti në këto dy vende), gjykatat duhet sidoqoftë t’i përdorin të gjitha kompetencat e zbatimit me forcë të ligjit për të siguruar që procesi të zhvillohet me hapin që përlligj natyra e çështjes dhe rrethanat e palëve, t’u vendosin afate palëve në përputhje me kërkesat e nenit 6, pika 1, dhe nëse del nevoja të ndëshkojnë çdo mosrespektim të këtyre vendimeve.

Gjykata nuk e pranon argumentin se paditësit nuk janë prekur negativisht nga vonesat. Për shembull, në aktgjykimin e çështjes “Jorge Nina Jorgedhe të tjerë - Portugali”, datë 19 shkurt 2004 (vetëm në frëngjishte), Qeveria pretendonte se zgjatja e fazës gjyqësore të procesit nuk i kishte cenuar paditësit duke qenë se e kishin marrë tashmë kompensimin në fjalë. Gjykata konstatonte se Konventa mund të shkelet edhe sikur të ketë cenim, e kjo e fundit nuk qe konstatuar në asnjë mënyrë.

Por është mirë të vërejmë këtu se Protokollin nr.14 shton një kriter të ri të pranueshmërisë, krahas atyre që parashikohen në nenin 35 të Konventës. Gjykata tani mund të shpallë si jo të pranueshme jo vetëm kërkesëpadinë që është “dukshëm e pabazuar ose përbën abuzim të së drejtës për të bërë padi”, por, gjithashtu, pas datës 1 qershor 2010, edhe një kërkesëpadi në lidhje me të cilën Gjykata konsideron se “paditësi nuk ka pësuar disavantazh të konsiderueshëm, nëse respektimi i të drejtave të njeriut sikurse përcaktohet në Konventë dhe në Protokollet e saj nuk kërkojnë një shqyrtim në themel të kërkesëpadiës dhe me kusht që asnjë çështje të mos mund të rrëzohet me këtë arsye e cila nuk është shqyrtuar rregullisht nga një gjykatë e brendshme”. Gjykata kohët e fundit ka përcaktuar se “disavantazhi i konsiderueshëm”, në kuptim të nenit 35, pika 3, shkronja “b”, të Konventës duhet vlerësuar në funksion të efektit që ka pasur shkelja e pretenduar tek situata e paditësit (në çështjen në fjalë, në procesin e apelit përpara Gjykatës Kushtetuese, mos-njoftimi paditësit nga ana e kësaj të fundit e mendimeve të Gjykatës së Lartë dhe gjykatës rajonale), jo në bazë të shumës monetare për të cilën bëhet fjalë përpara gjykatave të brendshme (aktgjykimi i çështjes “Holub - Republika Çeke”, datë 14 dhjetor 2010).

Ish-Komisioni gjithashtu ka vendosur se parashikimi në legjislaionin e brendshëm i mundësisë për shtyrjen e afateve që duhet të respektojë prokurori për paraqitjen e konkluzioneve nuk e çliron shtetin nga përgjegjësitë e veta dhe se mund të konstatojë se vonesat përkatëse kanë qenë të tepruara (çështja e Komisionit “Macedo - Portugali”, datë 6 nëntor 1989, vetëm në frëngjishte).

Në aktgjykimin e çështjes “Desrués - Francë”, datë 21 korrik 2005 (vetëm në frëngjishte), Qeveria argumentonte se botimi i një vendimi më 10 janar 1992 ku parashtraheshin rregullat dhe kriteret për klasifikimin dhe vlerësimin e çrregullimeve psikiatrike që lindin nga aksionet ushtarake kishte sjellë një fluks kërkesash për pensione invaliditeti ushtarak të lidhura me këtë, çka çoi në vonesa në trajtimin e çështjeve të tilla. Gjykata Evropiane thjesht është përgjigjur se vonesat në gjykatat e brendshme që kanë ardhur nga fluksi i kërkesave pas ndryshimit të akteve nënligjore nuk janë të pranueshme si argument mbrojtës.

Në mënyrë të ngjashme, një reformë e sistemit gjyqësor të Turqisë e cila e kalonte kompetencën për disa çështje të caktuara nga gjykatat ushtarake tek ato civile mund të ketë kontribuar në vonesa⁴¹, por në lidhje me parimet e cituara më lart në çështjen “Zimmermann dhe Steiner” Gjykata shprehej se *“neni 6, pika 1, vendos mbi Shtetet Kontraktuese detyrimin për ta organizuar sistemin gjyqësor në atë mënyrë që gjykatat e tyre të mund t’i përmbushin të gjitha kërkesat e tij,*

⁴⁰Obs.N Fricero, JCP G Nr. 16, 15 prill 2009, II, 10070.

⁴¹ Tetë vjet e 11 muaj, në dy shkallë gjykimi, që prej njohjes së të drejtës për kërkesë individuale.

përfshirë edhe detyrimin për t'i dëgjuar çështjet brenda një afati kohor të arsyeshëm" (aktgjykimi i çështjeve "Sahiner - Turqi", datë 25 shtator 2001).

Shtyrja procedurale mund të jetë e nevojshme, sidomos kur një seksioni të gjykatës së lartë i duhet të marrë një vendim paragjyqësor, por këto vendime paragjyqësore duhet medoemos të çojnë në një zgjidhje të formës së prerë, pa hequr dorë më tej nga kompetenca (aktgjykimi i çështjes "Hadjidjanis - Greqi", datë 28 prill 2005).

Me raste, krahas çështjeve të prapambetura në disa gjykata të caktuara, mund të shkaktohen vonesa nga dëshira e një gjykate të një shkalle më të lartë për t'i dëgjuar së bashku disa çështje të ngjashme. Gjykata Evropiane e konsideron një qasje të tillë si mbase të pranueshme në interes të dhënies së duhur të drejtësisë por kjo nuk duhet të çojë në kohëzgjatje të tepruar të procesit.

Aktgjykimi i çështjes "Hentrich - Francë", datë 22 shtator 1994, ofron një ilustrim. Në këtë çështje *"kohëzgjatja e procesit në Gjykatën e Kasacionit ka ardhur kryesisht nga dëshira e asaj gjykate për të shqyrtuar së bashku katër çështje me probleme të ngjashme – qasje e cila është e kuptueshme, mirëpo sipas nenit 6 të Konventës nuk mund ta justifikojë vonesën e konsiderueshme"*. Çështja kishte zgjatur katër vjet në shkallën e apelit, për shkak të numrit të çështjeve të prapambetura në gjykatë, dhe dy vjet në Gjykatën e Kasacionit. Në tërësi, procesi kishte zgjatur shtatë vjet e tre muaj në të tre shkallët e gjykimin, periudhë e konsideruar si e paarsyeshme nga Gjykata Evropiane bazuar në atë që rrezikonte paditësja, së cilës i qenë hequr të gjitha pasuritë ngaqë autoritetet tatimore kishin ushtruar të drejtën e tyre për të vepruar paraprakisht⁴².

Siç e kemi parë Gjykata i mban në konsideratë rrjedhojat që kanë çështjet për paditësit. Cilat lloje të proceseve i konsideron Gjykata si mjaftueshmërisht të rëndësishme për këtë qëllim?

D. ÇFARË RREZIKON PADITËSI

Është e mundshme të identifikohen nga aktgjykimet e Gjykatës ato situata të cilat, sipas saj, kërkojnë përsheptim, por nuk del asnjë hierarki e vërtetë nga e cila të mund të konstatohet shkalla e kërkuar e korrektesës. Për rrjedhojë, duhet përcaktuar se çfarë interesash vihen në diskutim, sipas fakteve të çështjes.

Në çështjet "me përparësi" përfshihen:

- **Mosmarrëveshjet e lidhura me marrëdhëniet e punës**, që kanë të bëjnë me largimet nga puna, rikuperimin e pagave apo ushtrimin e profesionit të paditësit, ku Gjykata konsideron se gjykata në fjalë duhet të tregojë korrektesë të veçantë.

Në një çështje lidhur me një kontratë midis një arkitekti të pavarur dhe një autoriteti vendor, që ishte klienti kryesor i paditësit, Gjykata konsideronte se prej gjykatave që merreshin me çështjen kërkohej korrektesë e posaçme, po të kemi parasysh faktin se shuma që pretendonte paditësi kishte rëndësi jetike për të dhe lidhej me veprimtarinë profesionale të tij (aktgjykimi i çështjes "Doustaly - Francë", datë 23 prill 1998).

Në aktgjykimin e çështjes "Lechelle- Francë", datë 8 qershor 2004 (vetëm në frëngjishte), Gjykata konfirmonte se *"çështjet e lidhura me mosmarrëveshjet mbi marrëdhëniet e punës kanë mbuluar çështje me rëndësi kritike për punën e individëve dhe duhej të ishin zgjidhur me përsheptim të veçantë"*.

Në referim me aktgjykimet e çështjeve "Obermeier - Austri" (29 qershor 1990), "Buchholz - Gjermani" (6 maj 1981) dhe "X - Francë" (31 mars 1992), Gjykata shprehej se *"çështja ka pasur të bëjë me procedurën e largimit të puna të paditësit dhe se interesat në fjalë kanë kërkuar një korrektesë të jashtëzakonshme nga ana e gjykatave të brendshme"* (shih edhe çështjen e kohëve të fundit "Mianowicz - Gjermani" (nr.2), vendim datë 11 qershor 2009 dhe "Petko Ivanov - Bullgari", vendim datë 26 mars 2009).

Gjykata ka ritheksuar kohët e fundit qëndrimin e saj *"lidhur me çështjet mbi marrëdhëniet e punës, se kërkohet korrektesë e jashtëzakonshme"*⁴³.

⁴² E drejta e paraveprimit e organeve tatimore prej atëherë është shfuqizuar.

⁴³ Aktgjykimi i çështjes "Hüseyn Ertürk - Turqi", datë 22 shtator 2005, pika 32 (vetëm në frëngjishte).

Në aktgjykimin e çështjes së lartpërmendur “Sartory - Francë”, datë 24 shtator 2009, Gjykata vërente se interesat e rrezikuar qenë të konsiderueshme (anulimi i një transferimi) dhe se periudha mbi gjashtë vjet për gjykimin e një çështjeje të këtij lloji qe e tepruar⁴⁴.

- **Çështjet mbi dëmshpërblimin e viktimave të aksidenteve:** kur vdekja aksidentale e një anëtarit të familjes i privon paditësit nga mjeti parësor i mbështetjes financiare, këta kanë një interes madhor vetjak për të siguruar një vendim të shpejtë gjyqësor për dhënien e dëmshpërblimit⁴⁵.

Në një çështje gjyqësore ku paditësi kishte kërkuar dëmshpërblim për një aksident automobilistik, Gjykata vërente se *“pas një aksidenti automobilistik paditësi fitoi paaftësi të pjesshme dhe interesat në rrezik për të kishin një vlerë të konsiderueshme që kryesisht kishte për qëllim shpërblimin e paaftësisë së tij dhe humbjes së zotësisë për të punuar. Në bazë të këtyre rrethanave, Gjykata konstaton se kërkohej përshpejtim i posaçëm”*⁴⁶.

Kriteri i korrektesës së jashtëzakonshme në çështjet që kanë të bëjnë me dëmshpërblimin e një personi që ka vuajtur dëme aksidentale është përmendur edhe në aktgjykimin e çështjes “Stefanova - Bullgari”, datë 11 janar 2007.

- Gjykata konsideron gjithashtu që **kohëzgjatja e burgimit të një paditësi** kërkon korrektesë të caktuar.

Në aktgjykimin e çështjes “Soto Sanchez- Spanjë”, datë 25 nëntor 2003 (vetëm në frëngjishte), Gjykata shprehej se *“çështja ka pasur një rëndësi të veçantë për paditësin sepse dënimi me katër vjet e dy muaj burgim të vendosur në fillim nga Audencia Nacional është rritur në nëntë vjet nga Gjykata e Lartë dhe ai ishte duke e vuajtur këtë dënim kur e apeloj çështjen përpara Gjykatës Kushtetuese”. Gjykata konstatoi se kohëzgjatja e procesit (pesë vjet, pesë muaj e 18 ditë vetëm në shkallën e Gjykatës Kushtetuese) ishte e papranueshme.*

Gjykata është shprehur se në çështjet penale, e drejta për t’u dëgjuar brenda një afati kohor të arsyeshëm “synon të evitohet që një person kundër të cilit është formuluar akuza të mos mbetet për tepër gjatë në gjendje pasigurie për fatin e tij” (aktgjykimi i çështjes “Stögmüller - Austri”, datë 10 nëntor 1969). Në rastin e çështjes “Şinegudhe të tjerë - Turqi”, vendim datë 13 tetor 2009, Gjykata vërente se paditësit qenë mbajtur në paraburgim gjatë të gjithë procesit; një situatë e tillë kërkon prej gjykatave që janë marrë me çështjen të tregonin korrektesë të jashtëzakonshme në mënyrë që të jepnin sa më shpejt drejtësi.

Në aktgjykimin e çështjes “Caloc - Francë”, datë 20 korrik 2000, Gjykata mban qëndrimin se *“kërkohej korrektesë e posaçme e autoriteteve gjyqësore përkatëse në hetimin e një ankese të depozituar nga një individ i cili pretendonte se kishte pësuar dhunë nga punonjësit e policisë”*.

•Çështjet e lidhura me dhunën policore.

Në një çështje bullgare lidhur me dhunën e paligjshme policore dhe përgjegjësinë shtetërore për dëmet e lindura nga një sjellje e tillë, Gjykata shprehej se *“sa i takon rëndësisë së asaj që rrezikon paditësi, Gjykata vëren se kjo padi kishte të bënte me shpërblimin e dëmeve të rënda të vuajtura si pasojë e dhunës policore. Në çështje të tilla kërkohej korrektesë e posaçme nga autoritetet gjyqësore”* (aktgjykim i çështjes “Krastanov - Bullgari”, datë 30 shtator 2004).

Në çështjet ku vonesat mund t’ia heqin çdo vlerë vendimit, Gjykata u kërkon autoriteteve të shfaqin jo thjesht njëfarë korrektesë por të tregojnë përshpejtim të jashtëzakonshëm.

- E njëjta vlen edhe për **gjendjen shëndetësore të paditëseve, për të mos përmendur jetën e tyre.**

⁴⁴ Obs. N. Fricero, *Procedures* Nr. 11, nëntor 2009, kom. 363.

⁴⁵ Aktgjykimi i çështjes “Mehmet Ozel dhe të tjerë - Turqi”, datë 26 prill 2005, pika 38 (vetëm në frëngjishte), shih edhe këto aktgjykime: “Hatun Güven dhe të tjerë - Turqi”, datë 8 shkurt 2005, “Meryem Güven dhe të tjerë - Turqi”, datë 22 shkurt 2005, dhe aktgjykimet për çështjet “Obermeier - Austri”, datë 28 qershor 1990, pika 72, dhe “Karakaya - Francë”, datë 26 gusht 1994, pika 30.

⁴⁶ Aktgjykimi i çështjes “Kurt Nielsen - Danimarkë”, datë 15 shkurt 2000.

Kjo vlen për çështjet e gjykuara nga gjykatat administrative franceze lidhur me përgjegjësinë civile të shtetit dhe dhënien e dëmshpërblimit për hemofilikët e infektuar me virusin HIV gjatë transfuzioneve të gjakut.

Për shembull, është bërë thirrje për korrektesë të jashtëzakonshme sidomos në çështjet tragjike "X - Francë", datë 31 mars 1992, në të cilën paditësi, një hemofilik i cili kishte bërë transfuzione gjaku, vdiq nga AIDS ndërsa çështja e tij po gjykohej nga Gjykata Evropiane. Njësoj si Komisioni, Gjykata mbajti qëndrimin se *"interesi në rrezik në procesin e kontestuar ka pasur rëndësi jetike për paditësin, po të kemi parasysh sëmundjen e pashërueshme nga e cila vuante dhe shkurtimin e jetës për të."*⁴⁷

Në një çështje gjyqësore të ngjashme, Gjykata shprehej se *"interesi në rrezik në procesin që është objekt gjykimi ishte me rëndësi jetike për paditësin, i cili kishte lindur me infektim nga virusi HIV.Me pak fjalë, në këtë rast kishte nevojë për korrektesë të jashtëzakonshme, pavarësisht numrit të çështjeve që duheshin trajtuar"* (Aktgjykimi i çështjes "Henra - Francë", datë 29 prill 1998)⁴⁸.

Që Gjykata të konstatojë shkelje, interesi i rrezikuar duhet të jetë me rëndësi kritike. Ajo ka bërë dallimin mes paditësve të cilët infektohen gjatë jetës me virusin HIV, të cilët kanë të drejtë të trajtohen me korrektesë të jashtëzakonshme, dhe atyre që janë në vartësi apo prindër të viktimave të AIDS-it, për të cilët vlen një shkallë më e ulët korrektese. Në një çështje të vetme me disa paditës ("A dhe të tjerë - Danimarkë", datë 8 shkurt 1996, në të cilën sjellja e paditësve kishte kontribuar ndjeshëm në kohëzgjatjen e procesit) u konstatua se anëtarët e grupit të parë në fjalinë e fundit qenë viktimat të shkeljes së nenit 6, pika 1, ndërsa anëtarët e grupit të dytë jo.

Në çështjen "Gheorghe- Rumani", vendim datë 15 qershor 2007, Gjykata rikujtonte se *kërkohet korrektesë e posaçme nga autoritetet kur paditësi vuan nga një sëmundje e rëndë dhe e pashërueshme dhe kur gjendja shëndetësore e këtij të fundit përkeqësohet me shpejtësi (pika 54) [...]. Po të kemi parasysh përkeqësimin e shëndetit të paditësit gjatë procesit, dhe meqë nga autoritetet duhej të tregonin një nivel të lartë korrektese, Gjykata arrin në përfundimin se kohëzgjatja e procesit në fjalë është e tepruar (pika 60).* Në këtë çështje, shkaku kryesor i vonësës ishte një mosmarrëveshje lidhur me kompetencën mes dy gjykatave të cilat kishin bërë gabime në vlerësimin e kompetencave përkatëse të tyre.

Në çështjen "Sopp - Gjermani, datë 8 tetor 2009, Gjykata vërente se duhej treguar vëmendje e veçantë për njohjen e origjinës profesionale të një sëmundjeje duke mbajtur në konsideratë rëndësinë që ka për paditësin procesi, meqë synimi ishte t'i jepeshin atij mjete të tjera shtesë mbështetjeje përmes një shume vjetore të posaçme në të ardhmen"⁴⁹.

•**Mosha e shtyrë e paditësve** gjithashtu mund të kërkojë zhvillim të shpejtë të procesit. Për shembull, në lidhje me dhënien e një pensioni lufte, të kërkuar nga një tetëdhjetëvjeçar ndërgjygjës ("Pantaleon - Greqi", vendim datë 10 maj 2007).

•**Në çështjet për kujdestarinë apo autoritetin prindëror mbi fëmijët**, Gjykata tregon ndjeshmëri për nevojën **për t'i ruajtur lidhjet familjare dhe për të siguruar që marrëdhëniet prind-fëmijë** të mos dëmtohen nga kalimi i kohës. Në përgjithësi Gjykata thekson nevojën që çështjet gjyqësore për kujdestarinë të trajtohen me shpejtësi (si në aktgjykimi e çështjes "Hokkanen - Finlandë", datë 23 shtator 1994, ku Gjykata konstatonte se 18 muaj proces nuk përbënin shkelje të nenit 6, pika 1).

•**Dhe, në fund, i njëjti parim zbatohet për çështjet e lidhura me gjendjen dhe zotësinë fizike të individëve.** Edhe urdhrat për dhënien e kontributit financiar për mbështetjen dhe rritjen e fëmijëve duhet të ekzekutohen me shpejtësi, edhe atëherë kur procedura e përmbarrimit është në pritje të një aktgjykimi të huaj (aktgjykimi i çështjes "Dinu - Rumani dhe Francë", 4 nëntor 2008). Në këtë rast të fundit një paditës kishte siguruar një vendim kundër Francës dhe Rumanisë në bazë të faktit se procedura e përmbarrimit kishte zgjatur nëntë vjet për shkak të vonësave jo vetëm në dy sistemet gjyqësore por edhe në ministrinë përkatëse.

⁴⁷ Për qëndrimet kritike për shtetit francez: S. Guinchard, "Fair trial" (Gjykimi i rregullt) Adresari i Procedurës Civile, op. cit, f.90, Nr. 330

⁴⁸ Por shih edhe aktgjykimet "X - Francë", datë 31.03.1992, "Vallée - Francë", datë 26.04.1994, "Karaya - Francë", datë 26.08.1994, "Paillet - Francë", datë 22.04.1998, "F.E - Francë", datë 30.10.1998, "Kritt - Francë", datë 19 mars 2002, "Beaumer - Francë", datë 8 qershor 2004.

⁴⁹ Obs. P. Coursier, JCP, Nr. 16, 20 prill 2010, 1164.

Në fund të këtij raport jepet një listë e hollësishme e çështjeve në të cilat Gjykata ka qenë më kërkuese për kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore⁵⁰.

E. VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM I RRETHANAVE TË ÇËSHTJES

Kohët e fundit, siç e kemi thënë, Gjykata zhvillon një analizë të gjithanshme të proceseve dhe i mbledh të gjitha periudhat e mbuluara nga etapat e ndryshme të procesit. Por kjo nuk e pengon të bëjë një vlerësim të kohëzgjatjes së tepruar të një faze të veçantë të procesit apo ta vlerësojë një periudhë të tillë lidhur me çdo etapë, sipas rrethanave të çështjes. Për shembull, në aktgjykimin e çështjes “Martial Lemoine - Francë”, datë 29 prill 2003, lidhur me një mosmarrëveshje pronësie të përbashkët që kishte zgjatur shtatë vjet e tetë muaj në katër shkallë të ndryshme gjyqësore, procesi zgjati një vit e dhjetë muaj në shkallën e parë, një vit e tetë muaj në shkallën e apelit, një vit e nëntë muaj përpara Gjykatës së Kasacionit dhe mbi dy vjet përpara gjykatës së apelit së cilës iu rikthye çështja. Gjykata arriti në përfundimin si më poshtë: *Sipas mendimit të Gjykatës, edhe nëse kohëzgjatja gjithsej prej mbi shtatë vjet e tetë muaj është një periudhë mjaft e gjatë, periudhat që janë si pasojë e autoriteteve nuk mund të konsiderohen të paarsyeshme po të kemi parasysh rrethanat e çështjes dhe jurisprudencën e Gjykatës* (pika 33). Po kështu, në aktgjykimin e çështjes së lartpërmendur “Sopp - Gjermani”, datë 8 tetor 2009, ishte periudha e pajustificuar e pritjes prej dy vjetësh e dy muajsh përpara Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane, nga 18 vjet e gjysmë gjithsej, që mundësoi konstatimin e shkeljes së të drejtës për t’u dëgjuar brenda një afati kohor të arsyeshëm.

Në dy aktgjykime, “Société Canal Plus dhe të tjerë” dhe “Compagnie des gaz de petrole Primagaz- Francë”, datë 21 dhjetor 2010, Gjykata Evropiane analizoi, nga këndvështrimi i kriterit të kohëzgjatjes së arsyeshme, një apelim të depozituar kundër një vendimi gjyqësor për autorizimin e një kontrolli dhe sekuestrimet e kryera nga nëpunësit e Autoritetit të Konkurrencës, dhe e lidhi këtë kriter me atë të efektivitetit të apelit të lartpërmendur. Gjykata konsideronte se për të qenë i efektshëm një apelim nuk duhet të varet nga ekzistenca dhe rezultati i një apelimi për themelin kundër vendimit të Autoritetit të Konkurrencës dhe duhet të shqyrtohet brenda një afati kohor të arsyeshëm. Për rrjedhojë, Gjykata bëri një vlerësim shumë specifik të një etape të caktuar të procesit, por e vlerësoi kohëzgjatjen në bazë të rëndësisë së saj brenda procedurës së gjerë (duke e rrokur kundërshtimin përmbajtës ndaj vendimit të marrë nga autoriteti në fjalë), që mund të përfshijë disa procese më vete⁵¹.

Rrjedhimisht, vlerësimi merr në konsideratë të gjithë procesin dhe kërkon marrjen në konsideratë (shih II Pjesa 1 më poshtë për datën e fillimit dhe afatet e periudhës që duhen verifikuar) të shkallëve të ndryshme të shqyrtimit gjyqësor dhe fazat administrative para dhe pas aktgjykimit. Për shembull, në mosmarrëveshjet mbi marrëdhëniet e punës, duhen marrë në konsideratë të gjitha procedimet administrative dhe gjyqësore, si edhe afati kohor për vendimin e Gjykatës së Posaçme Industriale (aktgjykimi “Seguin - Francë”, datë 16 prill 2002).

Megjithatë, periudhat e mëposhtme nuk merren në konsideratë gjatë llogaritjes së kohëzgjatjes së përgjithshme: procedurat për autorizimin e procesit me datë fikse (aktgjykimi “R. - Francë”, datë 3 dhjetor 2002), proceset thjesht parandalues ose për masa paraprake (aktgjykimi i çështjes “Maillard Bous - Portugali”, datë 28 qershor 2001) dhe procedurat për shqyrtimin e një kërkesë për rigjykim të çështjes (aktgjykimi i çështjes “Jussy - Francë”, datë 8 prill 2003).

Por në shumë raste, një kohëzgjatje e përgjithshme e tepruar e procesit nuk përbën bazë të mjaftueshme për të konstatuar shkelje. Kjo vlen sidomos kur një çështje është trajtuar nga një shkallë e vetme gjykate (sidomos kur një gjykatë e lartë merr vendimin gjyqësor në shkallën e parë dhe të fundit)⁵². Kjo përbën bazë të mjaftueshme për të konstatuar kohëzgjatje të tepruar të procesit, nëse nuk përliqjet me arsye të tjera.

Kjo ilustron qartë në aktgjykimin e çështjes “Obermeier - Austri”, datë 28 qershor 1990, ku Gjykata shprehej: *“Palët kanë diskutuar për kriteret e ndryshme që përdor Gjykata në raste të tilla, siç është periudha e saktë që duhet marrë në konsideratë, shkalla e kompleksitetit e çështjes, sjellja e palëve e kështu me radhë. Por Gjykata vëren se jurisprudenca e saj bazohet në parimin themelor se arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procesit duhet konstatuar duke iu referuar rrethanave të veçanta të çështjes. Në këtë rast, këto rrethana kërkojnë një vlerësim global kështu që Gjykata nuk e konsideron të nevojshme marrjen në shqyrtim me hollësi të këtyre çështjeve.”*

⁵⁰ Shtojca 2.

⁵¹ Obs. G. Decocq, *Contrats Concurrence Consommation*, Nr. 2, shkurt 2011, kom. Nr. 40.

⁵² Në këto çështje të shumta përfshihet edhe aktgjykimi i çështjes “Assymomitis - Greqi”, datë 14 tetor 2004.

Pas marrjes në shqyrtim të rrethanave të çështjes, sidomos sa i takon interesit që ka paditësi në të dhe kompleksitetit të çështjes, Gjykata arriti në përfundimin se *“megjithatë, mbetet fakti se një periudhë prej nëntë vjetësh pa arritur një vendim të formës së prerë e tejkalon afatin kohor të arsyeshëm. Pra është kryer shkelje e nenit 6, pika 1 edhe për këtë pikë.”*

Në një çështje gjyqësore për një blerje të detyruar e cila prodhoi tre procese gjyqësore, dy prej të cilave nuk kishin përfunduar ende dhe të cilat përfshinin, përkatësisht, dy dhe tri shkallë kompetence, Gjykata konstatoje se vonesat në proces, i cili zgjati më shumë se shtatëmbëdhjetë vjet, qenë shkaktuar kryesisht nga sjellja e autoriteteve dhe e gjykatave në fjalë (*“Aktgjykimi i çështjes “Nastou - Greqi”, datë 16 janar 2003, vetëm në frëngjishte*).

Në aktgjykimin e çështjes *“Comingersoll SA- Portugali”*, datë 6 prill 2000, Gjykata qe e mendimit se rrethanat e çështjes duheshin vlerësuar në tërësi dhe se *“një periudhë prej shtatëmbëdhjetë vjetësh e pesë muajsh për një vendim të formës së prerë i cili ende nuk është përmbushur në proces në bazë të një autoriteti për ta ekzekutuar (që për nga vetë natyra duhet të trajtohet në mënyrë të përshpejtuar) nuk mund të thuhet se është periudhë e arsyeshme”*.

Në lidhje me një sërë mosmarrëveshjesh ligjore mes një paditësi dhe autoriteteve të sigurimeve shoqërore, Gjykata zbatoi për rrethanat e çështjes kriteret e veta normale dhe arriti në përfundimin se kohëzgjatja gjithsej prej më shumë se katërmëdhjetë vjetësh për këtë lloj çështjeje qe e mjaftueshme në vetvete për ta bërë këtë proces të papërputhshëm me kriterin e afatit kohor të arsyeshëm të nenit 6 pika 1 të Konventës (aktgjykimi i çështjes *“J-M F. - Francë”*, datë 1 qershor 2004, vetëm në frëngjishte).

II. LLOGARITJA E KOHËZGJATJES SË PROCESIT DHE FAKTORËT QË NDIKOJNË NË KËTË LLOGARITJE

A – PIKËNISJA

Momenti i fillimit të procesit ndonjëherë është i diskutueshëm mes palëve dhe mund të jetë i vështirë për t’u përcaktuar. Për shembull, në aktgjykimin e çështjes *“Darnell - Mbretëria e Bashkuar”*, datë 26 tetor 2003, ku rrethanat kërkonin një vlerësim të përgjithshëm, Gjykata nuk e konsideroi të nevojshme marrjen e një vendimi për momentin e diskutueshëm të fillimit të procesit dhe u shpreh se edhe sikur të mbante qëndrimin e Qeverisë *“kalimi i kohës prej gati nëntë vjetësh deri gjersa Gjykata e Posaçme e Apelit për Çështjet mbi Marrëdhëniet e Punës dhe gjykimin e vet të rezervuar ... nuk mund të konsiderohet si arsyeshëm në bazë të rrethanave të çështjes që kemi përpara”*.

Kur bëhen negociime mes palëve lidhur me masën e kompensimit të pagueshëm përpara se çështja të vijë në gjykatë, Gjykata nuk i merr në konsideratë këto negociime. Ajo nuk mendon se këto mbulohen nga neni 6, pika 1, meqë asnjëri prej negociuesve nuk mund t’u imponojë një zgjidhje të tjerëve dhe diskutimet mund të mbyllën në çdo moment (aktgjykimi i çështjes *“Lithgow dhe të tjerë - Mbretëria e Bashkuar”*, datë 8 korrik 1986).

Për më tepër, kur Shteti si palë paditëse e ka ratifikuar Konventën pas datës së fillimit të procesit në fjalë, periudha përkatëse fillon më datën e hyrjes në fuqi të Konventës në lidhje me atë Shtet, megjithëse duhet medoemos të mbahet në konsideratë gjendja e procesit më datën e hyrjes në fuqi të Konventës (për shembull, aktgjykimi i çështjes *“Kaici dhe të tjerë - Kroaci”*, datë 17 korrik 2008, pika 14).

Momenti i fillimit **në çështjet penale** është shumë specifik. Një këqyrje nga afër e nenit 6, pika 1, tregon se nocioni i një akuze penale mund të përfshijë etapa të procedurës që jo medoemos dhe jo automatikisht hyjnë në objektin e procedimit penal.

Sipas jurisprudencës së Gjykatës, data e fillimit nuk është automatikisht ajo më të cilën është sjellë përpara gjykatës individit. Kjo datë mund të jetë përpara se çështja t’i kalohet për gjykim gjykatës, siç është data e arrestimit, data kur personi në fjalë është njoftuar zyrtarisht se do të ndiqet penalisht ose data kur janë çelur hetimet paraprake.

Në çështjen e parë mbi kohëzgjatjen e procesit të drejtuar Gjykatës, Komisioni fillimisht mori si moment fillimi datën më të cilën qe marrë për herë të parë në pyetje nga gjyqtari hetues paditësi (21 janari i vitit 1960) dhe jo, për shembull, data e ngritjes së aktakuzës (17 marsi i vitit 1964).

Gjykata ndoqi një rrugë të mesme duke marrë si moment fillimi datën 23 shkurt 1961: data kur gjyqtari hetues vendosi të çelte hetimin për paditësin.

Sipas Gjykatës, “akuza” në kuptim të nenit 6, pika 1, mund të përkufizohet si “njoftimi zyrtar që i jepet individit nga autoriteti kompetent lidhur me një pretendim se ky individ ka kryer një vepër penale”, një përkufizim që “mund të përfshijë edhe masa të tjera që e nënkuptojnë një pretendim të tillë të cilat mund të kenë një pasojë të konsiderueshme tek situata e personit të dyshuar⁵³”.

Nëse kriteri i afatit kohor të arsyeshem fillon të zbatohet në momentin kur personit i drejtohet një “akuzë”, kjo është atëherë kur ai preket në mënyrë të konsiderueshme nga situata. Data përkatëse nuk është ajo kur janë vendosur gjoba fiskale mbi shoqëritë e paditësit (dhe jo mbi vetë paditësin kështu që nuk kishte arsye që ai të supozonte se qe objekt hetimi si person fizik ai vetë) por data kur ai është marrë në pyetje për herë të parë si person i dyshuar, duke u prekur kështu në mënyrë të konsiderueshme.

Në aktgjykimin e çështjes “Hozee- Vendet e Ulëta”, datë 22 maj 1998, Gjykata vërente se “edhe sikur një gjobë fiskale apo një mbitaksë mund të konsiderohet, në rrethana të veçanta, si akuzë penale në kuptim të nenit 6, pika 1, të Konventës (shih aktgjykimin e çështjes “Bendenoun - Francë”, datë 24 shkurt 1994, Seria A nr.284, f 20, pika 47), gjoba në çështjen që kemi përpara është vendosur nga autoritetet tatimore në fund të vitit 1981 mbi shoqëritë e paditësit dhe jo mbi atë vetë si person. Nuk ka pasur asgjë që të sugjeronte se paditësi në atë fazë qe vetë i dyshuar për krim ekonomik, vepër me të cilën është akuzuar më pas. Për më tepër, vendosja e një gjobe fiskale sipas nenit 21 të Ligjit të Përgjithshëm për Tatimet Shtetërore nuk kërkon çeljen e një procedimi penal në mungesë të elementeve që do të justifikonin ndërhyrjen e FIOD-së [autoriteteve tatimore] (pikat 23, 32, 33 dhe 31, më lart)”.

Në aktgjykimin e çështjes “Lopez Sole y Martin de Vargas - Spanjë”, datë 28 tetor 2003, Gjykata pranoi datën 8 qershor 1985 duke specifikuar “Po atë ditë, gjyqtari udhëheqës dha urdhër për kontrollin e mjediseve në adresën e përhershme të paditësit, kontroll që u krye të nesërmen dhe pati pasoja të rëndësishme për situatën e paditësit” (pika 25).

Në çështjen “McFarlane- Irlandë”, datë 10 shtator 2010, Gjykata rikujtonte se në çështjet penale “afati kohor i arsyeshem”, i përmendur në nenin 6, pika 1, fillon sapo personit i “drejtohet një akuzë e natyrës penale”. “Drejtimi i një akuze të natyrës penale”, në kuptim të nenit 6, pika 1, mund të përkufizohet si “njoftimi zyrtar që i jepet individit nga autoriteti kompetent lidhur me një pretendim se ky individ ka kryer një vepër penale”, një përkufizim që përkon edhe me testin nëse “është prekur apo jo në mënyrë të konsiderueshme situata e personit të dyshuar”. Gjykata qe e mendimit se paditësi qe “prekur në mënyrë të konsiderueshme” në momentin e arrestimit të tij më 5 janar 1998, duke qenë se ai e pranon se ky ka qenë momenti kur është njoftuar për herë të parë nga policia lidhur me akuzat e ngritura kundër tij.

Kur legjislati brendshëm ua lejon viktimave të ngrënë padi civile të veçantë për dëmshpërblim, për shembull pas një aksidenti rrugor, procesi penal mund të çojë thjesht në shpalljen fajtor për akuzat e natyrës penale të drejtuara kundër autorit të aksidentit, pa mundësuar dëmshpërblimin e viktimës.

Në raste të tilla, Gjykata konsideron se ngritja e një padie të natyrës civile do të thotë se paditësi ka hequr dorë nga të drejtat me natyrë civile në procesin penal, edhe sikur padia civile të jetë ngritur për shkak të vonësive të çështjes penale. Atëherë quhet se procesi penal nuk ka të bëjë më me përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve civile të paditësit apo të akuzave penale të drejtuara kundër tij dhe një kërkesëpadi që lidhet vetëm me kohëzgjatjen e procesit penal bëhet i papërputhshëm *ratione materia* me Konventën (vendim i formës së prerë për pranueshmërinë, çështja “Garimpo - Portugali”, datë 10 qershor 2004, vetëm në frëngjishte).

Në një çështje që kishte të bënte me krimin ekonomik dhe atë financiar, Gjykata mori si pikë fillimi datën kur autoritetet sekuestruan çekun që kërkonte të thyente paditësi (aktgjykim i çështjes “Nuvoli - Itali”, datë 16 gusht 2002).

⁵³ Shih aktgjykimin e çështjes “Eckle – Republika Federale e Gjermanisë, datë 15 korrik 1982, dhe aktgjykimin e çështjes “Reinhardt dhe Slimane-Kaïd - Francë”, datë 31 mars 1998.

Në një çështje me objekt falsifikim dhe mashtrim, pika e fillimit u mor momenti kur u krye kontrolli në zyrën qendrore të paditësit të parë dhe në shtëpinë e paditësit të dytë, dhe jo më herët kur prokurori shpalli zyrtarisht se paditësi i dytë dyshohej për falsifikim dhe mashtrim (aktgjykimi i çështjes “Stratégies et Communications dhe Dumoulin - Belgjikë”, datë 15 korrik 2002, vetëm në frëngjishte).

Në një çështje me objekt mashtrim, Gjykata nuk e pranoi argumentin e autoriteteve se pika e fillimit duhej të ishte ajo kur u paraqitën për herë të parë përpara gjyqtarit hetues paditësit. Gjykata vendosi të merrte si pikë fillimi një datë më të hershme, në momentin kur policia i kishte marrë për herë të parë në pyetje paditësit dhe njëri prej tyre qe rrëfyer. *“Ky ka qenë momenti kur paditësit e kanë kuptuar se po bëhej një hetim paraprak me objekt veprimtaritë e tyre dhe kur paditësi e dytë i kishte pranuar akuzat. Për rrjedhojë kjo ka qenë një masë që i ka prekur në mënyrë të konsiderueshme personat në fjalë* (aktgjykimi i çështjes “Martins dhe Garcia Alves - Portugali”, datë 16 nëntor 2000, vetëm në frëngjishte).

Neni 71 i Kodit të Procedurës Penale të Portugalisë ua lejon viktimave të veprave penale dhe, në disa rrethana të caktuara, familjarëve të rrethit të ngushtë të tyre, të ndërhyjnë aktivisht si *“assistantes”* në procesin penal, pra si asistentë të prokurorit.

Në aktgjykimin e çështjes “Moreira de Azevedo - Portugali”, datë 23 tetor 1990 (vetëm në frëngjishte), Gjykata konstatoi se të drejtat dhe detyrimet civile të paditësve filluan të marrin rol vetëm kur ata kanë ndërhyrë si *“assistantes”*, pra më 1 shkurt 1993. Në atë moment, ata treguan interes për të siguruar jo vetëm shpalljen fajtor për veprën penale të personit të pandehur por edhe për marrjen e shpërblimit monetar për dëmet e pësuarat. Për rrjedhojë, kjo qe data kur filloi periudha që duhej marrë në konsideratë. Argumenti i Qeverisë se në atë moment paditësit nuk kishin kërkuar ende përsheptim të procedurës, në mënyrë që të shteroheshin rrugët ligjore të brendshme në përputhje me nenin 35, pika 1, të Konventës, nuk ndryshonte asgjë. Kishte shumë të ngjarë që paditësit ta kishin bërë këtë kërkesë kur kishin menduar se kohëzgjatja e procesit po e tejkalonte *“afatin e arsyeshem”*.

Në çështjet penale, pika e fillimit zakonisht përkon me datën kur çështja i është kaluar gjykatës kompetente, duke ndryshuar sipas llojit të procesit. Mirëpo, jurisprudenca e Gjykatës do të dukej se sugjeron se mund të përdoren edhe pika të tjera të fillimit, në varësi të procedurave ose rrethanave specifike.

Në një çështje në të cilën shoqëria e paditësve qe vendosur në fillim në administrim gjyqësor dhe pastaj u shpall e falimentuar, Gjykata e llogariti kohëzgjatjen e procesit duke filluar nga data kur pagat e paditësve, të cilat kishte disa muaj që nuk paguheshin, u njohën nga gjykata portugeze si të drejta të kërkueshme ndaj shoqërisë, dhe jo data e shpalljes së këtyre të drejtave të kërkueshme si pjesë e procedurës së mëpasshme të falimentimit, siç kishin propozuar autoritetet (aktgjykimi i çështjes “Oliviera Modesto dhe të tjerë - Portugali”, datë 8 qershor 2000, vetëm në frëngjishte).

Gjykata ndjek një qasje pragmatike sa i takon datës kur arrihet ose shpallet një vendim. Për shembull, nëse vendimi jepet më ditën x por teksti regjistrohet pranë sekretarisë më ditën x+20, Gjykata njeh këtë të dytën si datë të aktgjyimit (shih, ndër të tjera, aktgjykimin e çështjes “Ridi - Itali”, datë 11 maj 1990 dhe aktgjykimin e çështjes “Ceteroni - Itali”, datë 21 tetor 1996).

Në rastet e dëmshpërblimit të viktimave të dhunës policore, momenti i fillimit të procesit është data kur ka ndodhur dhuna, që përkon me fillimin e hetimeve penale, dhe jo data e paraqitjes së ankesës kundër refuzimit nga Shteti për t’i paguar paditësit shpërblimin e dëmeve që ka kërkuar, përkundër nevojës për hetime penale paraprake në mënyrë që të konstatohet përgjegjësia dhe rregulli që *“çështjet penale kanë epërsi kundrejt çështjeve civile”* (çështja “Iribarren Pinillos - Spanjë”, vendim datë 8 janar 2009, loc.cit., pika 65).

Në çështjet gjyqësore me objekt trashëgiminë ose, më në përgjithësi, në praninë e trashëgimtarit të një personi të vdekur, Gjykata mban qëndrimin se kur paditësit paraqiten në proces si trashëgimtarë ata mund të ankohen për të gjithë kohëzgjatjen e procesit të kaluar, edhe pse marrin pjesë në procesin e brendshëm vetëm për llogari të tyre dhe periudha që duhen mbajtur në konsideratë fillon më atë datë (aktgjykimi i çështjes “De Hohenzollern (de Roumanie) - Rumanë”, datë 27 maj 2010).

Gjatë përcaktimit të momentit të fillimit, në funksion të kriterit të afatit kohor të arsyeshëm, në konsideratë merren edhe tiparet specifike të çështjeve administrative. Gjykata konsideron gjithashtu se momenti i fillimit është data e depozitimit të ankesës administrative të detyrueshme, për shembull ajo e Ministrit (çështja “Marschner - Francë”, vendim datë 28 shtator 2004)⁵⁴, jo apelimi i mëpasshëm përpara gjykatës administrative kundër vendimit që e rrëzon autoritetin administrativ në fjalë. Kështu ndodh edhe kur paditësi nuk ka pasur mundësi të apelojë përpara gjykatës kompetente përpara se të kërkojë shqyrtim, në procedurë paraprake (*Vorverfahren*) përpara autoritetit administrativ, të ligjshmërisë dhe përshtatshmërisë së masave administrative objekt i ankimit, si në çështjen “König - Gjermani”, vendim datë 28 qershor 1978⁵⁵, në çështjen “Donnedieu - Francë”, vendim datë 7 shkurt 2006, Gjykata Evropiane mori në konsideratë datën e kërkesës të depozituar pranë Komisionit *d'accès aux documents administratifs*, përpara kalimit tek gjykata administrative, për shfuqizimin e vendimit të një spitali universitar për të mos vënë në dispozicion dokumentet administrative dhe mjekësore lidhur me institucionalizimin e paditësit.

Që prej aktgjykimit të çështjes “Golder - Mbretëria e Bashkuar”, datë 21 shkurt 1975, Gjykata mban qëndrimin se kjo mund të zbatohet për çdo autoritet administrativ, siç është këshilli social i një rrethi (aktgjykimi i çështjes “Olsson - Suedi”, datë 27 nëntor 1992).

Më gjerësisht, Gjykata Evropiane merr në konsideratë edhe çdo kërkesë të detyrueshme të mëparshme drejtuar një autoriteti gjyqësor. Kjo vlen për procesin e detyrueshëm përpara një komisioni kombëtar për të shqyrtuar nëse punëdhënësi ka kryer apo jo faj të pajustificueshëm, përpara kalimit të çështjes gjykatës kompetente (aktgjykimi i çështjes “Santoni - Francë”, datë 29 korrik 2003). Kjo zbatohet edhe për rastet e aksidenteve në punë apo për shqyrtimin nëse një sëmundje e caktuar është apo jo e fituar gjatë punës (shih aktgjykimin e çështjes së lartpërmendur “Sopp - Gjermani”, datë 8 tetor 2009, ku nuk kishte proces të mëparshëm administrativ, por ku Gjykata e Lartë Sociale konsideronte fillësën profesionale të sëmundjes).

Në përgjithësi, momenti i fillimit është atëherë kur çështja i kalohet gjykatës së shkallës së parë, por mund të jetë edhe momenti i kalimit të çështjes gjykatës së lartë, meqë kjo e fundit shpesh i shqyrton në shkallë të parë dhe shkallë të fundit.

Momente të tjera të veçanta fillimi mund të përfshijnë në veçanti masat procedurale të tilla si urdhrat për të paguar në Francë dhe Itali, kërkesat për masa të ndërkohshme, prapësimet ndaj një mase përmbarimi ose paraqitja e vetë të paditurit në seancat dëgjimore.

Një tipar tjetër i përbashkët për të gjitha vendet është se ka një jurisprudencë të qartë të afirmuar në lidhje me kompetencën kohore të Gjykatës dhe mënyrën si e prek kjo kompetencë kohore vlerësimin që i bën ajo kohëzgjatjes së procesit. Gjatë konstatimit të datës së fillimit të procesit, Gjykata nuk mund të përfshijë asnjë periudhë përpara njohjes nga shteti të së drejtës për kërkesë individuale (e cila mund të dallojë nga data e aderimit në Konventë) edhe pse në praktikë procesi përkatës ka filluar përpara asaj date. Në raste të tilla, Gjykata e bën të qartë se gjatë vlerësimit të arsyeshmërisë së kohës që ka kaluar pas datës zyrtare të fillimit, duhet marrë në konsideratë gjendja e procesit kur shteti i paditur e ka pranuar të drejtën për kërkesë individuale.

Për shembull, në aktgjykimin e çështjes “Kanoun”, datë 3 tetor 2000 (vetëm në frëngjishte), ku procesi përkatës kishte filluar në vitin 1975, Gjykata mund të merrte në konsideratë vetëm periudhën që fillonte më 2 tetor 1981, data kur Franca njohu të drejtën për kërkesë individuale. Por, duke cituar aktgjykimin e çështjes “Foti - Itali”, datë 10 dhjetor 1982, ajo theksonte nevojën për të marrë në konsideratë gjendjen e procesit më datën në fjalë.

Kjo është jurisprudenca e afirmuar. Në aktgjykimin e çështjes “Proszak - Poloni”, datë 16 dhjetor 1997, momenti i fillimit ishte data 1 maj 1993, kur hyri në fuqi njohja nga Polonia e të drejtës për kërkesë individuale në funksion të nenit 25 të Konventës, edhe pse kërkesa e parë e depozituar përpara gjykatës polake mbante datën 25 tetor 1990.

Në vendimin e çështjes “Marciano Gama Da Costa - Portugali”, datë 5 mars 1990 (vetëm në frëngjishte), Komisioni “*në fillim vërejtë se në vetvete ai nuk ka kompetencë kohore për të marrë në konsideratë kohëzgjatjen e procesit përpara datës 9 nëntor 1978, data kur qeveria e paditur e ratifikoi Konventën dhe e njohu të drejtën për kërkesë individuale. Megjithatë, në përputhje me jurisprudencën e afirmuar për këtë objekt, Komisionit i duhet të mbante në konsideratë gjendjen e procesit më atë datë.*”

⁵⁴ Shih edhe aktgjykimin e çështjes “Jorge Nina Jorge dhe të tjerë - Portugali”, datë 19 shkurt 2004.

⁵⁵ Shih edhe “Farnage S.A. - Francë”, datë 13 korrik 2006, pika 39, dhe “Hellborg - Suedi”, datë 28 shkurt 2006, pika 59.

Në aktgjykimin e çështjes “Zana - Turqi”, datë 25 nëntor 1997, megjithëse procesi në fjalë dukej relativisht i shkurtër (një vit e gjashtë muaj), Gjykata konstatoi shkelje të nenit 6, pika 1, dhe mori në konsideratë faktin se deri më datën e depozitimit të deklaratës së Turqisë procesi kishte zgjatur dy vjet e pesë muaj⁵⁶.

Gjykata nuk e pranoi argumentin e qeverisë se edhe faktet që vinin pas njohjes së kompetencës së detyrueshme të saj qenë përjashtuar nga fushëveprimi, kur nuk qenë gjë tjetër veçse shtojca të një situatë ekzistuese prej më parë, për të cilën nuk kishte kompetencë për ta marrë në konsideratë⁵⁷.

Këtij raporti i bashkëlidhet një tabelë⁵⁸ ku jepet data e aderimit në Konventë për secilin shtet kontraktues dhe data e njohjes për kërkesë individuale nëse ndryshon nga e para. Duke qenë se Protokolli nr. 11 ka hyrë në fuqi më 1 nëntor 1998, nuk ka qenë e mundur të aderosh në Konventë pa njohur të drejtën për kërkesë individuale.

Kjo ka rëndësi të veçantë gjatë përcaktimit se sa pas mund të kthehesh gjatë këqyrjes së jurisprudencës në lidhje me shtete të veçanta, sidomos lidhur me ato shtete që e kanë ratifikuar kohët e fundit Konventën.

Në fund, disa periudha të caktuara nuk merren në konsideratë gjatë llogaritjes së kohëzgjatjes së procesit, kur ky konsiderohet nga Gjykata. Kjo ka të bëjë me çështjet e kaluara nga njëra prej gjykatave të përfshira tek Gjykata e Drejtësisë të Komuniteteve Evropiane për një vendim paragjyqësor (aktgjykimi i çështjes “Koua Poirrez - Francë”, datë 30 shtator 2003 dhe aktgjykimi i çështjes “Pafitis dhe të tjerë - Greqi”, datë 26 shkurt 1998).

B – FUNDI I PERIUdhËS ME INTERES

Në çështjet penale, periudha përfundon kur jepet aktgjykimi i formës së prerë për akuzat e ngritura. Në përgjithësi, ky bëhet në formën e shpalljes si i pafajshëm ose si i fajshëm pa të drejtë apelimi të mëtejshëm, por mund të jetë edhe një vendim i prokurorisë për ta pushuar çështjen apo një vendim i gjykatës për parashkrimin e çështjes⁵⁹.

Por, në aktgjykimin e çështjes “Stoianova dhe Nedelcu - Rumani”, datë 4 gusht 2005 (vetëm në frëngjishte), Gjykata vendosi se lirimi nga akuza i paditësit nuk përbënte vendim të brendshëm të formës së prerë sepse kodi rumun i procedurës penale ia lejon prokurorisë të shfuqizojë çdo vendim për çlirim nga akuza dhe të rihapë hetime penale pa asnjë afat kohor të përcaktuar.

Në çështjet civile, vendimi i formës së prerë dhe i pakthyeshëm shënon parimisht përfundimin e periudhës që duhet marrë në konsideratë. Më konkretisht, Gjykata përmend një vendim i cili “i jep fund mosmarrëveshjes” (aktgjykimet e çështjeve “Guincho - Portugal”, datë 10 korrik 1984 dhe “Erkner dhe Hofauer - Austri”, datë 23 prill 1987). Ky koncept është më i gjerë sesa referimi tek *res judicata* duke qenë përfshin edhe fazën e përmbarimit, siç do ta shohim më poshtë.

Në proceset ku përfshihen kompetencat gjyqësore të gjykatave gjyqësore dhe administrative, siç janë proceset e shpronësimeve, Gjykata i merr proceset në konsideratë në tërësinë e tyre dhe mban qëndrimin, siç ka vepruar në çështjen “Guillemin - Francë”, vendim datë 21 shkurt 1997, se “*periudha arsyeshmëria e së cilës bie në objektin e shqyrtimit përfshin tërësinë e të gjithë procesit, deri në vendimin për dhënien fund të mosmarrëveshjes (“kontestimi”). Në çështjen që kemi përpara, zgjidhja e mosmarrëveshjes, e cila mund të ishte zgjidhur në mënyrë miqësore, kërkoi dy procese: Një proces përpara gjykatave administrative, sepse vetëm ato kanë kompetencë për të vlerësuar nëse është i ligjshëm apo jo interesi publik i një shpronësimi dhe një proces i dytë i zhvilluar paralelisht si para gjykatave administrative ashtu edhe përpara atyre të zakonshme, për të siguruar kompensim për paditësen për shpronësimin e paligjshëm të pronës së saj nga autoritetet publike.*

⁵⁶ Në këtë çështje, Gjykata mori në konsideratë edhe se cili qe interesi në rrezik i paditësit.

⁵⁷ Aktgjykimi i çështjes “Yagci dhe Sargin - Turqi”, datë 8 qershor 1995.

⁵⁸ Shtojca 1.

⁵⁹ Aktgjykimi i çështjes “Mori - Itali”, datë 19 shkurt 1991.

Ky proces i dytë është ende i papërfunduar. Kohëzgjatja që duhet marrë në konsideratë i kalon katërmbëdhjetë vjet (19 nëntor 1982-22 janar 1997)”.

Mënyra e vlerësimit nga Gjykata i jep kësaj mundësi të marrë në konsideratë vetëm kohëzgjatjen e tepruar të procesit në shkallë të parë, edhe sikur ky proces të jetë ende i papërfunduar. Shpesh kjo vlen në çështjet me objekt përgjegjësi civile për dëme të shkaktuara nga pakujdesia, në të cilën momenti i fillimit është vendimi për dhënien e dëmshpërblimit që i jep fund mosmarrëveshjes, dhe jo vendimi për parimin e përgjegjësisë civile⁶⁰. Në çështje të tilla kohëzgjatja e tepruar e procesit shpesh shkaktohet nga koha e nevojshme për depozitimin e akt-ekspertizës⁶¹.

Në çështjen “Silva Pontes”, Gjykata shprehej qartë se “nëse legjislacioni i brendshëm i një Shteti parashikon proces me dy etapa, një etapë në të cilën gjykata shprehet me vendim për ekzistencën e një detyrimi për të paguar dhe një tjetër ku gjykata përcakton shumën e dëmshpërblimit, është e arsyeshme të mendohet se, në kuptim të nenit 6 pika 1 e drejta civile nuk “konstatohet” gjersa të mos jetë vendosur shuma. Konstatimi i të drejtës përfshin marrjen e vendimit jo vetëm për ekzistencën e kësaj të drejte, por edhe për objektin apo mënyrën me të cilën mund të ushtrohet (shih, mes autoriteteve të tjera, aktgjykimin e çështjes “Pudas - Suedi”, datë 27 tetor 1987, Seria A nr. 125-A, f 14, pika 31), që dukshëm do të kishte përfshirë llogaritjen e shumës së detyrimit.” Mirëpo Gjykata mund të vendosë se etapa e parë e procesit në vetvete e ka kapërcyer afatin kohor të arsyeshëm.

Por Gjykata Evropiane nuk i merr në konsideratë procedurat paragjyqësore përpara GJDBE-së (ish-GJDKE), sepse “nëse do t’i merrte në konsideratë kjo do ta prekte negativisht sistemin e ngritur me nenin 177 të Traktatit të KEE-së (tani neni 287 të TFBE-së) dhe do të binte ndesh me qëllimin e synuar në thelb nga ky nen” (aktgjykimi i çështjes “Pafitis dhe të tjerë - Greqi”, datë 26 shkurt 1998, pika 95).

Gjykata sanksionon edhe kohëzgjatjen e paarsyeshme të procesit të apelit. Konstatimet negative janë mbështetur përgjithësisht në procesin tejet të gjatë të kasacionit përpara institucionit *Conseil d’Etat* (çështja “Ouendeno - Francë”, datë 16 prill 2002) dhe Gjykatës së Kasacionit (çështja “Brochu - Francë”, datë 12 qershor 2001)⁶³.

Në rastin e referimit tek gjykatat kushtetuese, Gjykatës i duhet të vendosë nëse kanë ndikuar apo jo në rezultatin e procesit në fjalë. Nëse është kështu, shqyrtimi nga gjykata kushtetuese përfshihet në kohëzgjatjen e procesit.

Për shembull, në aktgjykimin e çështjes “Deumeland- Gjermani”, datë 29 maj 1986, Gjykata vendosi në lidhje me Gjykatën Kushtetuese Gjermane se “megjithëse nuk kishte juridiksion për të vendosur në themel të çështjes, vendimi i saj që në gjendje ta prekte rezultatin e padisë”, dhe konstatoi shkelje të nenit 6, pika 1.

Në Francë, hyrja në fuqi e të ashtuquajturës “Çështje Kushtetuese Parësore” (ÇKP) më 1 mars 2010, që futi një shqyrtim *a posteriori* nga Këshilli Kushtetues i kushtetutshmërisë së ligjeve, duhet të prekë edhe vlerësimin e kriterit të kohëzgjatjes së arsyeshme të procesit, sidomos meqë ky mekanizëm, i cili mund të vihet në zbatim vetëm në kuadër të një mosmarrëveshjeje, kërkon që gjykata që e gjykon çështjen të mos marrë asnjë vendim pa u përfunduar procedura ÇKP. Megjithatë, këto dispozita të reja vendosin afate shumë strikte për shqyrtimin e këtyre çështjeve: gjykatat në fjalë duhet të vendosin “pa vonesë” dhe gjykatat e larta të sistemit administrativ dhe atij gjyqësor si edhe Gjykata Kushtetuese, duhet ta japin vendimin brenda tre muajve, me një afat maksimal prej 6 muajsh.

Gjykata konsideron se koha e kaluar që u ngarkohet autoriteteve administrative mund t’i ngarkohet edhe shtetit, edhe sikur këto autoritete të jenë të dallueshme nga autoritetet qendrore.

⁶⁰ Aktgjykimi “Guincho - Portugali”, datë 10 korrik 1984.

⁶¹ Për shembull, procesi që zgjati mbi 17 vjet e 10 muaj në të cilin nuk u dha kurrë vendimi në themel (“Roselli - Itali”, datë 15 shkurt 2000), ose çështja që vazhdon pa një vendim në gjykatën e shkallës së parë 8 vjet e 8 muaj pas fillimit të procesit (“Marques Gomes Galo - Portugali”, datë 23 nëntor 1999).

⁶² Aktgjykimi i çështjes “Silva Pontes - Portugali”, datë 23 mars 1984.

⁶³ N. Fricero, *Garanties de nature procédurale : équité, publicité, célérité et laïcité*, në *Dorit et pratique de la procédure civile*, Dalloz action, 2009-2010, Nr. 212.136, f 562.

Kjo vlen, për shembull, për autoritetet vendore, si në aktgjykimin e çështjes “Kurt Nielsen - Danimarkë”, datë 15 shkurt 2000, ku Gjykata shprehej “*por Palët Kontraktuese mbajnë përgjegjësi edhe për vonesat që u ngarkohen organeve të së drejtës publike, siç janë autoritetet bashkiake, të cilat, edhe pse nuk janë organe të Shtetit, kryejnë detyra zyrtare që u ngarkohen me ligj*”. Me këtë lidhet edhe aktgjykimi i çështjes “H. - Mbretëria e Bashkuar”, që ka të bëjë me sjelljen zvarritëse të një komiteti të një këshilli vendor i cili ishte përgjegjës për mbikëqyrjen dhe përkujdesjen e të miturve.

Gjykata përfshin në llogaritjen e periudhës së përgjithshme edhe kohën që merr procedura e përmbartimit. Ekzekutimi i një vendimi nga cilado gjykatë duhet të konsiderohet si pjesë integrale e “gjykimit” në kuptim të nenit 6: e drejta për t’u dëgjuar brenda një afati kohor të arsyeshëm do të mbetet një iluzion nëse sistemi juridik i brendshëm i Shtetit do të mundësonte që vendimi gjyqësor i formës së prerë të mbetet jo i efektshëm në dëm të ndonjë pale (shih aktgjykimin e çështjes “Hornsby - Greqi”, datë 19 mars 1997, pika 40).

Gjatë këtyre viteve të fundit, mosekzekutimi ose ekzekutimi i vonuar i vendimeve të gjykatave të brendshme është bërë problemi i dytë më i shpeshtë i identifikuar në aktgjykimet e Gjykatës. Këshilli i Ministrave e ka bërë prioritet këtë problem në kuadër të mbikëqyrjes së ekzekutimit të aktgjytimeve të Gjykatës⁶⁴.

Në çështjen e kohëve të fundit “Ziabreva- Rusi”, vendim datë 18 mars 2009, Gjykata sanksiononte kohëzgjatjen e tepruar të procedurës së përmbartimit në bazë të shkeljeve si të së drejtës për dëgjim të rregullt (neni 6, pika 1) dhe të së drejtës për respektim të pronës të siguruar me nenin 1 të Protokollit 1, që ilustron rëndësinë që ka faza e përmbartimit për zbatimin e efektshëm të së drejtës së garantuar.

Kohëzgjatja e procedurës së përmbartimit duhet vlerësuar edhe në përputhje me të njëjtat kritere si kohëzgjatja e procesit kryesor (çështja “Bendayan Azcantot dhe Benalai Bendayan - Spanjë”, vendim datë 9 qershor 2009, pika 71; kjo çështje kishte të bënte me ekzekutimin e një aktgjykimi që i kërkonte një individ të paguante dëmshpërblim të një natyre civile të lidhur me një vepër penale si edhe shpenzimet dhe kostot e lindura në kuadër të procesit penal).

Në aktgjykimin e çështjes “Pinto de Oliveira- Portugali”, datë 8 mars 2001 (vetëm në frëngjishte), konstatoi se procesi që duhej marrë në konsideratë fillonte më 11 maj 1993, kur çështja i qe kaluar gjykatës Mangualde, dhe që ende e pambyllur në momentin e dhënies së aktgjykimit ngaqë në vendimin nëse që apo jo e arsyeshme kohëzgjatja duhej marrë edhe procesi i papërfunduar i ekzekutimit që kishte filluar më pas.

Në një çështje italiane, Gjykata nuk pranonte të shprehte një mendim nëse sipas legjislacionit italian procedura e përmbartimit që autonome, duke shtuar se “*Gjykata vendos duke iu referuar Konventës dhe jo në bazë të legjislacionit të brendshëm, nëse e drejta e konfirmuar nga ... [paditësit] që bërë e efektshme dhe, nëse po, kur*”.⁶⁵Në këtë mosmarrëveshje, Gjykata konsideronte se procedura e përmbartimit duhet konsideruar si fazë e dytë e procesit të parë, i cili nuk kishte përfunduar ende duke qenë se gjyqtari përgjegjës për procedurën e përmbartimit nuk e kishte dhënë ende vendimin.

Në shkelje të nenit 6, pika 1, mund të çojë edhe moszbatimi i vendimit të formës së prerë brenda një afati kohor të arsyeshëm nga autoritetet.

Kjo është veçanërisht e vërtetë kur detyrimi për zbatimin e vendimit i kalon një autoriteti administrativ, si në një sërë aktgjykimesh të kohëve të fundit: “Metaxas - Greqi”, datë 27 maj 2004, “Timofeyev - Rusi”, datë 23 tetor 2003, “Prodan - Moldavi”, datë 18 maj 2004 dhe “Romashov - Ukrainë”, datë 27 korrik 2004. Në çështjen “Metaxas” (aktgjykim vetëm në frëngjishte), Gjykata konstatoi se në shkelje të nenit 6, pika 1, autoritetet kombëtare nuk e kishin respektuar brenda një afati kohor të arsyeshëm një vendim të Gjykatës së Kontrollit, që që dhënë më 13 prill 2000, por e kishin zbatuar vetëm më 19 shtator 2001, duke ia hequr të gjithë efektin e dobishëm.

⁶⁴ Udhëzuesi për praktikën e mirë, që shoqëron Rekomandimin CM/Rec(2010)3 për rrugët ligjore të efektshme për kohëzgjatjen e tepruar të proceseve, f 5, shënimi 13.

⁶⁵ Aktgjykimi i çështjes “Zappia - Itali”, datë 26 shtator 1996.

Gjykata e bën Shtetin përgjegjës për përmbaruesit të cilëve u jep kompetencën, në formë monopoli, për kryerjen e masave të përmbarimit: i takon Shtetit të bëjë të gjithë hapat e nevojshëm për t'u mundësuar përmbaruesve kryerjen e detyrës së ngarkuar, sidomos duke siguruar pjesëmarrjen e efektshme të autoriteteve të tjera që mund të asistojnë përmbarimin kur këtë e kërkojnë rrethanat (aktgjykimi i çështjes "Pini dhe të tjerë - Rumani", datë 22 qershor 2004, pika 183).

Po kështu, në aktgjykimin "SARL IZA dhe Makrakhidze - Gjeorgji", datë 27 shtator 2005, Gjykata shprehej se "duke mos siguruar për katër vjet ekzekutimin e vendimit të ekzekutueshëm të datës 14 maj 2001, autoritetet gjeorgjiane ua kanë hequr dispozitave të nenit 6, pika 1, të Konventës të gjithë efektin e dobishëm".

Në mënyrë të ngjashme, procedura e ekzekutimit të vendimit të huaj është objekt i të njëjtave kritere dhe duhet të plotësohet brenda një afati kohor të arsyeshëm, kriter i cili nuk përmbushet nëse duhen mbi pesëmbëdhjetë vjet për këtë për shkak të pakujdesisë së gjykatës (aktgjykimi i çështjes "Hohenzollern - Rumani", datë 27 maj 2010)⁶⁶.

Njësoj si Komisioni më parë, Gjykata merr në konsideratë apelimet e jashtëzakonshme. Në vendimin për pranueshmërinë, datë 14 janar 1998, në çështjen "Z.C. - Poloni" (vetëm në frëngjishte), Komisioni vërente se Gjykata e Lartë i kishte pranuar dy herë apelimet e jashtëzakonshme të paditësit dhe i kishte prishur vendimet e gjykatave të shkallës së parë për gabime të dukshme në interpretimin e ligjit. Kompetenca për autorizimin e apeliemeve të tilla u ishte dhënë Prokurorit të Shtetit dhe Ministrisë së Drejtësisë. Gjykata e Lartë, e cila i shqyrtonte apelieme të tilla, kishte kompetencën për t'i shpallur të pavlefshme, për t'i prishur ose për t'i lënë në fuqi vendimet e gjykatave të shkallëve të mëposhtme. Për rrjedhojë, shqyrtimi nga e saj ishte vendimtar për të drejtat dhe detyrimet civile të paditësit, në kuptim të nenit 6, pika 1, të Konventës, kështu që të gjitha apelimet, duke përfshirë edhe ato të jashtëzakonshme, duheshin marrë në konsideratë gjatë llogaritjes së kohëzgjatjes së procesit.

Kontrolli mbikëqyrës i Gjykatës mund të shtrihet edhe mbi proceset sekondare. Në aktgjykimin e çështjes "Robins - Mbretëria e Bashkuar", datë 23 shtator 1997, që kishte të bënte me një kërkesëpadi për kostot në bazë të Ligjit të brendshëm për Ndihmë Juridike, Gjykata konstatonte se "edhe pse vendimi për procesin për kostot merret në mënyrë të veçantë, duhet të shihet si vazhdim i ndërgjygjësisë bazë, pra si pjesë e konstatimit ... të të drejtave dhe detyrimeve civile". Ajo mbështetej tek një sërë aktgjykimesh të mëparshme, përfshirë edhe atë të çështjes "Silva Pontes - Portugali", datë 23 mars 1994, "Di Pede - Itali", dhe "Zappia - Itali", datë 26 shtator 1996, dhe "Hornsby - Greqi", datë 19 mars 1997. Ndonjëherë, nuk ka mbaruar ende as gjykimi. Në aktgjykimin e çështjes "Grauslys- Lituani", datë 10 tetor 2000, drejtori tregtar i një shoqërie private që pezulluar për arsye krimi ekonomik dhe që proceduar penalisht nga prokuroria. Kjo çështje penale zgjati pesë vjet pa u dhënë asnjëherë asnjë aktgjykim në shkallën e parë.

Sa më i madh efekti që ka vonesa tek rezultati i procesit, aq më ashpër e gjykon çështjen Gjykata. Një shembull është kur përdorimi i afatit kohor e pengon paditësin të marrë një vendim në themel të çështjes. Në aktgjykimin e çështjes "Textile Traders Limited - Portugali", datë 27 shkurt 2003 (vetëm në frëngjishte), Gjykata konstatonte se i bënte veçanërisht përshtypje që prokurorisë i qe dashur të vendoste për kërkesat për shfuqizimin e disa masave procedurale ngaqë nuk i qenë njoftuar shoqërisë që paraqiste kërkesën. Më në fund procesi penal që pushuar ngaqë qe tejkalluar afati, duke mos ia lejuar kështu shoqërisë marrjen e një vendimi për kërkesën që kishte paraqitur gjatë procesit.

Në fund, kërkohet një korrektesë edhe më e madhe në rastet kur procesi kërkon të konstatojë përgjegjësinë e shtetit lidhur me shkeljen e kriterit të afatit kohor të arsyeshëm. Aktgjykimi i çështjes "Vaney- Francë", datë 30 nëntor 2004 (vetëm në frëngjishte) ka të bëjë me një padi për të vendosur nëse ka qenë apo jo përgjegjës shteti, dhe nëse po a duhej penalizuar, për kohëzgjatjen e tepruar të një procesi gjyqësor të mëparshëm. Në aktgjykimin arrihej në përfundimin se procesi që kishte zgjatur dy vjet e shtatë muaj përpara gjykatës së apelit dhe dy vjet e gati katër muaj përpara Gjykatës së Kasacionit e kishte tejkalluar kriterin e afatit kohor të arsyeshëm.

⁶⁶ Obs. N. Fricero, *Procédures*, Nr. 7, korrik 2010, kom. 271.

PJESA E DYTË

ARSYET E VONESAVE DHE RRUGËZGJIDHJET PËR TO: GJETJA E PERIUHËS SË ARSYESHME

Pjesa e dytë e raportit ka të bëjë me:

1. Arsyet e vonesave, siç dalin, shprehimisht apo të nënkuptuara, nga aktgjykimet e Gjykatës, vendimet për pranueshmërinë e çështjes nga Gjykata dhe Komisioni dhe materialet e paraqitura nga Drejtorja e Ekzekutimit të Aktgjytimeve të Gjykatës.

Drejtorja vëren se aktgjykimet e Gjykatës po bëhen gjithnjë e më pak të heshtur sa u takon arsyeve të vonesave dhe se është e nevojshme të kërkohet sqarim për pengesat përkatëse dhe vështirësitë nga autoritetet kombëtare në fjalë. Rezolutat e Këshillit të Ministrave janë interesante në këtë aspekt sepse ofrojnë informacion të vlefshëm për reformat e kryera, që mundësojnë identifikimin në mënyrë retrospektive problemet e njehershme dhe ato më strukturore për të cilat janë ideuar të ndreqin. Këto rezoluta janë të përfshira në raportet vjetore të Këshillit të Ministrave, i pari prej të cilëve mbulon vitin 2007⁶⁷.

Ka tre shkaqe kryesore për vonesat:

- shkaqe jashtë sistemeve juridike dhe gjyqësore në kuptimin e ngushtë të fjalës, të cilat lidhen me kushtet politike dhe ekonomike;
- shkaqe që hasen në të gjitha llojet e proceseve;
- shkaqe që vlejnjë për një kategori të caktuar procesesh, në varësi të faktit nëse janë procese civile, penale ose administrative.

2. Reformat kryesore të zbatuara në sistemet e brendshme pas aktgjytimeve negative të Gjykatës dhe rrugëzgjdhjet e brendshme për të kërkuar vënien në vend të drejtësisë për dëmin e pësuar si pasojë e kohëzgjatjes së tepruar të proceseve apo për të përshpejtuar proceset.

3. Afatet e konsideruara si të arsyeshme, pasi janë përshkruar shumë vonesat e tepruara dhe “patologjike”, është mirë të këqyren deri në fund dhe pasi të jetë theksuar trendi kryesor i Gjykatës, të nënvizohen disa llojeve vonesash që konsiderohen si të arsyeshme. Disa çështje përshkruhen më me hollësi në tabelat e shtojcave 3 dhe 4 të këtij raporti.

I. ARSYET E VONESAVE

A. Arsyet e jashtme të vonesave

•Prejardhja e vonesave: ngjarjet e mëdha politike

Marrja në konsideratë e ngjarjeve politike nga Gjykata ndryshon sipas rasantit, nëse çështjet paraqiten përpara gjykatave të zakonshme apo përpara gjykatës kushtetuese të Shtetit në fjalë: ky dallim zyrtarizohet në aktgjykimin e çështjes “Süssmann - Gjermani”, dhe në çështjet e mëpasshme.

Në kushtet e ribashkimit të Gjermanisë, në vitin 1990, për disa vjet vendi u bë objekt aktgjykimesh me konstatim shkeljeje si pasojë e krijimit të stokut të çështjeve të prapambetura në Gjykatën Kushtetuese, e cila qe shumë e zënë me çështje madhore të lidhura me ribashkimin.

⁶⁷ Për një analizë të mënyrës së mbikëqyrjes së ekzekutimit të aktgjytimeve nga Këshilli i Ministrave dhe vendimet e ndryshme që ka marrë ky organ i Këshillit të Evropës, shih E. Lambert Abdelgawad, *The Execution of Judgments of the European Court of Human Rights* (Ekzekutimi i aktgjytimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut), raport vjetor, në *Revue trimestrielle des droits de l’homme*, 2006, f. 669 ff, dhe 2007, f. 647 ff.

Shumë prej këtyre kanë pasur të bëjnë me kompensimin e viktimave të shpronësimeve të bëra nga viti 1945 deri në vitin 1949 në atë zonë të Gjermanisë të pushtuar nga sovjetikët pas reformës agrare ose pas vitit 1949 në ish-RDGJ.

Kohët e fundit, Gjykata shqyrtoi njërën prej këtyre çështjeve (“Von Maltzan dhe të tjerë, Von Zitzewitz dhe të tjerë, Man Ferrostaal dhe Alfred Töpfer Stiftung - Gjermani”, vendim datë 2 mars 2005) nga këndvështrimi i kohëzgjatjes së procesit dhe e konstatoi si të papranueshme kërkesëpadinë. Gjykata u mbështet në jurisprudencën “Süssmann” të disa viteve më parë, e cila njihnte rolin e veçantë të gjykatave kushtetuese në shtetet demokratike.

Në aktgjykimin e çështjes “Süssmann- Gjermani”, datë 16 shtator 1996⁶⁸, gjykata shprehej (pika 55-57): *“Roli si mbrojtëse e Kushtetutës e bën veçanërisht të nevojshme që Gjykata Kushtetuese ndonjëherë të marrë parasysh konsiderata të tjera sesa thjesht rendin kronologjik në të cilin futen në listë çështjet, siç është natyra e një çështjeje dhe rëndësia e saj në aspektin politik dhe shoqëror.”*

Në këtë çështje, e cila kishte të bënte me një mosmarrëveshje për nivelin e pensionit shtesë të pleqërisë që prekte shumë nëpunës civilë, Gjykatës i duhej të arrinte një drejtpeshim mes kriterit për afat kohor të arsyeshëm dhe parimit më të përgjithshëm të dhënies së drejtësisë, që në këtë rast justifikonte grupimin në një vend të njëzetekatër çështjeve dhe dhënien përparësi nga Gjykata Kushtetuese të një vargu çështjesh të tjera të ngutshme të lidhura me ribashkimin e Gjermanisë dhe që preknin kontratat e punësimit të 300.000 nëpunësve civilë të ish-RDGJ-së. Gjykata arriti në përfundimin se nuk kishte pasur shkelje të Konventës, në një çështje të ngritur përpara Gjykatës Kushtetuese si pasojë e apelimeve individuale dhe jo e ardhur nga një gjykatë tjetër.

Një çështje tjetër e rëndësishme kishte të bënte me kushtetueshmërinë e dispozitave ligjore të futura në zbatim kur sistemi i sigurimeve shoqërore dhe pensionale të Gjermanisë Lindore u integrua në atë të Republikës Federale dhe në veçanti se si duheshin trajtuar pensionet shtesë të punës. Në disa vendime për mospranimin e çështjes⁶⁹, Gjykata konstatonte se koha e përdorur për zhvillimin e procesit përpara Gjykatës Kushtetuese nuk qe e tepruar, duke pasur parasysh kompleksitetin dhe në përputhje me jurisprudencën e nxjerrë nga çështja “Süssmann”.

Çështja “Trikovic - Slloveni” ka të bëjë me situatën e Shteteve të reja të lindura nga shpërbërja e ish-Jugosllavisë. Padiësi, një slloven me origjinë serbe parashtroi se kërkesa e tij lidhur me pensionin ushtarak përpara Gjykatës Kushtetuese qe gjykuar tepër ngadalë (me kohëzgjatje 2 vjet e shtatë muaj). Mirëpo, Gjykata nuk e mbante si shkelje të afatit të arsyeshëm kohëzgjatjen e procedurës përpara Gjykatës Kushtetuese të Sllovenisë, duke theksuar se dosja e padiësit qe e para e një vargu mosmarrëveshjes me një ndërlikim të skajshëm, të përbëra nga personeli ushtarak i ish-Jugosllavisë, Gjykata e pranonte se kjo situatë nënkuptonte për të një këqyrje me hollësi të çështjes.

Në të kundërt, kur vonesat në fakt shkaktohen nga gjykatat e zakonshme dhe përkundër kushteve të një politike të përgjithshme të trazuar, Gjykata tregohet më kërkuese kundrejt Shtetit në fjalë duke i rikujtuar angazhimin konvencional në përputhje me nenin 6, pika 1.

Me kthimin në demokraci në vitin 1978, Spanja përjetoi probleme gjyqësore të konsiderueshme. Në aktgjykimin e çështjes “Union Alimentaria Sanders SA”, datë 7 korrik 1989, Gjykata shprehte vetëdijen se *“Spanjës i është dashur të kapërcejë vështirësi të mëdha gjatë rivendosjes së demokracisë. Gjykata e vlerëson rregullisht punën e bërë nga autoritetet spanjolle për rritjen e mundësive që i jepen publikut për t’iu drejtuar gjykatave dhe për përmirësimin e sistemit gjyqësor të vendit. Por, Gjykata rithekson se, me ratifikimin e Konventës, Spanja ka marrë përsipër ta riorganizojë sistemin e saj gjyqësor në mënyrë të atillë që të sigurojë përmbushjen e kërkesave të nenit 6, pika 1 [të Konventës]”.*

Shembuj nga jurisprudenca

⁶⁸ Shih edhe vendimet për mospranimin e çështjeve “Scwengel - Gjermani”, datë 2 mars 2000 dhe “Kuna - Gjermani”, datë 10 prill 2001.

⁶⁹ Çështja “Kuna - Gjermani”, vendim datë 10 prill 2001, çështja “Schwengel - Gjermani”, vendim datë 2 mars 2000.

⁷⁰ Aktgjykim datë 12 qershor 2001.

Jurisprudenca "Süssman" është konfirmuar nga Gjykata në aktgjykimin e çështjes "Gast dhe Popp - Gjermani", datë 25 shkurt 2000, ku shprehej se *"edhe pse neni 6 kërkon që procesi gjyqësor të jetë i shpejtë, aty vihet theksi gjithashtu tek parimi më i përgjithshëm i dhënies së drejtësisë"*.

Gjykata e rikonfirmoi këtë argument në lidhje me Gjykatën Kushtetuese të Portugalisë, në aktgjykimin e çështjes "Rosa Marques dhe të tjerë - Portugali", datë 25 korrik 2002 (vetëm në frëngjishte), në të cilin pranonte argumentin e qeverisë se kriteri i afatit kohor të arsyeshëm nuk mund të interpretohej njësoj si për gjykatën e zakonshme ashtu edhe për gjykatën kushtetuese, nëse kemi parasysh rolin e kësaj të fundit si kujdestare e kushtetutës dhe përparësinë që duhej t'u jepte çështjeve të caktuara me rëndësi më të madhe shoqërore dhe politike. Sidoqoftë, gjykata konstatoi shkelje të nenit 6, pika 1, duke qenë se kjo çështje kishte të bënte me proces shpronësimi pa ndonjë ndërlikim të veçantë i cili kishte zgjatur tetë vjet e dy muaj në katër shkallë të veçanta gjykimi.

Lidhur me gjykatat e shkallës së parë dhe apelit të Portugalisë, ky vend qe përballur me të njëjtat vështirësi disa vjet më parë, siç e ka pranuar në mënyrë të ngjashme Gjykata: *"Ajo (Gjykata) nuk mund ta shpërfillë faktin se rivendosja e demokracisë në prill 1974 bëri që Portugalia të kryente një riorganizim të sistemit gjyqësor në rrethana të trazura të cilat nuk kishin shoqe në shumicën e vendeve të tjera evropiane dhe të cilat bëheshin më të vështira nga procesin i shkolonizimit si edhe nga kriza ekonomike ..."*⁷¹. Megjithatë, Gjykata konstatoi në këtë çështje se Portugalia e kishte shkelur detyrimin që rridhte nga Konventa sipas të cilit duhej të siguronte që çështjet të shqyrtoheshin brenda një afati kohor të arsyeshëm.

Reformat madhore

Spanja ndërmori reforma të konsiderueshme në sistemin gjyqësor kombëtar me ligjet organike të datës 10 janar 1980 me të cilin ngrihej një komision për shërbimet gjyqësore dhe datës 1 korrik 1985 për sistemin gjyqësor. Në Barcelonë katër gjykata të shkallës së parë filluan punën në shtator 1981 dhe u krijuan rrethet e reja gjyqësore.

•Prejardhja e vonesave: kalimi nga ekonomia e planit në atë të tregut

Trazirat politike dhe ekonomike në disa shtete të caktuara kontraktuese çuan në ndryshime të organizimit të sistemeve gjyqësore të tyre.

Jurisprudenca e Gjykatës lidhur me shtetet që e kanë nënshkruar Konventën pas rënies së Murit të Berlinit zbulon një lidhje mes problemeve të kohëzgjatjes së procesit dhe ndryshimeve në sistemet politike dhe ekonomike të Evropës Lindore. Kalimi nga ekonomia e planit në atë të tregut solli ndryshime në marrëdhëniet e shtetasve me ligjin dhe proceset gjyqësore dhe në formimin e gjyqtarëve, reforma në kodin e procedurës dhe një rishpërndarje të përgjegjësisë mes gjykatave, të cilat më pas çuan në vonesa.

Gradualisht janë vendosur parimet e reja kushtetuese të një sistemi gjyqësor të pavarur dhe ndarja e pushteteve. Këto ndryshime kanë sjellë vonesa në proceset gjyqësore, siç ka sjellë edhe vetë praktika gjyqësore e Gjykatës, çka i ka shtyrë disa prej këtyre vendeve ta reformojnë procedurën civile dhe penale të tyre.

Shembuj nga jurisprudenca

Republika Çeke i filloi reformat e gjyqësorit pas vitit 2000. Në aktgjykimin e çështjes "Zouhar - Republika Çeke", datë 11 tetor 2005 (vetëm në frëngjishte), Gjykata pranonte se gjykatës rajonale i qe dashur t'ua kalonte çështjen në disa raste autoriteteve të tjera kombëtare në funksion të proceseve përpara saj dhe se sistemi gjyqësor kombëtar qe riorganizuar ndërkohë që çështja qe në shqyrtim e sipër.

Në aktgjykimin e çështjes "Podbielski", datë 30 tetor 1998, Gjykata e njihte këtë problem në lidhje me Poloninë, lidhur me një paditës i cili qe ende në pritje të një vendimi të formës së prerë. Ajo vërente se *"vonesa në dhënien e një vendimi të formës së prerë për padinë e paditësit qe shkaktuar në një masë të madhe nga ndryshimet legjislative që rridhnin nga kërkesat e tranzicionit nga një sistem i kontrolluar nga shteti në një sistem të tregut të lirë dhe nga kompleksiteti i procedurave të lidhura me ndërgjygjësinë dhe të cilat e pengonin marrjen e një vendimi të përsheptuar për padinë e paditësit"*.

⁷¹ Aktgjykimin e çështjes "Guincho - Portugali", datë 10 korrik 1984.

Gjykata rikujton në këtë aspekt se neni 6, pika 1, vendos mbi Shtetet Kontraktuese detyrimin për t'i riorganizuar sistemet gjyqësore të tyre në mënyrë të atillë që gjykatat të mund t'i përmbushin secilën prej kërkesave të saj, përfshirë edhe detyrimin për të marrë vendim për çështjet gjyqësore brenda një afati kohor të arsyeshëm. Për rrjedhojë, vonesa në proces duhet t'u ngarkohet kryesisht autoriteteve kombëtare" (pika 38).

B. Vonesa që hasen në të gjitha llojet e proceseve

1. Vonesa në fillimin e procesit

•Prejardhja e vonesave: problemet gjeografike

Shpërndarja jo e njëtrajtshme e gjykatave brenda vendeve del shpesh si problem nga aktgjykimet e Gjykatës, të cilat përmendin ngarkesën e tepruar me çështje që lind nga organizimi gjeografik i cili nuk ka arritur t'u përgjigjet ndryshimeve demografike dhe ekonomike.

Shembuj nga jurisprudenca

Problemet e shkaktuara nga ngarkesa e tepruar e disa gjykatave të caktuara përshkruhet me njëfarë hollësie në aktgjykimin e çështjes "Union Alimentaria Sanders SA - Spanjë", datë 7 korrik 1989: gjykatat e ulëta të mbingarkuara (secilës prej gjykatave të shkallës së parë të Barcelonës i duhej të merrej mesatarisht me 1.800 çështje), 62% rritje nga viti 1981 në 1984 në vëllimin e çështjeve të trajtuara nga gjykata e apelit e Barcelonës, e kështu me radhë. E njëjta histori ndodh në shumë shtete kontraktuese në pika të ndryshme të historisë juridike të tyre. Në rastin e Spanjës, përkundër masave që mori shteti, Gjykata konstatoi se pesë vjet e dy muaj proces përpara dy shkallëve gjykim qenë të tepruar.

Reformat kombëtare

Pas konstatimeve të ndryshme të shkeljeve të lidhura me kohëzgjatjen e proceseve, autoritetet italiane e informuan Këshillin e Ministrave se qenë filluar disa reforma të caktuara. "Ligji nr. 30, datë 1 shkurt 1989, (hyrë në fuqi po atë vit), lidhur me gjykatat e shkallës së parë (preturë), e ripërcakton kompetencën territoriale të këtyre gjykatave e cila tashmë nuk kufizohet me departamentin. Kjo ka bërë të mundur heqjen e 273 gjykatave të shkallës së parë të cilat kishin ngarkesë të ulët çështjesh dhe rishpërndarjen e magistrave dhe personelit ndihmës mes gjykatave me ngarkesë më të madhe çështjesh."⁷²

Në Hungari, ngarkesa e Gjykatës së Lartë ka rënë ndjeshëm pas një reforme të sistemit gjyqësor në vitin 2002. Kjo reformë ua kaloi funksionet e apelit të kësaj gjykate pesë gjykatave të apelit të krijuara në 2003 dhe 2004.⁷³

- **Prejardhja e vonesave: transferimet dhe numri i pamjaftueshme i gjyqtarëve dhe moszëvendësimi i gjyqtarëve të transferuar dhe të padisponueshëm**

Vonesa shkaktohet nga tërheqja e gjyqtarit që gjykon çështjen, zëvendësimi i vonuar ose moszëvendësimi dhe problemi i rekrutimit të gjyqtarëve.

Kjo çështje lidhet me mënyrën si merren dhe mbahen në punë gjyqtarët.

Ky problem ka ndodhur në shumë shtete kontraktuese në periudha të ndryshme dhe shpesh ndërthuret me vështirësi të tjera që prekin funksionimin e gjykatave, siç është mungesë stafi mbështetës adekuat. Gjykata rregullisht vë në pah se neni 6, pika 1, vendos mbi Shtetet Kontraktuese detyrimin për t'i riorganizuar sistemet gjyqësore të tyre në mënyrë të atillë që gjykatat të mund t'i përmbushin secilën prej kërkesave të saj, përfshirë edhe detyrimin për t'i shqyrtuar çështjet gjyqësore brenda një afati kohor të arsyeshëm.

Nëse masat e marra nuk janë të mjaftueshme për ta përmirësuar situatën, Gjykata bën përgjegjëse autoritetet kombëtare.

⁷² Rezoluta ResDH (95) 82 lidhur me çështjen "Zanghi - Itali".

⁷³ Çështja "Timar dhe të tjerë - Hungari". Rendi i ditës, me shënime, i mbledhjes së 922-të të Këshillit të Ministrat, prill 2005, CM/Del/OJ/(2005) 922, vol I

Mungesa e gjyqtarëve ndonjëherë e pengon zbatimin e masave procedurale që përndryshe do të ndihmonin në shmangien e vonesave. Në çështjen “Guincho”, doli se sipas nenit 159 dhe 167 të Kodit portugez të Procedurës Civile të zbatueshëm asokohe gjyqtari mund të paraqiste një kërkesë për dorëzimin e fletë-thirrjes, pas së cilës sekretarisë së gjykatës i mbeteshin dy ditë për t’ia paraqitur gjykatës përkatëse dhe kjo e fundit duhej të jepte urdhër për dorëzimin e fletë-thirrjes brenda pesë ditëve (pika 11). Por në këtë rast, gjyqtari i cili kishte lëshuar kërkesën për fletëthirrje në fillim të dhjetorit që transferuar dhe që zëvendësuar me një koleg i cili e lëshoi përsëri kërkesën më 18 janar dhe në disa raste të tjera më pas, por përgjigjen e mori më 18 qershor, pra pas gjashtë muajve.

Shembuj nga jurisprudenca

Një prej këtyre çështjeve të shumta kishte të bënte me një proces civil që kundërshtonte një barrë sigurorese⁷⁴, ku gjyqtari i ngarkuar me çështjen u transferua dhe çështja mbeti pasive gjer në zëvendësimin e tij pas thujse shtatëmbëdhjetë muajsh.

Në çështjen “Nankov- ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë”, datë 2 qershor 2008, një prej shkaqeve të vonesës në një proces penal që kishte vazhduar dhjetë vjet që ndryshimi i shpeshtë i gjyqtarëve.

Në aktgjykimin e çështjes “Pokhalchuk - Ukrainë”, datë 7 tetor 2010, Gjykata vërente se disa vonesa qenë shkaktuar nga shtyrjet e seancave për arsye se nuk ndodhej gjyqtari dhe se trupi gjykues nuk që i plotë, çka e bëri procesin të zgjaste mbi dhjetë vjet lidhur me një çështje jo komplekse mbi caktimin e kufijve të pronës.

Në shembujt e kohëve më të fundit përfshihen një sërë çështjesh belge, në veçanti aktgjykimi i çështjes “Willekens - Belgjikë”, datë 24 prill 2003, dhe aktgjykimi i çështjes “Dumont - Belgjikë”, datë 28 prill 2005. Në këtë të fundit (vetëm në frëngjishte), Gjykata konstatonte se i vetmi shkak i vonesave përpara gjykatave të shkallës së parë të Brukselit që mungesa e personelit gjyqësor, çka nga ana e saj solli vështirësi në rekrutim të lidhura me kriterin ligjor që gjyqtarët duhej të dinin frëngjishten dhe holandishten⁷⁵.

Në aktgjykimin e çështjes “Wauters dhe Schollaert - Belgjikë”, datë 13 maj 2008, Gjykata konstatoi se kohëzgjatja e tepruar e procesit që shkaktuar nga mungesa e oficerëve të policisë në hetim.

Reformat kombëtare të zbatuara:

Në vitin 2002, autoritetet belge i ndryshuan dispozitat për gjuhën e përdorur në fushën gjyqësore në mënyrë që t’i bënin më të lirshme kërkesat ligjore për dygjuhësinë dhe të siguronin burime për gjykimin e çështjeve gjyqësore në gjuhën frënge, që përbënin shumicën e çështjeve të paraqitura përpara gjykatave të Brukselit. Më 26 prill 2007 u miratua një ligj i ri me shtesa dhe ndryshime në Kodin Gjyqësor, për t’i dhënë zgjidhje numrit të çështjeve të prapambetura. Në vitin 2008 u rrit buxheti i gjyqësorit, duke siguruar më shumë burime operative (për shembull për vijimin e kompjuterizimit të administratës gjyqësore dhe zhvillimin dhe sigurimin e funksionimit të gjykatave) dhe duke mundësuar rekrutimin punonjësve të tjerë shtesë, duke i dhënë përparësi ekzekutimit të dënimeve⁷⁶.

Një prej shkaqeve kryesore të kohëzgjatjes së tepruar të proceseve në Luksemburg, që çoi në konstatime negative kundër këtij vendi, erdhi edhe si rezultat i mbingarkesës në punë dhe numrit të vogël të punonjësve të policisë dhe gjyqtarëve hetues. Në vitin 2003 u morën masa për riorganizimin e policisë dhe rekrutimin e më shumë policëve. Gjithashtu, në vitin 2001, 2003 dhe 2005 u rekrutuan gjyqtarë dhe prokurorë dhe në vitin 2006 u miratua një ligj i ri për drejtësinë penale, i cili filloi një sërë reformash procedurale për uljen e ngarkesës së punës për gjyqtarët hetues⁷⁷.

⁷⁴ Aktgjykimi i çështjes “Diana - Itali”, datë 27 shkurt 1992: shkelje për procesin që zgjati 11 vjet e 11 muaj përpara dy shkallëve të gjykatave në një çështje gjyqësore relativisht komplekse.

⁷⁵ Raporti vjetor 2007 i Këshillit të Ministrave, f.83 dhe 84.

⁷⁶ Raporti vjetor 2008 i Këshillit të Ministrave, f. 122 dhe 123.

⁷⁷ Raporti vjetor 2007 i Këshillit të Ministrave, f. 94 dhe 95.

Në Slloveni, po kështu, ka nisur një reformë madhore e gjyqësorit, e cila ka çuar në rritje të personelit të gjyqësorit pas konstatimit kundër këtij Shteti në aktgjykimin e çështjes “Lukenda”, datë 6 janar 2006, ku evidentoheshin problemet e sistemit që lindnin sidomos nga mungesa e burimeve⁷⁸.

Një shkak që lidhet ngushtë me numrin e vogël të punonjësve të gjyqësorit dhe moszëvendësimin e tyre janë çështjet e prapambetura nëpër gjykata.

Prejardhja e vonesave: numri i çështjeve të prapambetura

Çështjet e prapambetura nëpër gjykata shkaktohen nga rritja e dukurisë së ndërgjygjësisë pa rritje paralele të burimeve, që është një prej faktorëve kryesorë në kohëzgjatjen e tepruar të proceseve.

Dukuria e çështjeve të prapambetura nuk sjell probleme nëse ndodh me raste. Por, nga ana tjetër, nëse është diçka që ndodh vazhdimisht, Gjykata e Strasburgut mban qëndrimin se zbatimi nga Shteti i masave joadekuade për trajtimin e çështjeve të prapambetura përbën përgjegjësi për autoritetet kombëtare. Për shembull, në çështjen e lartpërmendur “Guincho”, Gjykata konsideronte se, duke pasur parasysh rritjen e parashikueshme të numrit të proceseve në gjykatë, masat e marra nga Shteti për t’i dhënë zgjidhje problemit të çështjeve të prapambetura qenë tepër pak, tepër vonë.

Reforma e sugjeruar nga Gjykata Evropiane:

Kjo çështje lidhet me problemin e përpunimit të numrit në rritje të çështjeve gjyqësore kur ka ngarkesë pune të tepruar nëpër gjykata dhe me faktin se përparësi u duhet dhënë çështjeve të vjetra dhe atyre që nuk kanë përfunduar ende.

Gjykata jep udhëzime në çështjen spanjolle të lartpërmendur “Union Alimentaria Sanders SA”: “Në këto rrethana (krijimi i përkohshëm i ngarkesës me çështje të prapambetura në punën e gjykatës) është legjitime si masë përshtetuese e përkohshme marrja e një vendimi për rendin sipas të cilit do të trajtohen çështjet, në bazë të urgjencës dhe rëndësisë së tyre. Por, me kalimin e kohës, urgjenca e një çështjeje rritet. Për pasojë, nëse kjo situatë kritike vazhdon, del se përshtetues të tillë nuk janë të mjaftueshëm dhe se Shteti duhet të marrë masa të tjera më të efektshme për t’i përmbushur kërkesat e nenit 6, pika 1”.

Reformat kombëtare:

Pas konstatimit kundër Gjermanisë për shkak të kohëzgjatjes së tepruar të procesit të bashkuar penal (1996-2006) në lidhje me paditësit, të cilët qenë dënuar me burgim të përjetshëm, sidomos për shkak të vonesave të konsiderueshme përpara Gjykatës Kushtetuese Federale (mbi gjashtë vjet e një muaj për shkak të ngarkesës jashtëzakonisht të madhe të punës me të cilën përballej asokohe Gjykata Kushtetuese Federale), Shteti Gjerman ngriti një sekretari të re gjyqësore, rekrutoi punonjës shtesë gjyqësorë dhe i thjeshtoi procedurat, ku vendimmarrja iu ngarkua një trupe me tre gjyqtarë (çështja “Kaemena dhe Thöneböhn - Gjermani”, vendim datë 22 prill 2009).

Në përgjithësi, detyrimi për Shtetet anëtare që këto t’i organizojnë sistemet gjyqësore të tyre në mënyrë të atillë që ta respektojnë të drejtën për t’u dëgjuar brenda një afati kohor të arsyeshëm i ka nxitur disa Shtete të ndërmarrin reforma në shkallë të gjerë.

I tillë është rasti i Sllovenisë (pas aktgjykimin të çështjes “Jakub - Sllovaki”, datë 28 maj 2006, mes të tjerash), e cila ka kryer një varg reformash, përfshirë edhe një “reformë të madhe të Kodit të Procedurës Civile” më 15 tetor 2010, me një sërë risish të tilla si thjeshtimi i rregullimeve për vënien në dispozicion të dokumenteve, harmonizimin e procedurës për kundërshtimin e caktimit të gjyqtarëve të çështjes, zgjerimin e zotësisë së gjykatave për të vendosur për një çështje pa seancë dëgjimore, thjeshtimin e procedurave të trashëgimisë, futjen e një procedure të thjeshtuar për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të vogla, zgjerimin e fushëveprimit të rregullave ligjore që rregullojnë vendimet gjyqësore, futjen e mundësisë që gjykatat të caktojnë avokatë mbrojtës të përbashkët për disa palë të një procesi të vetëm, kufizimin e mundësisë së gjykatave të apelit dhe kasacionit për t’i kundërshtuar ose prishur vendimet e një gjykate të një shkalle më të ulët dhe për t’i rikthyer për rigjykim⁷⁹.

⁷⁸ Po aty, f 100 dhe 101.

⁷⁹ Raporti vjetor 2010 i Këshillit të Ministrave, f.137.

Në mënyrë të ngjashme, në Republikën Çeke në Kodin e Procedurës Civile janë përfshirë disa ndryshime procedurale në vitin 2000, 2005, 2008 dhe 2009, që synonin zvogëlimin e ngarkesës së punës për gjyqtarët, thjeshtimin e procedurave dhe parandalimin e vonesave. Ndër më të rëndësishmet janë: procedura e zëvendësimit për gjyqtarët e anshëm; mundësia për të apeluar në thuajse të gjitha çështjet; detyrimi i gjyqtarëve për t'i udhëzuar palët për të drejtat dhe detyrimet procedurale të tyre dhe për të nxitur zgjidhjet miqësore; rregullat e reja të vendosura për të siguruar korrektesë të veçantë në çështjet e të drejtës familjare, vendimmarrje të shpejtuar në proceset që kanë të bëjnë me fëmijët dhe mundësi ndërmjetësi dhe zgjidhje paqësore të mosmarrëveshjeve mes prindërve; një sistem i ri për vënien në dispozicion të dokumenteve të gjykatave, duke u mbështetur në "presumimin e vënies në dispozicion" dhe "seancën përgatitore" që synojnë t'i bëjnë proceset më të përqendruara, në mënyrë që gjykata të mund marrë vendim për çështjen në një seancë të vetme⁸⁰.

Franca e miratoi planin pesëvjeçar të orientimit dhe programimit "ligj për drejtësi" më 9 shtator 2002, që synon rritjen e efektivitetit të drejtësisë në veçanti përmes shkurtimit të kohëzgjatjes së çështjeve civile dhe penale. Së pari, është rritur shumë numri i punonjësve nëpër gjykata. 950 magjistra dhe 3500 punonjës të Shtetit dhe agjentë të shërbimeve gjyqësore u planifikuan për vitin 2007. U rritën edhe burimet financiare me më shumë se 11% për vitin 2004 dhe 2005⁸¹.

Ngarkesa e çështjeve penale të prapambetura të gjykatave dhe shqetësimi për të mbrojtur të drejtën për t'u dëgjuar brenda një afati kohor të arsyeshëm e ka nxitur gjithashtu Francën të zbatojë procedura të përsheptuara në fushën e së drejtës penale. Ligji i datës 9 mars 2004 e zgjeroi fushën e veprimit të disa llojeve të përzgjedhura të proceseve mbështetur në pëlqimin e të paditurit, si një zgjidhje në fushën penale, ndërkohë që u fut një procedurë e re për gjykimet e menjëhershme në bazë të pranimit paraprak të fajësisë. Tani kohët e fundit, ligji nr.2011-1862, datë 13 dhjetor 2011, për shpërndarjen e proceseve, miratuar në bazë të propozimeve të paraqitura në raportin "Guinchard"⁸², e ka zgjeruar në mënyrë të konsiderueshme objektin e kësaj procedure, si edhe të procedurave të tjera të përsheptuara siç është përpunimi i çështjeve të thjeshta dhe të vogla përmes një *ordonnance pénale*.

•Prejardhja e vonesave: koha e përdorur në fakt nga gjyqtarët për veprimtaritë jashtëgjyqësore

Disa çështje të caktuara italiane dhe çështje të tjera tregojnë se pjesëmarrja e gjyqtarëve në veprimtaritë jashtëgjyqësore të kërkuara me ligj siç është drejtimi i komiteteve për parandalimin e krimit, vëzhgimin e zgjedhjeve e kështu me radhë, e pakëson në mënyrë të konsiderueshme kohën që mund të përdorin për seancat dëgjimore dhe dhënien e vendimeve. Prandaj statistikat për numrin e punonjësve në gjyqësor mund të jenë çorientuese sa i takon kohës efektive të përdorur për të gjykuar.

Shembull nga jurisprudenca

Kishte edhe shumë arsye të tjera për vonesat, në çështjen gjyqësore "Capuano", por Gjykata vërente edhe se "seanca dëgjimore u shty për më datën 24 janar 1978, por u bë më 31 janar, për shkak të një shtyrjeje tjetër të shkaktuar nga zgjedhjet bashkiake".

Reformat kombëtare:

Në Sllovaki, legjislacioni i vitit 2003 për nëpunësit e gjykatave i cili hyri në fuqi më 1 janar 2004 futi postin e kryesekretarit të gjykatës për të mundësuar që personeli administrativ të kryente detyra të ndryshme që nuk kërkojnë angazhimin e gjyqtarëve.

•Përdorimi sistematik i trupave gjyqësore në shkallën e parë

Përdorimi i trupave të gjyqtarëve, sipas parimit kolegjal, së bashku me administrimin joefikas të personelit të gjyqësorit, mund të përbëjë burim vonesash. Nëse një anëtar i trupit gjyqësor mungon ose nuk mund të marrë pjesë ose është transferuar, seancat mund të shtyhen. Jurisprudenca e Gjykatës paraqet pamje të këtij lloje vonese nëpër gjykatat civile si edhe nëpër gjykatat penale. Për më tepër, megjithëse trupat gjyqësore konsiderohen si garanci e paanshmërisë dhe një standardi të lartë drejtësie, përdorimi i tyre edhe për çështje dhe mosmarrëveshje për shumën të vogla kërkon një numër të konsiderueshëm gjyqtarësh.

Shembuj nga jurisprudenca në çështje civile:

⁸⁰ Raporti vjetor 2009 i Këshillit të Ministrave, f.121.

⁸¹ Raporti vjetor 2007 i Këshillit të Ministrave, f.83.

⁸² S.Guinchard, *L'ambition raisonnée d'une justice apaisée*, paraqitur Ministrisë të Drejtësisë në korrik 2008.

Aktgjykimi i çështjes “Bento da Mota - Portugali”, datë 28 qershor 2001 është një shembull. Në një çështje të vogël gjyqësore për përcaktimin e përgjegjësisë civile, dy seanca u shtynë për shkak të mungesës së një gjyqtari të gjykatës së ulët. Ka pasur edhe vonesa të mëpasshme për arsye të tjera dhe më se 3 vjet janë humbur pas dorëzimit të një akt-ekspertize.

Parimi kolegjal është gjykuar si njëri prej shkaqeve të vonesave në Itali.

Reformat kombëtare:

Në Itali, ka pasur reforma në vitin 1995, të cilat futën gjyqtarët e paqes dhe në vitin 1999 vendosën trupat gjykuese me gjyqtarë të vetëm. Është rritur ndjeshëm edhe juridiksioni i trupave me gjyqtar të vetëm në shkallën e parë. Dekreti francez nr. 98-1231, datë 28 dhjetor 1998, e shtriu përdorimin e gjyqtarit të vetëm në çështjet civile. Për më tepër, në vitin 2002, u futën *juges de proximité* (“gjykatat vendore”) për t’u marrë me paditë e vogla⁸³.

Shembuj nga jurisprudenca në çështje penale:

Kjo vlen për gjykatat penale në disa shtete të caktuara kontraktuese ku një kryetar profesionist i trupës gjykuese ndihmohet nga dy gjyqtarë jo profesionistë.

Reformat kombëtare:

Gjyqtari i vetëm në çështjet penale është parashikuar në disa shtete kontraktuese për padi të vogla. Parashikuar më parë në Francë për shkelje të vogla nëpër gjykatat e rretheve, me ligjin nr.95-125, datë 8 shkurt 1995, gjyqtari i vetëm parashikohet të punojë edhe në gjykatat penale për disa vepra siç janë shkeljet e kodit rrugor.

•Prejardhja e vonesave: pasiviteti nga autoritetet gjyqësore

Pasiviteti i gjyqësorit, sidomos moskryerja e masave procedurale për një periudhë të caktuar, gjithmonë konsiderohet nga Gjykata si e papranueshme nëse nuk shpjegohet si duhet nga autoritetet kombëtare⁸⁴. Në një çështje portugeze (vetëm në frëngjishte), Gjykata nuk qe në gjendje ta pranonte një periudhë pasiviteti total prej katër vjet e njëmbëdhjetë muaj që nga orvatja për pajtim deri në vendimin përgatitor⁸⁵.

Shembuj nga jurisprudenca

Çështja franceze “Piron - Francë”⁸⁶ zbuloi periudha të shumta pasiviteti në një çështje për konsolidimin e tokës bujqësore, ku paditësit e kishin kundërshtuar caktimin e parcelave. Këto ndodhën në komitetin e riorganizimit dhe konsolidimit të tokës së *Département*, i cili e dha vendimin gjashtë vjet e gjysmë pas vendimit të gjykatës administrative, por edhe në vetë gjykatat administrative, sidomos në *Conseil d'Etat*, i cili e dha vendimin katër vjet pasi çështja kaloi përpara tij.

Në një çështje penale greke⁸⁷ e cila zgjati gati tetë vjet dhe e cila kaloi në apel, Gjykata vërente disa periudha pasiviteti të shaktuara nga autoritetet kombëtare. “Gjykata vëren se ka pasur disa periudha pasiviteti në procesin e apelit përpara Gjykatës Penale të Apelit të Selanikut. Pasi paditësi kishte depozituar ankesën më 18 shkurt 1988, çështja mbeti pasive mbi një vit e shtatë muaj gjersa u fut në listë për seancë të parë më 6 tetor 1989. Për më tepër, pas datës 6 tetor 1989, çështjes iu ndryshua vendi në listë katër herë: 19 prill 1991, 8 shkurt 1993, 5 dhjetor 1994 dhe 12 shkurt 1996”.

Në aktgjykimin e çështjes “Lavents- Letoni” (vetëm në frëngjishte), Gjykata e kritikoi periudhën prej dhjetë vjet e 28 ditë që kishte kaluar që nga tërheqja e një grupi gjyqtarësh deri në rifillimin e çështjes përpara një trupe të re gjykuese.

Në aktgjykimin e çështjes “Santilli”, datë 19 shkurt 1991, Gjykata konstatoi se procesi që kishte zgjatur thuajse gjashtë vjet e nëntë muaj ishte në shkelje të nenit 6, pika 1, dhe e kritikoi gjykatën e ulët, e cila kishte “*lejuar kalim periudhash tepër të gjata dhe ka qenë tërësisht pasive për thuajse dy vjet (23 qershor 1982 - 20 qershor 1984).*”

⁸³ Ligji orientues dhe programues për Drejtësinë, 9 shtator 2002.

⁸⁴ Për shembull, një pasivitet i tillë mund të shpjegohet nga një kërkesë për ndihmë gjyqësore ndërkombëtare.

⁸⁵ Aktgjykimi i çështjes “Rego Chaves Fernandes - Portugali”, datë 21 mars 2002; Shih edhe aktgjykimin e çështjes “Condé-Portugali”, datë 23 mars 2000.

⁸⁶ Aktgjykimi i çështjes “Piron - Francë”, datë 14 nëntor 2000 (vetëm në frëngjishte).

⁸⁷ Aktgjykimi i çështjes “Portington - Greqi”, datë 23 shtator 1998.

Në çështjen “Leandro da Silva- Luksemburg”, vendim datë 11 shkurt 2010, Gjykata konstatoi se edhe pse gjyqtari e kishte ndryshuar disa herë kalendarin e seancave, procesi kishte zgjatur katër vjet në shkallën e parë të gjyqësorit, që nuk mund të konsiderohet e përputhshme me kriterin e “afatit kohor të arsyeshëm” të parashikuar në nenin 6, pika 1.

Çështja “Delic - Kroaci”⁸⁸ zbulon mosfunksionimin e këtij lloji në rastin e disa mosmarrëveshjeve civile të çelura nga paditësi kundër disa të pandehurve të ndryshëm. Gjykata nënvizon periudhat e pasivitetit në çdo autoritet: 2 vjet e 10 muaj në njërin, 2,5 vjet në tjetrin, më shumë se 1 vit në një të tretë, 1 vit e 6 muaj në të katërtin.

Në çështjen “Atanasić- ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë”, një gjykatë e shkallës së parë qëndroi pasive pa asnjë arsye të dukshme, çka bëri që procesi të zvarritej disa vjet.

Reformat kombëtare:

Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë miratoi një ligj të ri për proceset civile në shtator 2005. Ky tekst synonte kryesisht rritjen e efektivitetit të procedurës civile dhe shkurtrimin e kohëzgjatjes së saj. Në vitin 2005 është miratuar edhe një ligj i ri për përmbarimin. Krahas këtyre, në shkurt 2009 është ngritur në të gjitha gjykatat e brendshme një sistem automatik informacioni dhe menaxhimi të çështjeve. Të gjitha çështjet janë regjistruar në të që prej datës 15 shtator 2009, dhe duke filluar nga data 1 janar 2010 regjistrimi, monitorimi dhe menaxhimi i çështjeve do të bëhet vetëm përmes këtij sistemi⁸⁹.

•Prejardhja e vonesave: pasiviteti i gjykatave dhe rregullat për provat

Pasiviteti, pavarësisht nëse është absolut apo relativ (për shembull, kur audienat caktohen larg njëra-tjetrës), shpesh ka pasoja lidhur me nevojën për paraqitjen e provave. Palëve mund t’u duhet ta përditësojnë vazhdimisht informacionin faktik apo financiar të nevojshëm për çuarjen përpara të çështjes.

Shembull nga jurisprudenca

Aktgjykimi i çështjes “Kubiznakova- Republika Çeke”, datë 21 qershor 2005 (vetëm në frëngjishte), është një shembull veçanërisht i mirë. Çështja në fjalë kishte të bënte me ushtrimin e autoritetit prindëror përpara një divorci dhe ritmi i ngadaltë i procesit i detyronte palët ta përditësonin informacionin për të ardhurat, çka solli kundërshtime nga pala tjetër.

Prejardhja e vonesës: mangësi në sistem të rregullores procedurale

Ndonjëherë Gjykata i identifikon shkaqet e vonesës të lidhura në mënyrë të vetvetishme me legjisllacionin e brendshëm, çka kërkon reforma madhore. Kjo situatë është karakteristike për disa Shtete të lindjes, si Polonia, Sllovenia, Kroacia, Ukraina, Hungaria dhe Bullgaria ku rregullat procedurale mundësonin rishqyrtimin pa fund të të njëjtave çështje: në aktgjykimin e çështjes “Wierciszewska- Poloni”, datë 25 nëntor 2003, Gjykata Evropiane e nënvizon kështu këtë mosfunksionim: “Vonesa është shkaktuar kryesisht nga rimarrja në shqyrtim e çështjes. Megjithëse Gjykata nuk i ka pozitat për të analizuar cilësinë juridike të jurisprudencës së gjykatave të brendshme, ajo konsideron se, meqë rimarrja në shqyrtim e çështjeve zakonisht vendoset si pasojë e gabimeve të kryera nga gjykatat e ulëta, përsëritja e vendimeve të tilla brenda një procesi të vetëm dëshmon mangësi të rënda të sistemit gjyqësor”⁹⁰.

Shembull nga jurisprudenca

Në aktgjykimin e çështjes “Floarea Pop- Rumania”, datë 6 prill 2010, Gjykata konstatoi se një prej shkaqeve kryesore të vonesave në një çështje për përgjegjësinë administrative e cila kishte zgjatur 7 vjet e 10 muaj qe mungesa e një dispozite legjisllative që nuk do t’ia lejonte gjykatës ta shtynte në mënyrë të përsëritur procesin.

⁸⁸ Aktgjykim i datës 27 qershor 2002.

⁸⁹ Raporti vjetor 2010 i Këshillit të Ministrave, f.135.

⁹⁰ Edhe aktgjykimet e mëposhtme: “Pavlyulynets - Ukrainë”, datë 6 shtator 2005, “Carstea & Grecu - Rumania”, datë 15 qershor 2006, “Ferlic - Slloveni”, datë 6 prill 2005 (pika 46).

Aktgjykimi i çështjes “Horvat - Kroaci”, datë 26 korrik 2001; ose “Preloznik dhe të tjerë - Republika Sllovaqe”.

Reformat kombëtare:

Masat që marrin Shtetet lidhur me zgjidhjen e këtij problemi jepen në një dokument publik: “Lista e masave me natyrë të përgjithshme të miratuara për parandalimin e shkeljeve të reja të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Masat e komunikuara Këshillit të Ministrave gjatë kontrollit të ekzekutimit të aktgjykimeve dhe vendimeve sipas kushteve të Konventës (zbatimi i neneve të mëparshme 32 dhe 54 dhe nenit 46)”, përditësuar në maj 2006⁹¹.

Kështu, në Kroaci, reformimi i rregullave të procedurës civile në vitin 2003, lidheshin në veçanti me këtë problem.

•Prejardhja e vonesave: Vështirësitë e lindura nga ekzistenca e gjykatave administrative dhe gjyqësore

Dy lloje gjykatash ekzistojnë në një sërë vendesh, për shembull në Greqi, Francë, Belgjikë dhe Austri, dhe janë pjesë integrale e kulturave gjyqësore të tyre. Ndonjëherë kjo mund të sjellë vonesa. Nëse procesi zhvillohet paralelisht në të dy sistemet, paditësit mund të jenë të pasigurt se cila gjykatë ka kompetencë ose mund të ketë pezullim të procesit.

Shembull nga jurisprudenca

Aktgjykimi i çështjes “Nouhaud- Francë” (vetëm në frëngjisht) ofron një ilustrim të qartë të problemeve të shkaktuara nga ky lloj organizimi, në lidhje me shtrimin me forcë në spital psikiatrik, që bie në objektin si të gjykatës administrative (ligjshmëria e urdhrin të prefektit) dhe të gjykatës gjyqësore rajonale (përshtatshmëria e urdhrin të ndalimit). Kjo mbivendosje kompetence solli pezullim të procesit në gjykatën gjyqësore në pritje të një vendimi nga gjykata administrative, ku procesi zgjati tre vjet e gjysmë vetëm në *Conseil d’Etat*, kohë të cilën Gjykata e konsideroi si të tepruar.

Në çështjen “Obermeir”⁹², ndërveprimi mes procesit administrativ dhe atij gjyqësor lidhur me pushimin e personave me aftësi të kufizuara që shkakoi kryesor i vonesave.

2. Vonesat që ndodhin në fillim dhe në fund të procesit

•Prejardhja e vonesës: miratimi ose refuzimi me vonesë i një kërkesë për ndihmë ligjore

Për të siguruar respektimin e të drejtave të palës mbrojtëse, kërkesa për ndihmë ligjore që mundëson caktimin e një avokati dhe ndonjëherë kushtet për vijimin e autoriteti nga paditësi në fjalë shpesh e vonojnë caktimin e seancës së parë në gjykatë.

Shembull nga jurisprudenca

Në çështjen “Mangulade Pinto- Francë”, datë 9 prill 2002, GJEDNJ e kritikoi kohëzgjatjen e procesit prej shtatë muajsh nga data 17 prill 1997, data e kërkesës për ndihmë ligjore e formuluar nga paditësi që ai të përgatiste apelin në kasacion, deri më 26 nëntor 1997, data kur zyra e ndihmës ligjore ia hodhi poshtë kërkesën.

•Prejardhja e vonesave: Mosthirrja e palëve, dëshmitarëve ose të paditurve, ose fletëthirrjet e paligjshme

Zakonisht ky është një problem i lidhur me sekretaritë e gjykatave kur e kanë këto monopolin e fletëthirrjeve, por lidhet edhe me rregulloret e keqpërshtatura.

Shembull nga jurisprudenca

Në aktgjykimin e çështjes “Roubies- Greqi, datë 30 prill 2009, lidhur me çështje vërtetësie testamenti, Gjykata vërente se gjykatës së brendshme i qenë dashur 26 muaj të siguronte dëshmitë e katër dëshmitarëve, çka, së bashku me faktorë të tjerë, kishte çuar në kohëzgjatje të tepruar të procesit prej 14 vjetësh. Në një tjetër çështje, konkretisht “Mincheva - Bullgari”, vendim datë 2 shtator 2010, Gjykata konstatoje se autoritetet bullgare nuk kishin qenë në gjendje të thërrisnin ligjërisht një palë që të paraqitej në një çështje civile familjare.

⁹¹ Gjendet në hapësirën në internet të GJEDNJ-së: <http://www.ehcr.coe.int/ehcr>

⁹² Aktgjykimi i çështjes “Obermeir - Austri”, datë 28 qershor 1990.

Në aktgjykimin e çështjes “Djanzozov- Bullgari”, datë 8 tetor 2004, Gjykata vërente, në mbrojtje të autoriteteve gjyqësore, se krahas periudhave të pasivitetit të pashpjeguar, dy seanca qenë shtyrë ngaqë pala e paditur nuk qe thirrur siç duhej në një çështje shpifjeje ku aspektet penale kishin epërsi mbi ato civile (pika 39).

Gjykata mbështet argumentin e paditësit sipas të cilit gjykata nuk e ka përmbushur detyrimin e saj për të siguruar paraqitjen e dëshmitarëve në çështjen “Volf”⁹³, çka çoi në shtyrje të përsëritura të seancave gjyqësore.

Reformat kombëtare:

Në vitin 2007, Bullgaria miratoi një kod të ri të procedurës civile me synimin kryesor përshpejtimin e proceseve gjyqësore. Në veçanti, ky kod i ri synonte përqendrimin e hapave hetimorë në shkallën e parë dhe kufizimin e kërkesave në shkallën e apelit dhe në lidhje me interpretimin e ligjit⁹⁴.

Në Kroaci, në vitin 2003 reforma e proceseve civile i ka ndryshuar rregullat e lidhura me thirrje të tilla për t’u paraqitur në sallën e gjyqit, në mënyrë që të evitohen vonesat (nenet 66-79 të Ligjit datë 14 korrik 2003)⁹⁵.

Në Suedi, për ta përmirësuar dorëzimin e ftesave për gjyq, autoritetet kombëtare janë mbështetur në shoqëri private, shërbimet e të cilave paguhen vetëm nëse ftesat për gjyq dorëzohen me sukses⁹⁶.

•Prejardhja e vonesës: koha e caktimit të gjyqtarit që drejton procedurën

Kjo lloj vonese është më serioze kur një çështje procedohet përpara disa autoriteteve të njëpasnjëshme dhe ku caktimet e gjyqtarëve, në çdo fazë, janë shkak i një vonese tjetër shtesë.

Shembuj nga jurisprudenca:

Aktgjykimi i çështjes “Martial Lemoine- Francë”, datë 29 prill 2003, ka të bëjë me një mosmarrëveshje pronësie të përbashkët, e cila zgjati, në katër shkallët e gjykimit, 7 vjet e 8 muaj; duke qenë veprimtari e gjykatave, gjyqtarët evropianë caktojnë vetëm një periudhë në të cilën ngrenë çështjen e vonesës të pajustificuar, e cila, sipas tyre, shkaktohet vetëm nga autoritetet e brendshme: afati prej tetë muajsh për caktimin e këshilltarit ligjor nga gjykata e lartë e apelit qe një afat i tepruar.

•Prejardhja e vonesave: hyrja në fuqi me vonesë e akteve nënligjore të domosdoshme

Gjykata i ka kritikuar këto vonesa, të cilat i vendosin në pozita shumë të pafavorshme palët e proceseve. Mund të propozohet një detyrim për autoritetet administrative që këto t’i nxjerrin aktet e nevojshme nënligjore në zbatim të akteve ligjore brenda një “afati kohor të arsyeshëm”.

Shembuj nga jurisprudenca:

Në aktgjykimin e çështjes “Vallée- Francë”, datë 26 prill 1994, ku kërkohej korrektesë e jashtëzakonshme duke pasur parasysh gjendjen shëndetësore të paditësve, të cilët qenë të infektuar me virusin HIV, kishte kaluar një vit e gjysmë që nga botimi i ligjit të datës 31 dhjetor 1991 i cili parashikonte kompensim të viktimave të transfuzioneve me gjak të kontaminuar deri në vendimin zbatues të datës 12 korrik 1993⁹⁷.

⁹³ Aktgjykimi i çështjes “Volf - Republika Çeke”, datë 6 shtator 2005.

⁹⁴ Raporti vjetor 2010 i Këshillit të Ministrave, f.131.

⁹⁵ Rezoluta ResDH(2005)60 lidhur me aktgjykimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në çështjen “Horvat” dhe 9 çështje të tjera kundër Kroacisë.

⁹⁶ Raporti i Grupit të Posaçëm të Punës “Menaxhimi i kohës në sistemet e drejtësisë: studim i Evropës së Veriut” (CEPEJ(2006)14).

⁹⁷ Në Francë një autoritetet ekzekutiv i cili nuk nxjerr aktet nënligjore mund të gjobitet nga gjykatat administrative gjersa të bëjë hapat e nevojshëm, por këto gjopa shtrënguese vendosen vetëm në rastet kur është vonuar nxjerrja e akteve nënligjore (vendim i *Conseil d’Etat*, datë 28 korrik 2000, *Association France. Nature Environnement*)

Në çështjen “Počuča- Kroaci”, vendim datë 29 shtator 2006 (ndër të tjera) shkelja e konstatuar kishte të bënte kryesisht me një boshllëk ligjor, të krijuar në vitin 1998 nga një vendim i Gjykatës Kushtetuese që i shpallte disa dispozita legislative për të drejtat për pension si jo kushtetuese, çka solli paraqitjen e më shumë se 427.800 kërkesave në zyrat rajonale të Fondit të Pensioneve. Legjislacioni i nevojshëm për mbushjen e këtij boshllëku ligjor u miratua në 2004 dhe 2005⁹⁸.

•Prejardhja e vonesave: kalimi me vonesë i dosjes së çështjes nga gjykata e shkallës së parë tek gjykata e apelit ose vonesa në vënien në dispozicion të provave

Ky problem pasqyron keqfunksionim si në organizimin e sekretarive të gjykatave ashtu edhe në kalimin e dosjeve.

Shembuj nga jurisprudenca:

Aktgjykimi i çështjes “Martins Moreira - Portugali”, ofron një ilustrim nga e drejta civile: *“pasi paditësi e depozitoi apelin më 13 tetor 1982, sekretaria e gjykatës në Evora priti gjer më 23 qershor 1983 për t’ia kaluar dosjen sekretarisë së gjykatës së apelit. Gjatë kësaj periudhe, ajo vetëm sa verifikoi nëse në dosje qenë përfshirë parashtrimet e ndryshme dhe përpiloi një pasqyrë të kostove dhe shpenzimeve të lidhura me procesin në shkallë të parë”*.

Vonesa të tilla mund të prekin edhe proceset penale dhe apelimet për interpretimin e ligjit, sikurse duket në aktgjykimin e çështjes “Bunkate - Vendet e Ulëta”, datë 26 maj 1993, ku Gjykata e kritikonte kohën prej 15 muaj e gjysmë që kishte kaluar që nga apelimi i paditësit për interpretimin e ligjit deri në mbërritjen e dosjes së çështjes në Gjykatën e Lartë (pika 22).

Reformat kombëtare:

Në çështjen “Borankova - Republika Çeke”, vendim datë 21 maj 2003, një prej shkaqeve të vonesës ka qenë përcjellja e vonuar e disa dokumenteve të caktuara. Në vitin 2009 hyri në fuqi një ligj i ri që futi përcjelljen elektronike të dokumenteve përmes kutive postare elektronike. Ky ligj është më i fundit i një vargu reformash të procedurës civile, me një sistem të ri për vënien në dispozicion të dokumenteve të gjykatave, duke u mbështetur në “presumimin e vënies në dispozicion” dhe “seancën përgatitore” që synojnë t’i bëjnë proceset më të përqendruara, në mënyrë që gjykata të mund marrë vendim për çështjen në një seancë të vetme⁹⁹.

•Prejardhja e vonesave: mosmarrëveshjet lidhur me gjykatën kompetente

Në aktgjykimin e çështjes “Mihalkov - Bullgari”, datë 10 prill 2008, Gjykata vërente se vonesat kryesore kishin ndodhur gjatë fazës procedurale fillestare, në lidhje me çështjen e kompetencës së gjykatës. Gjykata arrinte në përfundimin se periudha prej tre vjetësh për të zgjidhur çështjen se cila gjykatë kishte kompetencë qe qartësisht e tepruar sa i takon një problemi procedural të fazës fillestare.

•Prejardhja e vonesës: sjellja e aktorëve të tjerë në procesin gjyqësor:

- **avokatët:** mund të jetë një grevë e avokatëve që shkakton vonesa në përcaktimin e kalendarit të seancave gjyqësore, si në çështjen “Calvelli” dhe në çështjen “Ciglio - Itali”, datë 17 janar 2002¹⁰⁰. Shteti duhet t’i kufizojë pasojat mbi funksionimin e gjykatave. Kështu, Gjykata e rrëzon argumentin e qeverisë se pjesa më e madhe e vonesës është shkaktuar nga greva e avokatëve, duke vërejtur se është detyrë e Shteteve Kontraktuese që t’i organizojnë sistemet gjyqësore të tyre në mënyrë të tillë që gjykatat të mund të sigurojnë të drejtën e të gjithëve për të pasur një vendim të formës së prerë (aktgjykimi i çështjes “Tsilira - Greqi”, datë 22 maj 2008).

Vonesa shkakton edhe moskorrektesa e një avokati në rolin e tij si përfaqësues i njëres prej palëve, si në çështjen “Intiba - Turqi”, datë 24 maj 2005, ku Gjykata vërente se në zgjatjen e procedurës kishin kontribuar kryesisht paditësi dhe avokatët e tij. (Thuajse një vit vonesë u ngarkohej atyre). Ndonjëherë në vonesë merr pjesë edhe paditësi, përmes kundërshtimit të disa avokatëve radhazi: Aktgjykimi i çështjes “Klamecki - Poloni”, datë 28 mars 2002.

⁹⁸ Raporti vjetor 2008 i Këshillit të Ministrave, f.124.

⁹⁹ Raporti vjetor 2009 i Këshillit të Ministrave, f.121.

¹⁰⁰ Shih edhe aktgjykimin e çështjes “Papageorgiou - Greqi”, datë 22 tetor 1997 (7 muaj grevë).

- **Noterët**¹⁰¹: Në këtë çështje, dhoma e noterëve për të gjithë Parisin emëroi një noter të ri më 3 tetor 1996, pra gati 5 vjet pas aktgjykimit të datës 17 dhjetor 1991. “Sa i takon mungesës së korrektesës së këtij noteri, kjo është nënvizuar në veçanti nga kërkesat e administratorit”, nënvizon GJEDNJ (pika 41 dhe 42).

- **organet publike jozyrtare**: Njësitë e pushtetit vendor (Këshilli i një qarku në aktgjykimin e çështjes “H – Mbretëria e Bashkuar, datë 8 korrik 1987), ose organizatat e tjera publike siç janë shërbimet sociale vendore (zyra sociale e Helsinkit)¹⁰² e bëjnë me përgjegjësi Shtetin nëse nuk veprojnë me korrektesën e nevojshme kur u kërkohe mendim ose kur ndërhyjnë në kuadër të procedurave ligjore. Por përgjegjësia u kthehet gjykatave të përfshira sa u takon vonesave të përshtatshme.

Shembuj nga jurisprudenca: Sjellja e sigurimeve shoqërore ngrihet në çështjen “Robins – Mbretëria e Bashkuar, datë 23 shtator 1987: “Gjykata rikujton për më tepër se, kur u kërkojnë mendim autoriteteve të tjera, gjykatat vazhdojnë të mbajnë përgjegjësi për respektimin e afateve”.

Çështja “Ekholm- Finlandë”, vendim datë 24 qershor 2007, kishte të bënte me procesin përpara gjykatave administrative lidhur me një mosmarrëveshje gati 16-vjeçare mes disa fqinjëve për shqetësime të jetës private që kishin në një mospranim, për thujse 10 vjet, nga autoritetet kompetente (Këshilli Vendor i Shëndetit në Åland) për të zbatuar vendimet gjyqësore të formës së prerë në përgjigje të ankesave së paditësve.

Reformat kombëtare:

Në Francë, Ligji nr.2004-439, datë 26 maj 2004, për reformimin e procedurës së divorcit, përfshinte një sërë dispozitash që synonin përsheptimin e veprimeve noteriale për zgjidhjen e të drejtave mbi pronën që lindin nga marrëdhënia bashkëshortore, duke parashikuar emërimin e një agjenti përfaqësues për t’u marrë me këtë aspekt që në fillim të procesit, në mënyrë provizore, duke u kërkuar palëve që, në mënyrë që të pranohet kërkesa për divorc, të propozojnë zgjidhje të interesave mbi pasurinë dhe, në fund, duke u dhënë mundësi atyre ta konfirmojnë këtë marrëveshje në të gjitha fazat e procesit.

•Prejardhja e vonesave: reforma e legjislacionit gjatë procesit

Reforma e procedurës civile ose penale kur çështjet janë në proces e sipër mund të bëjë që kompetenca e gjykimit të kalojë nga një gjykatë tek një tjetër, çka kërkon kohë për përcjelljen e dosjeve dhe të dokumentacionit procedural dhe caktimin e gjyqtarëve të rinj, të cilët pastaj duhet të njihen me çështjet përpara se të caktojnë seancat.

Shembuj nga jurisprudenca: Aktgjykimi i çështjes “Krastanov - Bullgari”, datë 30 shtator 2004, ofron një ilustrim të mirë. Meqë Gjykata e Lartë e Kasacionit nuk kishte më kompetencë pas reformës së kodit të procedurës civile, Gjykata e Lartë ia përcollti apelimet një gjykate apeli të sapokrijuar. Më 28 tetor 1997, çështja iu përcoll Gjykatës së Lartë, kodi i ri i procedurës civile hyri në fuqi më 1 prill 1998 dhe më pas apelimet iu përcollën gjykatave të reja të apelit, proceset rinisën në gjykatën e re të apelit më 9 korrik 1998 dhe seancat u zhvilluan nga muaji tetor 1998 deri në prill 1999, duke kulmuar me vendimin e gjykatës së apelit më 5 maj 1999, pra një vit e shtatë muaj pas kalimit për herë të parë në Gjykatën e Lartë. Në çështjen “Dimov - Bullgari”, vendim datë 8 mars 2007, Gjykata shpalli se mund të pranonte se disa vonesa që preknin procesin në fjalë qenë shkaktuar nga reforma e sistemit gjyqësor bullgar, por njëri prej shkaqeve kryesore të vonesës vinte përpara fillimit të reformës më 1 prill 1998.

Në një çështje italiane¹⁰³, u fut në zbatim procedura që rregullonte mosmarrëveshjet përpara gjykatës për marrëdhëniet e punës, ndërkohë që çështja ishte në proces e sipër. Kjo i dha kompetencë gjykatës së magjistraturës në shkallë të parë dhe gjykatës së rrethit në apel, por nuk zbatohet për çështjet ekzistuese. Mirëpo, legjislacioni i ri solli si rezultat një pezullim gati katërvjeçar të procesit përpara gjyqtarit të parë hetues.

•Prejardhja e vonesave: dispozita në rregulloret e procedurës civile ose penale të cilat mund të prëdoren për të penguar ose vonuar procesin, pa masa mbrojtëse

¹⁰¹ Aktgjykimi i çështjes “Dumas - Francë”, datë 23 shtator 2003.

¹⁰² Aktgjykimi i çështjes “Nuutinen - Finlandë”, datë 27 qershor 2000: pika 114 – 118.

¹⁰³ Aktgjykimi i çështjes “Vocaturò - Itali”, datë 24 maj 1991.

Palët kanë mundur të përdorin disa dispozita të caktuara të procedurës civile ose penale për t'i vonuar proceset, siç është rasti i ish-sistemit italian ku procesi pezullohej automatikisht kur një palë e kundërshtonte kompetencën e gjykatës civile dhe ku palëve në çështjet penale u lejohej të paraqisnin dëshmi të reja gjatë gjithë procesit, pa një sistem afatesh.

Reformat kombëtare:

Në Francë, pas një relacioni të vitit 2004 për Ministrin e Drejtësisë, dekreti nr.2055-1078, datë 28 dhjetor 2005 lidhur me procedurën civile, disa procedura të caktuara ekzekutimi dhe procedurën e riemërtimit në nenin 23 parashikon një "kalendar të fiksuar" që nxirret nga gjyqtari në marrëveshje me avokatët e palëve, shprehur kështu: "Kalendari përfshin numrin e parashikueshëm dhe datën e shkëmbimeve të përfundimeve, datën e mbylljes, atë të debateve dhe, në përjashtim të paragrafit të parë dhe të dytë të nenit 540, datën e shpallës së vendimit. (...) Afati i parashikuar në kalendar nuk mund të shtyhet pa një shkak serioz dhe të justifikuar rregullisht". Gjithashtu, janë marrë masa ekuivalente për të rregulluar përgatitjet për gjykimin e çështjes nga gjyqtari në proces në seancë dëgjimore (të zbatueshme në shumë gjykata: gjykatat e rretheve, gjykatat industriale, gjykatat tregtare, etj.) sipas Dekretit nr.2010-1165, datë 1 tetor 2010, për kushtet e përdorimit të procedurave me shkrim, që lejon edhe "kalendarët proceduralë".

Sikurse e nënvizon prof. Fricero, "përcaktimi i një kalendari mbron afatin kohor të arsyeshëm në një proces gjyqësor, në bashkëpunim të ngushtë me palët ndërgjyqëse"¹⁰⁴.

•Prejardhja e vonesave: probleme në lidhje me dëshmitarët në cilësinë e ekspertit

Vonesat e lidhura me ndërhyrjen e një apo më shumë ekspertëve në procedurë janë shumë të zakonshme në proceset civile, penale dhe administrative dhe përkojnë me situata të ndryshme:

•Prejardhja e vonesave: Vonesa në caktimin e ekspertëve për shkak të pasivitetit të gjyqësorit

Megjithëse në Danimarkë palët mund të propozojnë caktimin e ekspertëve, sipas ligjit për dhënien e drejtësisë gjykatat nuk janë të detyruara të bien dakord me to. Në aktgjykimin e çështjes së lartpërmendur "A. dhe të tjerë - Danimarkë", Gjykata e kritikonte gjykatën daneze sepse u kishte lejuar palëve të negocionin thuajse dy vjet se cilët duheshin caktuar si ekspertë dhe çfarë pyetjesh t'u bëheshin, pa ndërhyrë asnjëherë (pika 80).

•Prejardhja e vonesave: ekspertë që nuk e përmbushin mandatin

Situata të tilla krijojnë vështirësi dhe vonesa dhe sjellin kërkesa për opinion të dytë. Gjykata e ka theksuar vazhdimisht se megjithëse ekspertët kanë autonomi të plotë në përpilimin e akt-ekspertizave, ata janë sidoqoftë objekt mbikëqyrjeje nga gjykata, çka duhet të sigurojë që vlerësimet e ekspertëve të kryhen si duhet.

Shembull nga jurisprudenca

Në aktgjykimin e çështjes "Versini - Francë", datë 10 korrik 2001 (vetëm në frëngjishte), Gjykata konstatoi se ekspertët e kishin kapërcyer objektin e detyrës, e cila ishte thjesht vlerësimi i dëmit. Kjo bëri që paditësi të kërkonte opinion të dytë, duke e zgatur kështu procesin.

•Prejardhja e vonesave: afati që i cakton gjykata ekspertit nuk mund të shtyhet në shkallë të ekzagjeruar

Në aktgjykimin e çështjes "Pena - Portugali", datë 18 dhjetor 2003 (vetëm në frëngjishte), Gjykata nxirrte në pah se vlerësimi i ekspertit që pjesë e procesit gjyqësor nën mbikëqyrjen e gjykatës, e cila mbante përgjegjësi për zhvillimin e përshpejtuar të çështjes. Kjo lidhej me një çështje në të cilën një laborator shkencor shtetëror i që kërkuar ta depozitonte raportin brenda 60 ditëve, pra më 19 nëntor 1996, por e kishte dorëzuar jo më parë se më 15 maj 2000, pasi gjykata civile kishte miratuar disa shtyrje afati¹⁰⁵.

¹⁰⁴ "Procédure civile chronique", Nathalie Fricero, Pierre Julien, në *Dalloz*, Nr. 8 f. 546.

¹⁰⁵ Shih edhe: Aktgjykimin e çështjes "Molin Insaat - Turqi", datë 11 janar 2005.

Në një çështje greke, gjykata e apelit kishte kërkuar akt-ekspertizë më 15 shkurt 1994, por ekspertin e caktoi jo më parë se data 16 shtator 1994. Pas një seance më 21 mars 1995, gjykata e apelit vendosi ta rimerrte në shqyrtim çështjen dhe ta thërriste përsëri ekspertin për shpjegime të mëtejshme, por seanca u zhvillua jo më parë se data 8 prill 1997. Aktgjykimi u dha më 28 korrik 1997, por u botua jo më parë se 22 maj 1998.

Çështja “Capuano”, lidhur me të drejtën e servitudit, është një tjetër shumë shembull i mirë i problemeve që lindin nga akt-ekspertizat. Më 14 mars 1978, gjykata i caktoi ekspertit të caktuar prej saj 60 ditë afat për dorëzimin e aktit por pas vonesash të shumta akt-ekspertiza u paraqit jo më parë se data 5 korrik 1979, pas së cilës menjëherë njëra prej depozitave një kërkesë për një akt-ekspertizë nga një ekspert privat.

•Prejardhja e vonesave: Mospenalizimi i ekspertëve në rast mungese korrekte

Përsëri Gjykata Evropiane e kritikon pasivitetin e gjykatave, duke theksuar se “eksperti punon në kuadër të procesit gjyqësor në mbikëqyrjen e gjyqtarit, i cili mban përgjegjësinë për përgatitjen dhe zhvillimin me shpejtësi të gjykimit”¹⁰⁶.

Shembull nga jurisprudenca

Një pjesë e nxjerrë nga aktgjykimi i çështjes “Zappia - Itali”, datë 29 gusht 1996 (23 vjet proces për një çështje të thjeshtë dhe ende të pambyllur mbi përgjegjësinë kontraktore dhe ekzekutimin e vendimit) ilustron radhën kohore të shtyrjeve të seancave që mund të ndodhin në kohëzgjatjen e proceseve: “Më 27 mars 1985, pas një shtyrjeje të vendosur nga gjykata kryesisht, gjyqtari caktoi një ekspert, i cili e bëri betimin më 25 shtator 1985. Seancat e caktuara për më 26 shkurt dhe 25 qershor 1986 u desh të shtyeshin, meqë eksperti nuk e kishte depozituar akt-ekspertizën brenda afatit gjashtëdhjetëditor. Seanca e caktuar për më 26 nëntor 1986 nuk mund të zhvillohej sepse qe transferuar gjyqtari.”

Në një çështje tjetër, Gjykata kishte këtë për të thënë lidhur me mungesën e nismës nga ana e gjykatës: “Gjykata vëren se dy rikujtesat nisur ekspertit nga gjyqtari që përgatiste çështjen për gjykim, e para prej të cilave, për më tepër, erdhi më se pesë muaj pas skadimit të afatit njëmuajor të caktuar më 4 korrik 1980 ... nuk e kanë arritur efektin e dëshiruar dhe se për rrjedhojë eksperti duhej të ishte zëvendësuar.” Aktgjykimi i çështjes “Di Pede - Itali”, datë 26 shtator 1996 (procedura civile).

Gjykata e dënonte sjelljen e gjykatës në një çështje ku paditësi kishte pasur sukses në kërkesën e tij për opinion të ri të një eksperti. Ajo nënvizon se “gjykata e brendshme nuk qe nën detyrimin për të miratuar kërkesën për opinion tjetër ekspertit sa herë që e kërkonte paditësi. Vetë gjykata ka autoritetin të vendosë si ta zhvillojë procesin dhe, në veçanti, çfarë provash të marrë” (pika 30¹⁰⁷). Gjykata çmon se vonesa e ndodhur gjatë periudhës 20 nëntor 2001 deri 7 maj 2003 ka të bëjë me përgjegjësinë e përbashkët mes paditësit dhe gjykatës.

Në një çështje në fushën e legjislacionit të ndërtimit, që kishte zgjatur 15 vjet, Gjykata vërente se njëra prej arsyeve për këtë kohëzgjatje të tepruar të procesit ishte se akt-ekspertiza e kërkuar nga gjykata e shkallës së parë për t’u dorëzuar brenda tre muajve nga data e kërkesës kishte marrë tre vjet e gjysmë pa asnjë arsye të fortë (aktgjykimi i çështjes “Raway dhe Wera - Belgjikë”, datë 27 nëntor 2007. Po kështu, në një çështje për një dëmtim trupor, e cila kishte zgjatur 16 vjet e 7 muaj, Gjykata e pranonte se për çështjen kishin qenë të nevojshme disa opinione të ekspertit të cilat kishin dashur njëfarë kohe për t’u përgatitur, por sidoqoftë Gjykata e dënonte vonesën gjithsej të shkaktuar (aktgjykimi i çështjes “Sürmeli - Gjermani”, datë 8 qershor 2006).

•Prejardhja e vonesave: vështirësi në marrjen e raporteve mjekësore (procedura penale)

Këto janë çështje ku institucionet mjekoligjore që normalisht janë përgjegjëse për kryerjen e ekzaminimeve mjekësore në proceset ligjore nuk janë në gjendje të vënë në dispozicion një ekspert brenda afatit të caktuar (aktgjykimi i çështjes “Martins Moreira - Portugali”, datë 26 tetor 1988).

¹⁰⁶ Aktgjykimi i çështjes “Zappia - Itali”, datë 26 shtator 1996, pika 25.

¹⁰⁷ Aktgjykimi çështjes “Sundov - Kroaci”, datë 13 prill 2006.

Reformat kombëtare:

Janë kryer reforma në institutet e mjekësisë ligjore për t'i bërë të përshtatshme në ndihmë të dhënies së efektshme të drejtësisë. Pas Urdhrit të Këshillit nr.169/83, datë 30 prill 1983, dhe vendimit ministror nr.316/87, datë 16 prill 1987, këto institute u pajisën me burimet e domosdoshme njerëzore dhe materiale. Për më tepër, sipas Urdhrit të Këshillit nr.387-C/87, datë 29 dhjetor 1987, janë zbatuar reforma për nivelin e organizimit të instituteve në mënyrë që të përgatiten për t'iu përgjigjur me shpejtësi kërkesave që u bëhen¹⁰⁸.

•Prejardhja e vonesave: Shtyrje të shumta të seancave dëgjimore, ose nga gjykata kryesisht ose me kërkesë të palëve, dhe intervale të tepruara mes seancave.

Vonesa të tilla pasqyrojnë mungesën e kontrollit mbi procesin nga ana e gjykatave civile.

Shembuj nga jurisprudenca:

Në aktgjykimin e çështjes "Baraona"¹⁰⁹, Gjkata shprehej se megjithëse legjislacioni i brendshëm ia lejonte avokatit të shtetit të kërkonte shtyrje të afatit, shteti prapëseprapë mbante përgjegjësi për çdo vonesë që vinte nga kjo.

Në aktgjykimin e çështjes "Vaz Da Silva Girao- Portugali", datë 21 mars 2002 (pika 12) (vetëm në frëngjishte), Gjkata vërente se megjithëse neni 264 i Kodit portugez të Procedurës Civile thoshte se palët mbajnë përgjegjësi për marrjen e nismës lidhur me ecurinë e procesit, neni 266 u kërkonte gjykatave të bënin të gjithë hapat e duhur për t'i hequr pengesat lidhur me zhvillimin e shpejtë të çështjeve. Gjkata tërhiqte vëmendjen edhe tek neni 68 i Kodit Rrugor, i cili kërkonte që çështja e paditësit të shqyrtohej me procedurë të shkurtuar, çka kërkonte uljen e disa afateve të caktuara.

Në një mosmarrëveshje mes paditësit dhe një zyre sigurimi shëndetësor, Gjkata e kritikonte gjykatën e apelit për mosshqyrtimin më herët të çështjes: "*në Gjykatën e Apelit në Rouen, çështja u shty për në një seancë të dytë e cila u zhvillua thuajse njëmbëdhjetë muaj pas së parës ... megjithëse, cilado qoftë arsyeja e kësaj shtyrjeje, asnjëra prej provave në dosjen e çështjes nuk e justifikonte një vonesë të tillë*"¹¹⁰.

Në çështjen "Günseli dhe Yayik- Turqi", vendim datë 21 shkurt 2008, Gjkata konstatoi se një prej shkaqeve kryesore të kohëzgjatjes së tepruar të procesit qe shtyrja e panevojshme dhe e pashpjegueshme e disa seancave penale.

Në aktgjykimin e çështjes "A. dhe të tjerë - Danimarkë", datë 8 shkurt 1996, Gjkata shprehej se "*paditësit kanë kontribuar ndjeshëm në kohëzgjatjen e procesit. Gjkata është gjithashtu në dijeni të faktit se procesi në fjalë nuk ka qenë i natyrës inkuizitoriale por ka qenë objekt i parimit se u takonte palëve të merrnin nismën lidhur me ecurinë e tij*". Mirëpo, Gjkata kritikoi edhe Gjykatën e Lartë, përpara së cilës çështja kishte qëndruar pa vendim për gati dy vjet, për miratimin e kërkesave të shumta për shtyrje nga të gjitha palët, "*pa përdorur ndonjëherë kompetencat e saj për t'u kërkuar palëve t'i specifikojnë kërkesat, t'i sqarojnë argumentet, të citojnë provat përkatëse ose të vendosin se kush duhej caktuar si ekspert*" (pika 80). Megjithatë, në Danimarkë i takon gjykatës të vendosë se kur ta mbyllë fazën paraprake me gojë ose me shkrim të procesit, që synon konstatimin e fakteve dhe të aspekteve ligjore të çështjes, për të siguruar që mbi çështjen të hidhet dritë dhe të identifikojë objektin e mosmarrëveshjes. Me mbarimin e përgatitjes së çështjes palët nuk mund të bëjnë më parashtrime të reja apo të citojnë prova të reja nëse nuk përmbushin disa kushte të caktuara kufizuese.

Në një çështje të kohëve të fundit, Gjkata shprehte keqardhjen se "*kanë kaluar më shumë se 2 vjet midis seancës së dytë dhe të tretë të zhvilluar në gjykatën komunale*"¹¹¹.

¹⁰⁸ Burimi: Lista e masave me natyrë të përgjithshme të miratuara për parandalimin e shkeljeve të reja të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Identifikimi i situatës së masave, raportuar Këshillit të Ministrave, në kuadër të kontrollit të ekzekutimit të aktgjyqimeve dhe vendimeve të marra në bazë të Konventës (përditësuar në maj 2006, f.155).

¹⁰⁹ Aktgjykimin e çështjes "Baraona - Portugali", datë 8 korrik 1987.

¹¹⁰ Aktgjykimin e çështjes "Duclos - Francë", datë 17 dhjetor 1996.

¹¹¹ Aktgjykimin e çështjes "Volesky - Republika Çeke", datë 29 qershor 2004, pika 105.

Shtyrjet e seancave janë konsideruar si më të dëmshme për një çështje ku kundërshtimi procedural i paraqitur përpara tre vjetësh është pranuar më në fund nga gjykata, duke i bërë të pavlefshme kështu të gjitha fazat e mëparshme të procesit (aktgjykimi i çështjes “Ferreira Alves - Portugali” (nr.2), datë 4 dhjetor 2003).

•Prejardhja e vonesave: gabimet në interpretim të ligjit nga gjyqësori

“Një gabim në interpretimin e ligjit nga gjyqtari mund ta çojë çështjen në apel dhe kështu ta zgjasë kohëzgjatjen e procesit. Nëse kjo, në vetvete, do të çonte në shkelje të së drejtës për t’u dëgjuar “brenda një afati kohor të arsyeshëm”¹¹², kjo do të thotë pranim i faktit se ekziston e drejta që vendimet e gjykatës të jenë pa gabime.” Gjykata nuk bindet plotësisht nga ky argument dhe konsideron se gabimi që i ngarkohet një gjykate mund të justifikojë konstatimin e një shkeljeje, por vetëm në ndërthurje me faktorë të tjerë.

Në aktgjykimin e lartpërmendur të çështjes “Rashid - Bullgari”, datë 5 qershor 2008, Gjykata theksonte se vonesa kishte ardhur kryesisht nga një varg rikthimesh të çështjes nga gjykatat në shkallë më lartë sërish në gjykatën e shkallës së parë dhe në fazën e hetimeve paraprake, për shkak të shkeljeve të rregullave të procedurës (sidomos për shkak të thirrjes së dëshmitarëve në mënyrë të paligjshme).

•Prejardhja e vonesave: llojet e ndryshme të pakujdesisë nga gjykata

Një shkak tjetër që haset shpesh për vonesat në procese është pakujdesia nga ana e autoriteteve të gjyqësorit, përfshirë edhe humbjen e dosjeve të çështjeve.

Në çështjen e lartpërmendur “Pokhalchuk- Ukrainë”, vendim datë 7 tetor 2010, për shembull, Gjykata rikujtonte se humbja e dosjes së paditësit përbënte pakujdesi që u ngarkohej tërësisht autoriteteve dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohej si fakt objektiv që të kërkonte nga Gjykata uljen e çmuarjes së saj për kohëzgjatjen e procesit (shih edhe çështjen “Karov - Bullgari”, vendim datë 16 nëntor 2006).

3. Vonesa që ndodhin pas procesit

•Prejardhja e vonesave: kalim i tepruar kohe nga çasti i dhënies së aktgjyimit deri tek njoftimi i tij sekretarisë së gjykatës ose palëve

Në disa vende të caktuara, mund të kalojnë disa muaj që nga dhënia e aktgjyimit dhe njoftimit palës përgjegjëse për ekzekutimin e tij. Problemi shpesh qëndron tek sekretaria e gjykatës apo tek niveli joadekuat i pajisjeve informatike të saj, ndërsa ndonjëherë aktgjykimet nuk njoftohen për shkak të numrit të vogël të nëpunësve të gjykatës.

Prandaj i duhet kushtuar vëmendje e veçantë rolit të këtyre nëpunësve të gjykatave kur të shqyrtohen shkaqet e vonesave.

Shembull nga jurisprudenca

“Në fund, është e vështirë të kuptohet përse u deshën dy muaj pas dhënies së aktgjyimit për t’ua njoftuar me shkrim palëve” (aktgjykimi i çështjes “Buchholz - Gjermani”, datë 6 maj 1981).

Reformat kombëtare:

Në Francë “kontratat me objektiva” janë miratuar në disa gjykata apeli pilot (disa gjykata administrative apeli). Në këmbim të rritjes së numrit të punonjësve dhe burimeve të tjera, ato marrin përsipër të bëjnë shkurtime të konsiderueshëm të kohës që përdoret për dhënien dhe zbatimin e aktgjyimeve.¹¹³

¹¹² Aktgjykimi i çështjes “Bock - Gjermani”, datë 23 mars 1989.

¹¹³ Rezoluta ResDH(2005)63, datë 18 korrik 2005, lidhur me aktgjykimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në 58 çështjet kundër Francës (shih Shtojcën e kësaj Rezolutive) sa i takon kohëzgjatjes së tepruar të disa proceseve lidhur me të drejtat dhe detyrimet civile ose përcaktimin e akuzave penale përpara gjykatave administrative. Shih edhe Raportin vjetor 2008 të Këshillit të Ministrave, f.88.

Në Austri, teknologjia e informacionit po futet në përdorim për të menaxhuar fluksin e çështjeve dhe për të monitoruar ecurinë e tyre¹¹⁴.

C. SHKAQET E VONESËS SIPAS LLOJIT TË PROCESIT

1. Proceset civile

Mospërdorimi nga gjykatat i kompetencave apo tagrit që u japin rregullat e procedurës.

•Prejardhja e vonesave: Pasiviteti gjyqësor në vënien në dispozicion të provave

Ka raste kur gjykatat civile nuk janë aktive në mënyrë të mjaftueshme edhe pse procedura ua lejon të jenë aktive.

Shembull nga jurisprudenca

Në aktgjykimin e çështjes së lartpërmendur “Kubiznakova” (vetëm në frëngjishte), Gjykata e pranoi argumentin e paditëses se arsyeja përse i qe dashur të paraqiste prova, shpesh në mënyrë të përsëritur, ishte ngaqë gjykata nuk e kishte përmbushur detyrimin e saj për sigurimin e provës kryesisht, sikurse i kërkohej të vepronte në këtë lloj çështjeje.

•Prejardhja e vonesave: Gjykatat nuk kontrollojnë nëse fletëthirret për gjyq janë të përpiluara siç duhet apo jo, edhe pse kodi i procedurës civile ua ngarkon atyre këtë përgjegjësi.

Shembuj nga jurisprudenca:

Aktgjykimi i çështjes “Capuano - Itali”, datë 11 nëntor 1994, ofron një prej shembujve të shumtë. Mund të përmendim edhe aktgjykimin e çështjes “Serrentino - Itali”, datë 27 shkurt 1992, pika 18, dhe, me përshtatjet e duhura, aktgjykimi i çështjes “Cifola”, datë 27 shkurt 1992, pika 16.

•Prejardhja e vonesave: Çështjet ku procedura civile e pengon shqyrtimin e bazave të reja në apel

Fakti që procedura civile e pengon shqyrtimin e bazave të reja në apel, çka do të thotë se gjykatat në shkallë më të ulët duhet të tregojnë vigjilencë të posaçme, nuk mund ta justifikojë kohëzgjatjen e tepruar të procesit në shkallë të parë.

Shembull nga jurisprudenca

Në çështjen “Lechner dhe Hess”¹¹⁵, Qeveria mbështetej në faktin se procesi civil në Austri mbështetej në parimin se nuk mund të ngrihen aspekte të reja në apel (*Neuerungsverbot*) për të justifikuar dhënien e një afati ekstra gjykatës për arritjen e një vendimi, duke qenë se gjykata në një shkallë më të lartë qe e kufizuar në shqyrtimin e vendimit të kundërshtuar në bazë të materialit të paraqitur përpara gjykatës në shkallën më poshtë. Në aktgjykim thuhej: “Pa minimizuar rëndësinë e këtij faktori, Gjykata nuk beson se ka kaq shumë peshë sa ta çlirojë gjykatën e një shkalle më poshtë nga detyrimi për të përmbushur kërkesat e nenit 6, pika 1, lidhur me zhvillimin dhe shpejtësinë e gjykitimit.”

•Prejardhja e vonesave: Procedura civile nuk ua lejon gjykatave të zgjidhin mosveprimin e palëve për ta zhvilluar procesin me një ritëm të arsyeshëm

Në lidhje me proceset e llojit “akuzatorial”, Gjykata shpesh shprehet se megjithëse sipas kodit të procedurës civile në fjalë u takon palëve të marrin nismën lidhur me ecurinë, kjo nuk i çliron gjykatat nga detyrimi për të siguruar përmbushjen e kërkesës së nenit 6 lidhur me afatin kohor të arsyeshëm.

Shembuj nga jurisprudenca:

¹¹⁴ Rezolutë përfundimtare ResDH (2004) 77 për çështjen “G.S - Austri”.

¹¹⁵ Aktgjykimi i çështjes “Lechner dhe Hess - Austri”, datë 23 prill 1987.

Komenti më lart del në aktgjykimet e këtyre çështjeve: “Capuano - Itali”, datë 25 qershor 1987, pika 24 dhe 25, “Martins Moreira - Portugali”, datë 26 tetor 1988, pika 46, “Vernillo - Francë”, datë 20 shkurt 1991, dhe “Proszak - Poloni”, datë 16 dhjetor 1997.

Më në kohët e fundit, në aktgjykimin e çështjes “Tsirikakis - Greqi”, datë 17 janar 2002 (vetëm në frëngjishte)¹¹⁶, Gjykata konstatoi se edhe pse procesi rregullohej nga parimi i nismës së palëve, kriteri i afatit kohor të arsyeshëm i kërkonte gjykatës të kontrollonte nga afër zhvillimin e procesit dhe të tregonte shumë kujdes në miratimin e shtyrjeve apo kërkesave për dëgjimin e dëshmitarëve, si edhe të siguronte që akt-ekspertizat e nevojshme të depozitoheshin brenda afatit.

Del nga disa çështje gjyqësore se legjislati i brendshëm nuk u jep tagër gjykatave të ndërhyjnë për ta përshpejtuar procesin. Sipas aktgjykimit të çështjes “Füterer - Kroaci”, datë 20 dhjetor 2001, “*Qeveria thekson se në procedurën civile gjykatat janë të kufizuara në veprimtarinë e tyre meqë nuk mund të bëjnë hapa proceduralë kryesisht por më së shumti në bazë të kërkesës së palëve.*”

Në disa çështjeve gjyqësore, Gjykata në mënyrë të nënkuptuar u kërkon autoriteteve kombëtare ta ndryshojnë legjislatin në mënyrë që t’u japin gjykatave kompetencat e duhura për t’u dhenë urdhër palëve zvarritëse që ta përshpejtojnë procesin. “*Sa i takon argumentit të qeverisë se gjykata e shkallës së parë nuk mund të ecte përpara me procesin sepse pala e paditur nuk i përmbushte urdhrat e gjykatës për të marrë pjesë në seanca dhe në analizat e ADN-së, Gjykata rithekson se u takon Shteteve Kontraktuese t’i organizojnë sistemet juridike të tyre në mënyrë të atillë që gjykatat e tyre të mund ta garantojnë të drejtën e të gjithëve për të pasur një vendim të formës së prerë për mosmarrëveshjet e lidhura me të drejtat dhe detyrimet civile brenda një afati kohor të arsyeshëm*”¹¹⁷.

Për këtë arsye, është e këshillueshme të vërehet praktika daneze për kalendarin e seancave të gjykatës: kjo praktikë është parë si shumë e efektshme në disa çështje të gjykuara nga Gjykata, e cila nuk vërejtë asnjë periudhë çuar dëm në proceset gjyqësore, që do të kishte çuar në konstatim shkeljeje.

Shembuj nga jurisprudenca:

Aktgjykimi i çështjes “Ciricosta dhe Viola - Itali”, datë 4 dhjetor 1995 (pika 30), vërente se “*principio dispositivo*”, objekt i të cilit qenë proceset në Itali, i detyronin palët të merrnin nismën lidhur me ecurinë e proceseve. Ky aktgjykim i kritikonte palët se e kishin shpërdorur këtë mundësi që u jepej dhe shtonte se kjo nuk i çlironte gjykatat nga detyrimi për të siguruar përmbushjen e kërkesave të nenit 6.

Në çështjen e lartpërmendur “McFarlane- Irlandë”, datë 10 shtator 2010, Gjykata vërente se edhe pse legjislati i brendshëm u kërkonte palëve të procesit civil të merrnin nismën për çuarjen përpara të procesit, kjo nuk e çlironte Shtetin nga detyrimi për ta organizuar sistemin e tij në atë mënyrë që çështjet të përpunohen brenda një afati kohor të arsyeshëm. Nëse lejon që proceset të vazhdojnë përtej një “afati kohor të arsyeshëm” pa bërë asgjë për t’i çuar përpara, Shteti është përgjegjës për vonesën që vjen prej kësaj.

Reformat kombëtare

Disa shtete që përdorin qasjen inkuizitoriale i kanë reformuar procedurat civile të tyre pas konstatimeve nga Gjykata për kohëzgjatjen e tepruar të procesit. Për shembull, me legjislatin që hyri në fuqi më 1 janar 2002 Sllovakia e zëvendësoi parimin inkuizitorial me atë akuzatorial. Barra e provës tani u mbetet vetëm palëve, të cilat, parimisht, mund të sjellin prova dhe fakte vetëm në shkallën e parë.¹¹⁸

Reforma e procedurës civile italiane në vitin 1990, me ndryshimet e vitit 1995, synonte përmirësimin e zhvillimit të proceseve përmes futjes së një sistemi me afate kohore, i cili u kërkonte palëve t’i paraqisnin provat në seancën e dytë, dhe të një organi të ri gjyqësor në formën e gjyqtarëve të paqes, për t’u dhënë mundësi gjyqtarëve të plotë të përqendroheshin në çështjet më të rëndësishme.

¹¹⁶ Shkelje e nenit 6, pika 1, për procesin që zgjati 13 vjet e 3 muaj në një çështje komplekse në fushën e shpronësimeve, me apelimin për interpretimin e ligjit ende të papërfunduar (tri shkallë gjykimi).

¹¹⁷ Aktgjykimi i çështjes “Mitkulic - Kroaci”, datë 7 shkurt 2002.

¹¹⁸ Burimi: Lista e masave me natyrë të përgjithshme të miratuara për parandalimin e shkeljeve të reja të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Identifikimi i situatës së masave, raportuar Këshillit të Ministrave, në kuadër të kontrollit të ekzekutimit të aktgjyqimeve dhe vendimeve të marra në bazë të Konventës (zbatimi i ish-nenit 32 dhe 54 dhe i nenit 46).

Në vitin 1973, autoritetet italiane miratuan një reformë e cila parashikonte një procedurë të posaçme për mosmarrëveshjet për marrëdhëniet e punës, për të cilat Gjykata kërkonte korrektesë të veçantë, ndërsa në vitin 1990 u miratuan masa urgjente për përshpejtimin e zhvillimit të proceseve të këtij lloji (shih, nga jurisprudenca e kohëve të fundit, aktgjykimin e çështjes “Lestini - Itali”, datë 26 shkurt 1992, pika 18).

Kroacia e reformoi procedurën e vet civile me legjislacionin e datës 14 korrik 2003, i cili e zëvendësoi procesin inkuizicional me atë akuzatorial në çështjet civile. Si rezultat, vetëm palët e procesit kanë detyrimin për të paraqitur faktet, dhe vetëm në shkallën e parë. Për rrjedhojë, nuk është më e mundshme që të prishen vendimet e gjykatave dhe çështjet të kthehen mbrapsht për rishqyrtim për arsye se gjykatat nuk kanë konstatuar fakte të caktuara kryesisht (nenet 7 dhe 195)¹¹⁹. Janë planifikuar gjopa për ato palë që i shpërdorjnë ligjet procedurale dhe kështu shkaktojnë vonesa të pajustificuara në procedurë (nenet 4, 56 dhe 84). Për më tepër, mundësia që përfaqësuesi i prokurorisë të kërkojë rishikim të vendimeve të formës së prerë të gjykatës në kuadër të procedurës së jashtëzakonshme është shfuqizuar me nenin 239 të ligjit të datës 14 korrik 2003¹²⁰.

Ka ndryshuar edhe sistemi hungarez. Gjyqtarëve nuk u kërkohet më t’i udhëzojnë palët për të drejtat e tyre; tani mund të sanksionohen masat e hartuara për të vonuar procesin; prej vitit 1995, provat duhen paraqitur në të njëjtën kohë me kërkesat; afatet mund të shtyhen vetëm nga gjykatat dhe asnjëherë me më shumë se 45 ditë; dhe janë futur rrugët alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, si ndërmjetësimi dhe arbitrazhi.

Në raportin e tij “Access to Justice”¹²¹, Lord Woolf e ka kritikuar kohëzgjatjen shpesh të tepruar të proceseve civile në Mbretërinë e Bashkuar dhe natyrën e çorganizuar të tyre. Objektivat e lartë të reformës së vitit 1999 të reformës së procedurës civile që pasoi propozimet e raportit të tij përfshinin zgjidhjen më të shpejtë të çështjeve. Kjo reformë përfshinte futjen e tre lloje procedurash në varësi të rëndësisë së mosmarrëveshjes (një procedurë për padi të vogla me vlerë jo më të madhe se 5.000 sterlina; një procedurë të përshpejtuar për padi me vlerë jo më madhe se 25.000 sterlina; dhe një procedurë normale për shuma më të mëdha), botimin e rregullave të qarta të paraqitura në një kod procedure civile (Rregullorja e Procedurës Civile), përfshirjen e parimeve orientuese për proceset civile me synim përgatitjen e çështjeve për gjykatë, fazën paraprake që duhet respektuar përpara fillimit të procesit në çështje të caktuara dhe sanksione për palët që nuk i respektojnë këto rregulla¹²². Këto reforma nuk i kanë prodhuar efektet e dëshiruara dhe Lord Jackson i paraqiti Qeverisë Britanike një raport të ri në janar 2010¹²³.

2. Proceset penale

•Prejardhja e vonesave: problemet strukturore në lidhje me organizimin e prokurorisë

Në disa çështje të caktuara, këto probleme organizative kanë çuar në akumulimin e vonesave dhe gabimeve procedurale.

Shembuj nga jurisprudenca:

Në aktgjykimin e çështjes “Mitev - Bullgari”, datë 22 dhjetor 2004, Gjykata e kritikonte rikthimin e shpeshtë të çështjes në fazën hetimore gjatë dy vjetëve për të korrigjuar gabimet procedurale.

¹¹⁹ Rezoluta ResDH(2005)60 lidhur me aktgjykimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në çështjen “Horvat” dhe 9 çështje të tjera kundër Kroacisë (shih shtojcën I) miratuar më 18 korrik 2005.

¹²⁰ Rezoluta ResDH(2005)60 po aty.

¹²¹ *Access To Justice - Interim Report to the Lord Chancellor on the civil justice system in England and Wales (Liria për t’iu drejtuar sistemit të drejtësisë, raport provizor për Lord Kancelarin për sistemin e drejtësisë civile në Angli dhe Uells)*, qershor 1995.

¹²² Lidhur me këto reforma dhe me një vlerësim të tyre, shih M. Haravon, “*Dix années de réforme de la procédure civile anglaise: révolte ou révolution*”, R.I.D.C., Nr. 4-2004, f. 825; “*Quelprocès civil en 2010? Regards comparés sur l’accès à la justice civile en Angleterre, aux Etats-Unis et en France*”, R.I.D.C., Nr. 4-2010.

¹²³ Shqyrtim i kostove të ndërgjyjesisë, raport përfundimtar (dhjetor 2009).

Çështja “Kitov - Bullgari”, vendim datë 3 korrik 2003, kishte të bënte me periudhat e zgjatura të pasivitetit gjatë hetimeve penale për shkak të pakujdesisë dhe mosmarrëveshjeve mes hetuesve dhe prokurorit (pika 72).

Reformat kombëtare:

Bullgaria miratoi një kod të ri të procedurës penale më 29 prill 2006, në kuadër të reformës së përgjithshme të sistemit të drejtësisë penale në Bullgari, që synonte përshtetimin e procedurave penale. Ky kod u kërkon shprehimisht gjykatave dhe organeve hetimore t’i trajtojnë çështjet penale brenda një afati kohor të arsyeshëm (në veçanti, dispozitat parashikojnë afate të shkurtra për marrjen në shqyrtim të një çështjeje dhe për shtyrjen e seancave dhe një përdorim më të gjerë të procedurave të thjeshtuara)¹²⁴.

•Prejardhja e vonesave: periudha në fazën hetimore ku pak ose aspak progres bëhet në proces apo në hetime

Gjykata e kritikon pasivitetin, edhe në fazën e hetimit.

Një prej problemeve ai i çështjeve të mbetura pezull ngaqë nuk bëhen kontrole të rregullta për të identifikuar çështjet me të cilat gjyqtarët hetues nuk merren më në mënyrë aktive.

Shembuj nga jurisprudenca:

Në aktgjykimin e çështjes “Nuvoli - Itali”, datë 16 maj 2002 (vetëm në frëngjishte), Gjykata konstatoi se kishte kaluar më shumë se një vit e pesë muaj pas kontrollit të mjediseve të paditësit deri në bërjen e kërkesëpadisë për ta paraqitur çështjen në gjykatë.

Në aktgjykimin e çështjes “Mutimura - Francë”, datë 8 qershor 2004 (vetëm në frëngjishte), Gjykata e pranonte se çështja që disi komplekse, por megjithatë ajo e kritikonte natyrën e zvarritur të hetimit dhe faktin se kërkesat për ndihmë gjyqësore ndërkombëtare qenë nxjerrë më shumë se pesë vjet pas datës së aktakuzës së parë të formuluar nga prokurori. Gjykata konstatoi se kishte shkelje të nenit 6, pika 1, në një çështje hetimi i secilës kishte zgatur nëntë vjet dhe ende vazhdonte kur Gjykata e dha aktgjykimin. Çështja në fjalë kishte të bënte me ankesa penale sipas të cilave një klerik nga Ruanda por me vendqëndrim në Francë kishte marrë pjesë në vepra gjenocidi në Ruanda.

Reformat kombëtare:

Disa vende kanë miratuar afate për t’i përshtetuar proceset penale.

Kodi i ri italian i procedurës penale që hyri në fuqi më 24 qershor 1989 vendosi afate për prokurorët ose gjyqtarët hetues dhe parashikoi procese penale më të shpejta. Përdoren aktgjykime të drejtpërdrejta për çështjet ku autori i veprës është ndaluar në flagrancë dhe aktgjykime të menjëhershme kur autoritetet proceduese i konsiderojnë si të pakundërshtueshme provat.

Në mënyrë të ngjashme, më 28 prill 2003, Spanja futi procesin e shpejtë penal me afate të kufizuara për etapat e ndryshme: 72 orë për hetimet paraprake nga policia gjyqësore dhe 72 orë për gjyqtarin hetues të rojës për ta hetuar çështjen dhe për të filluar procesin gojor, ku autoritetet proceduese duhet ta paraqesin aktakuzën me të filluar etapa me dëshmitë gojore. Synimi është të sigurohet një vendim jo më vonë se një muaj e gjysmë pas arrestimit të personit të dyshuar, sidomos në çështje të tilla si dhuna bashkëshortore dhe vjedhjet e banesave, me një ndikim të madh social.

Në Gjermani, procesi i përshtetuar përdoret për çështjet që i kap një dënim jo më i rëndë se një vit burgim. Seancat duhet të zhvillohen jo më vonë se gjashtë javë pasi autoritetet proceduese t’i kenë kërkuar gjykatës përkatëse lëshimin e urdhrit për procedurë të përshtetuar.

Pas reformës së vitit 1998 në kodin e procedurës penale, Portugalia përdor një procedurë të shkurtuar të ngjashme me atë të përshtetuar që përdoret në Gjermani.

¹²⁴ Raport vjetor 2010 për Këshillin e Ministrave, f. 131, dhe Raport vjetor 2007 për Këshillin e Ministrave, f.80.

Në Francë, 75% e çështjeve, kundrejt 45% dhjetë vjet më parë, janë objekt përcjelljeje me shpejtësi në gjykatën penale, ose nga gjyqtari hetues ose me mandat të drejtpërdrejtë, pa hetim paraprak. Këto zhvillime kanë ndihmuar në përshpejtimin e proceseve, ku 75% e personave të prekur tani paraqiten përpara gjykatës brenda një periudhe nga dy ditë deri në katër muaj¹²⁵.

•Prejardhja e vonesave: periudhë tepër e gjatë përpara ose midis seancave

Shteti është përgjegjës për vonesat gjatë dëgjimit të çështjeve pasi kanë përfunduar hetimet.

Shembuj nga jurisprudenca:

Në çështjen “Mattoccia”¹²⁶, kaluan tre vjet e shtatë muaj që nga çuarja për gjykim e paditësit deri në seancën e parë të zhvilluar përpara trupit gjykues.

Gjykata ka kritikuar edhe faktin se më se një vit kishte kaluar që nga depozitimi i apelimit deri në seancën e parë në gjykatën e apelit në aktgjykimet e çështjet “Hamanov - Bullgari” dhe “Belchev - Bullgari”, datë 8 prill 2004.

Nga ana tjetër, në një çështje polake që kishte zgatur pesë vjet e tetë muaj, konstatimi i Gjykatës se nuk kishte pasur shkelje mund të shpjegohet jo vetëm me kompleksitetin e kësaj çështjeje ndërkombëtare me objekt kontrabandën e lëndëve narkotike por edhe me hapat që ka marrë gjykata për t’i përshpejtuar proceset.

Në veçanti, Gjykata vërente mosmiratimin nga gjykata të një kërkesë të depozituar nga i pandehuri në seancën e parë që çështja t’i rikthehej prokurorisë për të mundësuar përfundimin e hetimeve, vendimin për ta veçuar shqyrtimin e çështjes së paditësit nga ajo e dy të pandehurve të tjerë dhe mosmiratimin e disa kërkesave të paditësit të cilat do ta kishin zgatur procesin. Megjithëse qenë shtyrë disa seanca, kjo i ngarkohej të pandehurit ose mungesës së dëshmitarëve. Asnjëra prej këtyre shtyrjeve nuk mund t’i ngarkohej gjykatës për mosshpejtim të procesit¹²⁷.

•Prejardhja e vonesave: vendimi për t’i bashkuar apo jo çështjet penale

Ndonjëherë Gjykatës i duhet të shprehet me vendim për vendimet e gjykatave për t’i bashkuar apo jo çështjet e lidhura, sidomos në çështjet penale komplekse me disa të pandehur. Asaj i duhet të vendosë nëse vendime të tilla janë apo jo në përputhje me kriterin e afatit kohor të arsyeshëm, duke mbajtur parasysh edhe rëndësinë e dhënies së drejtësisë, që mund të kërkojë një qasje alternative.

Shembuj nga jurisprudenca:

Në vendimin e çështjes “Wejrup - Danimarkë”, datë 7 mars 2002, që kishte të bënte me krim ekonomik ndërkombëtar dhe praktika të parregullta kontabiliteti, paditësi argumentonte se procesi që zgatur në mënyrë të panevojshme për shkak të bashkimit të gjykimit të tij me atë të të pandehurit tjetër dhe se disa aspekte nuk kishin të bënin me të. Mirëpo, Gjykata e aprovoi vendimin e prokurorisë për bashkimin e çështjeve kundër të pandehurve, synimi i së cilës që zvogëlimi i kostove të gjykatës dhe e përshkroi si “pa dyshim të duhur”.

Mirëpo, asaj i duhet të arrijë një drejtpeshim mes veçimit të proceseve në interes të shpejtësisë dhe dhënies së duhur të drejtësisë. Në çështjen “Absandze - Gjeorgji”, datë 15 tetor 2002 (vendim për rrëzimin e çështjes – vetëm në frëngjishte), Gjykata e bëri të qartë se veçimi i çështjes së paditësit nga ajo e të pandehurve të tjerë ka shumë të ngjarë se do ta kishte përshpejtuar procesin por se nuk kishte asgjë që do të tregonte se një veçim i tillë do të kishte qenë në përputhje me dhënien e duhur të drejtësisë¹²⁸.

•Prejardhja e vonesave: Mospjesëmarrja në seancë e dëshmitarëve, që shkakton shtyrje të përsëritura të seanca

¹²⁵ Raport informues nr.17 i Senatit Francez, datë 12 tetor 2005, për përshpejtimin e proceseve penale, përgatitur nga Senator François Zocchetto, dhe Anketë e legjislacionit krahasues nr.146-maj 2005- proceset penale të përshpejtuara – Shih hapësirën në internet: <http://www.senat.fr>

¹²⁶ Aktgjykim i çështjes “Mattoccia - Itali”, datë 25 korrik 2000.

¹²⁷ Aktgjykimi i çështjes “Salapa - Poloni”, datë 19 dhjetor 2002.

¹²⁸ Shih edhe aktgjykimin e çështjes “Neumeister - Austri”, po aty, pika 21.

Sa i takon rëndësisë së provave dhe dëshmive në procesin penal, vonesat e lidhura me mosparaqitjen e dëshmitarëve përbën burim shqetësimi.

Kur kodet penale kombëtare i lejojnë gjykatat t'i gjobisin dëshmitarët që janë thirrur rregullisht por nuk paraqiten pa arsye të fortë, ose edhe t'i sjellin në shoqërimin e policisë, Gjykata i kritikon gjykatat që nuk i përdorin këto kompetenca për t'i përshpejtuar proceset.

Shembuj nga jurisprudenca:

Në vendimin/aktgjykimin e dhënë për çështjen *Iłowiecki kundër Polonisë*, më 4 tetor 2001, për veprën penale të mashtrimit ndërkombëtar, Gjykata kritikoi shtyrjen e seancave dëgjimore, gjatë një periudhe një vjeçare, për mos-paraqitje të dëshmitarëve. Procesi gjyqësor kishte zgjatur shtatë vjet, dhjetë muaj dhe shtatë ditë, dhe, kur Gjykata nxori vendimin, çështja ishte ende në gjykim. Nga e gjithë kjo periudhë, 2 vjet dhe dhjetë muaj vonesë ishin për shkak të autoriteteve, të cilat vepruan në kundërshtim me nenin 6§1.

Vlen gjithashtu të përmendet vendimi i dhënë për çështjen *Trzaska kundër Polonisë*, më 11 korrik 2000, §90, dhe vendimi i dhënë për çështjen *Kusmieriek kundër Polonisë*, më 21 dhjetor 2004, ku Gjykata konstatoi se Polonia kishte vepruar në kundërshtim me Konventën për një vepër të shpifjes që kishte zgjatur nëntë vjet dhe gjashtë muaj, (prej të cilave vetëm tetë vjet dhe katër muaj ishin brenda juridiksionit të përkohshëm të Gjykatës).

Në vendimin/aktgjykimin e dhënë për çështjen *Kuibichev kundër Bullgarisë*, më 30 shtator 2004, Gjykata ngre çështjen e vonesave të shkaktuara nga gjykatat bullgare, veçanërisht të atyre që kanë të bëjnë me mungesën e dëshmitarëve, ose me pamjaftueshmërinë e masave të marra nga autoritetet për të garantuar praninë e tyre në seancën gjyqësore.

Çështja (e përmendur më lart) e *Stefanova kundër Bullgarisë*, vendimi/aktgjykimii datës 11 janar 2007, evidenton një sërë shkaqesh: seanca dëgjimore të vonuara, procedura të paligjshme të thirrjeve për në gjyq dhe shtyrje të njëpasnjëshme dhe të përsëritura të seancave dëgjimore.

- **Ndikimet e vonesave në proceset penale mbi proceset civile**

Kur proceset penale zvarriten, kjo mund të vështirësojë ose pengojë ecurinë e çështjeve në gjykatat civile.

Shembuj nga jurisprudenca: Në vendimin/aktgjykimin e dhënë për çështjen *Motta* të 12 shkurt 1991, ku një mosmarrëveshje civile midis një mjeku dhe autoriteteve të sigurimeve shoqërore çoi në proces penal për mashtrim kundër palës paditëse, Gjykata konstatoi se procesi penal kish qenë shumë i ngadaltë dhe shtoi se “*procesi civil u pengua në ecurinë e tij nga ngadalësia e procesit penal.*” Vendimi i dhënë për çështjen *Djangozov kundër Bullgarisë*, më 8 korrik 2004 ofron një shembull më të freskët.

3. Proceset gjyqësore administrative

- **Burimi i vonesës: vonesa të shkaktuara nga autoritetet jo-gjyqësore**

Vonesat e shkaktuara nga sjellja e ministrave apo përfaqësuesve të tyre ose nga institucionet e shëndetit publik, në lidhje me çështjet që duhet t'u referohen fillimisht autoriteteve përkatëse, i atribuohen shtetit kontraktues. Në çështjen *Meldrum kundër Hollandës* të 9 dhjetor 1994, palës paditëse iu desh të priste njëzet muaj për një vendim nga një shoqatë profesionale, përpara se të bënte apel.

Shembuj nga jurisprudenca:

Çështjet në Francë në lidhje me të sëmurët me hemofili, që u kontaminuan nga virusi i HIV (SIDA) gjatë transfuzioneve të gjakut ofrojnë një shembull të mirë në lidhje me këtë problem. Në çështjen Vallée të 12 dhjetor 1989, pala paditëse i dorëzoi Ministrit për Solidaritetin, Shëndetin dhe Mbrojtjen një kërkesë (pretendim) paraprake për zhdëmtim, në përputhje me nenin R. 102 të Kodit mbi Gjykatat Administrative dhe Gjykatat Administrative të Apelit. Më 30 mars 1990, pak para mbarimit të afatit kohor prej katër muajsh të parashikuar me ligj, Drejtori i Përgjithshëm për çështjet e shëndetit e hodhi poshtë kërkesën e palës paditëse.

Në çështjen *Kritt*

¹³⁰, më të vonshme në kohë, Gjykata kritikoi Autoritetin përgjegjës për Spitalet Publike të Parisit (AP-HP), duke thënë se kur një institucion ligjor publik është palë në një proces gjyqësor, vonesat e shkaktuara nga sjellja e institucionit u atribuohen "autoriteteve", siç parashikohet në jurisprudencën përkatëse. Kështu kishte ndodhur me vonesat për shkak të AP-HP. Në vend që të hidhte qartazi poshtë kërkesën paraprake të palës paditëse, AP-HP qëndroi i heshtur, dhe si rezultat palës paditëse iu desh të qëndronte në pritje për katër muaj, përpara se të aplikonte në Gjykatën Administrative. AP-HP-së iu desh gjashtë muaj për të dërguar vërejtjet e saj në Gjykatën Administrative. Gjykata kritikoi gjithashtu sjelljen e Gjykatës Administrative. Ajo kish pritur gjer në 16 shkurt 1999 përpara se të dërgonte udhëzimet e saj për AP-HP, dhe ekspertëve të caktuar nga gjykata iu deshën njëmbëdhjetë muaj për ta bërë këtë raport.

Në një çështje spanjolle, Gjykata vërejti se Gjykatës së Lartë të Spanjës (*Audiencia Nacional*) iu desh t'u kërkonte disa herë autoriteteve që të dërgonin dosjet përkatëse, pra pati një mungesë kujdesi nga ana e këtyre të fundit. Dokumenti u dorëzua vetëm katër vjet dhe gjashtë muaj pas kërkesës së parë¹³¹.

Në çështjen e Klinikës Mozart SARL (SHAPK)¹³², u vlerësua se autoritetet tatimore ishin përgjegjëse për dy vjet dhe nëntë muaj vonesë në procesin gjyqësor, për shkak të dorëzimit të vonë të deklaratave të tyre mbrojtëse.

Reformat kombëtare: Në mosmarrëveshjet në lidhje me kontributet për sigurimet shoqërore, kur organizata profesionale nuk merr një vendim brenda një kohe të arsyeshme, ose refuzon ta bëjë këtë, kodi i përgjithshëm administrativ i Holandës, që hyri në fuqi më 1 janar 1994, autorizon qytetarët që ta çojnë menjëherë çështjen në apel direkt në gjykatë.

(Përsëri: Reforma e të drejtësisë administrative në Francë, shiko Pjesën 2, II. B. Më poshtë).

II. ZGJIDHJET VENDASE PËR REDUKTIMIN E KOHËZGJATJES SË PROCESIVE GJYQËSORE DHE PËRMbledhje e PROCESIVE GJYQËSORE QË LIDHEN ME TO

A. Direktivat e Gjykatës Evropiane

Direktivat e Gjykatës Evropiane janë tashmë të përshkruara në detaj në të ashtuquajturat vendime pilote, në bazë të nenit 46 të Konventës, të cilat, megjithëse kanë të bëjnë me një kërkesë të vetme, konstatojnë shkelje të Konventës për shkak të një problemi strukturor, i cili prek një kategori të tërë personash, dhe përmbajnë këshilla në lidhje me një masë të përgjithshme që ndihmon zgjidhjen e problemit që është shkak i shkeljes, dhe ofron një model për një rrugëzgjdhje efikase në nivel vendor¹³³.

¹³⁰ *Kritt* kundër Francës, gjykimi i datës 19 mars 2002 (vetëm në frëngjishte).

¹³¹ Alberto Sanchez kundër Spanjës, vendim i datës 16 nëntor 2004.

¹³² Klinika Mozart SARL kundër Francës, vendimi i datës 8 qershor 2004.

¹³³ Shiko p.sh. Vendimet/Aktgjykimet e Dhomës së Madhe për çështjen *Broniowski kundër Polonisë* të 22 qershor 2004, *Burdov kundër Rusisë* (nr.2), i datës 15 janar 2009, *Ivanov kundër Ukrainës*, i datës 15 tetor 2009, dhe çështjet italiane të përmendura më lart për të cilat u morën disa vendime nga Dhoma e Madhe, më 29 mars 2006 (shiko PJESA 1.A. më lart).

Më në përgjithësi, organet e ndryshme të Këshillit të Evropës kanë marrë një numër vendimesh dhe kanë bërë një punë intensive me qëllim që të piketojnë rrugëzgjdhjet e duhura për shkeljet e detyrimit për një kohëzgjatje të arsyeshme të procesit gjyqësor.

Në seancën e tij të 114-të në maj 2004, Këshilli i Evropës aprovoi një Deklaratë që u drejtohej Shteteve Anëtare në lidhje me "Garantimin e efikasitetit të implementimit të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut" në nivel kombëtar dhe në nivel evropian".

Me kërkesë të Komitetit të Ministrave, Komiteti Drejtues për të Drejtat e Njeriut (CDDH), nëpërmjet Komitetit të Ekspertëve për Përmirësimin e Procedurave për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut¹³⁴, po studion mënyra për implementimin e rekomandimeve të Komitetit, duke përfshirë atë që ka të bëjë me përmirësimin e rrugëzgjdhjeve në nivel vendor.

Masat për të reduktuar kohëzgjatjen e proceseve përbëjnë një aspekt të rëndësishëm të kësaj veprimtarie.

Gjatë hartimit të Rekomandimit Rec (2004) 6, CDDH u kërkoi autoriteteve vendase të dërgonin shembuj të praktikave të mira për përmirësimin e rrugëzgjdhjeve në nivel vendor.

Komiteti i Ministrave sapo kishte miratuar një rekomandim të rëndësishëm mbi rrugëzgjdhjet efektive për kohëzgjatjen e tepruar të proceseve gjyqësore¹³⁵, shoqëruar me një Udhëzues të Praktikës së Mirë, me synim përmirësimin e implementimit të së drejtës për seancë dëgjimore brenda një afati të arsyeshëm dhe për rrugëzgjdhje efektive, gjë e cila, në fakt i referohet gjithashtu aktiviteteve dhe instrumenteve të CEPEJ (Udhëzuesi, p. 7-10)¹³⁶.

Pas vendimit të mëparshëm për çështjen *Kudla*, një numër shtetesh kanë marrë masa që t'u mundësojnë qytetarëve që kanë pasur kohëzgjatje të tepruar të procesit gjyqësor, dhe që janë ende në pritje të përfundimit të një faze të caktuar, të kenë një proces të shpejtë. Gradualisht po bëhet e qartë se alternativa e ofruar nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka një numër disavantazhesh. Duke u lejuar vendeve të zgjedhin midis dëmshpërblimit për dëm si rezultat i proceseve gjyqësore tepër të gjata dhe mundësisë për të përshpejtuar procesin gjyqësor, Gjykata ka krijuar mundësinë e rrugëzgjdhjeve të reja.

Në fakt, sikurse tregoi zbatimi i ligjit *Pinto*, dëmshpërblimi për dëmin që iu akordua palës paditëse, në përmbushje të kërkesave të Gjykatës Evropiane, e bëri këtë zgjidhje 'tepër tërheqëse'¹³⁷ dhe aktualisht ka shkaktuar një mbingarkesë të Gjykatës së Apelit në Itali, pa parandaluar afatet kohore tepër të gjata për të ardhmen.110.

Në vendimin kryesor të përmendur më lart Scordino kundër Italisë, ECHR/GJEDNJ i referohet punimit të CEPEJ: 'Në programin e tij kuadër (CEPEJ (2004) 19 Rev 2 § 6), CEPEJ vëren se mekanizmat që kufizohen vetëm në dëmshpërblim janë shumë të dobëta dhe nuk i nxisin si duhet Shtetet të ndryshojnë proceset e tyre të punës; ato ofrojnë kompensimin vetëm *à posteriori*, në rastin e një shkeljeje të provuar, në vend që të përpiqen të gjejnë një zgjidhje për problemin e vonesave'.

Punimi vazhdon kështu: 'Nëse një sistem ligjor dështon në këtë drejtim, zgjidhja më efektive do të ishte të gjendej një rrugëzgjdhje që të mundësonte përshpejtimin e procedurës me qëllim pengimin e kohëzgjatjes së tepruar. Kjo rrugëzgjdhje përbën një avantazh të pamohueshëm në krahasim me një rrugëzgjdhje që do të fokusohet vetëm në pagesën e një dëmshpërblimi financiar, sepse ajo gjithashtu shmang detyrimin për

¹³⁴ Rekomandim (2004) i Komitetit të Ministrave i datës 12 maj 2004

¹³⁵ CM/Rec(2010)3, miratuar nga Komiteti i Ministrave më 24 shkurt 2010 në takimin e 1077 të Zv/Ministrave.

¹³⁶ Duhet gjithashtu të përmendim raportin e Komisionit të Venecias (doc. CDL-AD(2006)036rev)

¹³⁷ Raporti i katërt informues CM/Inf/DH (2005) 31 i datës 6 qershor 2005.

konstatimin e shkeljeve të njëpasnjëshme për të njëjtën procedurë dhe, nuk kufizohet vetëm në veprimet *à posteriori*, siç ndodh me rrugëzgjdhjen për dëmshpërblim financiar, si ajo që parashikohet në ligjin italian.’

Shteteve u lejohet njëfarë hapësire për diskrecion në zgjedhjen e rrugëzgjdhjes që do të përdorin me qëllim përputhjen me kërkesat e nenit 13 të Konventës. Siç u tha më lart, vendimi/aktgjykimi për çështjen *Kudla kundër Polonisë* ofron një zgjedhje midis një rrugëzgjdhjeje të orientuar drejt shpejtimit të procedurave dhe një tjetre për të ndrequr pasojat, (Pjesa 1 si më lart), edhe pse Gjykata rregullisht thekson këtu se ‘zgjidhja ideale është parandalimi’, (p.sh. vendimi/aktgjykimipër çështjen *Vokurka kundër Republikës Çeke*, i datës 16 tetor 2007). Përveç kësaj, të gjitha rrugëzgjdhjet e parashikuara në ligjet vendase mund të përputhen me kërkesat e nenit 13, edhe pse asnjë prej tyre nuk është i mjaftueshëm në vetvete. (*Kudla kundër Polonisë*, i përmendur më lart §157). Disa shtete kanë zgjedhur kombinimin e dy rrugëzgjdhjeve, një për të përshpejtuar proceset gjyqësore, dhe tjetra për dëmshpërblim, (p.sh. vendimi/aktgjykimipër çështjen *Missenjov kundër Estonisë*, 29 prill 2009, §44).

Shtetet kanë futur në përdorim një gamë të gjerë rrugëzgjdhjesh për përshpejtimin e proceseve gjyqësore ose për dëmshpërblim për pasojat e vonesave¹³⁸.

Dëmshpërblimi mund të jetë gjithashtu në formën e një reduktimi të përshtatshëm të disa kostove, të dënimit apo të dëmit që i shkaktohet palës apeluese¹³⁹. Sidoqoftë Gjykata ka konsideruar se ‘një vendim apo masë e favorshme për palën apeluese nuk është në parim e mjaftueshme për ta privuar atë nga statusi i saj ‘si viktimë’, përveç rasteve kur autoritetet kombëtare e kanë pranuar shprehimisht ose në thelb, dhe pastaj kanë ofruar zhdëmtim për shkelje të Konventës’,(p.sh. vendimi i Dhomës së Madhe për çështjen Riccardo Pizzati kundër Italisë, 29 mars 2006, §70).

Gjykata pranon që një Shtet që ka futur në përdorim një sërë rrugëzgjdhjesh parandaluese dhe dëmshpërbljese, ku vendimet përkatëse, në përputhje me traditën ligjore dhe standartin e jetesës së vendit, janë të shpejta, të arsyetuara dhe zakonisht ekzekutohen me shpejtësi, të ofrojë shumën të cilat, edhe pse janë më të vogla se ato të vendosura nga Gjykata, nuk janë të paarsyeshme, (*Dubjakova kundër Sllovakisë*, 10 tetor 2004).

Raporti i Komisionit të Venecias vëren se: “për çështjet penale ekzistojnë forma specifike të rrugëzgjdhjeve dëmshpërbljese, që duhet të konsiderohen si forma të ‘*restitutio in integro*’ (rivendosje në pozitat fillestare): ndërprerja e ndjekjes penale, zbutja ose reduktimi i dënimit; shpallja e pafajësisë, vendosja e një gjobe të nivelit të ulët; dhe mos-privimi nga të drejtat civile dhe politike. Megjithatë, këto mund të shkaktojnë, në disa raste, mungesë të drejtësisë materiale. Shpallja e pafajësisë ose ndërprerja e procesit gjyqësor duhet të aplikohet vetëm në raste të jashtëzakonshme. Në motivimin e përdorur nga gjyqtari kur vlerësohet kohëzgjatja e procesit gjyqësor, duhet të bëhet e qartë lidhja midis kësaj të fundit dhe masës së dënimit që jepet, dhe duket se është me vend të përmendet se çfarë dënimi do të ishte dhënë nëse kohëzgjatja do të kishte qenë e arsyeshme¹⁴⁰.

B. Rrugëzgjdhjet ekzistuese vendase: përmbledhje¹⁴¹

Një numër rrugëzgjdhjesh interesante vendase ekzistojnë aktualisht.

Në Austri, Nënndarja 91 e Aktit për Gjykatat (*Gerichtsorganisationsgesetz*) ofron një rrugëzgjdhje që Gjykata së fundmi e përshkroi si ‘efektive’ në lidhje me vendimin e dhënë për çështjen Holzinger, të 30 janarit 2001. Ky

¹³⁸ Shiko raportin e sipërpërmendur të Komisionit të Venecias CDL-AD(2006)036rev., §§ 69-87: [http://www.venice.coe.int/webforms/documents/CDL-AD\(2006\)036rev-e.asp](http://www.venice.coe.int/webforms/documents/CDL-AD(2006)036rev-e.asp)

¹³⁹ Udhëzuesi i Praktikës së Mirë, nr. 112, f.25.

¹⁴⁰ Op. cit., § 240, përfshirë në Udhëzuesin e Praktikës së Mirë, Nr. 114, f. 26.

¹⁴¹ Për një studim në lidhje me këtë çështje, shiko raportin e Komisionit të Venecias të përmendur më lart.

konkluzion është ri-përsëritur, p.sh. në vendimin për çështjen *Saccoccia kundër Austrisë*, të 5 korrikut 2007. Dispozita të reja u shtuan në kodin e procedurës penale në mars 2004, të cilat u jepnin personave të akuzuar të drejtën që procesi i tyre gjyqësor të përfundonte brenda një kohe të arsyeshme.

Në Belgjikë një ligj i ri reformoi më 1998 Kodin e Hetimit Penal dhe prezantoi në ligjin vendas një rrugëzgjdhje të re që i lejonte personit të akuzuar të ankohej për kohëzgjatjen e tepruar të hetimit penal. Shembuj të jurisprudencës tregojnë se rrugëzgjdhja e parashikuar në dispozitë lejon përshpejtimin e hetimeve. Gjykata e konsideroi këtë rrugëzgjdhje efikase në vendimin e saj për çështjen *Strategji dhe Komunikime dhe Dumpulin kundër Belgjikës*, të datës 15 tetor 2002. Përveç kësaj, në dhjetor 2000, ligji belg parashikoi një sanksion për rastin e kohëzgjatjes së tepruar të procesit gjyqësor: 'gjyqtari mund të vendosi një dënim pasi thjesht ka konkluduar për fajin, ose mund të imponojë një dënim më të lehtë se dënimi minimum i parashikuar me ligj'¹⁴².

Republika Çeke ka hartuar reforma në vijim të vendimit/aktgjykimit për çështjen *Hartman*, të datës 10 korrik 2003, në të cilën Gjykata Evropiane konkludoi se apelet në Gjykatën Kushtetuese, që u mundësonin individëve të kundërshtonin çdo vendim të formës së prerë të një organi tjetër, qoftë administrativ apo gjyqësor, nuk ishin efikase. Akti nr. 192/2003 i ka shtuar një dispozitë Aktit nr. 6/2002 mbi gjykatat dhe gjyqtarët, sipas të cilës, që prej 1 korrikut 2004, është e mundur të kërkohet një rrugëzgjdhje për kohëzgjatje të tepruara të proceseve gjyqësore, duke bërë një kërkesë që të vendoset një afat kohor për përfundimin e një faze të veçantë procedurale ose të një formaliteti. Kjo procedurë është e ngjashme me atë të Austrisë, të përshkruar më lart.

Në vendimi/aktgjykimin e çështjes *Vokurka kundër Republikës Çeke*, të datës 16 tetor 2007, Gjykata shqyrtoi efektivitetin e një rrugëzgjdhjeje të re 'parandaluese', dhe deklaroi se ajo ishte jo-efikase. Por nga ana tjetër, ajo e çmoi efikase një zgjidhje dëmshpërblyese që erdhi në fuqi në prill 2006, që lejonte zhdëmtim për dëm jo-material, rezultat i mos-respektimit të detyrimit për kohën e arsyeshme'¹⁴³.

Neni 21 i kushtetutës finlandeze, "Secili ka të drejtën që çështja e tij/e saj të trajtohet në mënyrën e duhur dhe pa vonesa të papërshtatshme nga një gjykatë ose autoritet tjetër ligjërish kompetent për ta bërë këtë, si dhe ka mundësinë që vendimi që lidhet me të drejtat apo detyrimet e tij/të saj të rishikohet nga një gjykatë apo organ tjetër i pavarur i administrimit të drejtësisë"

Kodi i procedurës penale parashikon gjithashtu një procedurë të veçantë përzgjedhjeje që synon reduktimin e kohëzgjatjes totale të procedurës në çështjet penale apo civile. Neni 6 § 3 i kodit penal u lejon gjykatave të reduktojnë dënimet nëse një kohë veçanërisht e gjatë ka kaluar që nga koha kur është kryer vepra penale dhe kur ndëshkimi normal do të kishte një efekt të paarsyeshëm ose veçanërisht të dëmshëm.

Që nga 26 korriku 2004 ai konsideroi se ligji Pinto përbën një rrugëzgjdhje efikase dhe se mund të aplikohet për qëllimet e nenit 35 § 1 të Konventës.

Përsa i përket Francës, neni L 141-1 i Kodit Gjyqësor (më parë L 781-1) parashikon që Shteti të mbajë përgjegjësi në rast neglizhence serioze apo mohimi të drejtësisë. Shkelja e detyrimit në lidhje me kohën e arsyeshme mund të sanksionohet dhe të paguhet dëmshpërblim. Në një vendim të 23 shkurt 2011 (Bull.Ass.Plén. nr.5 – Buletini i asistencës plenare nr. 5), Asambleja Plenare e Gjykatës së Kasacionit i zgjeroi kufijtë e neglizhencës së rëndë shtetërore, duke urdhëruar që një neglizhencë e tillë të përfshinte çdo lloj të metete të përbërë nga një fakt apo nga një sërë faktesh që reflektonin paaftësinë e gjyqësorit për të përmbushur detyrat që i caktoheshin. Pak më vonë Gjykata Evropiane specifikoi se një rrugëzgjdhje e tillë nuk mund të konsiderohej si rrugëzgjdhje efektive për t'u përdorur nga pala paditëse, sepse kriteri i 'i neglizhencës së rëndë' që kërkonte të provohej përgjegjësia ligjore e Shtetit, pengonte shpalljen e një përgjegjësie të tillë. (Vendimi/aktgjykimipër çështjen *Girard kundër Francës*, i datës 30 qershor 2011 § 54). Por, që nga vendimi i çështjes *Zannouti kundër Francës*, i datës 26 shtator 2000 dhe vendimeve/aktgjykimevetë përmendura më lart për çështjet *Giummarra kundër Francës* dhe *Mifsud*, Gjykata Evropiane e ka njohur efikasitetin e një vendimi të tillë. Kjo rrugëzgjdhje mund të përdoret tashmë nga gjithkush që ka dëshirë të ankohet për kohëzgjatjen e tepruar të një sërë procesesh gjyqësore; si rezultat, të gjitha kërkesat e dorëzuara mbi këtë bazë në GJEDNJ, që

¹⁴² Raporti Vjetor i Komitetit të Ministrave 2007, f. 79.

¹⁴³ Për më shumë detaje, shiko Raportin Vjetor të Komitetit të Ministrave, 2009, f. 121.

nga shtatori 1999, për të cilat rrugëzgjdhja vendase nuk është përdorur më parë, deklarohen si të papranueshme.

Në lidhje me gjykatat administrative, Gjykata Evropiane fillimisht konsideroi se nuk kishte jurisprudencë vendase që të tregonte efikasitetin e rrugëzgjdhjes (vendase) në lidhje me përgjegjësinë ligjore të Shtetit për funksionimin e mangët të gjykatave administrative, (vendimi *Lutz kundër Francës* i datës 25 mars 2002). Në përgjigje, Këshilli i Shtetit, në një vendim të datës 28 qershor 2002 (*Magiera*), u shpreh se pala paditëse mund të përfitonte dëmshpërblim në një gjykatë administrative për dëm të shkaktuar nga shkelja e së drejtës për seancë dëgjimore brenda një kohe të arsyeshme. Gjykata Evropiane e konsideron tashmë të mjaftueshme padinë korresponduese për të përcaktuar përgjegjësinë ligjore të Shtetit, (vendimi/aktgjykimi *Broca dhe Texier-Micault kundër Francës*, 21 tetor 2003). Kjo jurisprudencë plotësohet me Dekretin nr. 2005-911, të datës 28 korrik 2005 (neni R. 311-1-7 i Kodit të Drejtësisë Administrative), i cili njeh kompetencën e *Këshillit të Shtetit*¹⁴⁴ për të gjykuar në shkallë të parë dhe të fundit paditë për dëme kundër Shtetit për kohëzgjatje të tepruar të proceseve gjyqësore në gjykatat administrative. Përveç kësaj, Dekreti nr. 2005-1586 i datës 19 dhjetor 2005 parashikoi shqyrtim administrativ parandalues për gjykatat administrative me qëllim zgjidhjen e vonesave të tepruara të tyre. (Neni R. 112-2 dhe 3 i Kodit të Drejtësisë Administrative). Së fundmi Këshilli i Shtetit konsideron kohëzgjatje të tepruar e procesit gjyqësor në një çështje për të cilën koha e arsyeshme për ta dëgjuar çështjen prezumohet se shkakton dëm moral për se (vetiu) (KSH, 19 tetor 2007)¹⁴⁵

Dhe pikërisht, rreth pesë vjet pas pranimit të efikasitetit të padive për shkaktim dëmi në Francë, numri i rasteve të shpalljes së Francës fajtoresh për akuza të tilla është reduktuar konsiderueshëm, (shiko Shtojcën Nr.). Në Rezolutën CM/ResDH(2009)59 Komiteti i Ministrave ndërpreu shqyrtimin e ekzekutimit të shtatë gjykimeve për kohëzgjatje të tepruar të proceseve administrative kundër Francës për arsye se janë miratuar masat e përgjithshme të nevojshme për parandalimin e shkeljeve të tilla.

Në Poloni, ligji i 17 qershorit 2004 (i ndryshuar, me efekt nga 1 maji 2009), parashikon dy lloje rrugëzgjdhjesh 'parandaluese' (përsheptim) dhe dëmshpërbluese. Në lidhje me rrugëzgjdhjen e parë, njëra nga palët në proces mund të dorëzojë një ankesë për arsye se e drejta e tij për t'u dëgjuar brenda një kohe të arsyeshme është shkelur. Kriteret për të përcaktuar një kohëzgjatje të paarsyeshme të proceseve gjyqësore bazohen në jurisprudencën e Gjykatës së Strasburgut. Nëse ankesa ka arsye të shëndosha, gjykata përkatëse duhet të urdhërojë, brenda dy muajsh nga dorëzimi i ankesës në gjykatën kompetente ose në prokurori, që të merren masat e duhura brenda një kohe të caktuar. Nëse është fjala për dëmshpërblim, praktika e gjykatave në Poloni konfirmon se është e mundur të kërkohet zhdëmtim në para për dëme jo-materiale të shkaktuara nga kohëzgjatja e tepruar e procesit gjyqësor, në bazë të nenit 448 të Kodit Civil dhe gjithashtu të nenit 417. Gjykata Evropiane konstatoi se rrugëzgjdhje e dytë ishte efikase. (Vendimi/aktgjykimi për çështjen *Krasuski kundër Polonisë* i datës 14 qershor 2005, § 72).

Neni 24 i Kushtetutës së Spanjës u jep të gjithëve të drejtën për një gjyq/seancë gjyqësore të ndershme/të drejtë, pa vonesa të pajustificuara.

Recurso di amparo (padi për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore) në Gjykatën Kushtetuese i ofron palës paditëse dy rrugëzgjdhje për procese të zgjatura në mënyrë të paarsyeshme, në të cilat çështjet ende në gjykim vihen menjëherë në rrugë të mbarë, me një urdhër që të përfundojë periudha e inaktivitetit, ose duke e hedhur poshtë vendimin i cili po e zgjat në mënyrë të pa-justifikueshme procesin gjyqësor.

Nënndarja 292 ff e Aktit të Drejtësisë autorizon individët, sapo mbaron procesi gjyqësor, të dërgojnë një kërkesë tek Ministria e Drejtësisë për zhdëmtim për keqfunksionim të drejtësisë.

Sipas jurisprudencës përkatëse, (*Gonzalez Marín kundër Spanjës* (vend.) nr. 39521/98, ECHR 1999-VII), proceset gjyqësore me një kohëzgjatje të paarsyeshme tregojnë keqfunksionim të sistemit gjyqësor. Vendimi i ministrit mund të apelohe në gjykatat administrative. Gjykata ka urdhëruar gjithashtu, në vendimin/aktgjykimin e saj për pranueshmërinë, të datës 28 janar 2003 për çështjen *Caldas Ramirez de Arellano*, mbi efikasitetin e rrugëzgjdhjeve të parashikuara në Nënndarjet 292 ff të Aktit të Drejtësisë në lidhje me kohëzgjatjen e tepruar të proceseve gjyqësore në Gjykatën Kushtetuese.

¹⁴⁴ Këshilli i Shtetit kryen gjithashtu funksionin e Gjykatës së Lartë për drejtësinë administrative (shën i përkthyesit)

¹⁴⁵ Shiko gjithashtu Raportin Vjetor të Këshillit të Ministrave 2008, f.125.

Në Kroaci, këto dy lloj rrugëzgjdhjesh kombinohen për një grup procesesh gjyqësore: neni 63 § 3 i së Drejtës Kushtetuese parashikon një rrugëzgjdhje në Gjykatën Kushtetuese orientuar si për vendosjen e afateve për fazat procedurale ashtu edhe për përcaktimin e shumave të dëmshpërblimit për shkeljen. Gjykata Evropiane fillimisht konstatoi se kjo dispozitë e re parashikonte një rrugëzgjdhje efikase për kohëzgjatje të paarsyeshme të proceseve gjyqësore, (shiko vendimin/aktgjykimin për çështjen *Radoš dhe të tjerët kundër Kroacisë*, të datës 7 nëntor 2002 dhe vendimet/aktgjykimet për pranueshmërinë në çështjet e *Slaviček* të 4 korrik 2002, *Nogolica* të 5 shtator 2002, *Plaftak dhe të tjerët* të 3 tetor 2002, *Jeftić* të 3 tetor 2002 dhe *Sahini* të 11 tetor 2002.

Megjithatë, implementimi i kësaj rrugëzgjdhjeje ka krijuar vështirësi. Në disa raste edhe vetë procedura e ankimimit kushtetuesmori shumë kohë. Si pasojë, Gjykata e Strasburgut vendosi që efikasiteti i ankimimit kushtetues, si rrugëzgjdhje për zgjatjen e proceseve civile që ishin ende në gjykim, dëmtohej nga kohëzgjatja e tepruar, (vendimi/aktgjykimi i *Vidas kundër Kroacisë* i datës 3 korrik 2008, pika 37).¹⁴⁶

Kushtetuta e Republikës Sllovaqe (e ndryshuar, hyrë në fuqi në 1 janar 2002) parashikon dy lloje rrugëzgjdhjesh 'përsheptimi' dhe dëmshpërblimi në Gjykatën kushtetuese (neni 127 i Kushtetutës). Gjykata e ka konsideruar këtë rrugëzgjdhje efikase (shiko *Andrášik dhe të tjerët kundër Sllovakisë*, vendim i datës 22 tetor 2002, dhe *Mazurek kundër Sllovakisë*, vendim i datës 3 Mars 2009).

Megjithatë, Gjykata Evropiane, ka identifikuar të meta në zbatimin nga Gjykata Kushtetuese të nenit 127, si p.sh:

- Dëmshpërblim i pamjaftueshëm ose jo-ekzistent (p.sh. *Komanický kundër Sllovakisë* (Nr. 5), vendimi/aktgjykimi i 13 tetor 2009; *Báňas kundër Sllovakisë*, vendimi/aktgjykimi i 12 shkurt 2008; *Judt kundër Sllovakisë*, vendimi/aktgjykimi i 9 tetor 2007; dhe *Magura kundër Sllovakisë*, vendimi/aktgjykimi i 13 qershor 2006);
- Mos-marrja në konsideratë nga Gjykata Kushtetuese e totalit të kohës që u duhet gjykatave vendase për shqyrtuar çështjen (p.sh. *Keszeli kundër Sllovakisë*, vendimi/aktgjykimi i 13 tetor 2009; *Softel kundër Sllovakisë* (Nr. 2), vendimi/aktgjykimi i 16 dhjetor 2008; dhe *Jakub kundër Sllovakisë*, vendimi/aktgjykimi i 28 shkurt 2006).

Pavarësisht nga këto të meta, Gjykata e konfirmon efikasitetin në parim të ankimimit kushtetues, për shkak të dëmshpërblimit të mjaftueshëm të akorduar nga Gjykata Kushtetuese, (p.sh. *Bartl kundër Sllovakisë*, vendimi/aktgjykimi i 6 tetor 2009; *Becová kundër Sllovakisë*, vendimi/aktgjykimi i 18 shtator 2007; *Cervanová kundër Sllovakisë*, vendimi/aktgjykimi i datës 9 janar 2006, *Machunka kundër Sllovakisë*, vendimi/aktgjykimi i 27 qershor 2006; dhe *Končecová*, vendimi/aktgjykimi i 9 maj 2006)¹⁴⁷.

Neni 39 i Kushtetutës së Maltës vendos të drejtën për seancë dëgjimore brenda një kohe të arsyeshme. Palët ndërgjyqëse që gjykojnë se e drejta e tyre për t'u dëgjuar brenda një kohe të arsyeshme është shkelur, mund të dorëzojnë njëkërkesë për apel tek Gjykata Civile që ka kompetencë kushtetuese, vendimi i së cilës është i apelueshëm në Gjykatën Kushtetuese. Ky apel mbulon proceset civile, administrative dhe penale. Gjykata e Strasburgut u shpreh se ky apel është përgjithësisht efikas, megjithëse në disa raste niveli i dëmshpërblimit të akorduar u vlerësua i pamjaftueshëm, (vendimet/aktgjykimet për çështjet *Zarb kundër Maltës*, të datës 4 korrik 2006, dhe *Korporata e Zhvillimit të Mesdheut Qendror kundër Maltës*, të datës 24 tetor 2006).

Në Slloveni, ligji i viti 2006 për mbrojtjen e të drejtës për seancë dëgjimore brenda një kohe të arsyeshme, (që erdhi në fuqi në 1 janar 2007)¹⁴⁸, u lejon palëve ndërgjyqëse të kërkojnë një rrugëzgjdhje dëmshpërblyese vetëm pasi t'i kenë përdorur të gjitha rrugëzgjdhjet për 'përsheptim'. Gjykata vërejt se ky mekanizëm kishte qëllimin legjitim të thjeshtonte procedurën dhe konsideronte se kjo rrugëzgjdhje sllovene dukej, në parim, të

¹⁴⁶ Re. Zhvillimi i jurisprudencës së Gjykatës për situatën në Kroaci, cf. Udhërrëfytes i Praktikës së Mirë, nr. 60-62, f. 14 dhe 15.

¹⁴⁷ Shiko Udhërrëfytesin e Praktikës së Mirë, nr. 93-96, f. 22 dhe 23, Për një vlerësim të përgjithshëm të mbikëqyrjes së ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut nga Sllovakia; shiko Raportin Vjetor 2010 të Komitetit të Ministrave, f. 142 dhe 143.

¹⁴⁸ Raporti Vjetor i Komitetit të Ministrave 2007, f. 94.

ishite efikase. (*Zunic kundër Sllovenisë*, vendimi/aktgjykimi i datës 18 tetor 2007, §§ 49, 50 dhe 54).

Në Bullgari, në rastet kur një Gjykatë nuk arrin të plotësojë një fazë procedurale brenda një kohe të arsyeshme, neni 255 i Kodit Civil të Bullgarisë i vitit 2006 u lejon palëve, në cilëndo fazë të procesit gjyqësor, të dorëzojnë një kërkesë për vendosjen e afatevetë përshtatshme kohore për përfundimin e kësaj faze. Neni 257 kërkon që gjykata e shkallës më të lartë të marrë në shqyrtim këtë kërkesë brenda një jave që nga marrja e saj, dhe, nëse e gjykon afatin ligjor të paarsyeshëm, të vendosë një afat kohor për implementimin e kësaj faze procedurale. Gjykata e Strasburgut e ka gjykuar këtë rrugëzgjdhje efikase në parim, megjithëse ajo duhet të kombinohet me një rrugëzgjdhje dëmshpërblyese, (vendimi/aktgjykimi *Jeliazkov dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, 3 prill 2008).

Në Gjermani e drejta për t'u gjykuar ose për të dëgjuar çështjen brenda një kohe të arsyeshme garantohet me Ligjin Bazë, dhe ankesat për shkelje të kësaj të drejte mund të dorëzohen në Gjykatën Kushtetuese Federale, e cila është e vetmja që ka kompetencën t'i kërkojë Gjykatës në fjalë ta përshpejtojë ose ta përfundojë procesin gjyqësor. Gjykata Kushtetuese Federale nuk ka kompetencën që të imponojë afate kohore mbi gjykatat më të ulëta ose të urdhërojnë masa të tjera për të përshpejtuar procedurat, dhe nuk ka as aftësinë të akordojë dëmshpërblim.

Një projekt-ligj për të futur në përdorim një rrugëzgjdhje të re kundër mosveprimit u vu për diskutim përpara zgjedhjeve parlamentare të 18 shtator 2005. Sipas qeverisë, kjo do të bënte të mundur reduktimin e ngarkesës me çështje në Gjykatën Kushtetuese Federale, meqenëse, paskëta, ankesa do të dorëzohej në gjykatën që merrej me çështjen, ose, nëse gjykata refuzonte të merrte masa për të përshpejtuar procesin gjyqësor, ankesa do të dorëzohej në një gjykatë apeli.

Gjykata Evropiane u shpreh se "Qeveria, duke zgjedhur një rrugëzgjdhje parandaluese, e ka bërë këtë në përputhje me frymën e sistemit të mbrojtjes të krijuar nga Konventa, meqenëse rrugëzgjdhja e re do të trajtojë shkakun bazë të problemit të kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore dhe duket se ka më shumë gjasa t'i ofrojë palëve ndërgjyqëse mbrojtjen e duhur në krahasim me rrugëzgjdhjet dëmshpërblyese, që mundësojnë vetëm veprimet që ndërmerren *a posteriori*¹⁴⁹.

Për më tepër, Gjykata Federale e Drejtësisë në Gjermani e ndryshoi jurisprudencën në një vendim të datës 17 janar 2008, që akordonte kompensim për kohëzgjatje të tepruar të procesit gjyqësor në çështjet me dënim të përjetshëm, duke mundësuar që një pjesë specifike e dënimit të konsiderohej se ishte kryer, (një koncept i njohur si *Vollstreckungslösung*, ose "zgjidhje në lidhje me ekzekutimin e vendimit"). Gjykata Evropiane e përshëndeti këtë anulim të precedentëve (vendimeve të mëparshme), edhe pse pala paditëse në fjalë nuk i plotësonte kushtet për këtë, sepse kjo kish ndodhur pas dënimit të tyre, (vendimi/aktgjykimi *Kaemena dhe Thöneböhn kundër Gjermanisë*, 22 prill 2009).

III. Puna kërkimore në lidhje me kohën e arsyeshme

Nga leximi dhe analiza e detajuar e një shumice vendimesh të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe të rezolutave të Komitetit të Ministrave, evidentohen tendencat e mëposhtme.

A. Tendencat kryesore të Gjykatës Evropiane në lidhje me kohën e arsyeshme:

Fazat procedurale që gjykohet se përputhen me kërkesën e kohës së arsyeshme zakonisht zgjasin **më pak se 2 vjet**.

Kur kjo periudhë është më e gjatë se 2 vjet, por nuk kritikohet nga Gjykata Evropiane, pothuaj gjithmonë është sjellja e palës paditëse që është shkak për këtë, dhe vonesa të paktën pjesërisht është shkaktuar nga pasiviteti i tyre ose nga qëllimet e këqija të tyre¹⁵⁰.

Në rastin e 23 çështjeve të ndërlikuara ku ishte vendosur se nuk ishte shkelur asnjë e drejtë, është e habitshme të vëresh se në dymbëdhjetë çështje – më shumë se gjysma – **sjellja e palës paditëse është kritikuar nga**

¹⁴⁹ Vendimi i Dhomës së Madhe për çështjen *Surmeli kundër Gjermanisë*, 8 qershor 2006, § 138.

¹⁵⁰ Vendimi i përmendur më lart i *Dosta kundër Republikës Çeke*, i datës 25 maj 2004: një vendim interesant në këtë drejtim, sepse tetë grupe procedurash civile ishin dorëzuar nga e njëjta palë paditëse në çështje të thjeshta të shqyrtuara nga GJEDNJ.

Gjykata sepse ka kontribuar në vonesë. Vendimi i Gjykatës se nuk ka pasur shkelje shpjegohet nga sjellja e papërshtatshme e palës paditëse.

Për shembull, në çështjen e *Özsoy kundër Turqisë*, vendimi/aktgjykimi i muajit shkurt 2006, për të cilën procesi gjyqësor kishte zgjatur gjashtë vjet, dhe ku përfshiheshin 33 të paditur, të akuzuar për ndihmë ndaj PKK dhe/ose sulm ndaj shtetit, Gjykata vërejt se *nuk kishte ndonjë periudhë të rëndësishme pasivitetit shkaktuar nga autoritetet vendase. Nga ana tjetër, Gjykata vëren se për rreth shtatë muaj pala paditëse nuk u paraqit në seancat gjyqësore në Gjykatën e Sigurisë së Shtetit, gjë që sigurisht nuk i lehtësoi gjërat për gjykatat ku bëhej gjyqi në lidhje me dëgjimin e palës paditëse . {...}. Gjykata konkludoi se kohëzgjatja e proceseve gjyqësore në çështjen në fjalë, të cilat u kryen në dy gjykatat ndryshme, megjithëse e kontestueshme, nuk ishte tepër e gjatë.” (§§ 2-4).*

Po kështu, në çështjen *Ancel kundër Turqisë*, vendimi/aktgjykimi i datës 17 shkurt 2009, Gjykata vëren se *disa nga vonesat në procesin gjyqësor janë për shkak të palës paditëse , veçanërisht ato që rezultojnë për shkak të mosparaqitjes së saj në seancat gjyqësore, gjë që bëri që kërkesë padia e saj të hiqej dy herë nga lista; dhe mosparaqitja e saj {në një seancë dëgjimore} rezultoi në një shtyrje të seancës, dhe këto iu shtuan vonesës të pashpjeguar në ekzekutimin e vendimeve në favor të saj (§ 44).*

Edhe nëse pala paditëse nuk vepron me korrektesën e duhur, Gjykata merr gjithnjë në konsideratë mënyrën se si kanë reaguar gjykatat: nëse gjykatat nuk gjenden në gabim në lidhje me ndonjë mosveprim të veçantë, dhe nëse çështja përfshin procese gjyqësore në të cilat palët mbajnë përgjegjësi për zhvillimin e procesit, palëve do t’u lihet plotësisht faji për vonesat e shkaktuara për shkak të gabimeve të tyre dhe të kërkesave të papërshtatshme, dhe gjykata do të vendosë se nuk ka pasur shkelje, edhe pse, në terma objektive, kohëzgjatja e proceseve gjyqësore duket e tepruar.

Për proceset gjyqësore që zgjasin më shumë se dy vjet, GJEDNJ shqyrton çështjen në detaj, për të kontrolluar korrektesën e autoriteteve kombëtare, dhe të palëve, në lidhje me kompleksitetin e çështjes; për procese më të shkurtra se dy vjet, Gjykata nuk e bën këtë shqyrtim të detajuar.

Në çështjen *Nikola Nikolov kundër Bullgarisë*, vendimi/aktgjykimi i datës 14 qershor 2007, për shembull, Gjykata vërejt një numër ndërlikimesh, ku përfshihej mungesa e dëshmitarëve okularë për faktet, që nxitën autoritetet vendase të kërkonin një sërë opinionesh nga ekspertët, (§ 9); ajo konkludoi se, *duke marrë në konsideratë të gjitha rrethanat e çështjes, veçanërisht kohëzgjatjen e përgjithshme dhe kompleksitetin e procedimeve, si dhe faktin që çështja u shqyrtua në tre nivele të ndryshme, Gjykata çmon se vonesat që janë shkaktuar nga autoritetet nuk janë të tilla që të bëjnë të mendosh se gjatësia e procesit ishte e tepruar (§14).*

Po kështu, në vendimin për çështjen *Veriter kundër Francës*, të datës 4 tetor 2010, Gjykata nuk e konsideron të tepruar kohëzgjatjen e procesit gjyqësor për shkak të kompleksitetit ligjor të çështjes, që ngriti çështjen madhore të interpretimit të ligjit të BE.

Po kështu, në vendimin për çështjen *Tan dhe të tjerët kundër Turqisë*, të datës 20 qershor 2006, Gjykata u mbështet në kompleksitetin e llojit të veprës penale në shqyrtim *për të konkluduar se karakteristika kryesore e çështjes ishte kompleksiteti i madh i saj. Dyshimet ndaj palës paditësekishin të bënin me krimet e ‘jakave të bardha’, pra mashtrim në shkallë të gjerë, ku ishin përfshirë një numër shoqërisht. Kjo lloj vepre penale kryhet zakonisht, siç ndodh me çështjen në gjykim, nëpërmjet transaksioneve komplekse qëllimshëm të mbikëqyrjes së organeve hetuese (§ 40).*

Ajo që rrezikohet për palën paditëse në mosmarrëveshje është kriter kryesor për vlerësim, dhe mund të nxisë Gjykatën Evropiane ta rishikojë praktikën normale të saj që konsideronte një periudhë më pak se 2 vjet si të pranueshme për çdo nivel gjykatë¹⁵¹.

Mund të jetë gjithashtu një arsye që gjykata t’i japë përparësi kësaj lloji çështjeje në planin kalendarik të

¹⁵¹ *Le Bechennec kundër Francës*, vendimi i datës 28 mars 2006.

seancave gjyqësore¹⁵². Për shkak të numrit të çështjeve të mbartura nëpër gjykata, Gjykata Evropiane kërkon të pajtojë shqetësimin në lidhje me kohën e arsyeshme me atë të ushtrimit siç duhet të drejtësisë; si rezultat, kur shqyrtohet mënyra se si do të trajtohen çështjet ende në gjykim, ajo i fton gjykatat që kanë çështje të mbartura që t'i caktojnë çështjet për shqyrtim sipas rëndësisë dhe jo më sipas parimit 'kush mbërrin i pari, shërbehet i pari'; kjo nënkupton që të merret parasysh çfarë rrezikon pala paditëse në mosmarrëveshje¹⁵³. Dhënia e përparësisë për disa kategori çështjesh është provuar me sukses në gjykatat e vendeve të Evropës veriore¹⁵⁴.

Për çështjet e ndërlikuara, Gjykata, duke mbajtur parasysh kompleksitetin e çështjes, fokusohet vetëm në kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore që janë dukshëm të tepruara dhe kërkon shpjegime të sakta në lidhje me këto kohëzgjatje 'jo-normale', në rastet kur vendimi është se nuk ka pasur shkelje¹⁵⁵. Por, në çështjet e thjeshta, kjo kërkesë është dukshëm më pak e rreptë.

B. Disa shembuj mbi "kohën e arsyeshme":

1. Çështje civile të thjeshta:

Për çështjet e thjeshta që kanë të bëjnë me një mosmarrëveshje mbi bashkëpronësinë, një kohëzgjatje totale prej 5 vjet dhe 3 muaj për të tre shkallët e gjykatave, e ndarë si më poshtë:

- 1 vit dhe 10 muaj për shkallën e parë

- 1 vit dhe 8 muaj në apel

- 1 vit dhe 9 muaj për kasacionin, gjykohet të jetë e arsyeshme (vendimi/aktgjykimi për çështjen *Martin Lemoine kundër Francës*, 29 prill 2003).

Për mosmarrëveshje për çështjet që lidhen me punën: klasifikuar nga Gjykata Evropiane si çështje që ka përparësi.

Çështja gjykohet brenda një kohe të arsyeshme, nëse është trajtuar:

- Në shkallën e parë për 1 vit dhe 7 muaj;

- Në apel për 1 vit dhe 9 muaj;

- Në kasacion për 1 vit dhe 9 muaj, (vendimi/aktgjykimi për çështjen *Guichon kundër Francës*, i datës 21 mars 2000).

Sjellja e palëve në këtë çështje ishte pika kryesore e kritikës nga Gjykata, e cila vuri theksin mbi vonesat si në kërkesën e palës paditëse për referim në gjykatën për marrëdhëniet industriale, edhe në apelin e saj, dhe po ashtu vonesa në dërgimin e konkluzioneve të palëve në Gjykatën e Kasacionit. **Pasi zbriten vonesat për shkak të palëve, mbetet: 1 vit dhe një muaj përpara gjykatës për marrëdhëniet industriale dhe njëmbëdhjetë muaj përpara Gjykatës së Kasacionit.**

¹⁵²Shiko në lidhje me këtë Programin kuadër të CEPEJ "Një objektivi i ri për sistemet gjyqësore: trajtimi i çdo çështjeje brenda një afati optimal e të parashikueshëm", i datës 11 qershor 2004, Linja e veprimit 10 "përcaktimi i prioritetëve në menaxhimin e çështjeve", f.15.

¹⁵³Vendimi për çështjen *Union Alimentaria Sanders SA kundër Spanjës*, i datës 7 korrik 1989.

¹⁵⁴Shiko raportin e CEPEJ "Menaxhimi i kohës në disa procese gjyqësore: një studim për Evropën Veriore" (CEPEJ(2006)14).

¹⁵⁵Gjyqtari hetues përfundoi hetimin gjyqësor paraprak [...] katër vjet dhe shtatë muaj pasi pala paditëse u mor për herë të parë në pyetje si e dyshuar. Kjo duket të jetë një periudhë jashtëzakonisht e gjatë kohe [...]. Në rrethana të tilla, është veçanërisht e nevojshme që kjo kohë kaq e gjatë të justifikohet në mënyrë bindëse." (§ 51). Hoyee kundër Holandës, vendimi i datës 22 maj 1998 (nuk ka shkelje në këtë çështje të ndërlikuar penale).

Për një çështje tjetër që përfshin një mosmarrëveshje për çështjet që lidhen me punën, të gjykuar për 6 vjet dhe 3 muaj, në katër shkallë gjykatash, (gjykata (tribunali) për çështjet e punës, gjykata e apelit për çështjet e punës, gjykata e lartë dhe gjykata kushtetuese), Gjykata çmoi se kohëzgjatjet e mëposhtme ishin të arsyeshme:

- 1 vit dhe 6 muaj përpara gjyqtarit të shkallës së parë, me seancadëgjimore të rregullta.
- 4 muaj në kasacion.
- Apeli zgjati një vit dhe nëntë muaj.

Por gjykata konsideroi se vonesa prej katër muaj përpara gjyqtarëve të shkallës së parë ishte për shkak të palës paditëse, si rezultat i mungesës së tyre të pajustificuar në një seancë dëgjimore, (*Antolic kundër Sllovenisë*, vendimi/aktgjykimi i datës 1 qershor 2006).

Dhe ndërsa një çështje tjetër e ngjashme për probleme të punës u gjykua më shpejt në shkallë të parë (5 muaj), dhe në apel (1 vit dhe 5 muaj), Gjykata e toleroi kohëzgjatjen më të madhe, (prej 2 vitesh dhe 2 muajsh) përpara gjykatës së kasacionit, (edhe pse e konsideroi periudhën disi të gjatë): **vlerësimi i saj i përgjithshëm i çështjes mbetet pozitiv**, (vendimi për çështjen *Gergouilkundër Francës*, i datës 21 mars 2000).

Për rishikim të një vendimi që anulon një adoptim:

Procesi gjyqësor i kundërshtuar zgjati gjithsej pesë vjet dhe dy muaj, duke përfshirë dy nivele gjyqësore. Shumica e kësaj vonese është ekskluzivisht për shkak të palës paditëse, (vendimi/aktgjykimi për çështjen *Bican kundër Rumanisë*, i datës 22 shtator 2009).

2. Çështje penaletë thjeshta

Për një vepër penale të mashtrimit bankar: një kohëzgjatje totale prej 3 vjetësh dhe 6 muajsh për të 3 shkallët e gjyqimit, të ndara si më poshtë:

- 6 muaj hetim
- 1 vit dhe 2 muaj në shkallën e parë
- 11 muaj në apel
- 1 vit dhe 5 muaj në kasacionu **gjykua e arsyeshme** (vendimi/aktgjykimi për çështjen *Kuibichev kundër Bullgarisë*, 30 shtator 2004).

Për veprat penale që përfshijnë demonstrata të paligjshme dhe përdorim eksplozivash që shkaktojnë vdekjen: një kohëzgjatje totale prej 5 vjetësh dhe 11 muajsh për 4 shkallë gjyqimi, të ndara si më poshtë:

- 1 vit dhe 8 muaj përpara Gjykatës së Shtetit për Sigurinë
- 1 vit dhe 7 muaj përpara Gjykatës së Kasacionit
- 1 vit dhe 2 muaj përpara Gjykatës për Sigurinë që vendosi për referimin në një gjykatë më të lartë
- 11 muaj përpara se Gjykata e kasacionit, **u gjykua e arsyeshme** (vendimi/aktgjykimi i *Soner Önder kundër Turqisë*, i datës 12 korrik 2005)

Për një çështje përdhunimi nga një oficer policie gjatë ushtrimit të funksionit të tij:

Procesi gjyqësor zgjatirreth pesë vjet e pesë muaj në dy shkallë të ndryshme gjykimi, kohë gjatë së cilës u dorëzuan katër kërkesa. Procesi gjyqësor u bë në dy faza, një fazë administrative dhe një fazë penale, gjatë së cilës çështja e palës paditëse u shqyrtua dy herë nga Gjykata Penale e Izmirit dhe dy herë nga Gjykata e kasacionit. Procesi filloi më 25 maj 1997, kur pala paditëse u ridërgua në paraburgim, (pra çështja u shty, dhe përfundoi në 16 tetor 2002, kur Gjykata e kasacionit konfirmoi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, (vendimi për çështjen *Yeniay kundër Turqisë*, 26 qershor 2007).

3. Çështjet e ndërlikuara

Për një çështje penale që ka të bëjë me mashtrim dhe konspiracion: një kohëzgjatje totale prej 8 vjetësh dhe 5 muajsh, që ndahen si më poshtë:

- Hetimi përgatitor prej 4 vjetësh dhe 7 muaj: kohëzgjatja u justifikua nga numri i dëshmitarëve që duhen marrë në pyetje dhe dokumenteve që duhen shqyrtuar.
- Gjykiminë tre shkallë të ndryshme gjykatash, që zgjati 3 vjet dhe 10 muaj, (vendimi/aktgjykimi për çështjen *Hozee kundër Holandës*, i datës 22 maj 1998), **u konsiderua i arsyeshëm.**

Për një çështje penale, që ka të bëjë me vrasje nga neglizhenca: procedurat që zgjatën 6 vjet dhe 3 muaj për të katër shkallët e gjykimin nuk mund të konsideroheshin të paarsyeshme, (vendimi/aktgjykimi për çështjen *Calvelli dhe Ciglio kundër Italisë*, i datës 17 janar 2002).

Për një çështje për vrasje në tentativë: procedurat zgjatën pak më shumë se 7 vjet dhe 9 muaj, në 5 shkallë të ndryshme gjykimi, megjithëse kohëzgjatja nuk ishte e paarsyeshme. Gjykata vërejti kompleksitetin e çështjes, në lidhje me faktet në fjalë dhe sjelljen e palës së akuzuar, që vazhdimisht kundërshtonte veten, (vendimi/aktgjykimi për çështjen *Pecheur kundër Luksemburgut*, i datës 11 dhjetor 2007).

Në çështjet komplekse, ku konstatohet një shkelje, nga dyzet e një çështjet që u gjykuan nga viti 1987 gjer në vitin 2004, dhe që përshkruhen në shtojcën 3, duhet bërë dallimi midis çështjeve penale dhe çështjeve të tjera¹⁵⁶.

Në lidhje me nëntëmbëdhjetë procedurat penale:

- Kohëzgjatja për secilën ishte më shumë se 5 vjet për një ose dy shkallë gjykimi, me një përjashtim: 2 vjet për një shkallë gjykimi.
- Gjashtë çështje ishin ende në gjykim në datën kur u bë gjykimi në GJEDNJ.
- Për shtatë çështje u kritikua faza e hetimit.
- Në katër çështje, Gjykata kritikoi intervalet e tejzgjatura midis seancave gjyqësore përpara gjykatës ku u bë gjykimi, ose midis gjykimin të shkallës së parë dhe seancës së parë në apel.

Në lidhje me njëmbëdhjetë proceset civile:

¹⁵⁶ Çështjet e tjera ishin procedura të gjykatave të zakonshme ose gjykatave administrative, si dhe një procedurë përpara Gjykatës Kushtetuese.

- Kohëzgjatjet që shkonin nga 2 vjet në 3 muaj për çështjet që zgjatën më pak, dhe 19 vjet për çështjen më të gjatë.
- Në pesë raste diçka rrezikohej për palën kërkuese (paditësin), duke kërkuar kështu korrektesë të veçantë nga ana e Gjykatës Evropiane.
- Në çështjet më të shkurtra, ka një detyrim për korrektesë të veçantë, që lidhet me çfarë rrezikohet për palën kërkuese/paditëse në mosmarrëveshje.

Në çështjet komplekse, ku nuk konstatohet shkelje, nga njëzet e tre çështje të shqyrtuara, rezultojnë:

- 16 procedura penale
- 6 procedura civile
- 1 procedurë administrative.

Në këto mosmarrëveshje, bën përshtypje fakti se, **në dymbëdhjetë çështje – më shumë se gjysma – sjellja e palës paditëse është kritikuar nga Gjykata** se ka kontribuar në vonesë.

Në çështjet penale, kohëzgjatja më e madhe është 8 vjet dhe 8 muaj për tre shkallë gjykimi, për një çështje franceze që ka të bëjë me trafikim droge, (vendimi/aktgjykimi për çështjen *Van Pelt kundër Francës* i datës 23 Maj 2000): Gjykata vërejt se në 3 vjetët e procedimeve përpara gjyqtarit hetueskishte pasur shkëputjepër shkak të masave hetimore të shumta, dhe se gjykatat i kishin marrë vendimet me shpejtësi. Sjellja e palës kërkuese (paditëse) nuk u kritikua. Për çështjet civile, kohëzgjatja më e madhe ishte 6 vjet për një çështje të prapambetur (ende në gjykim): Gjykata konstatoi se palës paditëse kishte dorëzuar padi të njëpasnjëshme, disa prej të cilave kishin rezultuar të kota dhe e kishin komplikuar edhe më keq çështjen, që edhe pa këtë konsiderohej një çështje ‘shumë komplekse’. Nga ana tjetër, asnjë periudhe pasiviteti (inaktiviteti) nuk ishte shkaktuar nga autoritetet.

KONKLUZION:

Në "studimin e saj për çështjet e shqyrtuara në 2004", Gjykata vërejt se “siç ndodhi në vitet e mëparshme, një përqindje e madhe e vendimeve/aktgjykimeve të dhëna nga Gjykata kishte të bënte ekskluzivisht ose kryesisht me kohëzgjatjen e tepruar të proceseve gjyqësore. Numri i këtyre vendimeve/aktgjykimeve ishte praktikisht identik me atë të viteve të mëparshme, (me një rritje nga 235 në 248), dhe e tillë ishte edhe shifra që tregonte përqindjen për të gjitha vendimet (rritje nga 33.43% në 34.49%)”.

Kjo gjetje është përsëritur që atëherë në të gjitha raportet vjetore të Gjykatës, me një pohim pothuaj ritual që mos-përputhja me të drejtën për t’u dëgjuar brenda një afati të arsyeshëm ishte një nga shkaqet kryesore të shkeljes së Konventës.

Z. Luzius Wildhaber, Kryetar i Gjykatës Evropiane që pas reformës së vitit 1998, në fjalën e tij me rastin e përvjetorit të pesëdhjetë të Konventës, i përshkroi sfidat me të cilat përballej makineria evropiane e mbrojtjes të së drejtave të njeriut. Në vitet e ardhshme, i tha ai audiencës, sukcesi i sistemit të Konventës do të gjykohej në bazë të tre kritereve: kohëzgjatjes së procedurave në Gjykatë, standartit të vendimeve dhe efektivitetit me të cilin këto vendime janë ekzekutuar. Ai u bëri thirrje shteteve kontraktore që t’i jepnin sistemit mbështetjen e tyre të plotë, gjë që ishte thelbësore për suksesin e makinerisë së Konventës.

Kohëzgjatja e procesit gjyqësor mbetet një shqetësim madhor, jo vetëm për gjykatat vendase kudo qofshin, por edhe, dhe mbi të gjitha, për Gjykatën Evropiane.

Në 2006, prej 1560 vendimeve që konstatuan shkelje të Konventës, 567 rezultuan të kishin një kohëzgjatje të tepruar të procesit¹⁵⁷. Në 2007, kishte 384 vendime të tilla nga 1503¹⁵⁸; në 2008 kishte 456 nga 1543¹⁵⁹; në 2009 kishte 449 nga 1645¹⁶⁰, dhe në 2010 kishte 461 nga 1499¹⁶¹. Kjo tregon se numri i konkluzioneve të pafavorshme ka ngelur relativisht i pandryshueshëm - i barazvlefshëm me një të katërtën e këtyre konkluzioneve.

Aktgjykimet dhe vendimet e Gjykatës tregojnë se del qartë nevoja e “kulturës së shpejtësisë apo dinamizmit”, që nuk është domosdoshmërisht sinonim i nxitimit, por nënkupton mbi të gjitha përkushtim për menaxhimin si duhet të kohës gjyqësore.

Që të arrihet kjo duhet të mobilizohen të gjitha palët në gjykim, e para së gjithash gjykatat, dhe brenda tyre magjistratët, nëpunësit/sekretarët dhe stafi administrativ. Teknologjia e informacionit ofron mjete të reja interesante për të lehtësuar monitorimin e proceseve dhe për të mundësuar një identifikim më të mirë të vonesave. Janë bërë propozime për mobilizimin e palëve të ndryshme¹⁶².

Duhet të mobilizohen të gjithë ata që përfshihen në proces, duke filluar nga gjykatat, ku përfshihen gjyqtarët, arkivistët, dhe stafi administrativ. Por arritja e këtij objekti kërkon gjithashtu përfshirjen e profesionëve të tjera ligjore, si p.sh.avokatët, noterët, përmbaruesit dhe ekspertët e caktuar nga gjykata, sepse të gjithë kontribuojnë sipas sferave të tyre respektive.

Gjykatat funksionojnë gjithashtu në bashkëpunim me një numër gjithnjë në rritje institucionesh të tjera. “Korrektesa” e nevojshme duhet të mbahet parasysh nga të gjitha institucionet kombëtare dhe zyrtarët që punojnë në këto institucione dhe që kanë përgjegjësinë si për hartimin e deklaratave të mbrojtjes në emër të qeverive, ashtu edhe për t’iu përgjigjur kërkesave për zgjidhjet e mosmarrëveshjeve jashtë gjykatës (me pajtim).Organe të tjera publiketë decentralizuara ose të deleguara duhet ta mbajnë këtë parasysh, kur bëhen pjesë e proceseve që kanë të bëjnë, për shembull, mekujdestarinë ose Shërbimet e Përkujdesjes Sociale, ose kur konsultohen nga gjykatat gjatë proceseve gjyqësore që lidhen me shërbimet sociale ose çështjet e sigurimeve shoqërore.

Së fundmi, duhet t’i kushtojmë vëmendje qytetarit të thjeshtë, kur ata janë palë në proces. Në rastet kur sjellja e tyre mospërfillëse nuk është me qëllim të keq, ajo zakonisht është për shkak të mungesës së informacionit mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre. Një informacion i tillë duhet të jepet me kujdes, dhe reagimi për sjelljen e plogësht (vonesat) duhet të jetë me urdhra gjykate dhe ndëshkime, në përputhje me ligjin, siç ka theksuar vazhdimisht Gjykata.

Nëse ky shqetësim në lidhje me informimin e publikut është shkruar në rregullat për funksionimin e gjykatës, sjelljet që sjellin vonesa, dhe që shkaktojnë zgjatjen e proceseve dhe nxisin mungesën e ndershmërisë, do të jenë më lehtë për t’u sanksionuar, siç rekomandohet nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Bibliografi e përzgjedhur

¹⁵⁷ Raporti vjetor 2006, f. 107 dhe 108; gjendet në faqen e internetit të Gjykatës <http://www.echr.coe.int/echr>

¹⁵⁸ Raporti vjetor 2007, f. 144 dhe 145.

¹⁵⁹ Raporti vjetor 2008, f. 134 dhe 135.

¹⁶⁰ Raportivjetor 2009, f 146 dhe 147.

¹⁶¹ Raporti vjetor 2010, f 149-151

¹⁶² Një nga aplikimet e përzgjedhura për çmimin e Peshores së Kristaltë të drejtësisë në 2006 synonte të reduktonte kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore: Gjykata e Shkallës së Parë të Torinos (Itali), “Programi Strasburg”, eksperiencia e parë e menaxhimit të çështjeve në Itali për të luftuar stokun e çështjeve të mbartura dhe për të përshpejtuar zhvillimin e proceseve gjyqësore.

Libra:

V. Berger, *Jurisprudence de la Cour européenne des Droits de l'Homme*, Ed. Dalloz-Sirey, Paris, 2009, 880 f.

F. Sudre, J-P Marguénaud, J. Andriantsimbazovina, A. Gouttenoire, M. Levinet, *Les grands arrêts de la Cour européenne des Droits de l'Homme*, Ed. Thémis, Puf Droit, 2009, 854 f.

F. Sudre, *La dimension internationale et européenne des libertés et droits fondamentaux*, nê: *Libertés et droits fondamentaux*, Ed. Dalloz, 2006, f. 389 ff.

S. Guinchard, « *Procès équitable* », Répertoire Procédure civile, Dalloz, mars 2011.

N. Fricero, « *Garanties de nature procédurale : équité, publicité, célérité et laïcité* », nê *Droit et pratique de la procédure civile*, Dalloz action, 2009-2010.

J. Fr. Flauss, « *Les cours constitutionnelles et la règle du délai raisonnable : le contrôle de la Cour EDH* », *Mélanges L. Favoreu*, Dalloz, 2007.

Raportet vjetore të Gjykatës për të Drejtat e Njeriut: gjendet në faqen e internetit të Gjykatës <http://www.echr.coe.int/echr>.

Raportet Vjetore të Komitetit të Ministrave mbi Mbikëqyrjen e Ekzekutimit të vendimeve/aktgjytimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut: gjendet në faqen e internetit të Këshillit të Evropës:

http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/execution/Documents/Publications_en.asp

G. Cohen-Jonathan, J.-F. Flauss dhe E. Lambert Abdelgawad (dir.), *De l'effectivité des recours internes dans l'application de la Convention européenne des droits de l'homme*, Droit et justice 69, Bruylant, 2006.

Gazeta:

Le délai raisonnable, nê: *Revue Trimestrielle des Droits de l'Homme*, n° 5, Janar 1991,

R. Bindels, L'influence du droit d'être jugé dans un délai raisonnable prévu par l'article 6§1 de la Convention européenne des Droits de l'Homme sur l'administration de la justice civile belge nê: *Annales de droit de Louvain (Bruxelles)*, Vol 62, 2002, f. 349-428

F. Gölcükü: Délai raisonnable et le procès équitable dans la Convention européenne des Droits de l'Homme , nê: *Mainly Human Rights*, Dir. Salvino Busuttil, 1999.

E. Lambert Abdelgawad, « *L'exécution des arrêts de la Cour européenne des droits de l'homme* », kronikë vjetore, nê *Revue trimestrielle des droits de l'homme*.

Shtojca 1 – e përditësuar

Shkeljet në lidhje me "kohëzgjatjen e procesit" (neni 6 § 1) për shtet (*)

| | 2006 | | | 2007 | | | 2008 | | | 2009 | | | 2010 | | | |
|---|-----------------------------------|--------------------------------------|----------------------|-------------------------|--------------------------------------|----------------------|-------------------------|--------------------------------------|----------------------|-------------------------|--------------------------------------|----------------------|-------------------------|--------------------------------------|----------------------|-------------------------|
| | Popullsia (në milion banorë) (**) | Numri total i vendimeve/aktgjykimëve | Nga të cilat shkelje | Kohëzgjatja e proceseve | Numri total i vendimeve/aktgjykimëve | Nga të cilat shkelje | Kohëzgjatja e proceseve | Numri total i vendimeve/aktgjykimëve | Nga të cilat shkelje | Kohëzgjatja e proceseve | Numri total i vendimeve/aktgjykimëve | Nga të cilat shkelje | Kohëzgjatja e proceseve | Numri total i vendimeve/aktgjykimëve | Nga të cilat shkelje | Kohëzgjatja e proceseve |
| Shqipëri | 3,2 | | | | 6 | 5 | 2 | | | | | | | 7 | 5 | 1 |
| Gjermani | 82,3 | 10 | 6 | 4 | 12 | 7 | 5 | 10 | 6 | 5 | 21 | 18 | 14 | 36 | 29 | 29 |
| Austri | 8,4 | 21 | 20 | 3 | 23 | 20 | 8 | 14 | 11 | 7 | 15 | 13 | 6 | 19 | 16 | 9 |
| Azerbajxhan | 9,2 | | | | | | | 9 | 7 | 2 | | | | | | |
| Belgjikë | 10,7 | 7 | 4 | 2 | 15 | 14 | 10 | 14 | 12 | 9 | 11 | 8 | 2 | | | |
| Bullgari | 7,5 | 45 | 43 | 16 | 53 | 51 | 19 | 60 | 51 | 25 | 63 | 61 | 21 | 81 | 69 | 31 |
| Qipro | 1,1 | 15 | 15 | 15 | 7 | 7 | 6 | 9 | 6 | 2 | 3 | 3 | 3 | | | |
| Kroaci | 4,4 | 22 | 21 | 16 | 39 | 29 | 14 | 19 | 16 | 11 | 19 | 16 | 6 | 21 | 21 | 8 |
| Danimarkë | 5,6 | | | | | | | 2 | 2 | 2 | 3 | 3 | 3 | | | |
| Spanjë | 46,1 | | | | | | | | | | 17 | 11 | 3 | | | |
| Estoni | 1,3 | | | | 3 | 3 | 2 | | | | 4 | 4 | 1 | | | |
| Federata Ruse | 143,0 | 102 | 96 | 18 | 192 | 175 | 11 | 244 | 233 | 20 | 219 | 210 | 34 | 217 | 204 | 29 |
| Finlandë | 5,4 | 17 | 12 | 7 | 26 | 16 | 9 | 9 | 8 | 2 | 29 | 28 | 19 | 17 | 16 | 9 |
| Francë | 62,8 | 96 | 87 | 25 | 48 | 19 | 6 | 34 | 24 | 1 | 33 | 20 | 2 | 42 | 28 | 1 |
| Gjeorgji | 4,4 | | | | | | | 6 | 4 | 1 | 11 | 11 | 2 | | | |
| Greqi | 11,4 | 55 | 53 | 32 | 65 | 61 | 38 | 74 | 73 | 53 | 75 | 69 | 41 | 56 | 53 | 33 |
| Hungari | 10,0 | 31 | 31 | 27 | 24 | 24 | 22 | 44 | 43 | 39 | 30 | 28 | 20 | 21 | 21 | 14 |
| Irlandë | 4,5 | | | | | | | | | | | | | 2 | 2 | 1 |
| Itali | 60,6 | 103 | 96 | 17 | 67 | 58 | 25 | 82 | 72 | 51 | 69 | 61 | 12 | 98 | 61 | 44 |
| Letoni | 2,3 | 10 | 9 | 3 | 12 | 8 | 2 | | | | | | | | | |
| «ish Republika Jugosllave e Maqedonisë | 2,1 | 8 | 7 | 7 | 17 | 16 | 11 | 15 | 15 | 10 | 17 | 16 | 10 | 15 | 14 | 7 |

| | | | | | | | | | | | | | | | | |
|----------------------|------|-----|-----|-----|-----|-----|----|-----|-----|----|-----|-----|----|-----|-----|----|
| Liçenstajn | 0,4 | 1 | 1 | 1 | | | | | | | | | | 1 | 1 | 1 |
| Lituani | 3,3 | 7 | 6 | 3 | 5 | 3 | 2 | | | | 9 | 8 | 7 | 8 | 7 | 3 |
| Liçenstajn | 0,4 | 1 | 1 | 1 | | | | | | | | | | 1 | 1 | 1 |
| Lituani | 3,3 | 7 | 6 | 3 | 5 | 3 | 2 | | | | 9 | 8 | 7 | 8 | 7 | 3 |
| Luksemburg | 0,5 | 2 | 2 | 1 | 7 | 6 | 2 | 6 | 4 | 3 | | | | 7 | 5 | 3 |
| Maltë | 0,4 | 8 | 8 | 3 | | | | 5 | 2 | 1 | | | | | | |
| Moldova | 3,6 | 20 | 18 | 1 | 60 | 59 | 2 | 33 | 28 | 3 | 30 | 29 | 3 | | | |
| Norvegji | 4,9 | | | | 5 | 5 | 1 | 5 | 3 | 1 | | | | | | |
| Holandë | 16,6 | | | | | | | | | | | | | | | |
| Poloni | 38,3 | 115 | 107 | 51 | 111 | 101 | 35 | 141 | 129 | 63 | 133 | 123 | 50 | 107 | 87 | 37 |
| Portugali | 10,7 | 5 | 4 | 1 | | | | 12 | 12 | 1 | 17 | 17 | 3 | 19 | 15 | 6 |
| Republika Çeke | 10,5 | 39 | 37 | 27 | 11 | 9 | 3 | | | | | | | 11 | 9 | 1 |
| Rumani | 21,5 | 73 | 64 | 7 | 93 | 88 | 8 | 199 | 189 | 25 | 168 | 153 | 16 | 143 | 135 | 16 |
| Mbretëria e Bashkuar | 62,0 | 23 | 10 | 1 | 50 | 19 | 1 | 26 | 27 | 1 | 18 | 14 | 2 | 21 | 14 | 1 |
| San Marino | 0,3 | | | | | | | | | | | | | | | |
| Serbi | 9,9 | | | | 14 | 14 | 8 | 9 | 8 | 3 | 16 | 14 | 5 | 9 | 9 | 2 |
| Slovaki | 5,5 | 35 | 35 | 32 | 23 | 22 | 14 | 15 | 12 | 11 | 39 | 38 | 29 | 40 | 40 | 29 |
| Sloveni | 2,0 | 190 | 185 | 183 | 15 | 14 | 13 | 9 | 8 | 7 | 8 | 7 | 4 | 6 | 3 | 2 |
| Suedi | 9,4 | 8 | 3 | 2 | 7 | 5 | 4 | 2 | 2 | 1 | | | | 6 | 4 | 1 |
| Zvicër | 7,7 | 9 | 9 | 1 | | | | | | | 7 | 5 | 1 | | | |
| Turqi | 72,8 | 334 | 312 | 48 | 331 | 319 | 67 | 264 | 257 | 64 | 356 | 341 | 95 | 278 | 228 | 83 |
| Ukrainë | 45,4 | 120 | 119 | 12 | 109 | 108 | 34 | 110 | 110 | 32 | 126 | 126 | 35 | 109 | 107 | 60 |

| | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---------------|--------------|-------------|-------------|------------|-------------|-------------|------------|-------------|-------------|------------|-------------|-------------|------------|-------------|-------------|------------|
| TOTALI | 811,9 | 1531 | 1420 | 566 | 1450 | 1285 | 384 | 1481 | 1374 | 456 | 1566 | 1455 | 449 | 1397 | 1203 | 461 |
|---------------|--------------|-------------|-------------|------------|-------------|-------------|------------|-------------|-------------|------------|-------------|-------------|------------|-------------|-------------|------------|

Burimi :

(*) Raporte vjetore 2007 gjer në 2010, Administrata e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Strasburg

(**)

INSEE (vlerësime e popullsisë në mes të vitit 2010):

http://www.insee.fr/fr/themes/tableau.asp?reg_id=98&ref_id=CMPTF01105 (faqe interneti e kontrolluar më 08/11/2011), dhe

OKB (Divizioni për Popullsinë i Departamentit të Ekonomisë dhe Çështjeve Sociale të Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara– Perspektiva e Popullsisë Botërore: http://esa.un.org/unpd/wpp/unpp/panel_population.htm (faqe interneti e kontrolluar më 08/11/2011)

Shtojca 1 bis e përditësuar

Shkeljet në lidhje me "kohëzgjatjen e procedurave" (neni 6 § 1) për shtet (*)

| | Popullsia (në milionë banorë) | Numri total i vendimeve/aktgjy- kimeve | Vendime që evidentojnë të paktën një shkelje | 1999 2006 | | 1999 2010 | |
|--|----------------------------------|--|--|------------------------------|--|---|---------------------------------|
| | | | | Kohëzgjatja e procedurave | Numri total i vendimeve/aktgjy- kimeve | Vendime që evidentoj në të paktën një shkelje | Kohëzgjatja e procedurave |
| Shqipëri | 3,2 | | | | 27 | 23 | 3 |
| Gjermani | 82,3 | 76 | 53 | 23 | 193 | 128 | 83 |
| Austri | 8,4 | 141 | 111 | 45 | 287 | 215 | 81 |
| Azerbajxhan | 9,2 | | | | 42 | 38 | 2 |
| Belgjikë | 10,7 | 67 | 50 | 33 | 162 | 113 | 55 |
| Bullgari | 7,5 | 116 | 109 | 45 | 375 | 343 | 141 |
| Qipro | 1,1 | 35 | 29 | 22 | 60 | 50 | 34 |
| Kroaci | 4,4 | 101 | 72 | 41 | 191 | 154 | 80 |
| Danimarkë | 5,6 | 20 | 5 | 2 | 34 | 13 | 8 |
| Spanjë | 46,1 | 32 | 24 | 6 | 91 | 56 | 11 |
| Estoni | 1,3 | 12 | 9 | 1 | 23 | 19 | 4 |
| Federata Ruse | 143,0 | 207 | 197 | 47 | 1079 | 1019 | 141 |
| Finlandë | 5,4 | 64 | 47 | 18 | 151 | 119 | 57 |
| Francë | 62,8 | 541 | 431 | 245 | 815 | 604 | 279 |
| Gjeorgji | 4,4 | 10 | 9 | 2 | 39 | 32 | 5 |
| Greqi | 11,4 | 301 | 258 | 181 | 613 | 541 | 353 |
| Hungari | 10,0 | 92 | 84 | 75 | 211 | 200 | 170 |
| Irlandë | 4,5 | 12 | 7 | 4 | 25 | 15 | 6 |
| Itali | 60,6 | 1648 | 1264 | 923 | 2121 | 1617 | 1139 |
| Letoni | 2,3 | 18 | 16 | 4 | 45 | 37 | 6 |
| «ish-Republika jugosllave e Maqedonisë» | 2,1 | 14 | 11 | 9 | 78 | 72 | 47 |
| Licënstajn | 0,4 | 4 | 4 | 1 | 5 | 5 | 2 |

| | Popullsia (në milionë banorë) | Numri total i vendimeve/aktgj ykimeve | Vendime që evidentojnë të paktën një shkelje | 1999 2006 | | 1959 2010 | |
|----------------------|----------------------------------|---|--|------------------------------|---|---|---------------------------------|
| | | | | Kohëzgjatja e procedurave | Numri total i vendimeve/aktgj ykimeve | Vendime që evidentoj në të paktën një shkelje | Kohëzgjatja e procedurave |
| Lituani | 3,3 | 30 | 23 | 7 | 65 | 52 | 19 |
| Luksemburg | 0,5 | 12 | 11 | 8 | 36 | 29 | 16 |
| Maltë | 0,4 | 15 | 14 | 4 | 31 | 25 | 5 |
| Moldova | 3,6 | 45 | 42 | 2 | 196 | 178 | 10 |
| Norvegji | 4,9 | | | | 28 | 20 | 2 |
| Holandë | 16,6 | 60 | 36 | 5 | 128 | 73 | 8 |
| Poloni | 38,3 | 378 | 318 | 210 | 874 | 761 | 397 |
| Portugali | 10,7 | 131 | 74 | 59 | 206 | 138 | 77 |
| Republika Çeke | 10,5 | 117 | 106 | 73 | 158 | 142 | 77 |
| Rumani | 21,5 | 186 | 152 | 13 | 791 | 719 | 78 |
| Mbretëria e Bashkuar | 62,0 | 206 | 141 | 17 | 443 | 271 | 25 |
| San Marino | 0,3 | 10 | 8 | 2 | 11 | 8 | 2 |
| Serbi | 9,9 | | | | 49 | 46 | 18 |
| Slovaki | 5,5 | 128 | 104 | 83 | 248 | 218 | 166 |
| Sloveni | 2,0 | 195 | 188 | 195 | 233 | 220 | 211 |
| Suedi | 9,4 | 35 | 13 | 5 | 95 | 47 | 12 |
| Zvicër | 7,7 | 34 | 27 | 4 | 102 | 71 | 6 |
| Turqi | 72,8 | 1310 | 1076 | 127 | 2573 | 2245 | 440 |
| Ukrainë | 45,4 | 263 | 258 | 32 | 717 | 709 | 193 |
| TOTALI | 811,9 | 6666 | 5381 | 2573 | 13651 | 11385 | 4469 |

Burimi :

(*) Raporte vjetore 2007 gjer në 2010, Administrata e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Strasburg

(**)

INSEE (vlerësime e popullsisë në mes të vitit 2010):

http://www.insee.fr/fr/themes/tableau.asp?reg_id=98&ref_id=CMPTFEF01105 (faqe interneti e kontrolluar më 08/11/2011), dhe

OKB (Divizioni për Popullsinë i Departamentit të Ekonomisë dhe Çështjeve Sociale të Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara–

Shtojca 2

Çështjet "Prioritare" për të cilat Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut kërkon një korrektesë të veçantë nga ana e autoriteteve (29/10/05)

Pavarësisht se mënyra e formulimit të fjalëve nga ana e Gjykatës mund të ndryshojë, duke variuar nga "përsheptim i jashtëzakonshëm" (çështje me HIV) në një "korrektesë/përkujdesje të caktuar" (kapaciteti mendor i paditësit), Gjykata nuk vë në funksionim ndonjë sistem klasifikimi lidhur me llojet e çështjeve në fjalë. Këndvështrimi i saj është se ato që të gjitha kërkojnë që gjykatat të tregojnë një vigjilencë të veçantë lidhur me kohëzgjatjen e procesit. Vlera e kësaj tablele është e tillë që tregon se çfarë vihej në rrezik nga ana e paditësve në çështjet në fjalë.

- ▣ Aktgjykimi *Gheorghe v. Rumanisë*, i datës 15 qershor 2007: Gjykata rikujtoi se *kërkohej një korrektesë e veçantë nga ana e autoriteteve aty ku paditësi vuan nga një sëmundje e rëndë dhe e pashërueshme dhe atëherë kur gjendja e tij po përkeqësohet me shpejtësi (§ 54) {...}. Duke pasur parasysh përkeqësimin e shëndetit të paditësit gjatë procesit, dhe meqë autoriteteve u kërkohej të tregonin një nivel të lartë korrektesë/përkujdesjeje, Gjykata arrin në përfundimin se kohëzgjatja e procesit në fjalë është e tepruar (§ 60). Në këtë rast çështja kryesore për vonesën ishte një mosmarrëveshje lidhur me juridiksionin mes dy gjykatave të cilat kishin bërë gabime lidhur me vlerësimin e kompetencave të tyre përkatëse.*
- ▣ Aktgjykimi *Sopp v. Gjermanisë*, i datës 8 tetor 2009: Gjykata vuri re se një vëmendje e veçantë duhej treguar lidhur me njohjen e origjinës profesionale të një sëmundjeje, duke konsideruar rëndësinë e procesit për paditësin, meqë qëllimi ishte që atij t'i siguroheshin mjete shtesë mbështetëse lidhur me një siguracion vjetor të prapësueshëm.
- ▣ Hemofilikët francezë të infektuar me virusin HIV gjatë transfuzioneve të gjakut:
- ▣ Aktgjykimet e GJEDNJ: *X v. Francës*, i datës 31 mars 1992, *Vallée v. Francës*, i datës 26 prill 1994, *Pailot v. Francës*, i datës 22 prill 1998: *"Ashtu si Komisioni, Gjykata konsideron se ajo që vihej në rrezik në procesin e ngritur ishte e një rëndësie të veçantë për paditësin, duke marrë parasysh sëmundjen prej së cilës vuan ai. në këtë rast kërkohej korrektesë/përkujdesje e jashtëzakonshme, duke mos neglizhuar as numrin e çështjeve për t'u shqyrtuar"* (Pailot, § 68).

Ushtrimi i autoritetit prindëror dhe kujdestaria e fëmijëve:

- ▣ *H v. Mbretërisë së Bashkuar*, aktgjykimi i datës 8 korrik 1987: në këtë çështje të kujdesit për fëmijën, Gjykata deklaroi se jo vetëm që procesi ishte *"vendimtar për marrëdhënien e ardhshme [të nënës] me fëmijën e saj, por që proceset kishin një farë cilësie të pakthyeshmërisë, duke përfshirë atë që Gjykata e Lartë e përshekroi grafikisht si "gijotina statutore" e adoptimit Në raste të kësaj natyre, autoritetet kanë për detyrë të ushtrojnë një korrektesë/përkujdesje të jashtëzakonshme"* (shkelje).
- ▣ *Johansen v. Norvegjisë*, aktgjykimi i datës 7 gusht 1996 (**nuk ka shkelje**): *"duke pasur parasysh atë që rrezikonte paditësi dhe natyrën e pakthyeshme dhe përfundimtare të masave në fjalë, kërkohej që autoritetet kompetente kombëtare të vepronin sipas Nenit 6, para. 1 me një korrektesë/përkujdesje të jashtëzakonshme në sigurimin e progresit të procesit"*.
- ▣ *EP v. Italisë*, aktgjykimi i datës 16 nëntor 1999, shkelje: procesi për kujdestarisë së fëmijës, që zgjati shtatë vjet.
- ▣ *Nuutinen v. Finlandës*, aktgjykimi i datës 27 qershor 2000.

▣ *Tetourova v. Republikës Çeke*, aktgjykimi i datës 27 shtator 2005 (vetëm në frëngjishte): vonesat në pjesë të veçanta të procesit mund të tolerohen vetëm nëse zgjatja e përgjithshme e procesit nuk është e tepërt. Nuk ka shkelje për procesin që zgjati për tri vjet e gjysmë. Sjellja e të paditurit (burrit të paditëses) ndihmoi në vonesën e procesit dhe ishte një element objektiv që nuk mund t'i atribuohet shtetit.

- ▣ *Jahnova v. Republikës Çeke*, aktgjykimi i datës 19 tetor 2004: shpallet një zgjatje e procesit prej 3 vjetësh e 5 muajsh, që ende vazhdon, ndërkohë që nëna është ndarë nga fëmija e saj që në vitin 1997.

Pagesa për personat në ngarkim (Pensioni ushqimor):

Kjo është çështja kur vendimi gjyqësor vendos për përfundimin e një procesi divorci (zgjidhje martese): *Kubiznakovav. Republikës Çeke*, i datës 21 qershor 2005: shkelje për kohëzgjatjen prej 6 vjetësh e 4 muajsh dhe dy instanca procesi që kanë marrë vendime nga tri herë secila.

Në aktgjykimin *Dinu v. Rumanisë dhe Francës*, 4 nëntor 2008 një paditës mundi të sigurojë një vendim, si kundër Francës, ashtu edhe kundër Rumanisë, për shkak se procedura e ekzekutimit, që kishte zgjatur nëntë vjet për shkak të vonesave jo vetëm të dy sistemeve gjyqësore, por edhe të ministrive përkatëse.

Mosha e paditësit:

- ▣ *Sussmann v. Gjermanisë*, aktgjykimi i datës 16 shtator 1996 që lidhet me rastin e përlogaritjes së pagesës shtesë të pensionit.
- ▣ *Styranowski v. Polonisë dhe aktgjykimi i datës 30 tetor 1998*: Gjykata mori në konsideratë moshën e paditësit, një gjyqtar i dalë në pension, në një proces për kompensim që pasoi një zvogëlim të pensionit të tij.

Aktgjykimi *Pantaleon v. Greqisë*, i datës 10 maj 2007 që kishte të bënte me pensionin e luftës të kërkuar nga një paditës tetëdhjetë-vjeçar: paditësi pati vështirësi në zbatimin e një vendimi gjyqësor lidhur me dhënien e pensionit të tij. Gjykata mori në konsideratë se procesi dy-vjeçar ishte mjaft i gjatë dhe se autoritetet administrative nuk kishin manifestuar korrektesën e nevojshme në këtë çështje, duke marrë parasysh moshën e thyer të paditësit dhe rëndësinë që kishte procesi për të.

Proceset për heqje nga puna – çështjet e punësimit, përfitimi i pensionit apo ndonjë burimi tjetër të ardhurash:

- ▣ *Ruotolo v. Italisë*, aktgjykimi i datës 27 shkurt 1992, vendimi për shkelje në një proces, që zgjati 11 vjet e 7 muaj, në tri instanca gjykatash, që u pasua nga një rivlerësim i çështjes që u vendos nga Gjykata e Kasacionit: zgjatje e tejskajshme e këshillim-votimit / rrahjen e çështjes në nivelin e apelit (7.5 muaj).
- ▣ Vendimi për papranueshmërinë për çështjen Komisioni *Labate v. Italisë*, i datës 14 janar 1998 (vetëm në frëngjisht): Komisioni konstatoi se Italia kishte treguar shkallën e duhur të korrektesës në çështjet e marrëdhënieve të punës, duke prezantuar masa të veçanta në vitin 1990 për të përshpejtuar procedurat.
- ▣ *Frydlander v. Francës*, aktgjykim i datës 27 qershor 2000, që ka të bëjë me proceset administrative në një mosmarrëveshje punësimi mes një departamenti qeveritar dhe një punonjësi me kontratë (aplikueshmëria e Nenit 6 § 1 në këtë lloj çështjeje dhe shkelje në lidhje me procesin që zgjati për 9 vjet e 8 muaj, duke përfshirë gjashtë vjet përpara *Conseil d'Etat* lidhur me aspektet ligjore). “mosmarrëveshjet e punës, nga natyra e tyre kërkojnë një vendim të shpejtë, duke pasur parasysh atë që rrezikon personi në fjalë, që përmes heqjes nga puna humbet mjetet e tij të ekzistencës”.
- ▣ *Mianowicz v. Gjermanisë*, aktgjykimi i datës 18 tetor 2001 (vetëm në frëngjisht): Sipas Gjykatës, një korrektesë e veçantë i duhej kushtuar mosmarrëveshjeve të punës, të cilat duheshin zgjidhur me shpejtësi të veçantë meqë ishin tejet të rëndësishme për situatën profesionale të individëve - shkelje (12 vjet e 10 muaj).
- ▣ *Garcia v. Francës*, aktgjykimi i datës 14 nëntor 2000 (vetëm në frëngjisht): Gjykata vuri re se vazhdimësia e punësimit të paditësit ishte varur në një masë të madhe nga procesi në fjalë dhe kishte arritur në përfundimin se, ashtu si në rastet e mosmarrëveshjeve të punës, ajo që vihej në rrezik nga ana e paditësit kishte kërkuar arritjen e një vendimi të shpejtë. Çështja kishte të bënte me një kërkesë që të mos merrej parasysh refuzimi absolut i një prefekti në dhënien e paditësit, një pronari lokal, të një zgjatjeje të orarit të tij të punës.

Oliviera Modesto dhe të tjerët v. Portugalisë, aktgjykimi i datës 8 qershor 2000 (vetëm në frëngjisht): Gjykata konstatoi se çështjeve që kishin të bënin me të drejtën e rrogës të punonjësve apo me pagesat e tjera që ishin pjesë e të ardhurave të tyre, u duhej kushtuar një rëndësi e veçantë deri në atë masë sa koha e arsyeshme e kërkuar sipas Nenit 6 § 1 mund të konsiderohet të jetë shkelur. Shih, po ashtu, edhe çështjet *FernandesCascao v. Portugalisë*, aktgjykimi i datës 1 shkurt 2001 dhe *Farinha Martins v. Portugalisë*, aktgjykimi i datës 10 korrik 2003.

- ▣ Aktgjykimet *Mianowicz v. Gjermanisë* (Nr.2), vendimi i datës 11 qershor 2009, dhe *Petko Ivanov v. Bullgarisë*, vendimi i datës 26 mars 2009, që kundërshton heqjet nga puna.
- ▣ (Siç është përmendur më sipër) aktgjykimi *Sartory v. Francës*, vendimi i datës 24 shtator 2009: periudha 6 vjeçare që u desh për të vendosur mbi një mosmarrëveshje lidhur me transferimin e një nëpunësi civil, u konsiderua tejet e gjatë.
- ▣ Aktgjykimi *Vassilios Athanasiou dhe të tjerët v. Greqisë*, i datës 21 dhjetor 2010: kjo çështje kishte të bënte me një mosmarrëveshje administrative për caktimin e një premiumi shtesë pensioni nga ana e Fondit të Solidaritetit të Ushtrisë.
- ▣ Aktgjykimi *Kalfon v. Francës*, i datës 29 tetor 2009: shpejtësia është thelbësore në fushën e mosmarrëveshjeve të punës, meqë ato kërkojnë një vendim të hershëm që nga përkufizimi sepse çështjet që rrezikojnë paditësi në proces, janë ato të jetës së tij personale dhe familjare dhe të karrierës së tij profesionale (§ 34).
- ▣ E njëjta gjë aplikohet edhe atëherë kur ajo që rrezikon paditësi është të qënurit në gjendje të ngrejë një biznes bujqësor (aktgjykimi *Gouttard v. Francës*, i datës 30 shtator 2011 – paditësit iu desh të priste për pothuaj shtatë vjet që të ngrinte fermën e tij).

Gjatësia e dënimit me burg të vuajtur nga paditësi:

- ▣ *Soto Sanchez v. Spanjës*, aktgjykimi i datës 25 nëntor 2003 (§ 41 – vetëm në frëngjisht): shkelje për një periudhë prej 5 vjetësh, 5 muajsh e 18 ditësh përpara Gjykatës Kushtetuese.
- ▣ *Motsnik v. Estonisë*, aktgjykimi i datës 29 prill 2003; në rastin e një vepre penale jo të komplikuar seksuale Gjykata konstatoi se nuk ka pasur shkelje të Nenit 6 § 1 nëse merret parasysh kohëzgjatja e procesit në të tre instancat e juridiksionit për periudhën në fjalë, që është 2 vjet e 7 muaj, kompetenca *ratione temporis* nëse merret parasysh vetëm periudha pas muajit prill 1996. Për paditësin, i cili u paraburgos në muajin shkurt 1998, çështja paraqiste një interes të veçantë, dhe kërkonte trajtimin me një shpejtësi të jashtëzakonshme nga ana e autoriteteve kombëtare.
- ▣ Aktgjykimi *Şinegu dhe të tjerët v. Turqisë*, i datës 13 tetor 2009: Gjykata vë re se paditësit ishin paraburgosur gjatë gjithë periudhës së procesit, situatë kjo që kërkonte një korrektesë të veçantë nga gjykatat ku zhvilloheshin gjykimet, me qëllimin e ushtrimit të drejtësisë sa më shpejt që të ishte e mundur.
- ▣ Aktgjykimi *Mihalkov v. Bullgarisë*, i datës 10 prill 2008: kjo çështje kishte të bënte me një padi për dëmet ndaj një dënimi të paligjshëm, paraburgimi të paligjshëm (11 muaj) dhe dëmet lidhur me reputacionin.
- ▣ Aktgjykimi *Gocmen v. Turqisë*, i datës 17 tetor 2006: Gjykata vuri re se kërkesa për përshpejtim ishte veçanërisht e rëndësishme për paditësin, i cili kishte qenë në paraburgim/ i ndaluar për më se gjashtë vjet e 9 muaj.

Statusi civil dhe kapaciteti i individëve:

- ▣ **Padi për të përcaktuar atësinë:**
- ▣ *Costa Ribeiro v. Portugalisë*, aktgjykimi i datës 30 prill 2003 (vetëm në frëngjisht). Gjykata deklaroi se çështjet që kishin të bënin me statusin civil dhe kapacitetin e individëve, kërkonin korrektesë të veçantë. Gjykata në fjalë kishte pasur për detyrë të procedonte rastin me korrektesë/përkujdesje të veçantë sepse ajo që vihej në rrezik për paditësit, në veçanti paditësin e dytë, ishte e drejta e një emri dhe përcaktimi i atësisë.

- ▣ Aktgjykimi *Ebru dhe Tayfun Colak v. Turqisë*, i datës 30 maj 2006: Gjykata rikujtoi që kërkohej korrektesë e veçantë në rastet që kishin të bënin me gjendjen dhe kapacitetin e individëve. Duke pasur parasysh rëndësinë e këtij rasti për paditësin vis-à-vis të drejtës së tij për të vendosur apo për të kundërshtuar atësinë, duke i dhënë fund në këtë mënyrë paqartësisë së tij lidhur me identitetin e babait të tij biologjik, Gjykata mori në konsideratë që Neni 6 § 1 kërkonte që autoritetet kompetente kombëtare të vepronin me një korrektesë të veçantë dhe të përshpejtonin përkatësisht procesin.
- ▣ Aktgjykimi *Tsikakis v. Gjermanisë*, i datës 10 maj 2011: procesi për njohjen e atësisë në këtë çështje zgjati pothuajse gjashtë vjet e pesë muaj, duke përfshirë tri instanca gjyqësore, dhe duke përfshirë katër vjet në gjykatën e apelit.

▣ **Kapaciteti mendor i paditësit për të nisur një proces ligjor:**

- ▣ *Bock v. Gjermanisë*, aktgjykimi i datës 23 mars 1989. Çështja kërkonte një "vendosje të shpejtë" (§ 47). Gjykata arriti në përfundimin se "*duke i kushtuar vëmendje korrektesës së veçantë që kërkohej në rastet që kishin të bënin me statusin civil dhe kapacitetin, rrjedhimisht ka pasur shkelje të Nenit 6 para. 1 të Konventës*", lidhur me procesin e divorcit që kishte zgjatur për nëntë vjet, së bashku me çështjen e pranueshmërisë së padisë (kapacitetin e paditësit për të nisur një proces ligjor).

Hetimi i ankesave të sulmeve nga ana e zyrtarëve të organeve të zbatimit të ligjit:

- ▣ *Caloc v. Francës*, aktgjykimi i datës 20 korrik 2000: "*korrektesë e veçantë nevojitej nga ana e autoriteteve përkatëse gjyqësore në hetimin e ankesës së bërë nga një person që aludonte se kishte qenë subjekt i dhunës së oficerëve të policisë*".
- ▣ Në një rast në Bullgari që kishte të bënte me dhunën e paligjshme policore dhe përgjegjësinë e shtetit për kompensimin e dëmit që rridhte si pasojë e një sjelljeje të tillë, Gjykata deklaroi se "*lidhur me rëndësinë e asaj që vihej në rrezik nga paditësi, Gjykata vë re se padia e tij kërkonte pagesë për lëndimet e rënda të vuajtura si pasojë e dhunës policore. Në raste të tilla, kërkohet korrektesë e veçantë nga ana e autoriteteve gjyqësore*".
(*Krastanovv. Bullgarisë*, aktgjykimi i datës 30 shtator 2004, § 70).

Të ardhurat e kufizuara të paditësit dhe gjendja e vështirë financiare, që rezulton nga përvetësimi i fondeve i bërë nga të pandehurit

- ▣ Në aktgjykimin *Dachar v. Francës*, të datës 10 tetor 2000, që kishte të bënte me akuza penale me një kërkesë/padi për dëme, në të cilën dy grupe procesesh zgjatën përkatësisht katër vjet dhe katër vjet e tri muaj, përpara dy instancave gjyqësore, Gjykata konsideroi se duke pasur parasysh atë që rrezikonte paditësi, çështja duhet të ishte trajtuar me korrektesën e duhur.

Kërkesë/padia e bërë bazuar në autoritetin për të ekzekutuar:

- ▣ *Comingersoll SA v. Portugalisë*, aktgjykimi i datës 6 prill 2000: "*një vendim përfundimtar që ende pritët të merret për procesin e filluar mbi bazën e një autoriteti për të ekzekutuar – të cilat për nga vetë natyra e tyre kërkojnë një trajtim të shpejtë*" (§ 23). Shkelje për një çështje që kishte zgjatur 17 vjet e 6 muaj.
- ▣ Shih, po ashtu, edhe *Frotal-Aluguer de Equipamentos SA v. Portugalisë*, aktgjykimi i datës 4 dhjetor 2003, që zgjati pothuajse nëntë vjet (që nga nëntori 1994 dhe që ishte ende e pazgjidhur në kohën e aktgjykimit – çështja nuk kishte qenë aktive që në mars të vitit 2000, në të cilën akuzohej paditësi) – shkelje.

Kompensimi për dëmet e vuajtura nga paditësi:

- ▣ Aktgjykimi *Floarea Pop v. Rumanisë*, i datës 6 prill 2010: procesi vendas kishte të bënte me kompensimin e dëmit të shkaktuar paditëses nga vdekja e djalit të saj.
- ▣ Aktgjykimi *Stefanova v. Bullgarisë*, i datës 11 janar 2007: procesi kishte të bënte me kompensimin për lëndimet aksidentale, të cilat kishin shkaktuar dëme të përhershme në shëndetin e paditësit, pa vënë në rrezik jetën e tij.

Arsye të tjera për shpejtësi të veçantë:

- ▣ Aktgjykimi *Wilczkowska dhe të tjerët v. Polonisë*, i datës 8 janar 2008: veprim për të rimarrë në posedim pronën e paluajtshme pas shpronësimit, dhe padia për kompensim.
- ▣ Aktgjykimi *Gunes v. Francës*, i datës 20 nëntor 2008: paditësi dëshironte të siguronte pjesë të informacionit të tij personal, pasaktësia e mundshme e këtij informacioni do të dëmtonte reputacionin e tij.
- ▣ Aktgjykimi *ORŠUŠ dhe të tjerët v. Kroacisë*, i datës 16 mars 2010: kjo çështje kishte të bënte me të drejtën e arsimit në kontekstin e diskriminimit kundrejt Romëve. Pavarësisht se Gjykata e pranoi që roli mbrojtës i Kushtetutës nga ana e Gjykatës Kushtetuese ndonjëherë e bënte veçanërisht të nevojshme marrjen në konsideratë të faktorëve të tjerë përveç thjesht aspektit kronologjik të përfshirjes në listë të çështjeve, të tillë si natyrës së çështjes dhe rëndësisë së saj në aspektin politik dhe shoqëror, Gjykata konstatoi se periudha që i tejkaloi katër vjetët për të vendosur lidhur me rastin e paditësit, veçanërisht duke pasur parasysh se çfarë rrezikohej, ishte e tejzgjatur.
- ▣ Aktgjykimi *Siffre, Ecoffet, Bernardini v. Francës*, i datës 12 dhjetor 2006: Gjykata vuri re se çështja ishte e një rëndësie të veçantë për paditësit sepse në kohën e fakteve zgjatja e procesit kishte pasur pasoja vendimtare lidhur me karrierat e tyre politike, që kishte rezultuar në dhënien e dorëheqjes së tyre nga postet e tyre dhe në një periudhë tri-vjeçare që i përjashtonte nga mundësia e rizgjedhjes përpara se të merrnin vendimin përfundimtar që i shkarkonte ata nga përgjegjësitë e tyre *de facto* financiare nga ana e *Chambre Régionale des Comptes*. Prandaj ata kishin një interes personal tejet të madh në marrjen e një vendimi përfundimtar që i përjashtonte ata nga përgjegjësitë e tyre financiare.

Shtojca 3 – Çështjet e natyrës komplekse – Shkelja e Nenet 6 § 1

| Çështja | Arsyet për kompleksitetin | Bazat për shkelljen | Lloji i procesit | Kohëzgjatja |
|---|--|--|------------------|--|
| Ilijkov v. BULLGARISË, 2 korrik 2001 | - disa bashkë-të pandehur që kishin përfutur në mënyrë mashtruese zbritje mga taksat | - intervale jashtëzakonisht të gjata mes seancave - autoritetet gjyqësore autorizuan shtyrjet e seancave pa justifikime të mjaftueshme - mungesa e gjyqtarëve të cilët nuk u zëvendësuan | PENAL | 5 vjet |
| Nikolova v. BULLGARISË, 25 mars 1999 | - disa të bashkë-të pandehur - veprimtari kriminale për një periudhë më se tri-vjeçare | - natyra komplekse e çështjes e pamjaftueshme për të shpjeguar kohëzgjatjen e procesit - reforma e kodit të procedurës penale nuk mund të justifikojë vonesat - mungesa e progresit të hetimeve pavarësisht udhëzimeve nga ana e autoriteteve të prokurorisë | PENAL | 5 vjet në një instancë gjykatash |
| Mitev v. BULLGARISË, 22 dhjetor 2004 | - një numër dëshmitarësh - përdorimi i ekspertëve - vështirësi në gjëtetjen e vendndodhjes së dëshmitarëve | - përpjekje të pamjaftueshme nga ana e autoriteteve për t'u siguruar që njëri nga të pandehurit të kishte përfaqësimit ligjor - periudhë tejet e gjatë hetimore (më shumë se pesë vjet) | PENAL | 6 vjet, 7 muaj në dy instanca gjykatash |
| Hamanov v. BULLGARISË, 8 prill 2004 | - një sërë personash të dyshuar - një sërë veprash penale financiare | - seanca e parë e gjykatës së apelit zhvillohet më se një vit pas anulimit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë - çështja ende e pazgjidhur që më 5 qershor 2000, duke përfshirë edhe një sfidë lidhur me pranueshmërinë e ankesës së dorëzuar në gjykatën e kasacionit | PENAL | 7 vjet, 1 muaj (çështja ende e pazgjidhur në datën e aktgjykimit) |

| Çështja | Arsyet për kompleksitetin | Bazat për shkeljen | Lloji i procesit | Kohëzgjatja |
|--|---|--|------------------|--|
| Belchev v. BULLGARISË, 8 prill 2004 | - një sërë personash të dyshuar - një sërë veprash penale financiare | - seanca e parë e gjykatës së apelit zhvillohet më se një vit pas anulimit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë - çështja ende e pazgjidhur që më 5 qershor 2000, duke përfshirë edhe një sfidë lidhur me pranueshmërinë e ankesës së dorëzuar në gjykatën e kasacionit | PENAL | (çështja ende e pazgjidhur në datën e aktgjykimit) |
| Sahiner v. TURQISË, 25 shtator 2001 | - një numër i madh të pandehurish dhe akuzash | - kohë tejet e gjatë për të shpallur aktgjykimet - ndryshimi i legjislacionit <i>por</i> shtetet duhet të organizojnë sistemet e tyre gjyqësore në mënyrën e duhur | PENAL | 6 vjet, 2 muaj (kohëzgjatja aktuale 15 vjet) |
| Mitap v. TURQISË, 21 shkurt 1996 | - natyra e akuzave kundër paditësve (veprimtari terroriste) - 627 vepra penale - 726 të pandehur | - periudha të gjata mos-veprimi (tri vjet për gjykatën ushtarake që të hartonte arsyetimin për aktgjykimin) dhe qeveria nuk ofroi asnjë informacion për të justifikuar këtë periudhë kaq të gjatë | PENAL | 6 vjet (kohëzgjatja aktuale 15 vjet) |
| Demirel v. TURQISË, 28 prill 2003 | - çështja u shqyrtua me atë të katër bashkë-të pandehurve të tjerë për anëtarësinë në PPK | - kërkimet paraprake duhet të ishin kryer më shpejt - ishte dashur një kohë e gjatë për të marrë në pyetje dëshmitarët | PENAL | 7 vjet, 7 muaj |
| Ilwanczuk v. POLONISË, 15 nëntor 2001 | - kompleksitet i qenësishëm i kësaj lloji çështjeje (falsifikim dokumentesh dhe përdorim dokumentesh të falsifikuara) | - ndryshimi në përbërjen e trupit gjykues - seancat filluan nga fillimi, pasi ishin zhvilluar tashmë 71 syresh | PENAL | 8½ vjet (kohëzgjatja aktuale: 10½ vjet, çështja mbetet ende e pazgjidhur) |
| Ilowiecki v. POLONISË, 4 tetor 2001 | - një sërë transakSIONESH ndërkombëtare bankare - nevoja për të thirrur një sërë ekspertësh | - një numër i përgjithshëm prej dy vjetësh e dhjetë muajsh, për të cilat qeveria nuk paraqiti asnjë shpjegim | PENAL | 7 vjet, 10 muaj (çështja mbetet ende e pazgjidhur) |

| Çështja | Arsyet për kompleksitetin | Bazat për shkeljen | Lloji i procesit | Kohëzgjatja |
|---|--|--|------------------|---|
| Grauslys v. LITUANISË, 10 tetor 2000 | - çështje mashtrimi | - neglizhenca e vazhdueshme e autoriteteve për të marrë në pyetje viktimat | PENAL | 5 vjet (çështja mbetet ende e pazgjidhur) |
| Kalashnikov v. RUSISË, 15 korrik 2002 | - vepra penale financiare, që përfshinin një numër të madh provash, si edhe nevoja për të marrë në pyetje një sërë dëshmitarësh | - edhe pse paditësi kishte ndihmuar në zhvillimin e procesit, Neni 6 §1 nuk kërkon që të pandehurit të bashkëpunojnë me autoritetet - paditësi ishte mbajtur në paraburgim, gjë e cila kërkonte që gjykatat të tregonin një korrektesë të veçantë dhe të administronin drejtësinë në mënyrë të përshpejtuar | PENAL | 2 vjet (kohëzgjatja aktuale: 5 vjet, 1 muaj në një instancë gjyqate |
| Lavents v. LATVIAS, 28 shkurt 2003 | - vepër penale mjaft e gjërë financiare - një sërë bashkë-të pandehurish - një sasi e jashtëzakonshme provash - shkalla e hetimit | - vonesat i atribuon gjykatave (shih komunikatën e përbashkët të kryeministrit dhe ministrit të drejtësisë, të cilët pranojnë përgjegjësinë e tyre) | PENAL | 6 vjet, 7 muaj (kohëzgjatja aktuale: 7 vjet, 8 muaj) |
| Stratégies et communications dhe Dumoulin v. BELGJIKËS, 15 korrik 2002 | - hetim kompleks, për shkak të rrethanave të çështjes (45 kuti me dosje të çështjes) | - Gjykata konsideroi se periudha gjashtë-vjeçare vetëm për fazën hetimore të procesit, e cila madje as nuk ishte përfunduar, nuk mund të konsiderohej e arsyeshme | PENAL | 6 vjet |
| Boddaert v. BELGJIKËS (Komisioni), 17 prill 1991 | - nuk kishte dëshmitarë të vrasjes - paditësi dhe bashkë-i pandehuri, deklarorin secili se tjetri ishte personi përgjegjës | - pezullimi i përgjithshëm i hetimit për tri vjet, një periudhë që iu atribuua autoriteteve | PENAL | 6 vjet, 2 muaj |

| Çështja | Arsyet për kompleksitetin | Bazat për shkeljen | Lloji i procesit | Kohëzgjatja |
|---|--|--|------------------|--|
| Metzger v. GJERMANISË, 31 maj 2001 | - problem lidhur me ligjin penal dhe mjedisin - ndotja e ujit - nevoja për dëshmi ekspert - një sërë dëshmitarësh | - hetimi nuk kishte pasur zhvillime për pesëmbëdhjetë muaj mes kohës që policia dorëzoi raportin dhe ngritjes së akuzave - vonesa të pajustificueshme nëpër gjykata, veçanërisht mes ngritjes së akuzave dhe vendimit të gjykatës rajonale që të mos lejohej hapja e gjykimit kryesor, dhe mes vendimit për të pezulluar procesin dhe caktimit të një eksperti nga ana e gjykatës rajonale - dy vjet e tri muaj vonesë që rezultoi nga gjykata federale e drejtësisë pas anulimit të aktgjykimit të gjykatës rajonale mbi baza procedurale, sepse nuk e kishte pranuar këtë aktgjykim brenda periudhës ligjrisht të përcaktuar në ligj | PENAL | Mëse 9 vjet |
| Nuvoli v. ITALISË, 16 gusht 2002 | - vepër penale ekonomike dhe financiare (sekustrimi i një instrumenti bankar sipas udhëzimeve të autoriteteve të prokurorisë) | - autoritetet u konsideruan përgjegjëse për vonesat e përgjithshme që zgjatën rreth tri vjet e katër muaj | PENAL | 5 vjet, 10 muaj për në një instancë gjykatë |
| Ouattara v. FRANCËS, 2 gusht 2005 | - çështja u bë edhe më komplekse nga fakti që personi ndaj të cilit paditësi kishte ngritur padi për kompensime dëmi, nuk mund të ekstradohej | - hetimi ende në zhvillim e sipër, pas më shumë se njëmbëdhjetë vjetësh që kur paditësi kishte ngritur padinë e tij - disa periudha kohore mosveprimi të cilat iu atribuuan autoriteteve | PENAL | 11 vjet, 6 muaj (hetimi ende në zhvillim e sipër) |
| Dobbertin v. FRANCËS, 25 shkurt 1993 | - vështirësi aktuale që dilnin nga natyra tejet sensitive e veprave penale të akuzuara, që lidheshin me sigurinë kombëtare (komunikimi me agjentët e një fuqie të huaj, Republikën Demokratike Gjermane) | - autoritetet nuk ndërmorën asnjë hap për t'u siguruar që çështjet që ishin ende të pazgjidhura, duke përfshirë edhe atë të paditësit, të shqyrtoheshin me shpejtësi - gjykatat e zakonshme ishin mjaft të ngadalta për të zgjidhur çështjen e vlefshmërisë së aktakuzës (nëntë muaj) dhe për të anuluar urdhrin për caktimin e ekspertëve (dy vjet) | PENAL | 12 vjet, 10 muaj në tri instanca gjykatash |
| H. v. MBRETËRISË SË BASHKUAR 8 korrik 1987 | - një sërë palësh: paditësi, burri i saj, personat e mundshëm adoptues, avokati zyrtar dhe këshilli lokal i rrethit - vështirësi në vlerësimin e një morie shumë të madhe provash | - në fazën përpara se çështja të kalonte në Gjykatën e Lartë, këshilli i rrethit (pra shteti në këtë rast) ishte përgjegjës për vonesat - marrëdhëniet e ardhshme të nënës me fëmijën ishin në rrezik, duke krijuar detyrimin për të treguar korrektesë të jashtëzakonshme | CIVIL | 2 vjet, 7 muaj |

| Çështja | Arsyet për kompleksitetin | Bazat për shkeljen | Lloji i procesit | Kohëzgjatja |
|---|--|--|------------------|---|
| Müller v. ZVICRËS, 5 nëntor 2002 | - çështje të reja dhe themelore për kompensim nga shpronësimi në lidhje me bezdinë nga zhurma | - proces jashtëzakonisht i gjatë përpara se çështja të kalonte në Gjykatën Federale (çështja <i>Süssmann</i> u quajt e pa-aplikueshme, lidhur me "kontekstin politik unik të ribashkimit gjerman") | CIVIL | 11 vjet, 6 muaj |
| Nuutinen v. FINLANDËS, 27 qershor 2000 | - jo çështje e natyrës komplekse në fillim të gjyqimit, por u bë i tillë në fazën e zbatimit të vendimit, me rivlerësime të vazhdueshme të interesave më të mira të fëmijës | - skadoi afati mes dorëzimit të padisë fillestare dhe seancës së parë, si edhe mes kësaj të fundit dhe procesit kryesor - çfarë rrezikohet në këtë çështje (që është themelore në çështjet e kujdestarisë së fëmijës në mënyrë që çështja të zgjidhet me shpejtësi) | CIVIL | 5 vjet, 5 muaj |
| T. v. AUSTRIË, 14 nëntor 2000 | - si padia e bankës, ashtu edhe kundërpadia e paditësit u zgjeruan gjatë zhvillimit të procesit | - vonesa që i atribuuan paditësit, që shpesh ndërronte avokatët, ishin më pak të rëndësishme se ato që i atribuuan autoriteteve (gjithsej katër vjet e tri muaj në gjykatën e qarkut) | CIVIL | 8 ½ vjet në një instancë gjykatash |
| Wiesinger v. AUSTRIË, 24 shtator 1991 | - çështja kishte të bënte me konsolidimin e tokës, që nga natyra e saj përbën një proces kompleks, që ndikonte interesat si të individëve ashtu edhe të komunitetit në tërësi - natyrë ligjore komplekse | - miratimi i një ndryshimi lidhur me planin e zonës nga këshilli komunal - vështirësi që dlinin nga mungesa e koordinimit mes autoriteteve komunale dhe bujqësore në finalizimin e skemave të tyre | CIVIL | më shumë se 9 vjet |
| Bayrak v. GJERMANISË, 20 dhjetor 2001 | - natyra komplekse u shkaktua nga lidhjet me jashtë shtetit të çështjes (mosmarrëveshja u klasifikua në bazë të ligjit turk, në vend që të klasifikohet në bazë të ligjit gjerman) - natyra komplekse si pasojë e çështjeve ligjore, të tilla si juridiksioni gjeografik i gjykatave gjermane | - në çështje ishin të përfshira gjashtë gjykata të ndryshme: duke u marrë në konsideratë individualisht, koha që ato morën në shqyrtimin e çështjes nuk ishte e paarsyeshme, por kohëzgjatja e përgjithshme e procesit, që i atribuohet autoriteteve, ishte e paarsyeshme | CIVIL | më shumë se 8 vjet |

| Çështja | Arsyet për kompleksitetin | Bazat për shkëlqjen | Lloji i procesit | Kohëzgjatja |
|---|---|--|---------------------------------|---|
| Mianowicz v. GJERMANISË, 18 tetor 2001 | - çështja kishte të bënte me heqjen nga puna të një personi të paaftë, natyra komplekse e së cilës ishte e lidhur me mbrojtjen ndaj legjislacionit të heqjes nga puna dhe të atij që lidhej me personat tejet të paaftë | - vonesat kryesore u shkaktuan nga vonesat e gjykatës së apelit të punësimit në Mynih, ku pati dy periudha mosveprimi - në çështjet e mosmarrëveshjeve të punës kërkohet korrektesë e veçantë, dhe këto çështje duhet të zgjidhen me një shtëpi të veçantë, sepse ato kanë të bëjnë me probleme që janë themelore për sa i përket situatës profesionale të individëve | CIVIL | 12 vjet, 10 muaj në dy instanca gjykatash |
| H.T. v. GJERMANISË, 11 tetor 2001 | - Gjykatës Kushtetuese iu kërkua të vendoste lidhur me kushtetutshmërinë e disa aspekteve të reformës së sistemit të pensionit të të mbijetuarve | - vonesat iu atribuuan gjykatës shoqërore - korrektesë e veçantë kërkohet në varësi të asaj që rrezikohet | CIVIL | pothuajse 12 vjet |
| Klein v. GJERMANISË, 27 korrik 2000 | - një çështje mjaft e komplikuar, siç tregohet nga kohëzgjatja dhe arsyetimi i aktgjyqimit të Gjykatës Kushtetuese, që kishte kërkuar edhe vërejtjet e autoriteteve të ndryshme | - numri i vazhdueshëm i çështjeve të pashqyrtuara në Gjykatën Kushtetuese nuk mund të justifikojë kohëzgjatjen e procesit - çështje të rëndësishme me interes për shumë qytetarë gjermanë | CIVIL | 9 vjet, 8 muaj |
| K. v. ITALISË, 20 korrik 2004 | - veprim për të siguruar ekzekutimin e një urdhri mirëmbajtjeje (vendimi i gjykatës polake që urdhëronte babanë italian të paguante për mirëmbajtjen e vajzës së tij ilegjitime, me kërkesën e nënës polake) | - autoritetet italiane priten për një kohë tejet të gjatë përpara se të fillonin procedurat e ndryshme | CIVIL | 8 ½ vjet |
| Obermeier v. AUSTRISË, 28 qershor 1990 | - ndërlidhja mes procedurave administrative dhe civile për sa i përket heqjes nga puna të personave të paaftë - një sërë gjykatash të përfshira | - "megjithatë, mbetet si fakt, se një periudhë prej nëntë vjetësh pa marrë një vendim të formës së prerë, e tejkalon kohën e arsyeshme" | ADM + CIVIL (heqje nga puna) | më shumë se 9 vjet |

| Çështja | Arsyet për kompleksitetin | Bazat për shkeljen | Lloji i procesit | Kohëzgjatja |
|--------------------------------------|---|---|------------------------------------|--|
| F.E v. FRANCËS, 30 tetor 1998 | - referenca e bërë seancës plenare të Gjykatës së Kasacionit, tregoi se çështja ishte disi komplekse | - Gjykata e Kasacionit kishte lëshuar tashmë disa aktvendime lidhur me çështjet ligjore që ishin ngritur - bëhej fjalë për përshpejtim të jashtëzakonshëm | CIVIL (HIV) | 2 vjet, 3 muaj |
| Kanoun v. FRANCËS, 3 tetor 2000 | - natyra e aseteve që do të ndaheshin mes ish-bashkëshortëve - paaftësia e tyre që të merrreshin vesh përpara avokatit, gjë kjo që e bëri të nevojshme referimin përpara gjykatës në mjaft raste | - autoritetet nuk treguan shpejtësinë e duhur në organizimin e marrëveshjes, pas divorcit në vitin 1974, për shembull Gjykata e Kasacionit iu nënshtrua kritikës | CIVIL | 19 vjet |
| Satomnet v. FRANCËS, 2 gusht 2000 | - statusi i paditësit si punonjës me kontratë i hequr nga puna, gjë kjo që do të thoshte se si gjykatat gjyqësore, ashtu edhe ato administrative duhet të vendosnin për çështjen | - natyra komplekse e çështjes dhe sjellja e paditësit nuk ishin justifikime të mjaftueshme për kohëzgjatjen e përgjithshme të procesit - pati disa periudha mosveprimi që iu atribuuan autoriteteve gjyqësore | CIVIL, pastaj ADMINISTRAT IV | 17 ½ vjet (çështja ende e pazgjidhur) |
| Vallée v. FRANCËS, 26 prill 1994 | - çështje të vështira dolën si pasojë e zëvendësimit të Fondit lidhur me të drejtat e personave të cilët kishin përfituar kompensim | - informacioni që nevojitej për të përcaktuar përgjegjësinë e Shtetit kishte qenë në dispozicion për një kohë të gjatë - çfarë vihej në rrezik | CIVIL, pastaj ADMINISTRAT IV (HIV) | 4 vjet vetëm në një gjykatë të vetme |
| Pailot v. FRANCËS, 22 prill 1998 | - një farë kompleksiteti për shkak të natyrës së çështjes | - informacioni që nevojitej për të përcaktuar përgjegjësinë e Shtetit kishte qenë në dispozicion për një kohë të gjatë - një periudhë prej një viti e dhjetë muajsh mes miratimit të raportit të Komisionit që vinte në dukje se kishte pasur një marrëveshje miqësore dhe aktgjykimin të <i>Conseil d'Etat</i> që e përfundonte procesin që kishte zgjatur tashmë pesë vjet e gjashtë muaj deri në arritjen e asaj marrëveshjeje, dhe që e kishte tejkaluar mjaft kohën e arsyeshme për një çështje të tillë - kërkohej korrektesë e jashtëzakonshme | ADM + CIVIL (HIV) | 1 vit, 10 muaj |

| Çështja | Arsyet për kompleksitetin | Bazat për shkeljen | Lloji i procesit | Kohëzgjatja |
|--|---|---|------------------|--|
| Nouhaud v. FRANCËS, 9 korrik 2002 | - një sërë palësh të përfshira dhe me pauza të gjata që kur kishte ndodhur ngjarja - statusi i të pandehurit sipas ligjit publik - problem lidhur me përcaktimin e juridiksionit mes gjykatave gjyqësore dhe atyre administrative | - natyra komplekse e çështjes dhe sjellja e paditësit nuk ishin të mjaftueshme për të shpjeguar kohëzgjatjen e përgjithshme të procesit | ADM | 10 vjet në katër instanca gjykatash |
| Piron v. FRANCËS, 14 nëntor 2000 | -konsolidim toke | - periudha të gjata mosveprimi që iu atribuan autoriteteve, e për të cilat nuk u paraqit ndonjë shpjegim | ADM | 26 vjet, 5 muaj (çështja ende e papërfunduar) |
| Marschner v. FRANCËS, 28 shtator 2004 | - vepra penale financiare | - vonesa në dorëzimin e raportit të ekspertit dhe në zhvillimin e seancave | ADM | 5 vjet, 4 muaj |
| Styanowski v. POLONISË, 30 tetor 1998 | - transferim nga një gjykatë në tjetrën | - 15 muaj mosveprimi të pashpjegueshëm | ADM | 2 vjet, 8 muaj |
| Naumenko v. UKRAINËS, 30 mars 2005 | - shtetit i mungonte dokumentacioni i nevojshëm teknik lidhur me çështjen (paafhtësi pas punësimit në impiantin e Çernobilit) | - vonesa të paarsyeshme që iu atribuan shtetit - rëndësia e asaj që rrezikohet nga paditësi (shëndeti) | ADM | 5 vjet, 8 muaj |
| Janosevic v. SUEDISË, 23 korrik 2002 | - autoriteti tatimor dhe gjykatat duhet të vlerësonin qarkullimin e biznesit të taksisë së paditësit dhe përgjegjësinë e tij për pagesën e taksave shtesë dhe detyrimeve shtesë tatimore | - kjo nuk e justifikoi kohëzgjatjen e procesit – në të kundërtën, masat zbatuese të ndërmarra ndaj paditësit, kërkonin një shpyrtim të saktë të ankesave të tij | ADM | 6 vjet, 8 muaj |

Shtojca 3: Çështjet e natyrës komplekse – mos-shkelja e Nenit 6 § 1

| Çështja | Arsyet për kompleksitetin | Bazat për shkeljen | Lloji i procesit | Kohëzgjatja |
|---|---|--|------------------|---|
| Gast dhe Popp v. GIERMANISË, 25 shkurt 2000 | - natyra komplekse e çështjeve ligjore të cilave iu referohej edhe vendimi lidhur me hedhjen poshtë të ankesave të paditësit | - vonesat që ndodhën nuk ishin aq substanciale për kohëzgjatjen e procesit përpara Gjykatës Kushtetuese të cilat e tejkaluan periudhën kohore të arsyeshme | PENAL | pothuajse 2 vjet për secilin paditës |
| Neumeister v. AUSTRISË, 27 qershor 1968 | - vështirësitë që hasën autoritetet austriake jashtë shtetit në marrjen e ekzekutimit të letrave të tyre të shumta rogatore | - vonesat në hapjen dhe rihapjen e seancës u shkakjuan në masën më të madhe nga nevoja për t'u dhënë përfaqësuesve ligjorë të çështjes dhe gjyqtarëve të trupit gjyqësor kohë që ata të familjarizoheshin me të dhënat e çështjes, që përbëhej nga njëzet e një vëllime prej rreth pesëqind faqesh | PENAL | 7 vjet (çështja mbetet ende e pazgjidhur në datën kur u shpall aktgjykimi) |
| Pedersen dhe Baadsgaard v. DANIMARKËS, 17 dhjetor 2004 | - nuk ka detaje lidhur me ato çështje për të cilat çështja u konsiderua i natyrës komplekse | - paditësit dhanë kontributin e tyre në vonesat (jo shumë të përfshirë, nuk kundërshtuan shtyrjet e seancave dhe avokatët e tyre nuk morën pjesë në seancat gjyqësore të caktuara) - Gjykata detajoi kohëzgjatjen e secilit grup procesi dhe nuk konstatoi ndonjë periudhë mosveprimi të zgjatur mjaftueshmërisht që do të përbënte shkelje | PENAL | 5 vjet, 9 muaj |
| Van Pelt v. FRANCËS, 23 maj 2000 | -trafikim ndërkombëtar droge, një sërë personash të përfshirë, natyra ndërkombëtare e organizatës së trafikimit, veprat penale pjesërisht të kryera jashtë shtetit, nevoja për përkthimin e dokumenteve | - një sërë masash të marra nga gjyqtari hetues dhe vendimet e duhura të marra nga trupi gjyqësor - dy mendime mospërputhëse lidhur me çështjen | PENAL | 8 vjet, 8 muaj |

| Gëshjtja | Arsyet për kompleksitetin | Bazat për shkeljen | Lloji i procesit | Kohëzgjatja |
|--|--|--|------------------|---|
| Calvelli dhe Ciglio v. ITALISË, 17 janar 2002 | - sigurisht komplekse (vdekja e një foshnjeje të sapolindur në spital) | - nuk pati periudha të konsiderueshme mosveprimi - gjashtë vjet, tri muaj e dhjetë ditë në katër instanca gjykatash nuk mund të konsiderohet e paarsyeshme | PENAL | 6 vjet, 3 muaj në katër instanca gjykatash |
| I.J.L. dhe të tjerët v. Mbretërisë së Bashkuar 19 shtator 2000 | - vepra penale financiare - vendimi i paditësit për të mos pranuar fajësinë | - autoritetet nuk mund të konsideroheshin përgjegjëse për vonesat | PENAL | 4 ½ vjet |
| Karabas v. TURQISË 21 korrik 2005 | - akuza që bartnin dënime të rënda me burgim - shtatë bashkë-të pandehur - nevoja për të marrë në pyetje disa prej bashkë-të pandehurve dhe dëshmitarëve në gjykata të tjera, pas kërkesës për ndihmesë gjyqësore nga gjykata e sigurisë shtetërore, e cila shkaktoi një vonesë të pashmangshme, veçanërisht në shkëmbimin e korrespondencës mes gjykatave në qytete të ndryshme | - nuk pati periudha të konsiderueshme mosveprimi | PENAL | 3 vjet, 9 muaj në dy instanca gjykatash |
| Özden v. TURQISË, 24 maj 2005 | - pesë bashkë-të pandehur, duke përfshirë dy që ishin arratisur | - mungesa e interesit nga ana e paditësit (mosparaqitja, abstenimi në ditën e shpalljes së aktgjykimit, gjë e cila shkaktoi vonesa lidhur me procesin e ankimit) | PENAL | 4 vjet, 9 muaj në dy instanca gjykatash |
| Sari v. TURQISË, 8 nëntor 2001 | - natyra komplekse pjesërisht e lidhur me ekstradhimin - gëshjtja u bë edhe më komplekse kur i pandehuri u arratis në Danimarkë - juridiksioni që kishin të dyja shtetet, që çoi në vështirësi burokratike dhe kërkesa për përkthime | - paditësi dha kontributin e tij në vonesat, meqenëse detyrimi për paraqitje në gjykatë është një element kryesor në procesin penal - autoritetet nuk dhanë kontribut në përzgjatjen e procesit | PENAL | 8 vjet, 7 muaj |

| Çështja | Arsyet për kompleksitetin | Bazat për shkalljen | Lloji i procesit | Kohëzgjatja |
|---|---|--|------------------|--|
| Kenan Yavuz v. TURQISË, 13 shkurt 2004 | <ul style="list-style-type: none"> - 21 të pandehur - natyra e akuzave kundër paditësit - një sërë veprash penale - nevoja për të mbledhur një sasi të konsiderueshme provash | <ul style="list-style-type: none"> - edhe pse shteti ishte përgjegjës për vonesa të caktuara, kohëzgjatja e përgjithshme e procesit nuk ishte e paarsyeshme | PENAL | më shumë se 5 vjet |
| Akçakale v. TURQISË, 25 gusht 2004 | <ul style="list-style-type: none"> - tri të pandehur për disa vepra penale (një sasi e madhe pune lidhur me rindërtimin e ngjarjeve, mbledhjen e provave dhe përcaktimin e nivelit të përfshirjes) | <ul style="list-style-type: none"> - paditësi dha kontributin e tij në vonesa, duke mos u paraqitur ose duke mos dorëzuar materiale me shkrim të nevojshme për këshillim-votimin e gjykatës - nuk ka periudha mosveprimi | PENAL | 5 vjet, 3 muaj |
| Intiba v. TURQISË, 24 maj 2005 | <ul style="list-style-type: none"> - një sërë personash në çështje - ligji i tatimit | <ul style="list-style-type: none"> - paditësi dha kontributin e tij në vonesa, duke mos u paraqitur, kur kërkoi shtyrje të seancës, shkarko avokatin e tij, ndryshoi adresën me qëllim të shmangies së njoftimit dhe refuzoi të përfaqësohej nga ndonjë avokat - autoritetet ishin përgjegjëse për një vit mosveprim, gjë kjo që nuk pati ndikim në kohëzgjatjen e procesit - në procedurën e kësaj shkalle, të vendosësh sipas një afati kohor varet nga disponueshmëria e avokatëve, si edhe ajo e gjykatës | PENAL | 7 vjet, 11 muaj |
| Keçeci v. TURQISË, 15 korrik 2005 | <ul style="list-style-type: none"> - një sërë të pandehurish, natyra e veprave penale, vështirësi në ripërcaktimin e ngjarjeve dhe përcaktimin e roleve të individëve | <ul style="list-style-type: none"> - nuk pati periudha të konsiderueshme mosveprimi | PENAL | 6 vjet, 2 muaj në pesë instanca gjykatash |

| Çështja | Arsyet për kompleksitetin | Bazat për shkeljen | Lloji i procesit | Kohëzgjatja |
|--|--|---|------------------|------------------|
| Klamecki v. POLONISË, 28 mars 2002 | <ul style="list-style-type: none"> - natyra e akuzave - nevoja për të mbledhur një sasi të konsiderueshme provash - një numër i madh dëshmitarësh të marrë në pyetje në gjykatën e shkallës së parë | <ul style="list-style-type: none"> - paditësit dhanë kontributin e tyre në vonesa, duke mos iu përgjigjur fletë-tërritjeve të gjykatës - i pandehuri mungoi në disa raste, gjë e cila çoi në shtyrjen e procesit - i pandehuri shkarikoi avokatin mbrojtës disa herë | PENAL | 6 vjet, 1 muaj |
| Salapa v. POLONISË, 19 dhjetor 2002 | <ul style="list-style-type: none"> - çështje e trafikimit ndërkombëtar të drogës - dhjetë bashkë-të pandehur - një sërë dëshmitarësh - nevoja për t'u konsultuar me dosjet e proceseve aktuale në gjykata të tjera, për qëllimet e provave | <ul style="list-style-type: none"> - paditësi dha kontributin e tij në vonesa, duke munguar disa herë (ashtu siç bënë edhe dëshmitarë të caktuar) - gjykata u përpoq të përshpejtonte procesin duke i refuzuar kërkesat e paditësit që çështja të kthehej në prokurori dhe që çështja e tij të ndahej nga ajo e dy bashkë-të pandehurve të tjerë, të cilët mungonin | PENAL | 5 vjet, 8 muaj |
| G.K. v. POLONISË, 20 janar 2004 | <ul style="list-style-type: none"> - çështje e natyrës komplekse siç tregohet edhe nga vëllimi i provave të marra dhe të dëgjuaara gjatë procesit - 13 të pandehur, 104 dëshmitarë dhe 9 dëshmitarë ekspertë | <ul style="list-style-type: none"> - i pandehuri dha kontributin e tij në vonesa, nëpërmjet mungesave ose kërkesave për shtyrje të seancave - vonesat nuk ishin relativisht të gjata dhe sigurisht nuk i atribuoheshin autoriteteve | PENAL | pothuajse 5 vjet |
| Sablon v. BELGJIKËS, 10 prill 2001 | <ul style="list-style-type: none"> - çështje e natyrës mjaft komplekse, për shkak të nevojës për përcaktim njëzet vjet më vonë nëse paditësi kishte qenë në nivelin e falimentimit dhe vështirësisë së përcaktimit të aseteve të tij | <ul style="list-style-type: none"> - paditësi kishte dorëzuar mjaft kërkesa, disa prej të cilave nuk kishin qenë relevante ose nuk kishin pasur kuptim, duke e komplikuar kështu çështjen edhe më tepër - nuk pati periudha të konsiderueshme mosveprimi që i atribuoheshin autoriteteve | CIVIL | |

| Çështja | Arsyet për kompleksitetin | Bazat për shkeljen | Lloji i procesit | Kohëzgjatja |
|--|---|--|------------------|---------------------------------------|
| Soc v. KROACISË, 9 gusht 2003 | - vdekja e palës bashkë-kontraktuese, që ia kishte shitur pronën një pale të tretë, pavarësisht nga kontrata - kontratat e tjera nuk ishin regjistruar | - paditësi nuk i kishte dhënë përgjigje aludimeve të të paditurit dhe kishte munguar nga seanca të caktuara - përndryshe seancat ishin zhvilluar rregullisht | CIVIL | 4½ vjet x dy grupe procesesh |
| Acquaviva v. FRANCËS, 21 nëntor 1995 | - klimë e tensionuar politike në Korsikë | - paditësit dhanë kontributin e tyre në zgjatjen e procesit - hapa të nevojshëm gjatë hetimit ishin ndërmarrrë me një ritëm të rregullt - vonesat e justifikuara nga situata politike | CIVIL | 4 vjet, 4 muaj |
| Proszak v. POLONISË, 16 dhjetor 1997 | - këshilla specialistike mjekësore themelore | - paditësja dha kontributin e saj në vonesat nëpërmjet tri sfidave (ankesave) të pabazuara, nuk mori pjesë nëpër disa seanca dhe refuzoi të merrte pjesë në ekzaminimin psikiatrik - pothuajse e gjithë periudha brenda juridiksionit të saj <i>ratione temporis</i> u kalua me kërkimet për gjetjen e një eksperti me kualifikime të mjaftueshme specialistike, ashtu siç kishte dashur vetë paditësja. Duke i kushtuar vëmendje të veçantë "pjesës që kishte luajtur paditësja përgjatë procesesh", Gjykata arriti në përfundimin se nuk kishte pasur shkelje | CIVIL | 3 vjet, 9 muaj |
| Glaser v. MBRETËRISË së BASHKUAR 13 dhjetor 2000 | - histori familjare e komplikuar: nevoja për të ripërcaktuar besimin mes paditësit dhe fëmijës së tij dhe vendosmërisë së nënës për të shmangur kontaktin me të | - paditësi dha kontributin e tij në vonesat - vonesat nuk i atribuohen autoriteteve | CIVIL | 3 vjet, 11 muaj |
| Olsson Il v. SUEDISË, 27 nëntor 1992 | - vlerësime të vështira dhe hetime gjithëpërfshirëse | - seancat u zgjatën për një periudhë prej 13½ muajsh në tri instance gjykatash, e cila nuk ishte e tepruar | CIVIL | 13½ muaj në tri instance gjykatash |

| | | | | |
|---|--|--|---|--|
| <p>Çështja</p> <p>Süssmann v. GJERMANISË, 16 shtator 1996</p> | <p>Arsyet për kompleksitetin</p> <p>- çështja "ishte njëra nga njëzet e katër ankesat kushtetuese që ngrinin çështje të ngjashme të një farë vëzhgimi, që kishin të bënin me pensionet shtesë të një numri nëpunësish civilë gjermanë, që shkaktoi nevojën e një shqyrtimi të detajuar substancial nga ana e gjykatës"</p> | <p>Bazat për shkeljen</p> <p>"duke pasur parasysh kontekstin unik politik të ribashkimit gjerman dhe ndërlikimet e mëdha shoqërore të mosmarrëveshjeve që kishin të bënin me ndërprerjet e kontratave të punës, Gjykata Federale Kushtetuese gëzonte të drejtën të vendoste se duhet t'i jepte prioritet këtyre çështjeve"</p> | <p>Lloji i procesit</p> <p>ADMINISTRAT IV</p> | <p>Kohëzgjatja</p> <p>3 vjet, 4 muaj</p> |
|---|--|--|---|--|

Shtojca 3 bis: Çështjet e natyrës komplekse – shkelja e Nenit 6 § 1

| Çështja | Arsyvet për kompleksitetin | Bazat për shkeljen | Lloji i procesit | Kohëzgjatja |
|--|---|---|---|---|
| Sürmeli v. GJERMANISË, 8 qershor 2006, 77529/01 | Kompleksiteti shkaktohet për faktin se ishin bërë disa vlerësime mjekësore për të përcaktuar dëmin fizik dhe mendor të vuajtur nga paditësi. Kjo vëzhgimi u shtua edhe më shumë për shkak të një aksidenti tjetër që ndodhi gjatë zhvillimit të procesit, që krijonte nevojën për vlerësime të mëtejshme ekspertësh. | Gjykata vë re se çështja nuk është veçanërisht e natyrës komplekse. Megjithatë, ajo pranon që kompleksiteti i saj u rrit në aspektin procedural atëherë kur u bë e nevojshme, pas aksidentit të dytë të paditësit, që të kërkohej mendimi i disa ekspertëve mjekësorë se deri në ç'masë i kishte shkaktuar aksidenti i parë dëme fizike dhe mendore. Për më tepër, ndërkohë që Gjykata e pranon se një kohë e caktuar ishte e nevojshme për përgatitjen e raporteve të ekspertëve, ajo konsideron se periudha e përgjithshme kohore që mori kjo gjë, e tejkaloi kohëzgjatjen e arsyeshme. Së fundmi, Gjykata vë re se vonesat e shkaktuara nga katër kërkesat e paditësit për dorëheqjen e gjyqtarëve, në vetvete nuk mund të jenë përgjegjëse për kohëzgjatjen e procesit. | Civil: padi për rritje të pensionit të paaftësisë si rrjedhojë e dy aksidenteve | 16 vjet e 7 muaj |
| Casse V. Luksemburgut 27 prill 2006, 40327/02 | Natyrë komplekse e çështjes rrjedh nga fakti se proceset civile me anë të të cilave kërkohej konfirmimi i vlefshmërisë së urdhrit të bashkëngjitur u pezulluan në pritje të rezultetit të procesit penal (për përvetësim) në përputhje me parimin që "proceset civile duhet të presin rezultatin e proceseve penale". Çështja mbetet ende në listën e çështjeve të gjykatës së apelit, në mungesë të ndonjë hapi të mëtejshëm të palëve në proces. Në kohën e marrjes së vendimit nga Gjykata, paditësi nuk ishte akuzuar ende. | Lidhur me shkeljen e aluduar të procedurës civile, Gjykata vë re se pezullimi i procesit civile në pritje të rezultetit të procesit penal, rezultoi në faktin që procesi civil zgjati për më shumë se 10 vjet. Ajo konstaton se është në dorën e autoriteteve kombëtare që të organizojnë sistemet e tyre gjyqësore në mënyrë të tillë që të sigurohen që përmbushet kërkesa e kohës së arsyeshme, sipas Nenit 6, për këdo. Më tej, Gjykata thekson se duke mos qenë ende i akuzuar, paditësi nuk ka ndonjë status procedural sipas ligjit vendor, që përbën edhe një rrethanë rëndëse lidhur me shkeljen e Nenit 6 § 1. | Civil: urdhër i bashkëngjitur Penal: përvetësim | Kohëzgjatja e përgjithshme (procese civile dhe penale): 9 vjet e 10 muaj, procesi penal ende nuk ka përfunduar |
| SIFFRE, ECOFFET, BERNARDINI V. FRANCËS | Natyrë komplekse e kësaj çështjeje rrjedh nga fakti i mbivendosjes së dy grupeve të proceseve në Gjykatën Rajonale të Auditorëve (GJRA) dhe | Gjykata vë re se GJRA-ja lëshoi gjashtë aktgjykime të përkohshme apo të formës së prerë, në përputhje me rregullin e "aktgjykimit të dyfishtë". Tri prej këtyre aktgjykimeve u dërguan si ankesa në Gjykatën e Auditorëve, e cila urdhëroi pezullimin e ekzekutimit | Administrativ: de facto menaxhimi i një shoqërie nga | 5 vjet e 4 muaj |

| Çështja | Arsyet për kompleksitetin | Bazat për shkeljen | Lloji i procesit | Kohëzgjatja |
|---|--|--|---|------------------------|
| <p>12 dhjetor 2006</p> <p>49699/99, 49700/99,</p> <p>49701/99</p> | <p>në Gjykatën e Auditorëve. Proceset financiare bazohen në rregullin e "aktgjykimit të dyfishtë", sipas të cilit lëshohet një vendim i përkohshëm nga GjRA-ja, dhe pastaj një vendim përfundimtar, që çon në faktin që Gjykata e Auditorëve të pezullojë procesin në pritje të vendimit përfundimtar.</p> | <p>Bazat për shkeljen</p> <p>përpara se të lëshonte aktvendime lidhur me meritat e çështjes shtatë muaj më vonë në ankesën e shkallës së dytë e të tretë; vonesa në dy rastet e fundit u shkaktua nga fakti se procedura e apelit në gjykatat financiare u pezullua në pritje të rezultateve të procesit gjyqësor që kishte të bënte me vlefshmërinë e vendimit të kështilltarëve të komunës.</p> <p>Pavarësisht se proceset në gjykatat financiare kanë specifika karakteristike që i bëjnë ato komplekse, Gjykata nuk e konsideron këtë si një shpjegim bindës për vonesat në proces dhe nuk konsideron që paditësit përfituan nga këto karakteristika për të justifikuar vonesat. Gjykata konstaton se, sipas jurisprudencës së ligjit vendor (Conseil d'Etat, 14 dhjetor 2001, <i>Société Réflexions, Médiations, Ripostes</i>), procese të tilla përbëjnë një grup të vetëm procesesh edhe nëse ato përfshijnë disa aktgjykime. Gjykatat vendore nuk mund të akuzohen për mosveprim. Megjithatë, në mënyrë paradoksale, numri i madh i hapave proceduralë të përfshirë në këto procese financiare, që synonin mbrojtjen e të drejtave të palës mbrojtëse, kanë efektin e kundërt tek i pandehuri. Procedura e "aktgjykimit të dyfishtë" u kritikua edhe nga vetë Gjykata e Auditorëve, në emër të së drejtës së gjykimit të drejtë.</p> | <p>kështilltarët komunalë</p> | |
| <p>KAROV V. BULLGARISË</p> <p>16 nëntor 2006</p> <p>45964/99</p> | <p>Natyra komplekse e kësaj çështjeje i atribuohet humbjes së dosjes penale të çështjes, dhe në veçanti, mangësi të shumta të pajustificuara të çështjes në fazën hetimore.</p> | <p>Gjykata vë re që në fillim se procesi u vonua për tri vjet e gjysmë për shkak të kohës që u desh autoriteteve të gjenin dosjen e humbur penale të çështjes. Megjithatë, Gjykata konstaton se nuk mund ta pranojë pretendimin e qeverisë se një vonesë e tillë kaq e gjatë mund të shpjegohet me anë të faktit "objektiv" të zhdukjes së dosjes, por ajo thekson, në të kundërtën, se autoritetet gjyqësore nuk vepruan me korrektesën e duhur. Më tej Gjykata konsideron se mangësitë e shumta kishin të bënin me parregullsitë procedurale, të cilat mund të korrigjoheshin vetëm duke e kthyer çështjen në fazën hetimore.</p> <p>Gjykata nxjerr në pah se mangësitë e përsëritura të pajustificuara të çështjeve në fazën hetimore ishin shaku i vonesave të tejzgjatura në proces në çështjet e mëparshme kundër Bullgarisë (<i>Vasilev v. Bullgarisë</i>, nr. 59913/00, 2 shkurt 2006).</p> | <p>Penal: pranimi dhe kërkimi i mitës</p> | <p>9 vjet e 9 muaj</p> |
| <p>RAZLOVA V. REPUBLIKËS ÇEKE</p> <p>20252/03</p> <p>28 mars 2006</p> | <p>Natyra komplekse e kësaj çështjeje shkaktohet nga madhësia e dosjes së çështjes, me shtatë persona, duke përfshirë edhe paditësin, të akuzuar për vepra penale financiare. Nevojitej një hetim i thelluar për të identifikuar lidhjet mes një numri të madh njerëzish. U morën në pyetje shumë dëshmitarë. Hetuesi kërkoi</p> | <p>Gjykata pranon se tipari kryesor i çështjes është natyra komplekse e saj. Paditësja dyshohet për kryerjen e veprave penale financiare të kryera me anë të transaksioneve komplekse të synuara për të mos u vënë re nga shqyrtimi i kujdesshëm i organeve hetimore. Shkalla e hetimit dhe natyra komplekse e dosjes së çështjes janë të pamohueshme, duke qenë kështu argumentet e para që mund të përdoren për të justifikuar proceset e zgjatura. Më pas, Gjykata vë re se disa vonesa të konsiderueshme u shkaktuan nga gjendja shëndetësore e paditëses, që u shtrua në spital për çrregullime psiqike. Deri në masën që këto vonesa i atribuohen mjekimit dhe shtrimit në spital të paditëses, ato përbëjnë një faktor force majeure. Sëmundja e paditëses e parandaloi atë</p> | <p>Keqërdorimi i informacionit në marrëdhëniet e biznesit</p> | <p>7 vjet e 9 muaj</p> |

| Çështja | Arsyet për kompleksitetin | Bazat për shkeljen | Lloji i procesit | Kohëzgjatja |
|--|--|--|---|--|
| | <p>autorizim paraprak që të kishte qasje në dokumente të caktuara, të cilat ishin subjekt i sekretit bankar. U debatua se edhe paditësit, po ashtu, dha kontributin e saj në gjatësinë e procesit në varësi të gjendjes së saj të shëndetit mendor, që e bëri të nevojshëm përgatitjen e disa raporteve. Pavarësisht se provat u mblodhën shpejt, nuk ishte e mundur të përfundonhej hetimi sepse paditësit nuk kishte qenë në gjendje të inspektonte dosjen që kishte të bënte me statusin e saj shëndetësor.</p> | <p>që të merrte pjesë në proces, gjë e cila pa dyshim pengoi kryerjen e hetimit. Për më tepër, paditësit nuk mori pjesë në seancat e caktuara dhe në dy raste ajo refuzoi të pranonte dorëzimin e njoftimeve që e ftonin të inspektonte dosjen e çështjes. Megjithatë, Gjykata konstatoi se Neni 6 nuk kërkon që palët të bashkëpunojnë në mënyrë aktive me autoritetet. Ndërkohë që pranohet se kryerja e hetimit u pengua nga sëmundja e paditësit, Gjykata theksoi se ky fakt nuk i justifikon vonesat në proces. Sipas Nenit 173 të Kodit çek të Procedurës Penale, hetuesi dhe, që më datën 1 janar 2002, prokurori publik mund të pezullojnë procesin penale nëse i pandehuri vuan nga një sëmundje e rëndë, që e bën të pamundur sjelljen e tij/saj përpara gjykatës, ose nëse, personi ka zhvilluar një sëmundje mendore pas kryerjes së veprës penale me të cilën akuzohet, i/e pandehuri/-a nuk është në gjendje të kuptojë procesin penale kundër tij/saj; nëse arsyeja për një pezullim të tillë nuk ekziston më, procesi duhet rifilluar. Megjithatë, duket sikur në çështjen në fjalë autoritetet nuk morën në konsideratë përdorimin e kësaj mase. Prandaj, Gjykata konsideron se autoritetet kombëtare nuk treguan korrektesën e kërkuar për zhvillimin e duhur të procesit.</p> | <p>Penali: grabitje me armë që përfshinte përdorimin e dhunës</p> | <p>4 vjet e 10 muaj</p> |
| <p>MONTHSEJEVS V. LATVIAS 64846/01 15 qershor 2006</p> | <p>Natyrë komplekse e kësaj çështjeje rezultoi nga fakti se përfshinte 12 raste grabitjeje me armë të kryera në vende të ndryshme në Letoni dhe disa vepra penale të vjedhjes së rëndë që përfshinin gjashtëmbëdhjetë të pandehur. Si rrjedhojë, dosja e çështjes është mjaft voluminoze, që përbëhet nga njëzet vëllime.</p> | <p>Gjykata e pranon se natyra komplekse e kësaj çështjeje penale është e pamohueshme. Akuzat kishin të bënin me dymbëdhjetë raste grabitjeje me armë të kryera në vende të ndryshme në Letoni dhe disa vepra penale të vjedhjes së rëndë. Gjashtëmbëdhjetë persona u akuzuan dhe autoritetet duhet të identifikonin natyrën e saktë të veprave penale të kryera nga secili prej tyre. Gjykata është vetëdijshme për problemet praktike të natyrës procedurale apo teknike që mund të dalin në çdo kohë gjatë procesit që përfshin një numër të madh të pandehurish. Gjykata vë re madhësinë e dosjes së çështjes, që përbëhet fillimisht nga pesëmbëdhjetë, dhe pastaj njëzet vëllime. Ajo pranon që analizimi i të gjithë dokumenteve në dosje nga ana e departamentit të prokurorisë publike, dhe më pas nga gjykatat kërkuan një kohë të gjatë. Megjithatë, Gjykata vë re se çështjet që kanë të bëjnë me funksionin administrativ të gjykatave, të tilla si një ngarkesë e madhe çështjesh, pushimet e gjyqtarëve, caktimi i çështjeve gjyqtarëve, njohuritë e tyre lidhur me një fushë të veçantë ligjore, etj..., mbeten përgjegjësia e vetme e Shtetit të paditur dhe nuk mund të përdoren në asnjë rrethanë për të justifikuar vonesat në procesin penal. Ndërkohë që Gjykata nje natyrën komplekse të çështjes, ajo konsideron se autoritetet nuk treguan korrektesën e kërkuar për kryerjen e procedurës në mënyrën e duhur.</p> | | |
| <p>HRISTOVA V. BULLGARIË 60859-00 7 dhjetor 2006</p> | <p>Kjo çështje ka të bëjë me një sërë veprash penale të kryera bashkërisht në territorin e disa vendeve. 129 persona u thirrën si dëshmitarë dhe dosja hetimore përbëhet nga më se 30 vëllime.</p> | <p>Gjykata vë re se akuzat kishin të bënin me vepra penale të një shkalle të gjerë, të cilat preknin mjaft persona, disa prej të cilave ishin kryer në vende të tjera. Shqyrtimi i çështjes përfshinte një sërë hapash hetimorë, duke përmendur këtu edhe kërkesat për ndihmesë gjyqësore. Po ashtu, gjykata mori në pyetje një sërë dëshmitarësh dhe ekspertësh. Prandaj, çështja ishte mjaft komplekse, si për sa i përket fakteve, ashtu edhe ligjit. Megjithatë, Gjykata vë re, se gjatë hetimit paraprak, që zgjati për një periudhë prej tri vjet e katër muaj, një sërë vonesash i atribuohen autoritetëve. Hetimi u mbyll tri herë, por prokurori publik e ktheu dosjen e çështjes për shkak të parregullsive procedurale ose sepse hetimi nuk ishte i plotë. Këto janë rrethanat të cilat i atribuohen autoritetëve dhe natyra përsëritëse e të cilave nuk mund të shpjegohet vetëm nga aspekti kompleks i</p> | <p>Transaksione mashtruese të kryera bashkërisht</p> | <p>Paraburgim: 3 vjet, 7 muaj e 19 ditë Gjithsej: 9 vjet, 3 muaj e 3 ditë, periudhë që mbulononte hetimin paraprak dhe 3 instanca juridiksioni</p> |

| Çështja | Arsyet për kompleksitetin | Bazat për shkeljen | Lloji i procesit | Kohëzgjatja |
|--|--|---|---|---|
| <p>REMZI AYDIN V. TURQISË</p> <p>30911/04</p> <p>20 shkurt 2007</p> | <p>Paditësi u akuzua për 43 akte terroriste, duke përfshirë bombardime dhe sulme të armatosura, të kryera në qytete të ndryshme në emër të një organizate të paligjshme.</p> | <p>çështjes. Këto probleme dhe periudhat disa mujore që iu nevojitën hetuesve në çdo rast për të ndërmarrë hapat e kërkuar nga departamenti i prokurorisë publike, çuan në vonesa të konsiderueshme të procesit. Pastaj, u dëshën disa muaj që të hartohet aktakuza. Gjykata vë re, po ashtu, se seanca ankimore në gjykatën e apelit u zhvillua rreth një vit e dy muaj pas dorëzimit të ankesës nga të pandehurit, që nuk mund të konsiderohet e arsyeshme në rrethanat e çështjes, duke pasur parasysh se procesi kishte zgjatur tashmë për pothuajse gjashtë vjet.</p> | <p>Penal: terrorizëm</p> | <p>8 vjet e 6 muaj, me pesë veprime të ndërmarrë dhe dy instanca juridiksioni</p> |
| <p>DIMOV V. BULLGARISË</p> <p>56762/00</p> <p>8 mars 2007</p> | <p>Marrja e provave, mbështetja në disa vlerësime ekspertësh</p> | <p>Gjykata vë re se kjo çështje ishte relativisht komplekse, si nga ana faktike, ashtu edhe ajo ligjore. Nga njëra anë, paditësi nuk e pranoi asnjëherë fajësinë dhe deklaroi që vepra penale ishte kryer nga njëri prej viktimave, i cili rrjedhimisht plagosi veten. Gjykatave iu desh të merrnin prova dhe të mbështeteshin në një mori vlerësimesh ekspertësh, me qëllim që të përcaktonte të vërtetën e versioneve të ndryshme. Nga ana tjetër, Gjykata vë re se paditësi ishte përgjegjës për dy shtyrje të procesit. Megjithatë, vonesa e përgjithshme e shkaktuar nga kjo gjë, ishte më pak se katër muaj, që nuk përbën shkak të mjaftueshëm për të shpërguar kohëzgjatjen e procesit.</p> | <p>Penal: vrasje dhe tentativë për vrasje</p> | <p>7 vjet e 9 muaj</p> |
| <p>RAWAY dhe WERA V.</p> <p>BELGIJIKËS</p> <p>25864/04</p> <p>27 nëntor 2007</p> | <p>Përgjegjësia e Shtetit belg del në pah, mbi bazën e jurisprudencës belge, lidhur me bazat e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - veprimet e gjyqtarëve - kohëzgjatje e tepërt e proceseve administrative - kohëzgjatje e tepërt e proceseve | <p>Gjykata vë re se procesi në shkallën e parë zgjati shtatë vjet. Raporti i ekspertit që u urdhërua nga gjykata e shkallës së parë, që do të dorëzohet brenda tri muajsh që nga caktimi i ekspertit, mori tri vjet e gjysmë. Edhe nëse zbritet koha e kërkuar nga paditësit për kërkesën e zëvendësimit të ekspertit, mbeten ende edhe dy vjet e gjysmë. Gjykata vë re se eksperti po punonte në kontekstin e procesit gjyqësor dhe po mbikëqyrej nga një gjyqtar, i cili ishte përgjegjës për përgatitjen dhe zhvillimin e shpejtë të çështjes. Së fundmi, Gjykata vë re se Gjykata e Kasacionit e shtyu procesinsine die. Në bazë të provave që kishte përpara saj, Gjykata konsideron se nuk është dhënë asnjë shpjegim i vlefshëm për këto vonesa nga ana e qeverisë. Në dritën e aktgjykimeve të fundit të shpallura për këtë temë lidhur me Belgjikën, Gjykata konsideron se kohëzgjatja e procesit është i tepërt dhe nuk mund të trajtohet si "e arsyeshme".</p> | <p>Civil: ndërtim prone</p> | <p>15 vjet</p> |

| Çështja | Arsyet për kompleksitetin | Bazat për shkëlqjen | Lloji i procesit | Kohëzgjatja |
|---|--|---|-------------------|--|
| <p>civile</p> <p>Natyrë komplekse e këtij çështjeje i atribuohet mbivendosjes së proceseve administrative (veprimi i sjellë përpara gjykatës administrative që kundërshtonte ligjshmërinë e vendimit të inspektoriatit të punës që autorizonte heqjen nga puna të një punonjësi të mbrojtur dhe veprimin për të përcaktuar përgjegjësinë e Shtetit për keqfunksionimin e sistemit të drejtësisë dhe procesi gjyqësor (padi në gjykatën e punës për të kundërshtuar heqjen nga puna, proces penale ndaj paditësit për falsifikim dhe përdorim të dokumenteve të falsifikuara, përvetësim dhe mashtrim, që kishin qenë edhe arsytet e heqjes nga puna). Paditësi kërkoi pezullimin e procesit në lidhje me padinë e tij për rrogat e prapambetura, pagesën e papunësisë, kompensimin për pushimet e pabëra, dhe rimbursimin për shpenzimet e udhëtimit, pas vendimit përfundimtar të procesit penal ndaj tij. Gjithashtu, ai kërkoi pezullimin e procesit lidhur me padinë e tij për kompensim për heqjen e gabuar nga puna, pas vendimit përfundimtar të gjykatave administrative.</p> | <p>Gjykata nxjerr në pah se organizimi i sistemit të drejtësisë në mënyrë të tillë që gjykatat e tyre t'i garantojnë secilit të drejtën e marrjes së një vendimi përfundimtar lidhur me paditë që kanë të bëjnë me të drejtat e tyre civile dhe detyrimet brenda një periudhe kohore të arsyeshme, është në dorën e Shteteve Kontraktuese.</p> <p>Gjykata konsideron se paditësi nuk mund të kritikohet për faktin se i ka ushtruar të gjitha mjetet ligjore (të zakonshme dhe ankesat e kasacionit) që ishin në dispozicion të tij. Lidhur me ankesat që u morën në shqyrtim nga gjykatat vendore e që mund të ishin dorëzuar si pjesë e një taktike vonuese apo për ndonjë qëllim tjetër të gabuar, vetëm veprimi i ndërmarrë ndaj aktgjykimit të gjykatës së apelit për mos-vendosjen e çështjes së ngritur në parashtrësia, ka të ngjarë të ketë pasur ndonjë ndikim në kohëzgjatjen e përgjithshme të procesit të punës. Së fundmi, fakti që paditësi kishte kërkuar pezullimin e procesit nuk i përjashtonte autoritetet vendore nga përgjegjësia e tyre lidhur me kohëzgjatjen e procesit administrative.</p> | <p>Gjykata e punës: heqja nga puna e një punonjësi të mbrojtur</p> <p>Administrativ:</p> <p>- padi që kundërshtonte ligjshmërinë e vendimit të inspektoriatit të punës, i cili autorizonte heqjen nga puna - përgjegjësia e Shtetit për keqfunksionimin e sistemit të drejtësisë</p> <p>Penale: falsifikim dhe përdorim i dokumenteve të falsifikuara, përvetësim dhe mashtrim</p> | <p>14 vjet</p> | |
| <p>REMZİ AYDIN V. TURQİSİ</p> <p>30911/04</p> <p>20 shkurt 2007</p> | <p>Paditësi ishte akuzuar për 43 akte terroriste, duke përfshirë bombardimet dhe sulmet e armatosura, të kryera në qytete të ndryshme në emër të një organizate të paligjshme.</p> | <p>Gjykata vë re, po ashtu si qeveria, natyrën relativisht komplekse të procesit të kundërshtuar, që ka të bëjë pjesërisht me shkallën e hetimit dhe numrin e vlerësimeve të ekspertëve që kërkoheshin për 43 aktet terroriste të kryera në qytete të ndryshme. Megjithatë, duke treguar vëmendje për jurisprudencën e përcaktuar që kishte të bënte me problemet e krijuara nga ngarkesa e gjykatave, Gjykata konsideron se procesi nuk u përfundua brenda një periudhe të arsyeshme. Nuk është e nevojshme që Gjykata të kërkojë të përcajtojë autoritetin përgjegjës për zgjatjen e tepërt të procedurës, sepse në</p> | <p>Terrorizëm</p> | <p>8 vjet e 6 muaj në dy nivele juridiksioni ku u aplikua 5 herë</p> |

| Çështja | Arsyet për kompleksitetin | Bazat për shkellen | Lloji i procesit | Kohëzgjatja |
|---|--|---|---|---|
| <p>DIMOV V. BULLGARISË 56762/00 8 mars 2007</p> | <p>Gjykata mori në pyetje 17 dëshmitarë, organizoi një sërë ballafaqimesh të dëshmitarëve dhe urdhëroi përgatitjen e disa raporteve të ekspertëve. Çështja u shqyrtua në gjashtë nivele juridiksioni.</p> <p>Për më tepër, seancat e kësaj çështjeje u vonuan nga reforma e sistemit gjyqësor bullgar në prill të vitit. 1998.</p> | <p>gjithë çështjet e kësaj natyre, përgjegjësia bie mbi Shtetin.</p> | <p>Penal: vrasje dhe tentativë për vrasje</p> | <p>7 vjet e 9 muaj</p> |
| <p>GÜNSELİ dhe YAYIK V. TURQISË 20872/02 21 shkurt 2008</p> | <p>Vështirësia doli nga bashkimi i gjashtë ndjekjeve penale për pengimin e lirisë së punës dhe punësimit</p> <p>Kjo çështje është komplekse për shkak të incidenteve të përsëritura procedurale dhe numrit të ndjekjeve penale në fjalë, që përfshinin 39 të pandehur.</p> | <p>Gjykata pranon se procedurat ishin relativisht komplekse lidhur me atë që gjykatat që kishin juridiksionin duhet të trajtonin procedurat që kishin të bënin me 39 të pandehur dhe Gjykata rajonale penale e shkallës së parë duhet të bashkonte disa çështje që kishin lidhje. Ky fakt dhe vetë natyra e veprave penale të aluduara nënkuptonin një proces të gjatë të rindërtimit të fakteve, mbledhjes së provave dhe përcaktimit të përgjegjësisë për secilin të pandehur të pretenduar. Megjithatë, këto tipare në vetvete nuk e justifikojnë kohëzgjatjen e procedurës. Që nga koha kur u bashkuar procedurat, gjykatës rajonale penale iu deshën pesë vjet e tetë muaj për të shpallur aktgjykimin e saj. Për më tepër, gjykata rajonale penale në mënyrë të përsëritur i shtyu seancat thjeshtë sepse njëri nga të pandehurit mungonte. Lidhur me këtë, Gjykata vë re se Neni 6 § 1 kërkon që Shtetet Kontraktuese të organizojnë sistemin e tyre gjyqësor në mënyrë të tillë që gjykatat të mund të përmbushin secilën prej kërkesave të tyre, duke përfshirë këtu edhe atë të kohës së arsyeshme. Gjykata vë re se seancat u shtynë në mënyrë të paarsyeshme nga ana e gjykatës rajonale penale, gjë e cila çoi edhe në tejzgjatjen e procesit.</p> | <p>Penal: pengimi i lirisë së punës dhe punësimit</p> | <p>6 vjet e 5 muaj në rastin e një paditësi 6 vjet e 2 muaj në rastin e një paditësi tjetër</p> |
| <p>SHORE TECHNOLOGIES V. LUKSEMBURGUT 35704/06 31 korrik 2008</p> | <p>Qeveria debatoi se kohëzgjatja e hetimit kishte të bënte me kohën që nevojitej për të përcaktuar vendndodhjen e së pandehurës dhe faktin që ndihmesa ndërkombëtare ligjore është duke u kërkuar aktualisht, me qëllim që ajo të merret në pyetje.</p> | <p>Gjykata pranon se hetimi ishte relativisht kompleks, veçanërisht duke pasur parasysh nevojën e kërkimit të ndihmesës ligjore ndërkombëtare, në mënyrë që e pandehura të merrej në pyetje pasi të ishte përcaktuar vendndodhja e saj. Megjithatë, vetëm kjo në vetvete nuk mund të jetë përgjegjëse për kohëzgjatjen e procesit. Lidhur me sjelljen e paditësit në kompani, Gjykata nuk gjen asnjë provë se ajo pengoi kryerjen e hetimit në mënyrën e duhur, gjatë ndonjë faze të tij. Sipas këtyre rrethanave, Gjykata konsideron se periudha prej gjashtë vjetësh vetëm për fazën hetimore, që është ende në zhvillim e sipër, nuk mund të quhet e arsyeshme.</p> | <p>Penal: palë civile në proces penal që lidhet me lëshimin e çqeve të falsifikuara</p> | <p>6 vjet e 8 muaj gjatë fazës hetimore Çështja mbetet ende e pazgjidhur</p> |
| <p>WAUTERS dhe SCHOLLAERT V.</p> | <p>Kjo çështje e veprave penale financiare përfshinte shoqata dhe</p> | <p>Gjykata vë re kompleksitetin e madh të çështjes, siç pranohet edhe nga qeveria dhe paditësit. Hetimi kishte të bënte me një çështje penale financiare që përfshinte disa</p> | <p>Penal: përvetësim fondesh në një</p> | <p>10 vjet e 11 muaj</p> |

| Çështja | Arsyet për kompleksitetin | Bazat për shkëlqjen | Lloji i procesit | Kohëzgjatja |
|--|--|--|--|---|
| <p>BELGIKËS 13414/05 13 maj 2008</p> | <p>kompani të ndryshme, gjashtë të pandehur dhe disa kërkesa për ndihmesë ligjore në vende të ndryshme (duke përfshirë Francën dhe Luksemburgun), që kërkonte një proces të konsiderueshëm të rindërtimit të fakteve dhe mbledhjes së provave (mbledhjen e të dhënave, seanca dëgjimore, sekuestime, bastisje, etj...). Çështja përbëhet nga rreth tridhjetë kuti dhe disa dosje dokumentesh, që zënë disa metra vend nëpër raftë. U sekuestruan një numër i madh dokumentesh (200 000) që u analizuan nga hetuesit specialë. U analizuan mjaft transaksione bankare, si edhe struktura të ndryshme financiare të ngritura për një periudhë prej rreth dhjetë vjetësh. Edhe komponenti fiskal, po ashtu, ishte mjaft kompleks. Paditësit debatojnë që ky kompleksitet ishte ndërfikuar nga fakti që gjyqtarit hetuesi mungonte personeli i nevojshëm dhe nuk ishin caktuar ekspertë.</p> | <p>shoqata dhe kompani. Struktura financiare dhe fiskale mbulonnte disa vende. Megjithatë, Gjykata vë re se disa vonesa ndodhën për shkak të problemeve, siç del të natyrës strukturore, që ishin specifike për gjykatën e shkallës së parë, që përfshin edhe zvogëlimin e ekipit hetues nga njëzet vetë në tri vetë dhe pranimin nga ana e gjyqtarit hetues se ishte e pamundur që për arsye logjistike të merreshin në pyetje paditësit. Së fundmi, Gjykata vuri re disa periudha mosveprimi, prej të cilave rrjedh se kohëzgjatja e hetimit që i kishte tejkaluar kufijtë e arsyeshëm.</p> | <p>grup shoqatash puna e së cilave kishte të bënte me kujdesin ndaj personave të paafitë dhe mbështetjen e projekteve integruese socio-arsimore.</p> | |
| <p>WILCZKOWSKA dhe të tjerët V. POLONISË 28983/02 8 janar 2008</p> | <p>Natyrë komplekse e kësaj çështjeje varet, nga njëra anë, për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar që kur kanë ndodhur faktet, sepse procedura për shpronësimin në interes të publikut daton që më 1975. Nga ana tjetër, ndërkohë sistemi gjyqësor polak është reformuar, gjë e cila ka pasur ndikimin e saj edhe në veprimet e paditësve ndaj administratës që nuk ka vepruar.</p> | <p>Gjykata vë re se paditësi dorëzoi një padi kundër autoritetit ankimor administrativ për mosveprim. Veprimet ndaj administratës që nuk vepron, siç parashikohet edhe me anë të ligjit të vjetër (1995) mbi Gjykatën Supreme Administrative dhe me anë të ligjit aktual në fuqi për proceset përpara gjykatave administrative, supozohet të jenë një mjet ligjor i efektshëm ndaj zgjatjes së tepruar të proceseve administrative (<i>Bukowski v. Polonisë</i>, nr. 38665/97, 11 qershor 2002).</p> <p>Gjykata e pranon se proceset ishin relativisht komplekse. Megjithatë, Gjykata konsideron se kohëzgjatja e procesit nuk mund të shpjegohet vetëm nga natyra komplekse e çështjes. Gjykata ka trajtuar, në mjaft raste, çështje që ngrenë probleme të ngjashme me ato të çështjes aktuale dhe ka konstatuar shkelje të Nenit 6 § 1 të Konventës.</p> | <p>Administrativ, veprim për të rimarrë pronën pas shpronësimit dhe kompensimin</p> | <p>14 vjet 10 vjet e 8 muaj të mbuluara nga Juridiksioni i gjykatës <i>ratione temporis</i></p> |
| <p>KEMAL BALIKÇI V. TUROJISË</p> | <p>Qeveria deklaroi se çështjet që lidhen me pronën janë më komplekse se të tjerat, e që kërkojnë</p> | <p>Pas shqyrtimit të të gjitha provave që kishte në dispozicion, Gjykata deklaroi se mungesa e paditësit, babait të tij dhe përfaqësuesit ligjor të tij nga seancat nuk mund të konsiderohen si arsyeja kryesore për zgjatjen e tepruar të procesit.</p> | <p>Mosmarrëveshje prone: veprimi që kundërshton</p> | <p>16 vjet e 7 muaj në dy instanca juridiksioni.</p> |

| Çështja | Arsyet për kompleksitetin | Bazat për shkëlqjen | Lloji i procesit | Kohëzgjatja |
|---|---|--|---|--|
| 20605/03 7 tetor 2008 | marrijen në konsideratë të natyrës dhe pozitës së pronës në fjalë. Prandaj, gjykata duhet të kërkojë dokumentacionin përkatës në çdo fazë të procesit. Qeveria tregon se as paditësi dhe as babai i tij nuk morën pjesë në mbledhjen e provave të dokumentuara dhe për këtë arsye vonuan procesin. | Nga procesverbalet e seancave mund të shihet se kohëzgjatja e procesit ka ndodhur kryesisht për shkak të ndërhyrjes së palëve të treta në proces, mbledhjes së provave të dokumentuara dhe përgatitjes së raporteve të ekspertëve. Prandaj, duhet pranuar se çështja ishte relativisht komplekse. Megjithatë, nuk ishte aq komplekse sa për të justifikuar procesin që zgjati gjashtëmbëdhjetë vjet e gjysmë. | analizën kadastrale | |
| PETRE IONESCU V. RUMANISË 12534/02 2 dhjetor 2008 | Kjo çështje u shqyrtua në katër grupe procesesh. Qeveria konsideron se çështja ishte veçanërisht komplekse, se nuk kishte periudha të gjata mosveprimi që i atribuoheshin autoriteteve dhe se ishte sjellja e paditësit ajo që shkaktoi zgjatjen e procesit. | Gjykata pranon se çështja ishte relativisht komplekse dhe se sjellja e paditësit mund të kishte çuar në vonesën e procesit. Megjithatë, Gjykata konsideron se as kompleksiteti i çështjes dhe as sjellja e paditësit nuk mund të shpjegojnë kohëzgjatjen e procesit. Gjykata vë re se vonesa në çështje ishte shkaktuar kryesisht nga vendimet e njëpasnjëshme të kasacionit, të cilat pasoheshin çdo herë me dërgimin mbrapsht të çështjes. Çështja ishte rikthyer tri herë, në gjykatën e shkallës së parë apo në gjykatën e rrethit, për shkak të gabimeve apo mangësive nga ana e gjykatave më të ulëta. Rikthimi i çështjes mund të kishte vazhduar pafundësisht, meqë nuk ka dispozitë ligjore që ta parandalojë një gjë të tillë. Përsëritja e vendimeve të kasacionit tregon për një keqfunksionim të sistemit gjyqësor. Sipas këndvështrimit të jurisprudencës së saj përkatëse, Gjykata konsideroi se kohëzgjatja e procesit në këtë rast ishte e tepruar. | Padi kompensim dëmes për shkak të pamundësisë së ndërtimit për shkaqet e tubacioneve të afërta të gazit. Refuzimi i lëshimit të lejes së ndërtimit. | 6 vjet, 9 muaj e 2 ditë |
| SHORE TECHNOLOGIES V. LUKSEMBURGUT 35704/06 31 korrik 2008 | Vështirësi në vendndodhjen e të pandehurve + kërkimi i ndihmesës ndërkombëtare gjyqësore në mënyrë që të merrej në pyetje e pandehura | Gjykata pranon se hetimi ishte relativisht kompleks, veçanërisht për sa i përket nevojës për kërkimin e ndihmesës ndërkombëtare gjyqësore, me qëllim që të merrej në pyetje e pandehura pasi, më në fund, të ishte gjetur vendndodhja e saj. Megjithatë, vetëm ky detaj nuk mund të justifikojë kohëzgjatjen e procesit. | Penal: palë civile në procesin penal që lidhet me lëshimin e çeqeve të falsifikuara | 6 vjet e 8 muaj në fazën hetimore Çështja mbetet ende e pazgjidhur |
| ŞİNEĞÜ dhe të tjerët V. TURQISË 4020/07, 4021/07, 9961/07 dhe 11113/07 13 tetor 2009 | Bashkim i katër çështjeve Qeveria deklaroi se kohëzgjatja e procesit së kundërshtuar nuk mund të konsiderohet e paarsyeshme duke pasur parasysh natyrën komplekse të çështjeve, madhësinë e dosjeve së çështjes, natyrën e akuzave kundër (katër) të pandehurve, numrin e veprave penale të kryera, numrin e | Gjykata pranon se këto procese që lidhen me krimin e organizuar ishin relativisht komplekse, sidomos për shkak të numrit të pandehurve, dëshmitarëve dhe paditësve, numrit të veprave penale për të cilat dyshoheshin të pandehurit dhe madhësisë së dosjeve të çështjeve. Megjithatë, ky kompleksitet në vetvete nuk është i mjaftueshëm për të justifikuar kohëzgjatjen e proceseve, që variojnë nga nëntë vjet e një muaj në mbi trembëdhjetë vjet e dhjetë muaj. Gjykata konsideron se kohëzgjatja e proceseve të kundërshtuara është e tepruar dhe se ato nuk e përmbushin kërkesën e "kohës së arsyeshme". | Penal: Anëtarësi në një organizatë të paligjshme të armatosur dhe përpjekje për të përmbytur rendin kushtetues turk me anë të forcës | Në rastin e dy paditësve: 13 vjet e 10 muaj Në rastin e një paditësi: 13 vjet e 8 muaj Në rastin e një paditësi: 9 vjet e 1 muaj Dy instanca juridiksioni |

| Çështja | Arsyet për kompleksitetin | Bazat për shkeljen | Lloji i procesit | Kohëzgjatja |
|--|--|--|--|---|
| MIANOWICZ V. GJERMANISË (nr. 2) 71972/01 11 qershor 2009 | të pandehurve, dëshmitarëve, paditësve dhe viktimave, dhe vështrësive të tjera të veçanta që do të dolën në këto çështje gjatë procesit që lidhej me krimin e organizuar. Kjo çështje është e natyrës komplekse për shkak të ndryshimeve të bëra nga paditësi në padinë e tij gjatë procesit dhe numrit të veprimeve që ai ndërmoi. | Gjykata pranon së çështja është relativisht komplekse. Ajo vë re se proceset ishin shtyrë për njëmbëdhjetë vjet në pritje të rezultatit të procedurës së heqjes nga puna. Më tej, Gjykata vë re se vonesat ishin shkakuar nga gjykatat e punës në kundërshtim me Nenin 6 të Konventës. Fakti që kohëzgjatja e procesit është bërë pjesërisht për shkak të vendimit për shtyrje nuk e bën atë më pak të tepruar, por kjo duhet të konsiderohet në varësi të Nenit 41 të Konventës. | Proces punësimi: heqje nga puna e pastaj anulim, aktgjykimi e la mënjanimë kontratën e punësimit, kërkesë për të ruajtur kontratën e punësimit | 19 vjet |
| BICAN V. RUMANISË 37338/02 22 shtator 2009 | Një kohë e gjatë që kishte kaluar që kur kishin ngjarë faktet.. | Çështja kishte të bënte me rishikimin e një vendimi gjyqësor të lëshuar në vitin 1959 që revokonte adoptimin e paditësit. Prandaj, çështja ishte relativisht komplekse, për shkak të kohës së gjatë që kishte kaluar që kur kishin ndodhur faktet. | Rishikimi i një vendimi për revokimin e një adoptimi | 5 vjet e 2 muaj |
| VERITER V. FRANCËS 31508/07 14 tetor 2010 | Natyra komplekse e çështjes rrjedh nga pyetjet që lidhen me aplikimin dhe interpretimin e Ligjit Komunitar në të dyja grupet e procesit | Gjykata konsideron se grupi i parë i proceseve ishte pa dyshim kompleks për shkak të pyetjeve që do të lidhen me aplikimin dhe interpretimin e Ligjit Komunitar. Çështja në fjalë kishte të bënte me faktin nëse paditësi, me kombësi belge por i rekrutuar nga ana e shërbimit civil francez për shkak të kombësisë së tij franceze, duke u konsideruar kështu sipas rregullit të përjashtimit të parashikuar me anë të Nenit 48 § 4 të Traktatit të KE-së, pavarësisht nga kjo mund të përfitonte në bazë të dispozitave të Ligjit Komunitar që lidhen me lirinë e lëvizjes dhe trajtimin e barabartë të punonjësve. Duke pasur veçanërisht parasysh natyrën komplekse të çështjes, Gjykata konsideron se kohëzgjatja e procesit nuk e shkelti kërkesën e kohës së arsyeshme të Nenit 6 § 1. Gjykata vë re se grupi i dytë i proceseve ishte relativisht kompleks për shkak se Ligji i datës 16 dhjetor 1996 që e harmonizonte ligjin francez me Ligjin Komunitar nuk aplikohet në mënyrë retroaktive. Lidhur me këtë Gjykata vë re se tri ministri (ajo e punëve të brendshme, ministria e mbrojtjes dhe ajo e punëve të jashtme) i dorëzuan mendimet e tyre gjykatës administrative. Gjykata thekson se nuk ka pasur vonesë nga ana e gjykatës administrative dhe nuk konstatohet shkelje të Nenit 6 § 1. | Administrative Dy grupe procesesh: Përlogaritja e kohëzgjatjes së shërbimit dhe promovimit të paditësit dhe të drejtat e pensionit: 5 vjet e 6 muaj në dy instanca juridiksioni | Përlogaritja e kohëzgjatjes së shërbimit dhe promovimit të paditësit dhe të drejtat e pensionit: 5 vjet e 6 muaj në dy instanca juridiksioni |

| Çështja | Arsyet për kompleksitetin | Bazat për shkeljen | Lloji i procesit | Kohëzgjatja |
|--|---|---|---|---|
| <p>KUHN v. LUKSEMBURGUT 53869/07 4 nëntor 2010</p> | <p>Njëzet pasagjerë u vranë gjatë një rrëzimi avioni.</p> | <p>Çështja ishte pa dyshim e natyrës komplekse. U morën dëshmi ekspertësh, së bashku me hapa të tjerë hetimorë, duke përfshirë edhe kërkesat për ndihmesë ndërkombëtare gjyqësore, për të përcaktuar shkaqet e aksidentit dhe përgjegjësitë e protagonistëve të ndryshëm. Për më tepër, duke pasur parasysh faktin se njëzet pasagjerë vdiqën gjatë rrëzimit të avionit, shumë njerëz u bënë pjesë e procesit në kapacitetin e palëve civile.</p> | <p>pensionit</p> <p>Procesi do të vendoste përgjegjësinë e Shtetit për keqfunksionimin e sistemit të drejtësisë</p> <p>Penal: Rrëzim avioni</p> | <p>6 vjet e 4 muaj</p> <p>Çështja mbetet e pazgjidhur</p> |

Shtojca 3 bis (vazhdim) – Çështjet e natyrës komplekse: mos-shkelja e Nenit 6 § 1

| Çështja | Arsyet për kompleksitetin | Bazat për vendimin | Lloji i procesit | Kohëzgjatja |
|---|--|---|-------------------------------------|--|
| <p>PECHEUR V. LUKSEMBURGUT</p> <p>16308/02</p> <p>11 dhjetor 2007</p> | <p>Natyrë komplekse e kësaj çështjeje rrjedh nga një hetim jashtëzakonisht i ngarkuar që u zhvillua në Luksemburg dhe në vende të tjera në mjedisin e padepërtueshëm ekonomik dhe financiar, në të cilin aludohej të ishte kryer vepra penale.</p> | <p>Gjykata konsideron se çështja ishte pa dyshim relativisht komplekse. Një sërë hetimesh duheshin kryer në Luksemburg dhe në vende të tjera për të përcaktuar rrethanat e sulmit të kryer nga paditësi ndaj një biznesmeni austriak në lidhje me një marrëveshje financiare që përfshinte disa vetë. Gjithashtu, Gjykata vë re se paditësi e rriti edhe më tej barrën e hetimit nëpërmjet sjelljes së tij, dhe në veçanti duke i ofruar hetuesve versione të ndryshme të ngjarjeve. Duke marrë parasysh që të gjitha rrethanat e çështjes, kohëzgjatja e procesit nuk duhet konsideruar e tepruar.</p> | <p>Penal: tentativë për vrasje</p> | <p>7 vjet e 9 muaj në 5 instanca juridiksioni</p> |
| <p>KEZÍČ V. SLOVĚNISĚ</p> <p>76395/01</p> <p>18 janar 2007</p> | <p>Çështje administrative e natyrës komplekse që lidhet me legalizimin e ndërtesave të ndërtuara pa leje, e që ngrinte një sërë pyetjesh lidhur me ligjin dhe faktet e që përfshinte disa palë me interesa kontradiktore.</p> | <p>Pas shqyrtimit të të gjitha provave që kishte në dispozicion, dhe duke pasur parasysh jurisprudencën përkatëse të shtetit, Gjykata konstatoi se kohëzgjatja e procesit nuk është e tepruar në këtë çështje dhe prandaj ajo e përmbush kërkesën e “kohës së arsyeshme”.</p> | <p>Administrativ: leje ndërtimi</p> | <p>4 vjet e 10 muaj në katër instanca juridiksioni administrativ</p> |
| <p>GIOSAKIS V. GREQISË (Nr. 3),</p> <p>5689/08</p> <p>15 shtator 2011</p> | <p>Çështje faktikisht komplekse që madje çoi në nevojën e zhvillimit të njëmbëdhjetë seancave përpara gjykatës penale të apelit dhe shkaktoi edhe hartimin e një aktgjykimi prej 300 faqesh.</p> | <p>Gjykata vë re inter alia se procesi përpara gjykatës penale të apelit ishte kryer brenda një periudhe jashtëzakonisht të shkurtër (nga 22 nëntor 2005 deri më 20 shkurt 2006). Ndërkohë që kaluan nëntë muaj që nga koha e aktgjyimit të gjykatës penale të apelit dhe ankesës së ushtruar nga ana e prokurorit publik, shqyrtimi i ankesës zgjati më pak se gjashtë muaj. Prandaj, Gjykata konsideron se kohëzgjatja e procesit së kundërshtuar nuk e tejkaloi “kohën e arsyeshme”.</p> | <p>Penal</p> | <p>4 vjet e 3 muaj</p> |

Shtojca 4: Çështjet e natyrës jo-komplekse - Shkelja e Nenit 6 § 1

| Çështja | Arsyet për kompleksitetin | Bazat për vendimin | Lloji i procesit | Kohëzgjatja |
|--|---------------------------|---|------------------|--|
| Broca dhe Texier-Micault v. FRANCËS, 21 tetor 2003 | Asnjë rrezik i veçantë | <p>- Lidhur me paditësin e parë qeveria pranoi se kohëzgjatja e procesit në shkallën e parë dhe në apel "mund të konsiderohej relativisht e gjatë"</p> <p>- Lidhur me të dytin, procedura e apelit kishte mbetur e pazgjdhur për tri vjet dhe qeveria nuk kishte dhënë ndonjë shpjegim për këtë</p> | ADMINISTRATIV | <p>- Paditësi i parë: tetë vjet e tetë muaj në tri instanca gjykatash</p> <p>- Paditësi i dytë: pesë vjet e tri muaj (çështja mbetet ende e pazgjdhur)</p> |
| Guiraud v. FRANCËS, 29 mars 2005 | Asnjë rrezik i veçantë | <p>-Pavarësisht se kohëzgjatja e gjykimit kryesor dukej e arsyeshme, në rrethanat e çështjes nuk mund të arrihej në përfundimin se hetimi ishte kryer me kujdes</p> | PENAL | <p>- Dhjetë vjet e tri muaj për një hetim në tri instanca gjykatash, duke përfshirë edhe gjashtë vjet e tetë muaj vetëm për hetimin</p> |

| | | | | |
|---|-------------------------------|---|---|--|
| <p>Quemar v. FRANCËS, 1 shkurt 2005</p> | <p>Asnjë rrezik i veçantë</p> | <p>- Vonesa të pajustificuara dhe periudha mosveprimi, si nga gjyqtari hetues, ashtu edhe nga divizioni i gjykatës së apelit që shqyrtonte ankesat lidhur me hetimet. Për shembull, gjyqtarit hetues (që tashmë po zëvendësohte një gjyqtar tjetër hetues) iu deshëm më shumë se dhjetë muaj të bashkonte ankesën e palës civile në procesin kryesor, dhe pothuajse edhe një vit tjetër (gjatë së cilës nuk u ndërmorën hapa proceduraië) për të thirrur një dëshmitar</p> | <p>PENAL</p> | <p>Hetimi: - dhjetë vjet e katër muaj për znj. Quemar - dhjetë vjet e dy muaj për z. Quemar</p> |
| <p>Fattell v. FRANCËS, 27 janar 2005</p> | <p>Asnjë rrezik i veçantë</p> | <p>- Vonesa të pajustificuara prej dy vjetësh e gjysmë që nga koha e regjistrimit të ankesës së paditësit dhe vendimit të gjykatës administrative të apelit - Vonesa të pajustificuara prej katër vjetësh e gjysmë që nga koha e regjistrimit të ankesës për çështjet ligjore e deri në vendimin e Conseil d'Etat</p> | <p>ADMINISTRATIV</p> | <p>- Katërbëdhjetë vjet e njëmbëdhjetë muaj për shqyrtimin e ankesës paraprake, si edhe shtatë fazat e tjera që pasuan procesin</p> |
| <p>Schwarkmann v. FRANCËS, 8 shkurt 2005</p> | <p>Asnjë rrezik i veçantë</p> | <p>- Gjyqtari hetues, i cili, edhe pas katër përkujtesave, nuk kishte marrë asnjë përgjigje ndaj një kërkesë të lëshuar dy vjet më parë për marrjen e provave pas kryerjes së veprës, tjetërshtë e përsëriti kërkesën duke kërkuar të njëjtën gjë</p> | <p>PENAL</p> | <p>- Hetimi zgjati shtatë vjet e një muaj</p> |
| <p>Guez v. FRANCËS, 17 maj 2005</p> | <p>Asnjë rrezik i veçantë</p> | <p>- Vonesa të pajustificuara, që janë: 1/ tri vjet e shtatë muaj në Gjykatën Administrative të Apelit në Paris për heqjen e parë nga puna (mes dorëzimit të padisë dhe aktgjyqimit që vendoste lidhur me kompensimin për humbjen e të ardhurave) 2/ katër vjet e tetë muaj në Gjykatën Administrative të Apelit në Paris për heqjen e dytë nga puna (mes aktgjyqimit që anulonte heqjen e dytë nga puna dhe urdhrin për të rimarrë në punë paditësin) 3/ tetë vjet e gjashtë muaj për kërkesën pasuese për kompensim (procesi është ende në zhvillim e sipër).</p> | <p>ADMINISTRATIV – GJYKATA E PUNËS</p> | <p>- Njëmbëdhjetë vjet në dy instanca gjykatash (gjykata administrative e apelit ende nuk kishte vendosur lidhur me kërkesën për anulimin e heqjes së parë nga puna)</p> |

| | | | | |
|--|---|--|--|--|
| <p>Podbielski v. POLONISË, 30 tetor 1998</p> | <p>Duke pasur parasysh inflacionin e tejskajshëm të kohës, paditësi kishte një interes ekonomik në sigurimin e shtyrjes së padisë së tij brenda periudhës së kohës së arsyeshme</p> | <p>- Vonesat u shkaktuan në pjesën më të madhe nga ndryshimet legjislative që rrodhën si pasojë e tranzicionit në sistemin e tregut të lirë dhe nga kompleksiteti i procesit.</p> | <p>CIVIL</p> | <p>- Pesë vjet e gjashtë muaj në dy instanca gjykatash (procedura është ende në zhvillim e sipër)</p> |
| <p>Bursuc v. RUMANISË, 12 tetor 2004</p> | <p>Gjendja shëndetësore e paditësit</p> | <p>- Që nga qershori 1999 deri në qershor 2000 gjykata urdhëroi shtyrjet e njëpasnjëshme të seancave mbi bazën që dëshmitarët nuk ishin paraqitur, pavarësisht nga fakti se ajo i kishte thirrur ata virtualisht çdo muaj dhe i kishte kërcënuar me ndëshkime procedurale, të cilat në fakt, nuk u aplikuan. Autoriteteve gjyqësore iu kërkohet të tregonin korrektesë të veçantë në përshpejtimin e këtyre proceseve duke pasur parasysh gjendjen shëndetësore të paditësit</p> | <p>PENAL</p> | <p>- Katër vjet, nga të cilët: - Një vit e nëntë muaj për hetimin nga shërbimi i prokurorisë - Dy vjet e tri muaj në gjykatën e shkallës së parë</p> |
| <p>Frydlander v. FRANCËS, 27 qershor 2000</p> | <p>Humbja e mjeteve të jetesës</p> | <p>- Conseil d'Etat e dha vendimin e tij pothuajse gjashtë vjet pasi çështja ishte sjellë përpara tij, dhe qeveria nuk ofroi asnjë shpjegim për këtë zgjatje qartësisht të tepërt</p> | <p>ADMINISTRATIV (mosmarrëveshje punësimi)</p> | <p>- Nëntë vjet e tetë muaj (pothuajse gjashtë vjet në Conseil d'Etat)</p> |
| <p>García v. FRANCËS, 26 shtator 2000</p> | <p>Humbja e mjeteve të jetesës</p> | <p>- Procesi ishte i shpejtë në Gjykatën Administrative të Dijon-it (pak më shumë se një vit) por jo në Conseil d'Etat (katër vjet e katër muaj) - Vazhdimësia e paditësit në biznes varej në një masë të madhe nga rezultati i procesit</p> | <p>ADMINISTRATIV</p> | <p>- Pesë vjet e tetë muaj në tri instanca gjykatash</p> |

| Çështja | Ç'rrezikonte paditësi | Bazat për vendimin | Lloji i procesit | Kohëzgjatja |
|--|-----------------------------|---|---------------------------------------|--|
| Ferdandes Cascao v. PORTUGALISË 1 shkurt 2001 | Humbja e mjeteve të jetesës | <ul style="list-style-type: none"> - Nuk u ndërmorën hapa procedurale themelore mes datës së urdhrimit të lëshuar nga gjyqtari dhe datës së vendimit paraprak – kjo vonesë dy vjeçare është pa dyshim e tepruar - Në rastet e mosmarrëveshjeve që kanë të bëjnë me të drejtat e punonjësve për pagesa apo kompensim të prapambetur, momenti që kur kërkesa e kohës së arsyeshme e Nenit 6 mendohet se është shkelur, duhet shqyrtuar me kujdes të veçantë | CIVIL (mosmarrëveshje punësimi) | - Katër vjet e shtatë muaj në një instancë gjykatë (që rezultoi në një zgjidhje miqësore) |
| Farinha Martins v. PORTUGALISË, 10 korrik 2003 | Mosmarrëveshje punësimi | - Koha që përdori gjykata e apelit për të shqyrtuar një ankesë të përkohshme e vonoi në mënyrë të konsiderueshme procesin. U deshën më shumë se dy vjet për të vendosur se aktgjykimi i gjykatës së punës duhej anuluar | CIVIL(mosmarrëvesh je punësimi) | - Shtatëmbëdhjetë vjet e nëntë muaj |
| Kress v. FRANCËS, 7 qershor 2001 | Asnjë rrezik i veçantë | <ul style="list-style-type: none"> - Vonesa të konsiderueshme në proces, si në shkallën e parë, ashtu edhe në atë të apelit, lidhur me çështjet ligjore -Në veçanti, Conseil d'Etat, iu deshën katër vjet dhe pak më shumë se një muaj për të shqyrtuar ankesën e paditësit lidhur me çështjet ligjore | ADMINISTRATIV | - Dhjetë vjet e një muaj |

| Çështja | Ç'rrezikonte paditësi | Bazat për vendimin | Lloji i procesit | Kohëzgjatja |
|--|-------------------------------|--|------------------|---|
| <p>Kuibichev v. BULLGARISË, 30 shtator 2004</p> | <p>Asnjë rrezik i veçantë</p> | <p>- Pavarësisht një vonesë prej pesë muajsh mes dy seancave në gjykatën e apelit, pamjaftueshmëria e hapave të ndërmarrë nga ana e autoriteteve në sigurimin e pranisë së dëshmitarëve në seancë dhe një vonesë e mëtejshme prej tri muajsh e gjysmë për shkak të mosveprimit nga ana e shërbimit të prokurorisë, procesi, që u zhvillua në katër faza dhe në tri instanca gjykatash, pa vonesë të tepruar në Gjykatën e Apelit në Sofje apo në Gjykatën e Kasacionit, nuk e tejkaloi kohën e arsyeshme</p> | <p>PENAL</p> | <p>- Katër vjet e tri muaj për tri instanca gjykatash (+hetimi)</p> |
| <p>Punzelt v. REPUBLIKËS ÇEKE, 25 prill 2000</p> | <p>Asnjë rrezik i veçantë</p> | <p>- Paditësi dha kontributin e tij në kohëzgjatjen e procesit duke bërë kërkesa të shumta për marrjen e provave të mëtejshme mes kohës së dorëzimit të aktakuzës dhe seancës së parë</p> <p>- Në periudhën nëntor – dhjetor 1994 gjykatat në dy instanca trajtuan kërkesën e paditësit për përjashtimin e gjyqtarëve të caktuar</p> <p>- Nuk ka pasur periudha mosveprimi që i atribuohen autoriteteve. Çështja u shqyrtua dy herë nga gjykatat e dy instancave. Seancat u zhvilluan në intervale të rregullta dhe u shpënë vetëm për të kërkuar prova shtesë</p> | <p>PENAL</p> | <p>- Tri vjet e tri muaj për tri instanca gjykatash</p> |

| | | | | |
|---|-------------------------------|--|--------------|---|
| <p>Zielinski v. POLONISË, 15 shkurt 2005</p> | <p>Asnjë rrezik i veçantë</p> | <p>- Paditësi dha kontributin e tij në kohëzgjatjen e procesit (nuk iu përgjigj vërejtjeve me shkrim të palës kundërshtare brenda periudhës së lejuar prej katërmbëdhjetë ditësh, por u përgjigj në seancë; nuk ndërmori ndonjë hap të gfarëdoilij për të përshepuar procesin; nuk e dorëzoi në kohë certifikatën shëndetësore, që rezultoi edhe në një vonesë prej tri muajsh, etj...)</p> <p>- Edha pala e kundërt dha kontributin e saj në kohëzgjatjen e procesit duke vonuar procesin në themel</p> <p>- Afërsisht një periudhë prej njëmbëdhjetë muajsh mosveprimi nga ana e autoriteteve ndodhi pjesërisht për shkak të sjelljes së paditësit. Në mënyrë të ngjashme, një vonesë prej nëntë deri në dymbëdhjetë muajsh u shkaktoi nga mos-paguesa në kohë e depozitës nga pala e kundërt.</p> <p>- Përveç këtyre periudhave mosveprimi, që zgjatën afërsisht një vit e tetë muaj, për të cilat kanë përgjegjësi të përbashkët edhe palët edhe gjykatat, seancat u zhvilluan në intervale të rregullta</p> | <p>CIVIL</p> | <p>- Pesë vjet e një muaj për tri instanca gjykatash</p> |
| <p>Dostál v. REPUBLIKËS ÇEKE, 25 maj 2004</p> | <p>Asnjë rrezik i veçantë</p> | <p><u>Cështja Nr. 23 C.227/94</u></p> <p>- U trajtua relativisht shpejt. Periudhë mosveprimi nga qershori 1994 deri në tetor 1996, që i atribuohet paditësit (paguesa me vonesë e tarifave)</p> <p><u>Cështja Nr. 30 C.580/95</u></p> <p>-Kërkesa të shumta dhe kundërshtime mbi bazën e anshmërisë të bëra nga paditësi (gjykatave kombëtare iu desh që të transferonin pafundësisht dosjen e çështjes nga njëra gjykatë në tjetrën, që shkaktoi edhe vonesa të konsiderueshme në proces)</p> <p><u>Cështja Nr. 30 C.581/95</u></p> <p>- Paditësi dorëzoi disa kërkesa procedurale të pasakta ose të pabazuara</p> <p><u>Cështja Nr. 58 C.37/96</u></p> <p>- Kërkesa të shumta procedurale: gjykatat pothuajse nuk reaguan fare ndaj këtyre kërkesave, dhe këtë gjë e bënë pa vonesa të tepruara</p> <p><u>Cështja Nr. 23 C.66/98</u></p> <p>- Kërkesa të shumta procedurale: gjykatat ishin të detyruara të transferonin dosjen e çështjes (gjë që u bë me shpejtësi)</p> | <p>CIVIL</p> | <p><u>Cështja Nr. 23 C. 227/94:</u> Gjashtë vjet e gjashtë muaj në dy instanca gjykatash <u>Cështja Nr. 30 C. 580/95:</u> Shtatë vjet e dy muaj në dy instanca gjykatash <u>Cështja Nr. 30 C. 581/95:</u> Shtatë vjet e dy muaj në dy instanca gjykatash <u>Cështja Nr. 58 C. 37/96:</u> Pesë vjet e tri muaj në dy instanca gjykatash <u>Cështja Nr. 23 C. 66/98:</u> Katër vjet e tetë muaj</p> |
| <p>Soner Önder v. TURQISË, 12 korrik 2005</p> | <p>Asnjë rrezik i veçantë</p> | <p>- Nuk ka periudha mosveprimi që i atribuohen autoriteteve kombëtare gjyqësore</p> | <p>PENAL</p> | <p>- Pesë vjet e njëmbëdhjetë muaj (dy grupe procesesh në Gjykatën e Sigurisë së Shtetit dhe dy të tjera në Gjykatën e Kasacionit)</p> |

| | | | | |
|--------------------------------------|------------------------|---|-----------------------------|--|
| Gergouil v. FRANCÉS, 21 mars 2000 | Asnjë rrezik i veçantë | - Iste snume se një vit e dy muaj në Gjykatën e Apelit, dhe me snume se kater muaj në Gjykatën e Kasacionit, që palët të dorëzonin parashtrësata e tyre - Procesi në Gjykatën e Kasacionit zgjati dy vjet, dy muaj e një ditë: një periudhë e përshtuar si relativisht e gjatë, por nuk kishte periudha mosveprimi që i atribuoheshin autoriteteve (kohëzgjatja e procesit në Gjykatën e Punës (pesë muaj) dhe në Gjykatën e Apelit (një vit e pesë muaj) nuk ishte subjekt kritikash. - Gjashtë muaj vonese për shtak të kërkesës së paditës për shtyrjen e seancës në Gjykatën e Punës. Paditësit iu deshën mbi tri muaj që të ankimonte vendimin e shkallës së parë dhe palëve iu deshën nëntë muaj që të dorëzonin parashtrësata e tyre në Gjykatën e Kasacionit. - Nuk ka periudha të konsiderueshme mosveprimi që i atribuohen autoriteteve kombëtare. Kohëzgjatja e procesit në Gjykatën e Punës (një vit e shtatë muaj), në Gjykatën e Apelit (një vit e nëntë muaj) dhe në Gjykatën e Kasacionit (një vit e tetë muaj) nuk ishte subjekt kritikash. | CIVIL (mosmarrëveshje pune) | - Kater vjet e tri muaj në tri instanca gjykatash |
| Guichon v. FRANCÉS, 21 mars 2000 | Asnjë rrezik i veçantë | - Dy vjet e dy muaj u deshën që të sigurohej një mendim ekspert, që çoi në një zgjidhje miqësore (pas së cilës nuk pati më mosmarrëveshje mes palëve). Kjo kohëzgjatje mund të konsiderohet si e pranueshme (duke pasur parasysh kohëzgjatjen e përgjithshme të procesit). | CIVIL (mosmarrëveshje pune) | - Pesë vjet e tri muaj në tri instanca gjykatash |
| Piccolo v. ITALISË, 7 nëntor 2000 | Asnjë rrezik i veçantë | - Një vit e tetë muaj për hetimin, që u pasua nga 20 muaj kalim kohe përpara se të zhvillohej seanca për shqyrtimin e çështjes. Pavarësisht, Gjykata konsideroi se kjo kohëzgjatje nuk mund të trajtohej si e pranueshme nëse do të krahasohej (siç ishte e nevojshme) me kohëzgjatjen e përgjithshme të procesit. | CIVIL | - Tri vjet e shtatë muaj në një instancë gjykate N.B.: Tri gjyqtarë që lëshojnë një mendim të përbashkët mospoftues ³⁵ |
| P.G.V. v. ITALISË, 7 nëntor 2000 | Asnjë rrezik i veçantë | - Një vit e tetë muaj për hetimin, që u pasua nga 20 muaj kalim kohe përpara se të zhvillohej seanca për shqyrtimin e çështjes. Pavarësisht, Gjykata konsideroi se kjo kohëzgjatje nuk mund të trajtohej si e pranueshme nëse do të krahasohej (siç ishte e nevojshme) me kohëzgjatjen e përgjithshme të procesit. | CIVIL | - Tri vjet e nëntë muaj në një instancë gjykate N.B.: Dy gjyqtarë që lëshojnë një mendim të përbashkët mospoftues ³⁶ |

³⁵ "Edhe pse një periudhë prej tri vjetësh e shtatë muajsh në një instancë të vetme gjyqësore, në një rast të një natyre jo komplekse, mund të konsiderohet në parim si e pranueshme, në vëmë re se ky kalim kohe është përlogaritur përgjatë periudhës kohore që shkon vetëm deri në korrik 1997, kur paditësi tregoi se ai kishte arritur një marrëveshje me të paditurin. Megjithatë, procedura në fakt vazhdoi edhe përtej asaj date, dhe duket që të ketë mbetur ende e pazgjidhur, në shkallën e parë, në shtator 1999, më shumë se pesë vjet e dhjetë muaj pas fillimit të saj. Sipas mendimit tonë, kjo është tejet e tepruar." (Gjyqtarët Tulkens, Bratza dhe Costa – përkthim jo-zyrtar)

³⁶ "Sipas mendimit tonë një periudhë prej tri vjetësh e nëntë muajsh në një instancë procedure, në një rast të një natyre vecanërisht jo komplekse, shkon përtej asaj që është e arsyeshme dhe prandaj kjo përbën edhe një shkelje të kërkesës së Nenit 6 § 1 të Konventës. Në vecanti, në vëmë re se ka pasur një interval të pashpjegueshëm kohor prej njëzet muajsh që nga koha kur palët dorëzuan parashtrësata e tyre e deri në aktgjykimin e Gjykatës së Milanos; përvec kësaj u nevojit edhe një periudhë shtesë prej pesë muajsh që aktgjykimin të dorëzohej në gjykatë." (Gjyqtarët Tulkens dhe Bratza – përkthim jo-zyrtar)

| | | | | |
|--|---|---|--|---|
| <p>Marcotrigiano v. ITALISË, 1 mars 2001</p> | <p>Mosmarrëveshje pune</p> | <p>- Çështja u bllokua për dy vjet e tetë muaj (transferimi i një gjyqtari): që iu atribuua autoriteteve. Megjithatë, koha që u desh aktualisht për të trajtuar çështjen ishte rreth pesë vjet e dy muaj në dy instanca gjykatash (duke nënshkruar në vitin 1999, një deklaratë me anë të së cilës ai hiqte dorë nga e drejta e tij për të rifilluar procesin në gjykatën kompetente territoriale, paditësi tregoi mungesën e interesit të tij në ndjekjen e procesit)</p> | <p>CIVIL</p> | <p>- Pesë vjet e pesë muaj (dy instanca gjykatash)</p> |
| <p>Mangualde Pinto v. FRANCËS, 9 prill 2002</p> | <p>Mosmarrëveshje pune</p> | <p>- Shtyrje të njëpasnjëshme të procesit të kërkuara nga palët çuan në një vonesë prej mëse një viti e tetë muajsh. Vonesat u shkaktuan, po ashtu, edhe nga pezullimi i procesit mbi bazën që paditësi nuk ishte paraqitur e më pas nga rifillimi i procesit.</p> <p>- Vetëm dy vonesa i atribuohen autoriteteve kombëtare: gjashtë muaj për Gjykatën e Punës që të shtynte çështjen, dhe shtatë muaj për të shqyrtuar kërkesën e paditësit për ndihmesë ligjore.</p> <p>- Gjykata konsideroi se kohëzgjatja e përgjithshme prej më shumë se gjashtë vjetësh ishte relativisht e gjatë, por vonesat nuk mund të konsideroheshin të paarsyeshme</p> | <p>CIVIL (mosmarrëveshje pune)</p> | <p>- Gjashtë vjet e tri muaj</p> |
| <p>Martial Lemoine v. FRANCËS, 29 prill 2003</p> | <p>Asnjë rrezik i veçantë</p> | <p>- Këmbimi i parashtresave dhe dokumenteve mes palëve përbënë shkaktuan e vonesës: kjo mori një vit e një muaj kohë në Gjykatën e Apelit të Parisit, pavarësisht se gjyqtari që ishte përgjegjës për përgatitjen e çështjes për seancë kishte përgatitur një plan kohor si edhe kishte përcaktuar një datë për përfundimin e fazës paraprake të çështjes.</p> <p>- Ngadalësia e paditësit në dorëzimin e parashtresës së tij të parë në Gjykatën e Apelit në Paris dhe kërkesa e palëve për të shtyrë datën përfundimtare të fazës paraprake në shkallën e dytë të apelit e vonoi procesin me pothuajse tetë muaj.</p> <p>- Gjykata konstatoi se kohëzgjatja e përgjithshme e çështjes (shtatë vjet e tetë muaj) ishte relativisht e gjatë, por periudhat kohore skaduese që i atribuoheshin autoriteteve nuk mund të konsideroheshin të paarsyeshme.</p> | <p>CIVIL</p> | <p>- Shtatë vjet e tetë muaj, duke përfshirë: - një vit e dhjetë muaj në shkallën e parë, dhe një vit e tetë muaj në apel, - një vit e nëntë muaj në gjykatën e kasacionit - dy vjet në shkallën e dytë të apelit</p> |
| <p>Mötsnik v. ESTONISË, 29 prill 2003</p> | <p>Paditësi në paraburgim në pritje të gjyqimit</p> | <p>-Seancat u shtynë disa herë për shkak të mungesës së paditësit ose avokatit të tij - Disa vonesa procedurale nuk i atribuohen paditësit, por kohëzgjatja e përgjithshme e procesit u konsiderua e arsyeshme</p> | <p>PENAL</p> | <p>- Katër vjet e gjashtë muaj por Gjykata nuk pati çështje juridiksioni <i>ratione materiae</i> për të trajtuar në proces në tri instanca gjykatash -Prandaj, periudha që duhej marrë në konsideratë ishte dy vjet e shtatë muaj</p> |

| | | | | |
|--|--------------------------------------|--|--------------|--|
| <p>Liadis v. GREQISË, 27 maj 2004</p> | <p>Asnjë rrezik i veçantë</p> | <p>- Të gjitha shtyrjet e seancave në procesin e shkallës së parë u shkaktuan nga mosparaqitja e paditësit. Përveç kësaj, paditësi ishte jashtëzakonisht i ngadaltë që të kërkonte një datë të re seance, gjë që çoi edhe në vonesën prej më shumë se njëzet vjetësh.</p> <p>- Paditësi nuk tregoi asnjë interes në rifillimin e procesit me rezultatin që gjykata nuk kishte më ndonjë mundësi për të vepruar (sipas Neneve 106 dhe 108 të Kodit të Procedurës Civile, kontrolli i rrjedhës së procedurës civile varet krejtësisht nga palët).</p> <p>- Nuk ka pasur periudha mosveprimi apo vonesa të pajustificuara që t'i atribuoheshin autoriteteve. Çdo herë që paditësi kërkonte një datë të re për një seancë, gjykata ka vepruar shpejt (dhe ajo e shpalli aktgjykimin e saj një vit e tri muaj pas kërkesës përkatëse). Procesi në gjykatën e apelit zgjati një vit e dy muaj.</p> | <p>CIVIL</p> | <p>- Njëzet e një vjet e njëmbëdhjetë muaj (duke përfshirë më shumë se katërmëdhjetë vjet e nëntë muaj, rrjedhimisht deri më datën 20 nëntor 1985, data kur Greqia njohu të drejtën e peticionit individual)</p> |
| <p>Patrianakos v. GREQISË, 15 korrik 2004</p> | <p>Asnjë rrezik i veçantë</p> | <p>- Palët nuk u paraqitën (ky ishte shkaku i të gjitha shtyrjeve në procesin në shkallën e parë) dhe ato ishin tejet të ngadalta që të kërkonin një datë të re për seancën. Kjo e shtyu procesin me pothuajse katërmëdhjetë vjet.</p> <p>- Palët nuk treguan asnjë interes në rifillimin e procesit në gjykatën e shkallës së parë, dhe sipas Neneve 106 dhe 108 të Kodit të Procedurës Civile, gjykata e apelit nuk kishte asnjë mundësi veprimi.</p> <p>- Paditësi vonoi dorëzimin e ankesës lidhur me çështjet ligjore për një vit e më shumë se dy muaj.</p> <p>- Nuk pati periudha mosveprimi apo vonesa pa shkak që do t'i atribuoheshin autoriteteve:</p> <ul style="list-style-type: none"> - çdo herë që palët kërkuar një datë të re për seancë, gjykatat reaguan menjaf shpejt - gjykata e shkallës së parë e shpalli aktgjykimin e saj shtatë muaj pasi ishte caktuar data e re për seancë - procesi në gjykatën e apelit zgjati një vit - Gjykata e Kasacionit e dha vendimin e saj pas një vitit e katër muajsh <p>Gjykata konstatoi se këto periudha nuk ishin aspak të paarsyeshme.</p> | <p>CIVIL</p> | <p>- Njëzet e dy vjet e tri muaj në tri instanca gjykatash, duke përfshirë pothuajse pesëmbëdhjetë vjet rrjedhimisht deri më 20 nëntor 1985, datë kur Greqia njohu të drejtën e peticionit individual.</p> |
| <p>Wroblewski POLONISË, 1 dhjetor 2005</p> | <p>v. Asnjë rrezik i veçantë</p> | <p>- Pasi dosja e çështjes nuk u shqyrtua nga paditësi brenda afatit kohor të përcaktuar nga prokurori publik, paditësi kërkoi që aktakuzat t'i kthehej prokurorit për korrigjime vetëm pasi të ishte mbyllur data e hetimit dhe të ishte caktuar data e gjykimit: kjo gjë e shtyu hetimin, dhe po ashtu edhe seancën dëgjimore të çështjes, me rreth katër muaj.</p> <p>- Qeveria nuk paraqiti asnjë shpjegim për periudhën e mosveprimi prej rreth njëmbëdhjetë muajsh, për të cilën u konsideruan përgjegjëse autoritetet gjyqësore. Megjithatë, përveç kësaj neglizhence të trajtimit me shpejtësi të procesit, autoritetet nuk qëndruan pasive dhe treguan korrektesën e kërkuar.</p> | <p>PENAL</p> | <p>- Pesë vjet në një instancë gjykatë</p> |

| | | | | |
|--|-------------------------------|---|--------------|---|
| <p>Venditelli v. ITALISË, 18 korrik 1994</p> | <p>Asnjë rrezik i veçantë</p> | <p>- Pavarësisht se ishin legjitime, dy shtyrjet e kërkuara nga paditësi shkaktuan një vonesë prej rreth gjashtë muajsh (e cila ishte relativisht e konsiderueshme duke pasur parasysh kohëzgjatjen e përgjithshme të procesit prej katërmbëdhjetë muajsh).</p> <p>- Gjykatës së shkallës së parë iu deshën njëmbëdhjetë muaj për t'ia dorëzuar vendimin e saj paditësit. Megjithatë, paditësi kishte marrë pjesë në seancë dhe mund të pritej që në mënyrë të arsyeshme të kishte marrë një kopje të aktykimit me iniciativën e tij.</p> <p>- Vendimi i gjykatës së apelit nuk iu dorëzua fare paditësit, por kjo nuk pati ndonjë efekt në kohëzgjatjen e procesit meqenëse kishte të bënte me marrjen në konsideratë të një dekreti amnistie.</p> | <p>PENAL</p> | <p>-Katër vjet e pesë muaj në dy instanca gjykatash</p> |
| <p>Cesarini v. ITALISË, 12 tetor 1992</p> | <p>Asnjë rrezik i veçantë</p> | <p>- Për pothuajse dy vjet paditësi mbeti pasiv dhe nuk ndërmori asnjë hap për të dorëzuar ankesën (aludohet me qëllim që të arrilhej një zgjidhje miqësore).</p> <p>- Disa periudha mosveprimi që i atribuohen autoriteteve: gjykata e shkallës së parë priti shtatëmbëdhjetë muaj përpara se të dorëzonte aktykimitin e saj, dhe gjykata e apelit priti njëzet muaj.</p> <p>- Megjithatë " duke marrë në konsideratë faktin që çështja u shqyrtua nga tri gjykata të ndryshme dhe pati një zgjidhje miqësore, vonesat që u shfaqën nuk duken se janë aq substanciale për kohëzgjatjen e përgjithshme të procesit, që të mund të quhen si të tepruara. "</p> | <p>CIVIL</p> | <p>- Gjashtë vjet e tetë muaj në tri instanca gjykatash</p> |

Shtojca 4 (vazhdim): Çështjet e natyrës jo-komplekse - mos-Shkelja e Nenit 6 § 1

NB: Në disa çështje Gjykata konstatoi se një vonesë nuk mund të konsiderohet si e pranueshme nëse krahasohet, ashtu siç duhej, me kohëzgjatjen e përgjithshme të procesit dhe me faktin që proceset u shtynë me kalimin e çështjes nëpër dy instanca gjykatash. Kjo u aplikua në veçanti në çështjen vijuese kundër Italisë (ashtu si edhe në aktgjykimin e sipërpërmendur PGV):

1. **G.L. v. ITALISË**, 3 tetor 2002
2. **GEMIGNANI v. ITALISË**, 6 dhjetor 2001

Shtojca 4 bis – Çështjet e natyrës jo-komplekse: shkella e Nenit 6 § 1

| Çështja | Ç'rrezikonte paditësi | Bazat për vendimin | Lloji i procesit | Kohëzgjatja |
|--|--|--|---|--|
| EUCONE D.O.O V. SLOVONISË 49019/99 9 mars 2006 | Asnjë rrezik veçantë | Gjykata e refuzoi mbrojtjen e paraqitur nga qeveria për mospërdorimin e mjeteve ligjore vendore, për shkak se i konsideronte ato të paefektshme për paditësin. | Proces ekzekutimi | Grupi i parë i procesit: 6 vjet Grupi i tretë i procesit: 8 vjet e 4 muaj |
| KOS V. SLOVONISË 77769/01 30 mars 2006 | Dëme | Pasi shqyrtoi të gjitha provat që kishte në dispozicion, dhe pasi mori në konsideratë edhe jurisprudencën përkatëse të shtetit, Gjykata konstatoi se kohëzgjatja e procesit së kundërshtuar, veçanërisht në gjykatën e shkallës së parë, është e tepruar dhe nuk e përmbush kërkesën e “kohës së arsyeshme”. | Padi për kompensim dëmi, përgjegjësi civile | 5 vjet e 8 muaj |
| LATRY V. FRANCËS 50609/99 23 shkurt 2006 | Asnjë rrezik veçantë | Sipas këndvështrimit të Gjykatës, një periudhë prej afro shtatë vjetësh vetëm për hetimin e ankesës me një kërkesë për bashkimin e procesit si palë civile kërkon një vlerësim të përgjithshëm dhe mund të justifikohet vetëm në rrethana të veçanta. Vetë fakti i thjeshtë që çështja paraqiste një farë shkalle komplekseti, për shkak të natyrës së veprës së aluduar, vështirësisë së vendndodhjes së dëshmitarëve dhe mungesës së dokumenteve që lidheshin me kushtet në të cilat ishin transferuar paratë, nuk ishte e mjaftueshme për të përcaktuar rrethana të tilla në këtë çështje. Po ashtu, Gjykata konsideron se paditësi nuk mund të kritikohet për shkak se përdori të gjitha mjetet ligjore në dispozicion të tij, sipas ligjit vendor. Duke marrë në konsideratë këta elementë, Gjykata konstatoi se çështja e paditësit nuk u shqyrtua brenda një kohe të arsyeshme. | Përvetësim, ankesë me kërkesë për t'iu bashkuar procesit si palë civile | 6 vjet e 10 muaj |
| SMASKOU V. GREQISË 37270/02 30 mars 2006 | Asnjë rrezik veçantë | Pavarësisht nga fakti që gjykata vendore e tërhoqi statusin e paditësit si palë civile, Gjykata konsideron se procesi i kundërshtuar bie në fushëpërimin e Nenit 6 § 1 të Konventës. Gjykata ka trajtuar një numër të konsiderueshëm çështjesh që ngrenë probleme të ngjashme me ato të çështjes në fjalë, dhe ka konstatuar shkelje të Nenit 6 § 1 të Konventës. Duke marrë parasysh jurisprudencën përkatëse të shtetit, Gjykata konsideron se kohëzgjatja e procesit së kundërshtuar nuk e përmbush kërkesën e “kohës së arsyeshme”. | Mashtrim, ankesë me kërkesë për t'iu bashkuar procesit si palë civile | 4 vjet, 11 muaj e 4 ditë |
| VILHO ESKELINEN dhe të tjerët V. FINLANDËS | Padi nga personeli i policisë për shtesë të pagave | Gjykata pajtohet me palët se çështja nuk ishte e natyrës komplekse. Sjellja e paditësve nuk pati efektin e zgjatjes së procesit. Sa për autoritetet, Gjykata vë re se Bordi Administrativ i Rrethit e pranoi kërkesën e paditësve më datën 19 mars 1993 dhe 19 20 pëllloi vendimin e tij më datën 19 mars 1997. Prandaj, atij iu deshën katër vjet që ta shqyrtonte çështjen. Ky kalim kohe nuk është shpjeguar as me anë të hapave proceduralë të ndërmarrë, dhe as me anë të ndonjë nevoje të perceptuar për të pritur rezultatit e çështjes | Administrativ: padi nga personeli i policisë për shtesë të pagave | 7 vjet |

| | | | | |
|--|-------------|---|--|---|
| 63235/00 19 prill 2007 | individuale | Askola, e cila tashmë kishte marrë formën e prerë më datën 7 dhjetor 1994. Gjykata arrin në përfundimin se ka pasur vonesa në procesin përpara Bordit Administrativ të Rrethit, për të cilat nuk ka gjetur shpjegime të mjaftueshme. Prandaj ka pasur shkelje të Nenit 6 § 1 të Konventës lidhur me kohëzgjatjen e procesit. | individuale | 9 vjet e 9 muaj, në tri instanca juridiksioni |
| ARAGUAS V. FRANCÉS 28625/02 9 janar 2007 | individuale | Gjykata ka trajtuar në mjaft raste çështje që ngrenë probleme të ngjashme me ato që dalin në çështjen në fjalë dhe ka konstatuar shkelje të Nenit 6 § 1 të Konventës. Pasi ka shqyrtuar provat në dispozicion të saj, dhe pasi ka shqyrtuar jurisprudencën përkatëse të shtetit, Gjykata konsideron se kohëzgjatja e procesit së kundërshtuar është e tepruar dhe nuk e përmbush kërkesën e "kohës së arsyeshme". | individuale | Administrativ: kërkesa për të lënë mënjane vendimin e inspektoriatit të punës dhe ministrin që autorizonin nxjerrjen e tij nga puna. Proces ndihmës penal: pengimi i ushtrimit të drejtave të sindikatës dhe funksionit të përfaqësuesit të sindikatës, pengim i funksionimit të komisionit të punonjësve |
| SPADARO V. ITALISË 52578/99 20 shtator 2007 | individuale | Gjykatës i kujtohet të ketë shqyrtuar një padi identike me këtë të paditësit dhe të ketë konstatuar shkelje të Nenit 6 § 1 të Konventës (<i>Delle Cave v. Italisë</i> , nr. 14626/03, 5 qershor 2007). Pasi ka shqyrtuar faktet në bazë të informacionit në dispozicion të siguruar nga palët, dhe pasi ka marrë parasysh jurisprudencën përkatëse të shtetit, Gjykata konsideron se, në çështjen në fjalë, kohëzgjatja e procesit së kundërshtuar është e tepruar dhe nuk e përmbush kërkesën e "kohës së arsyeshme". | individuale | 7 vjet në një instancë juridiksioni |
| ROMAN WILCZYŃSKI V. POLONISË 35840/05 17 korrik 2008 | individuale | Gjykatat kombëtare e pranuan që e drejta e paditësit për një seancë të drejtë brenda një periudhe kohore të arsyeshme ishte shkelur, por nuk e shpërbyen atë për ta shlyer këtë shkelje. Pasi ka shqyrtuar të gjitha provat në dispozicion, Gjykata konsideroi se qeveria nuk kishte sjellë ndonjë fakt apo argument që do të kishte çuar në një përfundim të ndryshëm të çështjes në fjalë. Duke pasur parasysh jurisprudencën përkatëse të shtetit, Gjykata konstaton se kohëzgjatja e procesit së kundërshtuar është e tepruar dhe nuk e përmbush kërkesën e "kohës së arsyeshme". | Administrative: Veprim për të përcaktuar pronësinë e një parcele toke | 8 vjet e 3 muaj në një gjykatë |

| | | | | |
|---|---|--|---|--|
| DEDEMAN V. TURQISË 12248/03 16 dhjetor 2008 | Shpifje | Lidhur me mbrojtjen për mospërdorimin e mjeteve ligjore vendore, Gjykata përmend se në sistemin ligjor turk nuk kishte asnjë mjet ligjor të efektshëm në dispozicion të paditësve. Periudha e marrë në konsideratë nga Gjykata – tri vjet në dy instanca juridiksioni – nuk duket veçanërisht aq e gjatë. Megjithatë, Gjykata vë re se çështja e paditësit mbeti e pazgjidhur për dy vjet e pesë muaj në Gjykatën e Kasacionit. Pasi ka shqyrtuar të gjitha provat në dispozicion, Gjykata konsideron se qeveria nuk solli ndonjë fakt apo argument që do të mundësonte vonesën e çështjes si atribut të paditësit. Duke marrë parasysh jurisprudencën përkatëse të shtetit, Gjykata konstaton se kohëzgjatja e procesit është e tepruar në rastin aktual dhe nuk e përmbush kërkesën e “kohës së arsyeshme”. | Shpifje përmes shtypit | 3 vjet në dy instanca juridiksioni |
| CASTRO FERREIRA LEITE V. PORTUGALISË 19881/06 1 dhjetor 2009 | Veprim për të përcaktuar atësinë | Gjykata konsideron se paditësi nuk mund të kritikohet për përdorimin e një morie mjeteve ligjore në dispozicion të tij dhe të mundësive të tjera procedurale që kishte në dispozicion sipas ligjit vendor. Sjellja e paditësit përbën një element objektiv, që nuk i atribuohet shtetit të paditur, që duhet të marrë parasysh përcaktimin nëse ishte tejkaluar koha e arsyeshme, apo jo. Megjithatë, sjellja e paditësit nuk mund të llogaritet si shkak i vonesave që i atribuohen autoriteteve gjyqësore që u panë në proces: në veçanti, kaluan pothuajse katër vjet që nga koha kur u dorëzua veprimi për të përcaktuar atësinë e deri në zhvillimin e seancës, më datën 31 tetor 1997, në Gjykatën Vila Nova de Gaia. Pasi ka marrë në konsideratë të gjitha rrethanat, Gjykata vë re se kohëzgjatja e procesit së kundërshtuar nuk e përmbushi kërkesën e “kohës së arsyeshme”. | Civil: veprim për të përcaktuar atësinë | 12 vjet në tri instanca juridiksioni |
| ARIKAN dhe të tjerët V. TURQISË 43033/02 2 qershor 2009 | Veprim për të lënë mënjandë regjistrimin e 100 hektarëve tokë bujqësore në regjistrat e tokës në emër të palëve të treta dhe ta ri-regjistronte në emrin e saj pas një kontrate mashtruese shitjeje, për të cilën ajo thotë se aludohet të ishte viktimë. | Gjykata vë re se procesi për të cilën ankohen paditësit filloi më datën 15 maj 1968 dhe ende nuk ka përfunduar. Që nga data 28 janar 1987, datë kur Turqia efektivisht njohu të drejtën e peticionit individual, e deri më sot, kanë kaluar pothuajse njëzet e dy vjet, në një instancë juridiksioni, duke kujtuar që deri më atëherë kishin kaluar mbi tetëmbëdhjetë vjet. | Pronë | 22 vjet në një instancë juridiksioni Çështja mbetet ende e pazgjidhur |
| CASTRO FERREIRA LEITE V. PORTUGALISË 19881/06 | Veprim për të përcaktuar atësinë | Ashtu siç është vënë re nga Gjykata në çështjen <i>Costa Ribeiro v. Portugalisë</i> , nr. 54926/00, 30 prill 2003, çështja aktuale nuk paraqiti asnjë kompleksitet të veçantë ligjor apo faktik. | Veprim për të përcaktuar atësinë | 12 vjet në tri instanca juridiksioni |

| | | | | | |
|--|----------------------|---|----------------------------------|--|--|
| 1 dhjetor 2009 | | | | | |
| MYASHEV V. BULLGARISË 43428/02 8 janar 2009 | Asnjë rrezik veçantë | Gjykata ka vënë re tashmë në çështje të tjera të mëparshme kundër Bullgarisë, se në kohën në fjalë, nuk kishte asnjë mjet ligjor në bazë të ligjit vendor që do të mund të përdorej për të përshpejtuar procesin penal ose për të marrë ndonjë kompensim për kohëzgjatjen e tepruar të procesit, dhe ajo konstatoi se rrjedhimisht ishte shkelur Neni 13. Ajo nuk shehasnjë arsye për të arritur në një përfundim të ndryshëm në çështjen në fjalë. Për më tepër, Gjykata konstaton se çështja, që kishte të bënte me pronësinë e paligjshme të një arme, nuk dukej të ishte veçanërisht komplekse. Ajo vë re se procesi mbeti në vend për periudha të gjata kohore (1993-1998, pastaj 1999-2002) pa ndërmarrrjen e ndonjë hapi procedural apo hetimor. | Pronësia e paligjshme e një arme | 10 vjet | |
| KOLA V. GREQISË 1483/07 2 prill 2009 | Asnjë rrezik veçantë | Gjykata nxjerr në pah se vetëm procedura e apelit zgjati pothuajse katër vjet. Ajo vë re, në mënyrë më specifike, se data e seancës përpara panelit të përbërë nga pesë gjyqtarë të gjykatës penale të apelit u caktua rreth dy vjet pas dorëzimit të ankesës. Për më tepër, ndërkohë që kjo gjykatë pranoi dy shtyrje seancash, që u kërkuan në mënyrë pohuese në emër të paditëses, ajo i caktoi datat e seancave shumë larg në të ardhmen: të parën pas dymbëdhjetë muajsh dhe të dytën pas dhjetë muajsh. As natyra serioze e çështjes për të cilën ishte akuzuar paditësi, dhe as dënimi i dhënë në gjykatën e shkallës së parë, nuk mund t'i justifikojë vonesa të tilla. Prandaj, kohëzgjatja e procesit nuk e përmbush kërkesën e "kohës së arsyeshme". | Trafikim paligjshëm droge | 6 vjet e 2 muaj në tri instanca juridiksioni | |

Shtojca 4 bis – Çështjet e natyrës jo-komplekse: mos-shkelja e Nenit 6 § 1

| Çështja | Ç'rrezikonte paditësi | Bazat për vendimin | Lloji i procesit | Kohëzgjatja |
|--|---|---|--|------------------|
| YENIAY V. TURQISË 14802/03 26 qershor 2007 | Ndjekje penale për përdhunim me një rrethanë rënduese | Gjykata penale vendosi ta pezullonte procesin penal në bazë të ligjit mbi ndjekjen penale të zyrtarëve publikë. Megjithatë, vonesa e shkaktuar nga kjo nuk e ka justifikuar kohëzgjatjen e procesit si të tepruar, veçanërisht kur procesi ishte shtyrë vetëm për pesë muaj. Gjykata vë re se nuk mund t'i atribuohet ndonjë vonesë e konsiderueshme autoriteteve kombëtare gjyqësore, të cilat i zhvilluan seancat në mënyrë të rregullt çdo dy-tri muaj. Shtyrjet e seancave u shkaktuan kryesisht nga fakti që paditësi, përfaqësuesi i tij dhe viktima, nuk morën pjesë në disa seanca të caktuara në gjykatat e shkallës së parë e të dytë, pavarësisht fletë-thirrjeve të përsëritura nga gjykatat kombëtare për të marrë pjesë. Megjithatë, gjykata penale konstatoi se do të vazhdohe procesin edhe në mungesë të viktimës "sipas parimit të ekonomizimit të procesit" dhe tregoi korrektesë të veçantë në trajtimin e çështjes. Gjykata nuk konsideron se kohëzgjatja e procesit kundër paditësit ishte e paarsyeshme. | Penal: përdhunim i kryer nga një oficer policie gjatë kryerjes së detyrës Proces ndihmës administrative | 5 vjet e 5 muaj |
| BICAN V. RUMANISË 37338/02 22 shtator 2009 | Rishikimi i vendimit për revokimin e adoptimit | Gjykata vë re se kohëzgjatja e tepruar e procesit i atribuohet sjelljes së paditësit. Shqyrtimi i çështjes u pezullua për shkak të mungesës së paditësit, e pastaj me kërkesën e paditësit, me qëllimin e dorëzimit të ankesave penale dhe dorëzimit të parashtrësave në Ministrinë e Drejtësisë për të ndërmarrë një veprim që vendimi të lihej mënjane nga Prokurori i Përgjithshëm i Rumanisë. Të tria pezullimet shkaktuan një vonesë prej rreth dy vjetësh e katër muajsh, që nuk mund t'i atribuohet autoriteteve gjyqësore, por që mund t'i atribuohet vetë paditësit. | Civie: rishikimi i vendimit për revokimin e adoptimit | 5 vjet e 2 muaj |
| NEVRUZ BOZKURT V. TURQISË 27335/04 1 qershor 2011 | Akuza terrorizmi | Gjykata konsideron se, pas marrjes parasysh të rrethanave të çështjes, kohëzgjatja e procesit, në dy instanca juridiksioni, nuk është e paarsyeshme dhe i referohet shqyrtimit të këtij problemi në çështjen <i>Ayhan İşık v. Turqisë</i> (nr. 33102/04, §§ 23-29) të datës 30 mars 2010. | Terrorizëm | 4 vjet e 10 muaj |